



BOOK OF PROCEEDINGS

SCfSD '24

Scientific Challenges for Sustainable Development

Eleventh International
Scientific Conference
Struga, May 31

www.scfSD.org.mk

ISBN-978-608-4573-50-0

INTERNATIONAL UNIVERSITY OF STRUGA

**Institute for European Studies and International Politics
"Luan Hajdaraga"**

ISBN 978-608-4573-50-0



Lodz University
of Technology



INTERNATIONAL
UNIVERSITY OF STRUGA



KOLEGJI
UNIVERSITAR I BIZNESIT



BOOK OF PROCEEDINGS

11th International Conference

“Scientific Challenges for Sustainable Development”-
SCfSD ‘24

CHAIRMAN OF THE CONFERENCE

Prof. Dr. Sejfulla Osmani

Rector of International University of Struga

Prof. Dr. Krzysztof Józwik

Rector of Lodz University of Technology

Prof. Dr. Ylber Bezo

University College of Business

SCIENTIFIC COMMITTEE

Prof. Dr. Armen Kadriu – International University of Struga

Prof. Dr. Biljana Ciglovska – International University of Struga

Prof. Dr. Ljupco Stojceski - International University of Struga

Prof Dr. Edit Bregu - University College of Business

Prof. Dr. Mersim Maksuti - International University of Struga

Prof. Dr. Gëzim Selimi - International University of Struga

Prof Dr. Shp;tim Cami – International University of Struga

Prof. Dr Luciano Boci - International University of Struga

Prof. Dr. Nazmije Merko Zabzun– International University of Struga

Prof. Dr. Emin Huseini - International University of Struga

Prof. Dr. Dashmir Nasufi - International University of Struga

Prof. Dr. Ali Musliu - International University of Struga

Prof. Dr. Ruzhdi Matoshi - International University of Struga

Prof. Dr. Elijor Vila - International University of Struga

Prof. Dr. Małgorzata Szykowska-Józwik - Lodz University of
Technology

Prof. Ass. Dr. Agnieszka Czyłkowska - Lodz University of Technology

Prof. Dr. Paweł Strumiłło - Lodz University of Technology

Prof. Dr. Festim Halili - Fund for Innovation and Technological
Development

Prof. Dr. Elez Osmani - Institute for Scientific Research and Development
- Ulqin

Prof. Dr. Fatmir Memaj - University of Tirana

Prof. Asoc. Dr. Skerdian Kurti - University of Tirana

Prof.Dr. Skender Topi- “Aleksander Xhuvani” University – Elbasan
Prof. Ass. Dr. Imelda Sejdini - “Aleksander Xhuvani” University –
Elbasan

Prof. Dr. Roland Zisi - “Ismail Qemali” University - Vlora
Prof. Ass. Dr. Besnik Hajdari - University “Isa Boletini” Mitrovica

ORGANIZING COMMITTEE

Doc. Dr. Guximtar Rushani- International University of Struga
Eng. Dominik Leżański - Lodz University of Technology
Doc. Dr. Senada Laçka– International University of Struga
Doc.Dr. Driton Haruni - International University of Struga
MSc. Semra Bujari – International University of Struga
MSc. Abidin Trena – International University of Struga
MSc. Lirinda Vako – International University of Struga
Dr. Fatos Gjata - “Aleksander Xhuvani” University – Elbasan

CONFERENCE SECRETARIAT

MSc. Djellza Lena – International University of Struga
MSc. Eriona Dauti– International University of Struga

TABLE OF CONTENTS

| | |
|--|-----|
| ÇËSHËTJA ÇAME NË KËNDVËSHTRIMIN HISTORIK, JURIDIK DHE POLITIK. ZGJIDHJA E MUNDSHME E SAJ | 11 |
| Endri Fejzullah | 11 |
| DETYRIMET ETIKE TË AVOKATËVE SIPAS AKTEVE NDËRKOMBËTARE, KODEKSIT TË ETIKËS DHE KORNIZËS JURIDIKE NË MAQEDONINË E VERIUT | 48 |
| Doc. Dr. Rudina Kaja | 48 |
| Doc.Dr.Senada Laçka | 48 |
| ANALYTICAL REVIEW OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE'S INFLUENCE ON THE BUSINESS SECTOR: APPLICATIONS, TRENDS, LIMITATIONS AND CHALLENGES | 62 |
| Dr. Fatmira PRODANI | 62 |
| PhD. Candidate Lirinda VAKO ABEDINI | 62 |
| Prof.Dr. Armen KADRIU | 62 |
| THE CHALLENGES OF INTEGRATING STUDENTS WITH DOWN SYNDROME | 78 |
| Ph. D cand. Miranda Lushaj Shala | 78 |
| GJEOGRAFIA E SHKALLEZIMIT ELEKTORAL SOCIALE-EKONOMIKE NE VERI – JUG TE SHQIPERISE, SI DHE PARAQITJA E INTEGRIMIT NE ORGANIZIMIN POLITIKO-KULTUROR. | 90 |
| <i>Adeljana Shehaj</i> | 90 |
| THE REVEALED COMPARATIVE ADVANTAGE OF WESTERN BALKAN COUNTRIES AND TURKEY EXPORTS TO EU MARKET | 97 |
| Dr.Agim NDREGJONI | 97 |
| KARAKTERISTIKAT E POLITIKËS AFARISTE TË BANKAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT | 108 |
| Phd.Cand. Semra Bujari | 108 |
| Phd.Cand. Drenushe Merko-Iljazi | 108 |

| | |
|--|-----|
| УЛОГАТА НА МЕНАЏЕРОТ ВО ГРАДЕЊЕТО НА МОДЕРНО УЧИЛИШТЕ | 118 |
| Д-р Снежана Петреска | |
| THE NEW TRENDS IN INTERNATIONAL TRADE IN THE WORLD | 136 |
| Biljana Ciglovska Bojchevska, | 136 |
| Drenushe Merko Iljazi | 136 |
| E DREJTA E LUFTËS | 150 |
| DISKRIMINIMI GJINOR NË MARRËDHËNIET E PUNËS | 162 |
| PhD Candidate Ardijsana Stafai | 162 |
| PhD Candidate Ardijsan Stafai | 162 |
| Inordinar Prof.D-r. Argëtim Saliu | 162 |
| ARSIMI NË FILLIM TË SHEK. XXI DHE ROLI I MËSUESIT | 171 |
| Doc. dr. Albana Hodaj | 171 |
| MARRJA NË PYETJE E TË DYSHUARIT NGA ANA E POLICISË | 185 |
| Prof. Dr. Emin Huseini | 185 |
| THE ELECTORAL SYSTEM OF THE PRESIDENT IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA-THE LATEST | 198 |
| <i>PHD CAND. MR.FAHRI BAJGORA</i> | 198 |
| General assesements | 216 |
| PARAQITJA E SHTETIT | 219 |
| <i>PHD CAND. MR.FAHRI BAJGORA</i> | 219 |
| POZITA JURIDIKE E FEMIJËVE JASHTËMARTESORË | 234 |
| Doc.Dr Rudina Kaja | 234 |
| DALLIMI MIDIS KONTRATËS SË RENTËS JETORE DHE KONTRATAVE TË TJERA | 257 |

| | |
|--|-----|
| MSc. Endi Kalemaj | 257 |
| THE IMPACT OF THE RECAPITALIZATION OF THE GREEK BANKING SECTOR IN THE REAL ECONOMY. | 270 |
| PhD. EMILJAN MUSTAQE | 270 |
| THE CIRCULAR ECONOMY AND REGULATORY FRAMEWORKS IN ALBANIA | 279 |
| MSc. Besmira Botusha | 279 |
| MSc. Monika Kolleshi | 279 |
| REVIEW OF CYBERSECURITY RISKS IN UNIVERSITIES | 295 |
| <i>Dr. Eda Tabaku</i> | 295 |
| COMPARATIVE ANALYSIS OF OBSERVED AND REANALYZED PRECIPITATION FROM SATELLITE PRODUCTS | 305 |
| MSc. PhD (c). Gazmir ÇELA, | 305 |
| *MSc. Ing. Elsuida HOXHA, | 305 |
| *Prof. Dr. Petrit ZORBA, | 305 |
| NACIONALIZMI DHE KEQINTERPRETIMET E TIJ DHE SFIDAT E NACIONALIZMIT NË SHOQËRI | 315 |
| PhD. Cand. Ibrahim Ceka | 315 |
| MSc. Selam Ceka | 315 |
| SIGURIA E INFORMACIONIT | 328 |
| Denisa Hani | 328 |
| SIGURIA E TË DHËNAVE NË INSTITUCIONET FINANCIARE | 336 |
| Viola Beqo | 336 |
| DATA PROCESSING OF MONTHLY PRECIPITATION AND RELATED ERRORS IMPACT ON SPI FINAL OUTPUTS | 354 |

| | |
|---|------------|
| Petrit Zorba | 354 |
| Elsuida Hoxha | 354 |
| DELIKUENCA E TË MITURVE DHE TRAJTIMI PENAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË | 372 |
| Klejvis Hoxha | 372 |
| VËSHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE ATIJ KOSOVAR NË FUSHËN E EKZEKUTIMIT TË DETYRUESHËM TË VENDIMEVE GJYQËSORE. | 393 |
| Esmeralda Rama (Dregjoni) | 393 |
| Hygerta Istrefi | 393 |
| IMPLEMENTIMI I NJË CHATBOT-I PËR VETË-DIAGNOSTIKIM TË SËMUNDJEVE DUKE PËRDORUR AI DHE NLP | 443 |
| Dr. Fatmira PRODANI | 443 |
| PhD. Candidate Lirinda VAKO ABEDINI | 443 |
| NDIKIMI I KURSIT TË KËMBIMIT VALUTOR NË EKONOMINË SHQIPTARE NË VITIN 2023 DHE 2024 | 458 |
| Doc.Dr.Gazmend Beshi, | 458 |
| CREATING PERSONALIZED LEARNER PROFILES IN E-LEARNING ENVIRONMENT USING AI TECHNIQUEA: A COMPARATIVE ANALYSIS | 468 |
| Dr. Frida Gjermani | 468 |
| MSc. Uendi Cerma | 468 |
| THE ROLE OF SOCIAL MARKETING IN ACHIEVING THE SUSTAINABLE DEVELOPMENT | 476 |
| Assoc. Prof. Dr.sc Lidija Risteska | 476 |

ÇËSHËTJA ÇAME NË KËNDVËSHTRIMIN HISTORIK, JURIDIK DHE POLITIK. ZGJIDHJA E MUNDSHME E SAJ

Endri Fejzullah

e.fejzullah19@eust.edu.mk

Abstrakt

Çështja çame është një ndër çështjet e cila haset shpesh në përditshmëri me perceptimin sipërfaqësor si “dëbimi i çamëve nga Greqia”, mirëpo nuk është vetem kjo. Ndërlidhshmëria historike dhe perceptimet e saj që i bëjnë dy vendet tona, janë të ndjeshme në marrëdhëniet midis dy vendeve aq sa tregon klimën e tensionuar që mbartin në vetëvete këto çështje. Çamëria nuk është thjesht e vetëm ushtrimi i një genocidi ndaj popullsisë muslimane shqiptare, por është edhe më shumë se kaq, është çështja e dinjitetit njerëzor, diskriminimit, akteve genocidiale, ligjet të cilat nuk janë në shërbim të të ashtuquajturit “shtet i së drejtës”, është çështja e pronave të “grabitura” ose të “shpronësuara” kundrejt 0 vlerëve të dëmshpërblyer, është çështja e shfrytëzimit të këtyre pronave për plot 8 dekada. Këtu nuk flitet vetëm për pronat e çamëve, por edhe për pronat e shtetit shqiptar, shtetasve shqiptarë të kohës si edhe pronat e komunitetit bektashi. Problemi çam filloj që kur Greqisë iu dhanë territoret shqiptare në jug pas vitit 1913, një ndër këto territore ishte edhe Çamëria. Popullsia në këtë zonë ishte shqiptare, kryesisht e fesë islame. Problemet u shtuan kur pas vitit 1923 në nënshkrimin e Traktatit të Lozanës midis Greqisë dhe Turqisë u ra dakord për shkëmbimin e popullsisë, shkëmbim ky të cilin Greqia e cilësoj me vend të realizonte pritjen e këtyre refugjatëve në zonat shqipfolëse, duke miratuar ligje, dekretligje e vendime për shpronësimin e pronave të çamëve. Tensionet midis Shqipërisë dhe Greqisë për mosrespektim të të drejtave të njeriut refelekttoheshin në marrëdhëniet dypalëshe, por edhe në Lidhjen e Kombeve. Ardhja e refugjatëve sipas marrëveshjes së Lozanës bëri që çamet të shpronësoheshin duke patur të drejta që buronin nga Traktati dhe ligjet vendase, por të mos merrnin asnjë para të deklaruar. Burokracitë e shtetit grek, reformat e mëvonshme agrare, reformat territoriale, pushtimi i Greqisë nga Italia nëpërmjet Shqipërisë, lënia e krahinës së Çamërisë si para ashtu edhe gjatë L.II.B, nën mëshirë dhe pa asnjë investim konkret, si dhe mosmarrëveshjet e mbartura e të akumuluar nga e shkuara si

pasojë e shpronësimeve të padrejta e pa iu dhënë asnjë qindarkë pronarëve çam, bëri të mundur një klim tejet jashtë kontrollit në zonën e Çamërisë. Në fund të L.II.B, forcat nacionaliste greke EDES të kryesuara nga gjenerali Napoleon Zerva kryejnë masakra të cilat i detyruan shqiptarët e Çamërisë të strehoheshin në trungun mëmë, Shqipëri. Masakrat e kryera nuk mohohen as nga autorë dhe historian , mirëpo ata mundohen që t'i japin një përkufizim terminologjik më të butë ngjarjeve duke i konsideruar si spastrim etnik. Shteti shqiptar e ka njohur datën 27 qershor 1944 si datën e genocidit shovinist grek kundrejt shqiptarëve të Çamërisë. Në rrugë zyrtare çështja çame është pjesë e shportës diplomatike të shtetit shqiptarë , megjithëse për Greqinë kjo çështje është mbyllur dhe nuk ekziston.

Fjale kyçe: *_Cameri, Gjenocid, Ligji i Luftes, Traktat*

Çamëria, pikëpamja e përgjithshme historike dhe pushtimi italian

Në vitin 1912 , Shqipëria pas disa kryengritjeve, arrin të organizohet duke hedhur poshtë pretendimet për autonomi dhe duke kërkuar pavarësinë nga Perandoria Osmane. Shqipëria arrin të shpallet e pavarur më 28 nëntor 1912. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë me një hapësirë gjeografike për t'u admiruar nga fqinjët, u bë objekt diskutimi në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës. Në vitin 1913 Shqipëria copëtohet dhe më shumë se gjysma e territoreve ngelën jashtë Shqipërisë së kohës. Pikërisht këtu merr zanafillën edhe problemi çam. Çamëria është një rajon në veri-perëndim të Greqisë, term i cili përdoret për të identifikuar banorët e kohës dhe pasardhësit e sotëm, të cilët sot jetojnë në Shqipëri e gjetkë. Greqia që nga koha e "Megalaidësë" kishte pikëpamje mbi një Greqi kombëtarisht dhe fetarisht të pastër , e cila nënkuptonte një Greqi të përbërë vetëm nga komuniteti ortodoks. Për Greqinë e kohës, çdo musliman ishte turk, duke i perifrashuar në këtë mënyrë edhe çamët musliman , të cilët ishin shqiptar. Perplasjet midis shqiptarëve të Çamërisë dhe nacionalistëve grek fillon me disa momente kyç të historisë. Në vitin 1913 theren në mënyrë të pabesë 72 krrerët e Çamërisë , në përroin e Selanit. Në vitin 1923 pas traktati të Lozanës , Greqia dhe Turqia nisnin shkëmbimin e popullsisë e cila parashikonte ardhjen e ortodoksve nga Azia e Vogël në Greqi dhe dërgimin e muslimaneve nga Greqia në Turqi. Muslimanët e Çamërisë protestuan dhe në përçarjet e tyre drejtuar Lidhjes së Kombeve kërkuan për shkak të lidhjes historike e tradicionale me zonën, kërkuan

të trajtoheshin si grek me fëmijët , çështje të cilën e fituan dhe arritën të ndalnin përfundimisht zbrazjen e zonës nga banoret autokton. Në vitin 1944-1945 forcat nacionaliste greke EDES me në krye gjeneralin Napoleon Zervas, kryen një operacion i cili konkludoi në dëbimin e afro 30.000 çamëve drejt Shqipërisë, djegien e 5800 shtëpive dhe 102 xhamive. Vrasjen e 2971 civilëve të pafajshëm si dhe vdekjen e rreth 3 mijë çamëve të tjerë rrugës për në Shqipëri në fshatin e quajtur Kllogjer , në afërsi të Konispolit. Më vonë në Janinë do të mbahej i ashtuquajtur i Gjyqi i Janinës i cili dënoj në mungesë 1900 çam si bashkëpunëtor të nazizmit. Në dënimin e këtyre individëve , kishte individ të cilët u shpallën fajtor dhe u dënuan me vdekje , disa me burgim të përjetshëm, ndërsa të gjithë këtyre shtetasve iu sekuestrua prona. Ky fakt në vijim do të studiohet në këndvështrimin grek i cili e cilëson si dënimin e bashkëpunotereve të nazizmit , këndvështrimin e shtetit shqiptar i cili e konsideron si " Genocid" dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Në këtë kuptim çështja çame është një çështje pronësore e pazgjidhur deri më sot.

A kanë bashkëpunuar çamët me nazi-fashizmin dhe a kanë kryer ata krime ndaj popullsisë vendase ? Po e vërteta e Ligjit të Luftës? A është kryer genocid ndaj çamëve musliman? A ka zgjidhje e ashtuquajtura çështja çame?

Pushtimi italian i Shqipërisë

Më 7 prill 1939 Italia fashiste ndërhyri ushtarakisht në Mbretërinë Shqiptare duke dërguar një ushtri të përbërë prej 22.000 ushtarë , 400 avion , 300 tanke të lehtë dhe 12 anije luftarë¹. Ushtria shqiptare në përgjithësi nuk bëri rezistencë , mirëpo luftimet e ashpra në Durrës nga xhandarmëria shqiptare, sollën 200 ushtarë italian të vrarë , por nuk e ndaluan dot ushtrinë italiane të merrte kontrollin e Shqipërisë. Pas kësaj Italia u mundua t'i jepte një "mbulesë" ligjore ndërhyrjes së saj ushtarake duke krijuar një Komitet Administrues i cili thirri Asamblenë e Përgjithshme të përbërë nga 100 anëtar ku kishte edhe deputet të vjetër të kohës të cilët vendosën t'i dorëzonin kurorën mbretërore Vittorio Emanuele të III-të në formën e një Bashkimi Personal. Por çfarë është Bashkimi Personal? Bashkimi Personal është bashkësi e dy ose me shumë shteteve të cilat i lidh vetëm monarku dhe krijohet kur përputhen rendet e trashëgimisë dhe kur një shtet zgjedh për mbret një mbret të një shteti tjetër. Në këtë këndvështrim Shqipëria ka bërë një Bashkim Personal me Italinë.

¹ "Lufta e fundit, pronat e shqiptareve ne Greqi" Mentor Nazarko

Pushtimi italian i Greqisë

Italia , pavarësisht marrëdhënieve të mira me Greqinë ajo duke e quajtur veten tashmë si pjesë e nje Bashkimi Personal me Shqipërinë, kërkonte të mbronte të drejtat e shqiptarëve të Çamërisë që sipas saj ishin shkelur vazhdimisht nga një regjim autokrat grek. Italia shpesh predikonte bashkimin e Çamërisë me Shqipërinë , saqë u përpoq të krijonte edhe një parti fashiste në Thesproti. Duke u nisur nga kjo situatë në qershor të vitit 1940 në Konispol vritet nga persona të armatosur irredentisti çam Daut Hoxha. Ai kishte qenë në kërkim nga qeveria greke prej 20 vjetësh , e cila kishte vënë edhe një shumë të majme për “kokën” e tij². Ky ishte dhe preteksti për të cilin Jakomoni (mëkëmbësi i Mbretit në Shqipëri) e ktheu në një çështje diplomatike duke ia faturuar Greqisë vrasjen e një atdhetari të shquar shqiptar çam. Me urdhër të Musolinit ushtria italiane , në përbërjen e së cilës kishte edhe dy brigada të ushtrisë shqiptare , ndërhyr ushtarakisht për të pushtuar Greqinë me pretekstin se Greqia nuk e kishte mbajtur neutralitetin. Ushtria Italiane propagandoi se “çlirimi i vëllezërve çam ” nga barbaritë greke po shkonte drejt rruges së duhur . Në nëntor të vitit 1940 disa ditë pas pushtimit të Greqisë , ushtria italiane filloj bastisjen e shtëpive në zonën e Çamërisë e cila arrestoj edhe çamet të cilët nuk pranonin të ndërmerinin aksione kundër Greqisë. Në përgjithësi çamët mbajtën qëndrim neutral. Këtu fillon tashmë edhe problemi ndërkombetarë ...të cilin do e shohim në vijimësi

Situata në Çamëri gjatë Luftës së Dytë Botërore

Gjatë kësaj periudhe, ashtu siç ka ndodhur gjatë 4 dekadave, shqiptarët e Çamërisë ishin përballur me reprezalje të xhandarmërisë greke, me ligje të ashpra siç ishin ligjet agrare që shkaktonin shpronësime tek çamët musliman , pa kurrëfare dëmshpërblimi , duke grabitur pronat e tyre , si dhe ligji i reformës territoriale mbi të cilin kushtëzohej përfaqësia e çamëve në parlamentin grek , bëri të mundur agravimin e situatës në Çamëri. Me pushtimin italian, çamët nacionalist si Nuri Dino i varën shpresat tek Italia për çlirimin nga terrori grek. Në këto kohë shqiptarët mundohen të hapin nëpër fshatrat e Çamërisë shkolla shqipe si dhe krijohen organe vetëadministruese të rendit dhe qetësisë publike nga vëllezërit Nuri dhe Mazar Dino. Disa pronarë shqiptarë të mbeshtetur edhe nga italianët , u përpoqen të rimerrnin pronat e tyre të cilëve u ishin zaptuar nëpërmjet ligjeve

² Ceshnja came gjate Luftes se Dyte Boterore” Lorenc Agalliu

agrarë prej të cilave edhe nuk ishin shpronësuar. Të gjitha keto sollën konflikte mes grekëve dhe shqiptarëve³. Sipas autoriteteve greke të kohës, dhuna e ushtruar ishte faktore nxitës i vrasjeve në Çamëri, mirëpo kjo në fakt rrëzohet me kundërgargumentin se këto përpjekje bëheshin si pasojë e shpronësimeve të padrejta të grekëve ndaj çamëve musliman dhe dhënien e këtyre pronave, subjekteve fizik grek. Le të shohim disa shembuj të konflikteve greko-çame në këtë periudhë. Në qoftë se do të shohim intervistat si dhe botimet e autorit grek Jorgos Margaritis do të shohim se në zonën e Çamërisë ka patur konflikte të vazhdueshme midis çamëve dhe grekëve.

1-Disa çam gjatë kësaj periudhe rrahën për vdekje Prokop Janaqisin i cili disa vite më parë kishte vrarë një çam musliman.

2-Vangjelis Grekos është një tjetër grek i cili u vra për gjakmarrje pasi disa kohe më parë kishte vrarë të birin e një çami musliman⁴.

3-Një xhandar grek, pas një zënke midis Spiros Vanagulis dhe një çami musliman, shkon në shtëpinë e këtij të fundit duke e ekzekutuar.

4-Në 12 janar 1942, vriten Tefik Qemali dhe Jahja Kasëmi, dy çamë me influencë në zonën e Çamërisë. Këto vrasje sollën një reagim të fortë në popullsinë vendase ku rreth një muaj më vonë në shenjë hakmarrjeje, çamët musliman ekzekutuan Prefektin e Gumenicës Jorgos Vasiliakos i cili akuzohej si përgjegjësi kryesor i vuajtjeve çame⁵.

5-Nga ana tjetër organet lokale greke dhe Prefekti Kostandinis, përpiqet për të qetësuar situatën mes muslimanëve dhe të krishterëve duke kryer disa takime, madje edhe me autoritetet italiane që ndodheshin në zonë, për t'i kërkuar krijimin e organeve mikse, në mënyrë që të arrihet një zgjidhje e përkohshme dhe një paqe midis tyre në këtë situatë të komplikuar. Paqja arrihet, mirëpo kjo nuk do të zgjaste shumë dhe do të prishej nga të krishterët grekë, të cilët vrasin në Parga Jasin Sadikun, një ndër personat më me influencë në zonën e Çamërisë. Kjo solli një revoltë tek muslimanët çam, të cilët edhe për shkak të situatave, reprezaljeve si dhe rehabilitimit të të krishterëve gjatë këtyre viteve në pronat e tyre, fajësonin për çdo gjë organet shtetërore greke. Kjo vrasje solli edhe njëherë klimën e tensionuar në Çamëri. Ky fakt i prishjes së paqes midis dy komuniteteve raportohet edhe nga Prefekti i Thesprotisë K.Kostandinis, i cili tregon hollësitë

³ Po aty, fq 148

⁴ Jorgos Margaritis “ Nga humbja në revolte. Greqi pranverë 1941- vjeshtë 1942”

⁵ “Ceshtja çame gjatë Luftës së Dytë Botërore” fq 150, 151, 152

dhe detajet në një letër të dërguar më 14 dhjetor 1942, Komandës së Përgjithshme të Epirit në Janinë⁶. Duke parë këto situata, shteti grek shpesh i akuzon çamët në disa raste si grup individesh të cilët kryen krime në popullsinë greke dhe shpesh si bashkëpunëtor të nazizmit. Këto krime e në veçanti ajo e vrasjes së prefektit të Gumenicës iu fatura Këshillit Nacional Çam i kryesuar nga Nuri Dino. Paradoksi dhe mosjustifikimi i burimit real të konfliktit është pikërisht një justifikim më tepër. Këshilli Nacional Çam është krijuar në mesin e vitit 1942, ndërkohë që vrasja e prefektit të Gumenicës u krye në shkurt të 1942. Ky është një argument i cili bie nga faktet historike. Në fakt për akuzën e parë e cila i trajtonte çamët si grup individësh që kryen krime në popullsinë vendase, duke parë edhe rastet e mësipërme të krimeve në Çamëri, konstaton në një fakt të pakundërshtueshëm. Krimeve të mësipërme nuk mund t'u vihen karakter politik, kur në fakt ishin vrasje të karakterit personal dhe hakmarrës. Ato nuk mund të trajtohen si krime për shkak të fesë apo etnisë, kur duket qartë që janë krime të kryera për shkak të gjakmarrjes dhe të nderzura e të përkrahura nga një retorik urryese e përçarëse nga xhandarmëria greke. Kjo tregon qartazi se burim i këtij konflikti midis komuniteteve fetare dhe etnike ishte reforma agrare e cila u "rrëmbente" pronat duke mos i shpronësuar në vlerën e tyre, pronat e shqiptarëve çam musliman. Ky është një fakt i cili pavarësisht çdo gjëje nuk mund të mohohet e nuk mund të tjetërsohet për qëllime politike e për t'i vënë një mbulesë mohuese krimeve që do të pasonin në vitet në vijim kundrejt popullsisë civile.

Rezistenca antifashiste çame

Që në fillim të vitit 1942 Musa Demi filloj organizimin e lëvizjes antifashiste çame e cila jo vetëm që do t'i shërbente çështjes kombëtare, por edhe do të pozicionoheshin në anën e duhur të historisë. Në fund të vitit 1942 çamët musliman dhe komuniteti ortodoks formuan çetën e parë të armatosur si pjesë e ushtrisë së ELAS-it (ELAS ishte ideologjia komuniste, kundërshtarja politike dhe ideologjike e forcave nacionaliste greke EDES). Udhëheqësit kryesor të kësaj çete ishin Musa Demi, Prokop Shqevi, Njazi Demi, Kasëm Demi, Mustafa Sulo, Dervish Dojaka, Muharrem Demi, Braho Karasani, Sami Alushi, Tahir Demi, Vehip Huso, Jani Konti, Vangjel Dhupi etj. Organizimi antifashist çam krijoi organet e veta (Këshillat Nacional-Çlirimtar) në zonat rreth Filatit fshatit Koqinisht dhe zonave të Konispolit (fshat çam në brendësi të territorit shqiptar). Ndër të tjera në 2 shkurt 1943 u krijua çeta "Çamëria" e përbërë prej 40-50

⁶ Raporti nr. protokollit 17 I Prefektit Kostandinis date 14 dhjetor 1942

luftetarëve çam me në krye Haki Rrushitin. Kjo çetë shumë shpejtë u shndërrua në një batalion i cili në gjirin e vetë kishte 300 luftëtar si Taho Sejko, Haki Rrushiti, Lefter Talo etj. Ky batalion mbahet mend për rezistencën e tij ndaj ushtrisë gjermane, ku Gjermania naziste nuk arriti t'a sulmonte Greqinë nga territoret çame, kjo falë batalionit "Çamëria". Por a kanë bashkëpunuar çamët me nazistët gjerman? Pyetje e cila ka trazuar jo vetëm skenën politike të dy vendeve, ka perplasur mendimet e autorëve të të dyja vendeve, por mbi të gjitha këto diskutime janë ngritur mbi varret e viktimave të pafajshme të cilët ende sot nuk kanë një vendprehje.

Megjithëse për t'a analizuar më tej kur drejtohet kjo pyetje është e pamundur të përgjigjesh me "po" ose "jo".

Çamët, Zerva, gjermanët dhe genocidi

Në pranverën e vitit 1943 krijohet Balli Kombëtar Çam (BKÇ) e kryesuar prej vëllezërve Dino, e kryesisht të Nuri Dinos. Kjo lëvizje e nacionalistëve çam kishte disa nga argumentat të cilët çamët dhe çetat e Nuri Dinos kishin pakënaqësi me forcat greke të cilat kishin shtypur popullsinë vendase dhe me reformat agrare si dhe me ligjet mbi shpronësimet, pas Marrëveshjes së Lozanës Turqi-Greqi, sillnin pakënaqësi në shpronësimet e çamëve të cilat cilësoheshin si të pabazuara në vlerën reale dhe një grabitje nga ana e shtetit. Dhuna, shtypja, terrori, detyroj vëllezërit Dino dhe përkrahës të tyre të krijojnë dhe të lobojnë tek gjermanët për krijimin e administratës lokale të udhëhequra nga çamët dhe çetat e Nuri Dinos si dhe bashkimin e Çamërisë me Shqipërinë. Gjermanët ashtu si dhe italianët duke parë situatën në Çamëri propogandonin se ata dëshirojnë të ishin shpëtimi i popullsisë shqiptare dhe se bashkimi i Çamërisë me Shqipërinë do të ishte thjesht çështje kohe. Kjo i la dorë që nacionalistët çam të kryesuar nga Nuri Dino, të kërkonin mbështetje tek shqiptarët e Çamërisë, për t'iu bashkuar çettave të Nuri Dinos. Ndërkohë forcat gjermane si pasojë e mosbindjes së popullsisë çame për t'iu bashkuar në luftë ndaj forcave greke, solli arrestimin e disa krerëve të fshatrave të Çamërisë të cilët dëshironin neutralitetin në këtë konflikt ndaj dy pushtuesve, atyre grek dhe atyre gjerman. U arrestuan Isuf Izeti nga Varfanji, Sako Braho nga Spatari, Qazim Rexhepi, Galip Rexhepi etj⁷. Nga të gjitha të dhënat historike, por edhe në raport me numrat e çetave të Nuri Dinos, mund të nxjerrim konkluzionin se shqiptarët çam e refuzuan në shumicën dërrmuese bashkëpunimin

⁷ Fq. 201 "Çështja çame gjatë Luftës së Dytë Botërore"

me gjermanin Në qëndrimet e sotme zyrtare të shtetit grek, ata iu referohen çetave të Nuri Dinos duke potencuar të gjithë popullsinë si bashkëpunëtore me nazistët, ndërkohë që kjo është në kundërshtim me çdo vlerë morale, por edhe me konventat ndërkombëtare të cilat theksojnë se nuk mund të ketë dënime kolektive për fajë individuale. Nga ana tjetër siç e kemi theksuar më lartë, kemi shumë shqiptar çam të cilët krijuan Batalionin "Çamëria", por edhe shumë të tjerë afro 1 mijë djem dhe vajza të cilët iu bashkuan forcave greke të EAM/ELAS-it , te cilët luftuan nazi-fashizmin, duke na dhënë fakte për pjeën dërrmuese të popullsisë çame e cila luftoj pushtuesin e përbashkët. Nëse sot, historia do të tregohet e padrejtë dhe qellimet e drejta të Nuri Dinos i cili kërkoj ndihmen gjermane për te shpëtuar nga masakrat dhjetra vjeçare greke, quhet kolaboracionist , çfarë mund të thuhet për Napoleon Zervën? Në bazë të të dhënave historike edhe të hisotianeve grek si Jorgos Margaritis, vetë Zerva, bashkëpunoj hapur me gjermanët në një paralelizëm së bashku me Nuri Dinon. Vetë qeveria greke dhe Kryeministri Rallis (i cili ishte një kryeministër kuisling) i kërkoj Noibaherit që këshillat shqiptar të themeluar per administrim lokal nga vëllezërit Dino, të pushonin së ekzistuari duke mos lejuar ushtrimin e veprimatrive luftarake të këtyre këshillave lokal⁸ . Kjo ishte një strategji e gjermanëve të cilët luftën më të madhe e kishin me forcat komuniste greke të EAM-it dhe për këtë arsye mundoheshin të mbanin një balancë ekuivalente midis forcave të Nuri Dinos dhe forcave nacionaliste EDES të udhëhequra nga Napoleon Zervas. Gjermanët dhe Zervas falë relatave të mira midis tyre patën një bashkëpunim të ngusht me njeri-tjetrin, duke luftuar së bashku kundër partizanëve grek. Kjo marrëdhënie midis Zervës dhe gjermanëve ishte një marrëdhënie simbiotike mes tyre, pasi forcat nacionaliste greke EDES, me në krye Zervën, duke i dhënë ndihmë ushtarake kundrejt EAM-it, do të mund të kishin një fitim të dyfishtë, edhe duke eliminuar kundërshtarët e tyre ideologjik për marrjen e pushtetit në Greqi , por edhe duke marrë nga gjermanët mbështetjen për administrimin e zonës së Çamërisë. Zerva ia doli, pasi gjermanët edhe falë këmbënguljes së qeverisë dhe kryeministrit Rallis, krijuan një situatë te pazakontë në Çamëri , duke mos ndërprerë aktivitetin e këshillave shqiptar, por duke i lënë dorë të lirë edhe EDES-it në Çamëri, e cila do të sillte një përshkallëzim të situatës .

Tashmë për t'iu përgjigjur pyetjes se a kanë bashkëpunuar shqiptarët çam me nazi-fashizmin, fare qartë mund të themi se :

1. Shqiptarët musliman çam, nuk bashkëpunuan me nazistët

⁸ Kotini "Cameria denoncon" fq.173

2. Ata në pjesën dërrmuese të tyre , mbajtën një qëndrim neutral

3. Nga ana tjetër luftëtar çam të cilët luftuan nazi-fashizmin duke u rreshtuar krah ELAS-it si dhe duke formuar batalione mikese , apo edhe Batalionin "Çamëria", ishin të konsiderueshëm në numër , duke marrë për bazë përpjestimin e tyre në raport me popullsinë e përgjithshme të Thesprotisë

4. Reprezaljet, arrestimet, grabitjet e ushtarëve gjerman tek banorët çam, të cilët nuk bindeshin për të luftuar kundër grekëve është një shenj e qartë se nëse ata do të ishin bashkëpunëtor tek gjermanët , gjermanët nuk mund të merrnin akte makabre, reprezaljesh grabitjesh apo arrestimesh tek "bashkëpunëtorët" e tyre. Kjo ishte një formë terrori gjerman për të hedhur popullsinë çame në luftën kundër grekëve,por e cila rezultoj e pasuksesshme.

5. Si është e mundur të hidhet poshtë qëndresa antifashiste çame, vetëm se disa prej tyre(ashtu siç pati kudo në botë) bashkëpunoj me gjermanin , ndërkohë që ata nuk përfaqësonin vullnetin e popullsisë e cila dha kontributet e veta kundër pushtuesit global? Me këtë logjik i bie që falë bashkëpunimit te forcave EDES dhe të Zervës të quhet i gjithë populli grek kolaboracionist.

6. Vetë Napoleon Zerva, EDES, Kryeministri Rallis, kolonel Kranjai , bashkëpunuan hapur me gjermanin dhe ky është një fakt i cili është vërtetuar edhe nga SHBA, të cilët detyruan Napoleon Zervën rreth viteve 1950 të jepte dorëheqjen si ministër ne qeverinë greke si pasoj e bashkëpunimit te tij me gjermanët ne kohën e luftës, duke qenë kështu një kolaboracionist.

7. Po, disa çam të shtypur , të masakruar , të cilëve nuk u lejohej arsimimi në gjuhën kombëtare , në një bashkëjetesë afro 30 vjeçare me Greqinë, pas grabitjes së pronave , pas sjelljes së ortodoksve nga Azia e Vogël në zonën e Çamërisë, pas shpërnguljeve të padrejta (të cilat do t'i shohim ne kapitullin tjetër) të pronave *me Reformen Agrare, me Ligjin Detyruës 735/8/15 qershor 1937 "Mbi muslimanët të quajtur me origjinë shqiptare dhe mbi dhënien atyreve të pronave te rivendikuara "* (Fletore Zyrtare 228/1937)⁹ kishin sjellë pakënaqësi mes pronarëve dhe bejlerëve të mëdhenj të tokave në Çamëri, me banorët e ardhur nga Azia e Vogël e sidomos me qeverinë greke , kishin detyruar disa çam si Nuri Dinua i cili nën kuadrin e gjithë këtyre reprezaljeve me formë ligjore, maskarave shtetërore në forma të ndryshme, duke mos lejuar edhe përfaqësimin e deputetëve çam në parlamentin grek , padyshim që sollën një pakicë të ngushtë njerëzish të cilët

⁹ Ligji detyruës nr.735/8/15 qershor 1937 , Fletorja Zyrtare greke 228/1937

kërkonin të gjenin diku mbështetje për padrejtësitë e tyre dhe realizimin e ëndrrës së kahershme të Shqipërisë Etnike.

8. Mirëpo të gjitha faktet e lartpërmenduar të çojnë vetëm në një konkluzion që shqiptarët e Çamërisë nuk ishin bashkëpunëtor me gjermanin, pasi nuk mund të fajësohet askush kolektivisht për faje individuale. Ky parim i drejtë dhe hyjnor mbi të cilat janë ndërtuar shtyllat e moralit ,aktet ligjore dhe jurisdiksionet ndërkombëtare nuk mund të shtrembërohet nga zyrtar grek për interesa shtetërore të padrejta e në kurriz të nje popullsie të pafajshme civile. Tashmë në një situatë të tillë , të pakënaqësive të medha , zhvillimeve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe një klime të tensionuar me shqiptarët musliman çam të cilet kishin afërsisht 4 dekada që luftonin për paqe dhe me forcat nacionaliste greke të ciët deshironin një Greqi fetarisht dhe kombëtarisht të pastër, si dhe me gjermanët nëpër këmbë, do të arrijmë në ngjarjet famëkeqe të 27 qershorit 1944, ndaj mijëra njerëzve të pafajshëm që gjetën vdekjen. Kjo datë njihet zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë si dita e genocidit shovinist grek ndaj shqiptarëve musliman të Çamërisë.

27 Qershor 1944

Një sërë problemesh në zonën Çamërisë, të cilat të akumuluar ndër vite si pasojë e shpronësimeve të gabuara dhe jolojale në raport me të drejtën,tjetërsimin e pronave të tyre , krimet e karakterit personal apo dhe terrori i ushtruar nga xhandarmëria greke e cila shpesh herë me aksionet që ndërmernte ndaj muslimanëve çam tek figurat më në zë të saj, sillte reagimin e këtyre te fundit, sollen edhe datën famëkeqe të 27 qershorit të 1944. Lidhja Demokratike Kombëtare Greke (EDES) me në krye gjeneralin Napoleon Zervas , kishte zonën e Çamërisë nën kontroll dhe kishin rënë dakort për një armëpushim në zonë me forcat gjermane, kjo edhe si pasojë e përfshirjes në këtë periudhë ne operacione ushtarake të forcave gjermane , të cilat për shkak të operacionit ushtarak me emrin Rosselpring, me urdhër nga Komanda e Lartë gjermane ,kishin pakësuar numrin e ushtarëve ne zonën e Çamërisë ne muajt maj-qershor 1944. Lidhja Demokratike Kombëtare Greke e cila njihet për qendrimit e saj radikale dhe për të jetësuar planin e një Greqie fetarisht dhe kombëtarisht të paster, kishte momentin më ideal për vënien në zbatim të ketij plani, me anën e një strategjie dinake e cila në fund do të konkludonte tragjike për fatin e muslimanëve shqiptar¹⁰. Kështu forcat e

¹⁰ Shih fq. 223 te librit “Ceshtja came gjate Luftes se Dyte Boterore”

Divizionit të X grek të EDES-it të komanduara nga Vasil Kamaras ndodheshin në rrethinat e Paramithisë . Zervas organizoj të gjithë shtabet e tij të zonës, duke proklamua, propoganduar dhe duke nxitur urrejtjen midis të krishteteve dhe muslimanëve të Çamërisë, ai vijoi me nxitjet e historive antishqiptare dhe duke futur në popull një frymë urrejtjeje e vëllavrasjeje midis banorëve. Ndërkohë që trupat e nacionalistëve çam qëndronin ende të armatosur. Në 22 qershor andartet grek, pas tërheqjes së ushtrisë gjermane, hynë në Pargë dhe sulmet e para u drejtuan ndaj vendbanimeve shqiptare të cilat i kishin rezistuar pushtimit kaqvjecare grek. Në mëngjesin e 26 qershorit të 1944-es, forcat zerviste dhe një grup ushtarakësh grek, duke ditur fuqinë që në atë kohë kishte Myftinia dhe besimi për shqiptarët musliman , realizojnë një takim me myftiun e Paramithisë ,Sali Hafuz Muhedinin , te cilit i premtuan se në rast dorëzimi të armëve të popullsisë çame, asgjë e keqe nuk do t’u ndodhte atyreve. Rendi dhe qetësia publike në Paramithi dhe në Çamëri do të mbroheshin nga Lidhja Demokratike Kombëtare Greke. Bashkë me rendin dhe qetësinë publike EDES zotohej në moscenimin e pronave të parisë çame. Duke iu besuar ushtarëve zervist Sali Hafuzi si dhe një perfaqësi e burrave dhanë fjalën se nuk do të sulmonin forcat e Napoleon Zervës. Në 27 qershor 1944, forcat Zerviste pas takimit me dhespoti e zonës dolën në qytete duke bere thirrje se ata do të ruanin rendin dhe qetësinë publike dhe pas dorëzimit të armëve të shqiptarëve të Çamërisë, u krijua një gjykatë e cila do të shërbente për dënimin e atyre personave që kishin bashkëpunuar me gjermanin. Në përbërjen e gjykatës bënin pjesë andartë greke si : Kristo Stavropullos, Muskunaqis Kostandinis,Arsitidh Kranja komandant i Regjimentit të XVI të EDES¹¹ . Ata arrestuan 35 persona, 34 prej të cileve u dënuan me vdekje. Mirëpo dita e cila pritej si nje ditë “çlirimi” (e përshkruar kjo në librin e Jorgos Margaritis, ”Bashkëpatriot të padëshiruar”) u kthye në nje ditë kasaphane , torturash dhe masakrash. Në po këtë datë andartet grek filluan krimet makabre në popullsinë civile. I pari që e pësoj ishte myftiu i Paramithisë Sali Hafuzi dhe dy djemtë e tij,ndërsa sipas autorit grek Krapsites në faqen 13 të librit të tij “Oι moussloumani” përshkruan se gruas së myftiut iu pre koka me hanxhar¹² . Shume gra u përdhuanuan shifra të cilat janë marramëndese dhe disa prej tyre pas përdhunimeve, digjeshin të gjalla, masakroheshin ose vriteshin në mënyrën më çnjerëzore si rasti i Sanije Bollatit të cilës pasi iu nxorr fëmija nga barku, i prenë veshët, i shpuan sytë, e dogjën me benzinë dhe i vunë flakën bashkë me të porsalindurin. Këto krime të cilat janë të paimagjinueshme për njerëzimin qenë të

¹¹Po aty

¹² Fq 225, po aty

shumta në zonën e Çamërisë, saqë Paramithia atë ditë ishte e gjitha e mbuluar në gjak si pasojë e vrasjeve masive me prerje kokash, hundësh, veshësh, gjymtyrësh , djegiesh të gjalla dhe mes një katrahure të permasve shokuese në Paramithi. Vetëm në Paramithi me datë 27 qershor u vranë 673 persona të pafajshëm, burra, gra, femijë, pleq të paarmatosur, nderkohë që shifrat që jep historiani grek Jorgos Margaritis llogariten në 500 persona. Nderkohe forcat edeiste të Zervës, nuk u mjaftuan me kaq , por u shtrinë në gjithë Çamerinë , duke prishur marrevëshjen e Kazertes midis Zervës se EDES-it dhe Sarafis të EAM-it(Partisë Komuniste Greke) e cila ndante zonat e administrimit në Çamëri , ku zona në veri të lumit Kalama i përkiste çamëve musliman. Kjo pranohet ne nje raportim të Shtabit të Përgjithshëm te Partisë Komuniste Greke e cila nxjerr ne pah dakordësimin e nenkolonelit Skobi te EDES me nr.1853¹³ . Në një tjetër raport të Partisë Komuniste Greke të nënshkruar nga sekretari Orfeas Vlahopoulos, tregon situatën në Çamëri duke përmenduar krimet e Napoleon Zervës dhe duke e quajtur EDES-in, pushtuesin e ri i cili prishi marrëveshjen e Kazertes duke i quajtur shtetasit musliman grek(çamët) si turko-shqiptar dhe ndërhyri ushtarakisht në zonat të cilat ishin percaktuar si të ndara dhe mori nën kontroll pothuajse të gjithë krahinën e Çamërisë¹⁴ . Pas marrjes nën kontroll të Çamërisë nga Zervas, masakrat u shtrinë në të gjithë Çamërinë. Në Gumenicë dhe rrethina u masakruan 192 njerëz të pafajshëm, në Filat 1286 persona , në Parga rreth 600 individ të pafajshëm, në Spatar pas plaçkitjes, u masakruan 152 persona¹⁵ . Sipas Shoqatës Patriotike “Çamëria” në Tiranë llogariten të masakruar 2771 individ të pafajshëm , kryesisht pleq,gra dhe femijë të cilët gjetën vdekjen nga masakrat zerviste, u dogjen dhe u plaçkitën 5800 shtëpi në 68 fshtara, u shkatërruan 102 xhami dhe u dëbuan nga trojet e tyre në drejtim të Shqipërisë 30.000 shqiptarë çam.

Ndërkohë që Jorgos Margaritis jep një shifër nga 22.000-25.000¹⁶ të dëbuar. Disa shembuj të masakrave makabre e çnjerëzore të bandave shoviniste greke, perveçse janë sot e kësaj dite reale e të deshmuar nga pleqtë çam që ende janë gjallë në Shqipëri, deshmohen edhe nga një letër e Këshillit Antifashist Çam , drejtuar Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 1947:

- Malo Muho 80 vjeç i cili kishte qenë i sëmurë prej 4 vjetësh, u vra me një levë përpara gruas së tij. E shoqja, mblodhi trute e tij përpara krahavorit të saj dhe i mbuloj me një batanije

¹³ Raporti I Partise Komuniste Greke mbi marreveshjen e Kazertes, date 14 dhjetor 1944

¹⁴ Jorgos Margaritis “Bashkepatriot te padeshiruar” shih fq.176,177,178

¹⁵ Shoqata Patriotike “Cameria” Tirane

¹⁶ “Bashkepatriot te padeshiruar” fq.145

- Ne Spatar Abdul Nurçe , u rrëmbye , u çua në Filat nga ku u tërhoq zvarrë e më pas u pushkatua përpara shtëpisë së Nidh Tafeq

- Familja e Lili Rustemit e përbërë prej 16 vetash, kryesisht fëmijë , u shfarros krejtësisht

- Xhelal Mini nga Paramithia u godit me një bajonetë të tipit VF7

- Trupat e myfti Hasan Abdulla, Sali Hafuz Muhedinit, Abedin Bako, Muharrem Pronja dhe Malo Sejdi kishin gishtat, hundët, gjuhët dhe gjymtyrët e prera. Ndërkohë që ata jepnin shpirt nga dhimbjet e shumta , Zervas dhe trupat e tij kendonin këngët e tyre.

- Çili Popova i veshur me uniformë ushtarake bashkë me disa xhandarë të tjerë u futën në shtëpinë e Sulo Tarit ku mbaheshin peng 40 gra. Ata zgjodhën vajzat dhe gratë me të bukura duke i çnderuar e më pas i vrane. Shtëpia u kthye në një ferr të vërtetë nga të qarat e grave dhe vajzave. Shënjestër e këtyre krimeve u bë edhe Seri Fejzo e Fizret Tare.

- Ymer Murati u vra dhe u gjymtua në Paramithi

- Hilmi Beqiri nga Filati u masakrua përpara familjes së tij dhe më vonë gjeti vdekjen

- Pale Çulani 50 vjece nga Spatari, u përdhunua e më pas iu morën të gjitha sendet personale me vlerë , i shkulën floket, i prenë veshët e më pas u pushkatua në oborrin e shtëpisë së fiqnjit të saj Muço (dëshmi e Dervish Sulos nga Spatari)

- Sanije Bollati u dogj e gjallë me benzinë, pasi i kishin prerë gjokset dhe i kishin nxjerrë sytë¹⁷ .

Në një listë të hollësishme të dëmeve materiale dhe ekonomike që jep Shoqata Patriotike “Çamëria” në Tiranë, përveç shtëpive dhe xhamive të djegura, placëçkitura dhe shkatërruara përfshihen 110 mijë dele, 24 mijë bagëti të trasha, 25 mijë ton grurë dhe 8 mijë ton vaji ushqimor. Në fshatrat e Çamërisë si Paramithi, Karbunarë, Veliat, Filat, Galbaq, Spatar, Sajadhë, Arvenicë, Arpicë ,Margëlliç u grabiën 4.949.000 okë drithë, 2.217.500 okë tërshërë dhe elb, 361.500 okë djathë, 457.700 okë vaji ulliri, 12.850 okë gjalp, 18.500 okë duhan, 26.800 okë oriz, 37 mijë okë bajame, dëmet per 3 mije shtëpi të

¹⁷ Raporti I Komitetit Antifashist te Emigranteve Cam(i plote ne fq.598-610 ne librin “Cameria, nje histori dokumentare “ Robert Elsie & Bejtullah Destani))

shkatërruara(ndërkohë që sipas Shoqatës Patriotike”Çamëria” llogariten në 5800 shtëpi) jane 84.700 frs¹⁸ .

Komiteti Antifashist i Emigrantëve Çam

Largimi i çamëve nga vatrat e tyre si pasojë e makabriteteve ogurzeza zerviste, solli një situatë anormale në Shqipërinë e rrënuar nga lufta. Çamët ishin të bindur, besonin dhe luftuan me një diplomaci të shkëlqyer , megjithëse në kryeqëndrat botërore nuk dha asnjë efekt, pasi koha në të cilën diplomacia e Komitetit Antifashist Çam, ishte një kohë ku mbarë globi ziente për çështje territoriale. Mund të themi pa frikë se themelimi i Komitetit Antifashist Çam i cili organizoj dy Kongrese një në Shalës dhe një në Vlorë , përpiloi një memorandum , futi nëpërmejt kanaleve të Ministrisë së Jashtme shqiptare të kohës , çështjen çame dhe me një diplomaci që rrallë herë e shef në Shqipërinë e sotme Komiteti në Kongresin e Vlorës me një diplomaci të rrallë, kjo për të kërkuar mbeshtetjen e qeverisë shqiptare , të Jugosllavisë si një ndër aleatet kryesor të kryeministrit Enver Hoxha, si dhe të forcave komuniste greke EAM /ELAS, shpallën presidentë nderi të Kongresit të tre liderët komunist, Enver Hoxhën , Josif Borz Titon dhe kreun e EAM-it Zahariadhis. Ky Komitet arriti të kërkonte në kryeqytetet me të mëdha botërore , Uashington, Londër dhe Moskë të drejtat e popullsisë çame duke kërkuar shprehimisht :

1. Rikthimin në Çamëri të popullsisë çame dhe siguri për jetën e tyre nga bandat e Zervës

2. Ngritjen e një komisioni hetimor ndërkombëtar për hetimin e krimeve ndaj njerëzimit dhe popullsisë civile

3. Largimin nga territori i Çamërisë dhe shtëpive të tyre të forcave edeiste, marrjen e masave për ndalimin e vendosjes së elementëve të huaj në këto shtëpi si dhe kompensimin e dëmit të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme.

4. Dënimin e personave të cilët kishin kryer krime pa dallim

5. Sigurimin e të drejtave politike, ekonomike, sociale dhe civile të popullsisë çame.

¹⁸ Wikipedia

6. Sigurimi dhe njohja e drejtë e tyre për pjesëmarrjen në luftën antifashiste nacional-çlirimtare

Çamët , nëpërmjet Komitetit ia dolën të lobonin dhe duhet thënë se nëse nuk do të ishte për kohën në të cilën kjo ngjarje ndodhi, atëhere do të thoshnim me bindjen e thellë se çamët do t'a kishin fituar luftën e tyre dhe Zervas do të ishte dënues për krime lufte. Komiteti mblodhi të dhënat të cilat ia dërgoj me memorandum Asamblesë së Kombeve të Bashkuara si dhe përfaqesuesit çam përfituan nga vizita e anëtarit të prlamenti britanik Lester Hutchison i cili vizitoj Shqipërinë në vitin 1945 dhe pa nga afër gjendjen, gjithashtu iu dërgua nga përfaqesuesi një letër ku pasqyroheshin krimet e kryera, të cilat Hutchison jo vetëm që i botoj në shtypin e kohës anglez , ku përmendte shifra si : vrasjen e 2509 personave nga nacionalistët grek dhe dëbimin me dhunë të 25 mijë çamëve nga trojet e tyre , por në fjalimin e tij në dhomën e komunave në parlamentin britanik shprehu revoltën e tij duke theksuar se : masakra të tilla vështirë se mund të besohen se janë bërë në ditët tona. Ai gjithashtu duke përkrahur Komitetin Antifashist Çam , kërkoi ngritjen e një komisioni parlamentar për të ushtruar presion në qeverinë greke e të lejonte kthimin e popullsisë çame në vatrat e veta¹⁹ . Kërkesat e tyre erdhën mbi bazën e Kartës së Atlantikut, kartë kjo e cila sot mund të përkthehet në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Në atë kohë në vitin 1941 SHBA me presidentin Roosvelt dhe Britania e Madhe me Kryeministrin Winston Churchill nënshkruan Kartën e Atlantikut mbi të cilën u bashkuan edhe shtetet e tjera për të pranuar parimet bazë të kësaj karte. Këto kërkesa patën edhe jehonën e cila u përhap me shpejtësi në mediat kombëtare dhe ndërkombëtare Misionet britanike në Shqipëri dhe Greqi, të cilat me heshtjen dhe mosreagimin e tyre duhet thënë se patën një rol të rëndësishëm qoftë në dëbimin e çamëve , qoftë në moszgjidhjen e çështjes çame, panë nga afër krahurën dhe gjendjen e popullsisë çame të vendosur në jug të Shqipërisë. Kështu, misioni dhe Palmer propozuan shkëmbimin e popullsisë ku popullsia greke e vendosur në Shqipëri të shkonte në Greqi dhe çamët të vendoseshin në këto zona, duke sjell kështu një zgjidhje. Kjo për interesat politike të të dy palëve nuk u pranua as nga popullsia shqiptare dhe as nga qeveria greke. Mediat brenda Shqipërisë dhe jashtë saj e cilësonin një katastrofë gjendjen e popullsisë çame, ku organi i shtypit të EAM-it shkruante më datë 19 janar 1945 se : “Krimet e kryera në Paramithi dhe Filat u udhëhoqën nga Napoleon Zervas, Kamara, Kaco , Harallambos. Ndër të tjera thuhej se hyrja e trupave ushtarake nuk linte asnjë shpresë për minoritetin musliman shqiptar.

¹⁹ Lorenc Agalliu “ Ceshtja çame gjate Luftes se Dyte Boterore” fq.298

Masakrat, dhunimet, plaçkitjet, krimet, djegiet vunë vulën e tyre në çdo cep të Thesprotisë” Reagime pothuajse të njëjta ne përmbajtje kishin edhe gazetat e tjera greke si “Embros “ “Zëri i Epirit” , apo shtimi i numrave të shtypit edhe në SHBA nga shqiptarët. Këto krime, edhe në librin e studiuesit Lorenc Agalliu, i cili me studimin e tij të pasuruar me bibliografi shqiptare, greke, italiane , britanike, gjermane dhe me aktet e zyrtarëve të kohës, ka realizuar një ndër punimet më objektive ku thuhet se edhe shtypi , turk , anglez apo media të tjera prestigjioze botërore kanë pranuar këtë fakt. Gazetarja turke , Belixhe shkruante në gazetën “Tan” atë çfarë kishte parë nga afër dhe se hidhte poshtë pretendimet greke se gjoja çamët kishin sulmuar të krishterët e zonës²⁰ . Në po këtë studim thuhet në faqen 297 se këto masakra tërhoqën vëmendjen edhe të shtypit britanik ku u dërgua në 1945 përfaqësues të gazetës prestigjioze “ Daily Telegraph “ ku pa nga afër gjendjen e mjerueshme të popullit çam dhe dënoj ashpër qeverinë greke për barbaritë e shkaktuara

Konferenca e Paqes, pretendimet greko-shqiptare

Konferenca e Paqes e mbajtur në Paris në vitet 1946-1947 shërbente si gurthemel në vendosjen e paqes me anë të traktateve ndërkombëtar të paqes si dhe dëmshtëpërlimet e luftës nga Forcat e Boshtit. Sipas Deklaratës së Moskës u pranuan dhe 22 delegacione ndërkombëtare që kishin dhënë një ndihmesë gjatë luftës përkrahë Forcave Aleate. Ndër të ftuarat në Konferencë ishte edhe Shqipëria, e cila në të njëjtën periudhë ziente krizën e refugjateve çam të cilët gjithashtu i drejtonin letra Asamblesë së OKB-së , Këshillit të Sigurimit, misionëve të UNRRAS dhe ku Shqipëria duhej në të njëjtën kohë të priste dhe strehonte në qytete këta refugjatë, duhej të merrej edhe me luftën civile në Greqi në të cilën Shqipëria kishte shprehur hapur mbështetjen për forcat komuniste greke EAM-ELAS, por po ashtu duhej të përballej edhe në zyrat ndërkombëtare në lidhje me statusin e Shqipërisë gjatë dhe pas luftës. Kështu në Konferencën e Paqes, delegacioni grek kërkonte dënimin e Shqiptarisë si vend i cili shkaktoj trazira në Ballkan dhe i cili së bashku me Italinë pushtuan Greqinë në vitin 1940 me argumentin se Shqipëria e zotëronte plotësisht sovranitetin e saj dhe me dëshirën e saj, Asambleja Kombëtare i kishte dorëzuar Italisë kurorën mbretërore, e cila u paraqit edhe nga Italia si një Bashkim Personal. Një ndër argumentet më të forta që Greqia përdori ishte marrëveshjet ligjore që Shqipëria dhe Italia kishin gjatë viteve 1923-1935 ku Italia kishte qenë një mbrojtëse e Shqipërisë ndërkohë

²⁰ Po aty, fq 295

që Shqipëria i vinte në dispozicion infrastrukturën e saj ushtrisë italiane e në të njëjtën kohë Shqipëria kishte mbështetur sulmin e Italisë kundër Etiopisë. Për të gjitha këto Greqia kërkonte që Shqipëria të cilësohej vend pushtues, një vend i mundur në luftë dhe për të cilën duhej të paguante duke i dhënë Greqisë “Epirin e Veriut”, një term ky irridentist në çdo periudhë që është përdorur. Epiri i Veriut ose Vorio Epiri është një term i përdorur nga Greqia për territoret shqiptare që fillojnë në lumin Vjosë e vazhdojnë në të gjithë pjesën jugore të Shqipërisë. Në fakt edhe sipas doktrinave të huaja e kryesisht atyreve italiane Shqipëria nuk mund të quhej një vend sovran, e në të njëjtën kohë jo përgjegjëse për sulmet që vinin nga ajo, të imponuara nga fashistët. Kjo për arsyen se sovraniteti në termin juridik do të thotë ushtrim i plotë i pushtetit sovran brenda vendit dhe pavarësi e plotë nga jashtë. Pra, Shqipëria e kishte humbur totalisht sovranitetin e saj, Mbreti Zog, ishte larguar dhe Asambleja e cila i dha kurorën Viktor Emanuelit të III nuk përfaqësonte dëshirën e popullit shqiptar, përderisa populli shqiptar me forcat partizane, nacional-çlirimtare dhe njësitet e veta guerrile, luftuan nazi-fashizmin duke u pozicionuar kundër doktrinave të tyre ideologjike dhe krahë Aleatëve. Për sa i takon termit juridik Bashkim Personal, ai bie poshtë sepse Shqipëria nuk kishte asnjë lidhje farefisnie për të realizuar një bashkim të till ligjor. Në të njëjtën kohë studiues italian, të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe jurista plotësojnë kuadrin e gjendjes së Shqipërisë duke cilësuar se nuk mund të paraqitet as edhe si Bashkim Real pasi Asambleja e Shqipërisë e cila kishte propozuar, ofruar dhe dorëzuar kurorën, ishte e imponuar dhe e organizuar nga pushtuesi. Dhe këtu dalim tek pika e parë e cila tregon qartazi humbjen e sovranitetit të Shqipërisë. Të njëjtat argumenta ka përdorur edhe Enver Hoxha në cilësinë e Kryeministrit të vendit duke potencuar faktin se në pushtimin e Greqisë, moren pjesë vetëm dy batalione ndërkohë pjesa dërrmuese dezertoj, Shqipëria nuk ishte vend sovran pasi nuk përfaqësonte popullin dhe se populli përfaqësoj vetëveten në luftën që bëri duke u pozicionuar krahë Aleatëve Perëndimor. Shqipëria u pranua si një fituese e luftës, duke hedhur poshtë pretendimet greke për aneksimin e Vorio Epirit dhe se Shqipëria ishte një vend i pushtuar nga Italia. Madje në traktatin e nënshkruar midis dy vendeve ku i jepej fund gjendja së luftës ka dy nene tejet të rëndësishme për interpretim. *Neni 27 i Traktatit përkufizonte se Italia njeh dhe angazhohet të respektojë sovranitetin e pavarësisë së Shqipërisë. Në nenin 28 thuhej se Italia hiqte dorë nga pretendimet e Sazanit dhe e njihje atë si pjesë të patjetërsueshme të Shqipërisë*²¹. Ajo që vëmë re nga këto dy nene të Traktatit është fakti se edhe Italia njeh më vonë se Shqipëria nuk

²¹ Mentor Nazarko “Lufta e fundit, pronat e shqiptareve në Greqi” fq.61

ka patur sovranitet gjatë luftës, e ka humbur atë e për rrjedhoj cilësohej si një vend i pushtuar.

Situata juridike e gjendjes së luftës dhe zgjidhja e saj

Nëse do të pasqyrojmë së shpejti një kronologji të ngjarjes në lidhje me këtë temë, do të shohim se : në 7 prill 1939 Italia pushton Shqipërinë (tashmë jemi edhe të sqaruar plotësisht nga ana juridike se ishte një pushtim dhe jo një Bashkim Real apo Personal shtetesh), në 12 prill 1939 vendoset një qeveri kukull dhe më 9 qershor 1940 Viktor Emanueli i III në atë kohë i konsideruar Mbreti i Italisë, Shqipërisë dhe Perandor i Etiopisë shpalli me dekretin mbrëteror nr.194 që Shqipëria do të ishte në luftë me të gjitha ato shtete që Italia do të ishte në luftë²² . Më 28 tetor 1940 pas vrasjes së Daut Hoxhës, Italia pushton Greqinë nga toka shqiptare dhe në dhjetor të vitit 1940 janë shpallur nga Mbreti i Greqisë ligjet nr.2636/1940, 2637/1940 të cilat njiheshin si Ligji i Forcës ose Ligji i Luftës²³. Këto ligje i shpallën luftë Shqipërisë e cila në të njëjtën kohë me diktim pushtuesisht kishte edhe ajo një të tillë. Këto ligje hyn në fuqi më 28 tetor, pra kishin një efekt prapaveprues dhe është tejet e rëndësishme të theksohet se Ligji i Luftës iu vendos shtetit shqiptarë dhe shtetasve shqiptarp me prejashtim të shtetasve shqiptarë me kombësi greke.Pra në këtë kuptim çamët ishin shtetas grek dhe nuk kishin lidhje me ligjin e luftës. Kur në vitin 1952 morën shtetësinë shqiptare , automatikisht edhe çamët janë sot në gjendje lufte , pra juridikisht. Një veprim i till i Greqisë ishte i pajustificueshëm duke parë edhe precedentet ku Çekoslovakia i kishte shpallur lufte BS dhe nuk kishte një akt të ngjashëm nga BS drejt Çekoslovakisë duke ditur që akte të tilla erdhën nën trysnin e pushtesit, pra nga pushtuesi dhe jo vendi konkret

Qeveria greke e kohës sekuestroj pronat e shqiptarëve duke i lënë në administrim të Ministrisë së Financave. Ndërkohë që pronat e çamëve në keto momente nuk kane lidhje me këtë ligj sepse ata si shtetas grek kishin ende problemet e mosdëmshpërblimit të pronave të shpronësuar nga qeveria greke për grekët e ardhur nga Azia e Vogel Në përfundim të L.II.B, Shqipëria fitoj betejën me Greqinë dhe u rendit krahe fituesve të luftës, ndërkohë që me një vendim të qeverisë hoxhiste ajo abrogojë të gjitha ligjet që Shqipëria kishte miratuar si e detyruar nga pushtuesi. Këto vendime u miratuan nga Kuvendi Popullor. Greqia

²² Po aty, fq.12

²³Eleftheria Mandas “Camet mysliman te Epirit”

hoqi ligjin e luftës me Italine, por jo me Shqipërinë, madje edhe gjatë sistemit komunist deklaronte shpesh këtë fakt me Shqipërinë , sa që lehtësisht mund të gjendet nëpër rrjete sociale edhe një fjalim i Enver Hoxhes si kundërpërgjigje për grekët në lidhje me këtë fakt. Në vitin 1971 Greqia dhe Shqipëria vendosin marrëdhënie diplomatike me njera- tjetrën dhe në vitin 1976 , Këshilli i Shtetit Gjykata më e lartë administrative e Greqisë merr vendimin *SE 2327/76*²⁴ sipas të cilit Shqipëria pushonte së qenuri një vend armik qe kur me të janë vendosur marrëdhënie diplomatike. Në fakt një veprim i pakuptueshëm, aspak i interpretueshëm nga ana e shtetit fqinj , pasi Gjykata më e lartë Administrative nuk është organ ligjvënës që të mund të miratoj, ndryshoj , anulloj apo abrogoj një ligj. Në vitin 1987 Andrea Papandreu deklaroi se Ligji i Luftës me Shqipërinë është hequr formalisht dhe se ai nuk ekziston. Në fakt kjo ishte një deklaratë politike e tij sepse dikë e till nuk ekziston të jetë e miratuar nga ndonjë organ kompetent siç është Parlamenti apo e dekretuar nga Kreu i Shtetit. Diçka e till rezultoi të jete pranuar zyrtarisht edhe nga Ministria e Jashtme e Greqisë e cila ka deklaruar në vitin 1999 se Ligji i Luftës është ende në fuqi dhe pronat e shqiptarëve janë ende nën sekuestro. Gjatë kësaj periudhe Minister i Jashtëm i Shqipërisë ka qenë historiani Paskal Milo i cili e ka bërë publik diçka të tillë madje e ka pranuar shpesh edhe në studiot televizive.

Pas viteve 90, edhe gjatë këtyre viteve shteti shiptarë të detyruar edhe nga Shoqata Patriotike “Çamëria “, i ka kërkuar palës greke heqjen e Ligjit të Luftës. Moskoherenca dhe deklaratat jo stabël të perfaqësuesve grek janë reflektuar gjatë 3 dekadave.

- 1-Përvecëç deklarimit te Andrea Papandreut i cili rezultoi jo vetëm politik , por nuk kishte asnjë akt juridik për t’a vërtetuar, kemi gjatë kësaj periudhe deklarata diplomatike të shoqëruara me nënqeshje të tipit “Pse në gjendje lufte jemi, kur kemi afërsisht 1 milion shqiptarë në Greqi?” Në fakt kjo është shmangie nga realiteti sepse kur flitet për këtë ligj , flitet për pasojat qe ky ligj sjell, për pasojat ekonomike e pronësore, për mbajtjen nën sekuestro të këtyre pronave të komunitetit bektashi, shqiptarëve dhe çamëve.

- 2-Në diskutime serioze është pranuar që ligji i luftës është hequr me nënshkrimin e Traktatit të Fqinjësisë së mirë i nënshkruar me 1996 dhe që është ratifikuar nga të dyja Parlamentet. Atëhere këtu lind një pyetje qe rrëzon këtë pretendim të palës greke. Ky traktat tashmë ka skaduar dhe lind si deduksion se

²⁴ Lufta e fundit, pronat e shqiptareve ne Greqi” Mentor Nazarko

me skadimin e këtij traktati a jemi automatikisht në gjendje lufte sërish? Nëse nënshkrimi i traktatit nënkuptonte heqjen e ligjit të luftes, atëherë si është e mundur që 3 vite pas nënshkrimit të tij, Ministria e Jashtme e Greqisë, pranon zyrtarisht ekzistencën e këtij ligji? Po të shohim traktatin i cili është trajtuar me shumë profesionalizëm në librin e Mentor Nazarkos “ Lufta e fundit, pronat e shqiptarëve në Greqi” do të shohim në faqen 91 se përmendet neni 15 i traktatit i cili thekson se secili prej vendeve nënshkrues në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues angazhohet të heq të gjithë vështirësitë që pengojnë gëzimin paqësor të pasurive të shtetasve të secilës palë kontraktuese, të pranishëm në territorin e shtetit tjetër kontraktues²⁵ . Kjo lojë fjalësh, që pasojnë njera-tjetrën e qe nuk mund të fshehin realitetin e gjendjes së luftës, është vetëm sa për t'i shërbyer deklaratave politike të gjoja fqinjësisë së mirë , por që në fakt eskopzojnë realitetin e mendësise së mbrapsht greke dhe politikave të tyre qindra vjecare, qysh nga Megalaidea (Ideja e Madhe) për zgjerimin e Greqisë deri në atë që shfaqet herë pas here midis dy vendeve tona , Epiri i Veriut. Kjo rrjedh si pasoje e togfjaleshit te përmendur në nenin 15 ku thuhet *KUADRI LIGJOR EKZISTUES*, çka nënkupton veprimet nul të cilitdo që ka pretendime pronësore në Greqi, sepse kuadri ligjor ekzistues e mohon këtë gjë e cila është e afirmuar po në këtë nenë, po në këtë traktat i cili ka skaduar tashmë.

- 3- Shpesh është thënë se Ligji i Luftes nuk ekziston sepse aktualisht Greqia është Republik dhe në kohën kur është vendosur Greqia ka qenë Mbretëri dhe duke qenë se për të hequr këtë ligj duhet sistemi mbretëror të cilin Greqia aktualisht nuk e ka ,atëherë ky ligj nuk ekziston. Nje justifikim tejet femijënor, aspak profesional e shumë qesharak , kur çdo kush e kupton se në cilindo sistem politik ka një organ ligjvënës dhe si në Monarki ashtu edhe ne Republik kemi institucione ligjvënëse që pavarësisht emërtimin , kanë të njëjtin funksion. Në po të njëjtën kohë Ministria e Financave është ajo e cila si në vitin 1940 ashtu edhe sot mori dhe ka nën administrim pronat e shqiptarëve. Ndërkohë për sa i takon dekretit të dekretuar nga Mbreti duhet të kuptojme se rolin e mbretit ne një Republik parlamentare e luan Presidenti i cili dekreton ligje të nxjerra nga organi ligjvënës, të njejtën gjë që bënë edhe monarku. Kështu që edhe në këndveshtrimin e Kreut të Shtetit, sistemit politik, Greqia luan në suaza që janë aspak profesionale, për një shtet ku pretendohet se ka lindur demokracia. Kështu duke zbaptuar teorinë e kundërt “contrarios actus” rezulton se Presidenti i Republikës së Greqisë për shkak të pozicionit që mbart , në marrëdhëniet ndërkombëtare është

²⁵ Shih po aty, fq 91

përfaqësuesi i Greqisë, Kryetari i Shtetit dhe personi përgjegjës i cili shpall gjendjen e luftes, firmos traktate ndërkombëtare , lidhë aleanca dhe firmos traktate paqeje 4-4-Në vizitat e Ministrave të ndryshëm grek kemi patur qendrimë jo luajale në raport me ligjin e luftës, ku vitet e fundit është premtuar nga pala greke se Greqia do t'a ndërmarr aktin e heqjes së Ligjit të Luftës. E kundërta ndodh me çështjen çame , ku të gjithë përfaqësuesit grekë kanë deklaruar se nuk e njohin, megjithëse çështja çame është e lidhur ngushtësisht edhe me ligjin e luftes, nëse ai do të hiqet së bashku me efektet dhe aktet e tjera ligjore në mbështetje të tij

Zgjidhja

Ashtu siç u argumentua edhe më lart që ligji i luftës ekziston dhe juridikisht jo vetëm që mban të sekuestruara pronat e shqiptarëve, por paradoksalisht jemi në të njejtën kohë edhe aleat të NATO-s edhe në gjendje lufte. Për të zgjidhur këtë çështje , mjafton vetëm vullneti i palës greke dhe ligji i luftës është lehtësisht i zgjidhshëm, duke ndërmarrë të njejtin veprim që bëri Shqipëria e sapodal nga L.II.B e cila me anën e organit të saj ligjvënës,nuk njohu dhe anulloj çdo akt të ndërmarrë nga ajo nën pushtimin fashist. Pra

- 1-Abrogimi i Ligjit të Forces 2636 dhe 2637/1940 nga Parlamenti i Republikës së Greqisë , dekretimi i tij nga Presidenti i vendit dhe botimi në Fletoren Zyrtare. Kjo është lehtësisht e zgjidhshme, mjafton vetëm vullneti. Mirëpo Greqia si një vend i cili e kupton mjaft mirë rolin dhe rendësinë e këtij ligji për pronat jo vetëm të komunitetit bektashi dhe shqiptarëve që në atë kohë ishin shtetas shqiptar , por edhe të çamëve, sepse kjo do të hapte një rrugë të re për zgjidhjen e mundshme të çështjes çame.

- 2-Mënyrë tjetër është adresimi në organet e NATO-s , për të kërkuar shpjegim se si është e mundur që dy vende aleate të organizatës, të gatshme për të luftuar kundër kujtdo në rast se një nga vendet e organizatës preket, juridikisht në gjendje lufte e gjithë organizata nëse një nga vendet e saj është në luftë, kanë një ligj lufte mes njera-tjetrës. Adresimi në NATO dhe me këmbëngulje për të arritur qëllimin final atë të heqjes së ligjit të luftës së bashku me aktet e tjera që pasojnë atë dhe efektet e tij, ndoshta do të arrinte në një presion ndërkombëtar e diplomatik të aleancës për të ndërmarrë veprimin e cituar me lartë , i cili do të ishte i vetmi akt juridik dhe i vetmi që do të çlironte Shqipërinë nga gjendja e luftës që ekziston aktualisht midis dy vendeve tona

Situata Juridike e çamëve dhe e pronave

Trajtimi më lartë i Ligjit të Luftës midis dy vendeve tona dhe zgjidhja e cila për këdo mund të konkludoj shumë e thjesht, në fakt nga analiza e mëposhtme do të shohim se kemi të bëjmë me një mosdashje të abrogimit së bashku me efektet e Ligjit të Luftës se sa me një ngërç ligjor , kjo për arsye të cilat do t'i rendisim më poshtë. Pas nënshkrimit të Traktatit të Lozanës midis Greqisë dhe Turqisë në vitin 1923 , ku do të shkëmbeheshin popullsitë e dy vendeve, e cila parashikonte që turqit e Greqisë do të shkëmbeheshin me ortodoksët që do të vinin nga Turqia për në Greqi. Lufta politike ishte e madhe pasi, ndjenja fetare ishte ndoshta edhe më e madhe se ndjenja kombëtare. Shqiptarët e Çamërisë, duke qenë se ishin musliman, shteti grek nxitoj që t'i dërgonte në Turqi në bazë të Traktatit të nënshkruar midis dy vendeve dhe në vitin 1923 kemi shqiptarët e parë çam të cilët largohen me vapor nga porti i Gumenices në drejtim të Izmirit (ku edhe sot e kësaj dite në Izmir ka shumë shqiptarë që pohojnë origjinën e tyre çame). Lufta që qeveria e Ahmet Zogut e më pas Mbretëria e tij bënte ,ishte e madhe,sepse për të qenë realist, shqiptarët çam në atë kohë kishin më shumë të theksuar ndjenjën fetare se sa atë kombëtare , pavarësisht se flisnin shumë mirë gjuhën shqipe , ku nuk duhet harruar që një pjesë e popullsisë ishin bilinguistik , personat që flisnin shumë mirë edhe gjuhën greke edhe gjuhën shqipe, madje kishte nga ata megjithëse të paktë në numër të cilët i zotëronin të trija gjuhët , shqip, greqisht dhe turqisht. Pikërisht në shkurt të viti 1923, përpara se Greqia të ndërmerre këtë hap, u miratua nje dekretligj në shkurt të 1923 mbi konçesionin e pasurive publike dhe shpronësimin për akomodimin e kolonëve refugjatë²⁶. Qeveria greke u mobilizua për të pritur fluksin e shpërnguljeve nga Turqia dhe si vendet më të përshtatshme për të realizuar akomodimin e tyre, kishte gjetur zonat shqipfolëse dhe kryesisht zonat e banuara nga çamët. Në këtë periudhë , edhe pas pranimit të Shqipërisë në Ligën e Kombeve u pranua gjegjësisht edhe si pasojë e një lufte të forte ndërkombëtare të qeverisë së Zogut , edhe për shkak të marrëveshjeve bilaterale të qeverisë shqiptare me atë greke, që çamët pas një beteje të gjatë u konsideruan shqiptarë musliman, ku edhe Turqia pranoj se jo të gjithë muslimanët e Greqisë konsideroheshin turq. Në marrëdhëniet e mira midis dy vendeve , pasi në krye të Greqisë kishte ardhur Pangallos u dakordësua që të hapeshin shkollat greke në Shqipëri dhe ato shqipe në zonën e Çamërisë. Megjithëse kjo marrëveshje nuk u zbatua në masën e saj 100% nga ana e qeverisë greke, kjo edhe për shkak të mungesës së vullnetit të qeverisë greke, por edhe për

²⁶“ Luftë e fundit, pronat e shqiptareve në Greqi” fq.49

shkak se çamët nuk integroheshin në shoqërinë greke , madje refuzonin që vajzat shqiptare të dërgoheshin në shkolla djemsh, pavarësisht se mësuesit vinin nga Shqipëria për të dhënë mësim. Në fakt qeveria greke duke ditur mentalitetin e popullsisë vendase kishte vendosur të bënte një lojë të dyfishtë, ku në shkollat mikse (greke dhe shqiptare) kishte futur edhe lëndën e fesë islame, ndërsa në shkollat të cilat ishin plotësisht shqiptare mungonte lënda islame. Pavarësisht këtyre problemeve të brendshme në Greqi të cilat reflektoheshin në marrëdhëniet shqiptaro-greke, në Traktatin e Lozanës thuhej shprehimisht se pasuritë shqiptare do të paguheshin me vlerë ari, duke përfshirë dhe interesat deri në derdhjen e plotë të shumave që i korrespondoheshin të ardhurave efektive të pasurisë²⁷ . Problem tjetër për Greqinë, rezultuan çamët të cilët fill pas nënshkrimit të marrëveshjes së Lozanës , u detyruan të largoheshin në Izmir, megjithëse shpronësimi i tyre u bë në bazë të dekretligjit të miratuar në 15 shkurt 1923, ata nuk morën pagesën e shpronësimeve. Duke shtuar këtu faktin që në atë kohë u pranua se jo të gjithë muslimanët ishin turq , një pjesë vendosi të kthehej , duke u përballur me shpronësimet e papaguara të Greqisë dhe pronat e tyre të zëna nga refugjatët. Për shkak të këtyre problemeve kemi disa ligje, ndryshime dhe shtesa në ligje të ndryshme që rregullonin shpronësimet e pronarëve çam. Në vitin 1930 hyn në fuqi ligji 4816/1930 që fuste një shtesë dëmshperblimi për pasuritë e shpronësuara të çamëve, si dhe ligjin nr.5136/1931 që realizonte kalimin e pronësisë nga çamët tek refugjatët nëpërmjet shortit publik²⁸. Këto ligje mbi shtesën e dëmshpërblimit vinin si pasojë e premtimit të qeverisë greke se shqiptarët (çamët) do të dëmshpërbleheshin njësoj si të huajt (megjithëse ishin shtetas grek) dhe me një vlerë shpronësimi më të madh se grekët. Diçka e till u shfaq dhe proklamua si një padrejtësi ndaj grekëve dhe dorëlëshime të medha në favor të Shqipërisë dhe dëm të Greqisë. Pavarësisht ligjeve të miratuara , burokracitë greke nuk i zbatonin ato në terren, duke nxitur një klimë konfliktuale midis banorëve ortodoks dhe çamëve musliman. Në vitin 1937 (pas ardhjes në pushtet të Metaksait) u miratua ligji detyrues nr.735 date 8 qershor 1937 “Mbi muslimanët të quajtur me origjinë shqiptare dhe mbi dhënien atyre të pronave të rivendikuara “²⁹ . Ky ligj vjen pas tensionimit që qeveria greke u përpoq edhe njëherë t’i cilësonte si çamo-turq muslimanët shqiptarë dhe t’i ridërgonte në Turqi dhe për këtë arsye pas ç’tensionimit të kësaj situatë u miratua ky ligj detyrues. Ky ligj parashikonte shpronësimin e detyruar të pasurive shqiptare çame , në emër të

²⁷ Eleftheria Mandas “Camet mysliman te Epirit”

²⁸ Fq. 49 “Lufta e fundit, pronat e shqiptareve ne Greqi”

²⁹ Fletorja Zyrtare greke 228/1937 , ligji detyrues nr.735 date 18 qershor 1937 si dhe fq. 123 “Bashkepatritot te padeshiruar”

rindarjes së tokës. Kjo u konsiderua nga çamët si një veprimtari armiqësore e shtetit grek kundrejt pronave të tyre, për arsye se ende e kaluara kishte lënë pezull regjimin e pronave dhe çamët me të drejtë mendonin se si me shpronësimet e detyruara si me shitblerjet e detyruara, ishin bërë abuzivisht, brenda regjimit të presionit shtetëror dhe mashtrimeve në lidhje me shpronësimet. Ky pretendim lidhej me të drejte jo vetëm si pasojë e burokracive të institucioneve greke të cilet jo vetëm që nuk kishin paguar asnjë qindarkë për shpronësimet , por solli një valë të re trazirash në trekëndëshin e e kryesuar nga shteti.

Gjatë L.II.B deri në Gjyqin e Janinës

Ndërkohë në vitin 1940 me anë të ligjit 2636 dhe 2637 vendoset i ashtuquajhuri në ditët e sotme Ligji i Luftës, i cili u vendos në një kohë që pakënaqësitë , trazirat, hakmarrjet personale midis banorëve për pronat të shkaktuara nga shteti grek si pasojë e mosplotësimit të detyrimeve të tij, solli edhe këtë ligj i cili përveçse i pakuptimtë ndaj një populli dhe shteti të pushtuar e shtoj dozën konflikteve juridike që ekzistojnë në ditët e sotme. Gjatë L.II.B siç është përmendur edhe në kapitujt më përpara, situata në Çamëri ishte tejet e tensionuar, me pronat e çamëve të zëna, të zaptuara, me çamët të cilët kishin në duar letrat e shpronësimeve , por jo parat me nisjen e Luftës së Dytë Botërore, me një situatë konfliktuale në zonën e Çamërisë, me krime të shumta penale midis të dyja popullsisive, me shtetin grek i cili i përdori këto konflikte për të ndezur zjarrin e urrejtjeve fetare, etnike dhe pronësore e cila përfundoj me dëbimin masiv të shqiptarëve në fund të Luftës së Dytë Botërore. Në librin e autorit grek Jorgos Margaritis “Bashkëpatriot të padëshiruar” pranohet se gjatë luftës, situata në Çamëri u rëndua edhe më shume kur në vitin 1942 u zbatua metoda e presioneve tatimore për të ardhurat bujqësore , që në fakt u zbatua për një sërë vendimesh qeveritare në të gjithë vendin³⁰ . Mirëpo kjo metodë tatimore, për shkak të problemeve të mbartura gjatë viteve rezultoj fatele për konfliktet e mëtejshme në Çamëri. Siç dihet në përfundim të L.II.Botërore, EDES me në krye Zervën, me mbështetjen e britanikëve dhe qeverisë greke kryen një ndër masakrat më të mëdha ballkanike gjatë L.II.B, vrasjen , masakrimin dhe dëbimin e mijëra shqiptarëve , fëmijëve , grave dhe pleqve në drejtim të Shqipërisë. Pas masakrave grekët i quajën çamët si bashkëpunëtor të nazizmi, kur në fakt realiteti është që jo vetem Nuri Dino apo vëllezërit Dino bashkëpunuan me nazizmin , por edhe vetë Napoeloen Zerva që predikonte të kundërtën, kishte marrëdhënie të ngrohta me

³⁰ Jorgos Margaritis “Bashkëpatriot te padëshiruar” fq. 133

gjermanët. Pasi u rivendosën autoritete greke në Çamëri , me procedurë të përshpejtuar Gjykata Speciale e Bashkëpunëtorëve të Fashizmit në Janinë dënoj në mungesë me vendimin e saj nr.344/23/1945 1930 çam si bashkëpunëtor të nazi-fashizmit , shumicën e të cilëve me vdekje. Akuza të cilat u ngritën dhe u gjykuan edhe nga ushtarë të EDES-it të cilët pak kohë më parë kishin qenë autorët e masakrave të mëdha. Pronat e çamëve musliman që u dënuan me vdekje nga Gjykata e Janinës, u konfiskuan , ndërkohë u ishte hequr edhe shtetësia greke (fjala është për vetëm 1930 çamët e dënuar).

Pas perfundimit të Luftës së Dytë Botërore

Ndërkohë tokat dhe pronat e lëna pas dëbimit të mbi 30 mijë shqiptarëve musliman në Çamëri , kishin ngelur bosh dhe pas vitit 1945 qeveria greke miraton një dekretligj nr.2185 “Mbi shpronësimin e detyrueshëm të tokës me qëllim të rimëkëmbjen e kultivuesve pa tokë dhe të blegtorëve³¹. Ndërkohë ndër të tjera me ligjin nr.2536/1952 “Mbi ripopullimin e rajoneve kufitare dhe mbështetjen e popullsisë së atjeshme si dhe ligjin me nr.2781 “Mbi amendimin dhe plotësimin e disa dispozitave të dekretligjit nr.2536 të vitit 1953 u shpronësuan pronat e patundshme të çamëve³², pronat e çamëve iu dhanë bujqve dhe blegtorëve pa tokë në bazë të ligjeve të mëparshme dhe shortit publik të përcaktuar nga Komisioni i Shpronësimeve të Thesportisë (Çamërisë). Kjo procedurë e till nuk u bë në emër të pronarëve të vërtete të atyre pronave , nuk u bë në emër të çamëve musliman. Mirëpo çfarë përmbanin këto ligje? Nëse do të shohim në thelb dhe me një skepticizëm do të vëmë re se këto ligje kanë rregulluar pozitën e tyre juridike për të pamundësuar një rikthim të mundshëm të çamëve në pronat e tyre autoktone. Në dekretligjin nr.2185 të vitit 1953 përmendeshin termat “tokë e braktisur “ dhe “largimi pa passportë”. Tokat e braktisura ishin vetëm tokat e lëna nga çamët të cilët për t’i shpëtuar masakrave nën plumbat kërcënuese të Zervës u larguan, u dëbuan në drejtim të Shqipërisë, ku qëllimi ishte shpëtimi i jetëve njerëzore dhe shumë pak prej çamëve , të cilët ishin shtetas grek mund t’a kishin në mendje për të marrë dokumenta shtëpish, apo Passportën e tyre. Dhe diçka e till ishte e përmendur shprehimisht në Nenin 6 të këtij dekretligji i cili thoshte se :”Konsideroheshin të braktisura të gjitha pasuritë e patundshme bujqësore nëse pronari i tyre ishte larguar jashtë kufijve të vendit pa passportë. Në pikën dy të këtij neni thuhej se shteti bëhej pronar i tyre me parashkrimin fitues prej 3

³¹ Eleftheria Mandas “ Camet mysliman te Epirit” fq.232

³² Po aty...

vjetësh³³ . Kjo tregon qartazi një ligj të bërë add hoc , pasi të gjitha dispozitat ligjore i përshtateshin dëbimit të çamëve , duke nisur që nga braktisja si pasojë e genocidit , të shtëpive , duke vazhduar me mosmarrjen e passaportës e duke e përmbyllur me faktin që mbas 3 vitesh kur pronari i tokës nuk shfaqej, shteti bëhej pronar. Për të vijuar më tej me ligjet add hoc shteti grek me dekretligjin nr.3958/1959 deklaronte në nenin 13 të tij të ligjshëm shpronësimet nga ana e shtetit të të gjithë pasurive të patundshme bujqësore në zonat kufitare duke mbështetur kështu dekretligjin nr.2185/1953 dhe dekretligjin 2536/1953, i cili “legjitimoj” kështu shpronësimet, termat e përmendura të tokave të braktisura, parashkrimet fituese si dhe shpërndarjen e pasurive nga Komisioni i Thesportisë.

Ndërkohë në vitin 1953 ndodh një akt i paprecedent ndërkombëtar. Qeveria e kryesuar nga Enver Hoxha, shpalli dekretin me nr.1654 ku iu dha nënshtetësinë shqiptare të gjithë çamëve që banonin në Shqipërinë komuniste³⁴ . Një akt i tillë, pra heqja dore nga shtetësia duhej bërë me dëshirë dhe kërkesën e çamëve, ndërkohë që një kërkesë të tillë nuk ka patur nga shqiptarët e Çamërisë, çka jo vetëm çon në një precedent ndërkombëtar , por kulmonte me dhënien e shtetësis në mënyrë kolektive , pa patur asnjë kërkesë për heqje dorë nga shtetësia greke. Këtu bëhej fjalë për çamët të cilët juridikisht e zotëronin shtetësinë greke, jo për atë grupim çamësh të cilëve u ishte hequr shtetësia për krim të lart shtetëror si pasojë e bashkëpunimit me nazizmin nga Gjykata e Janinës në vitin 1945 dhe 1946. Kjo në fakt hasi në një rezistencë të argumentit juridik nga ana e Seksionit Juridik të Kuvendit Popullor i cili argumentoj se:

1. Dhënia e nënshtetësisë shqiptare do të sillte automatikisht humbjen e nënshtetësisë greke si dhe të çdo të drejte apo detyrimi që lidhej me të

2. Si dhe, me hyrjen në fuqi të këtij dekreti çamët do të bëheshin shtetas shqiptar me ose pa dëshiren e tyre. Në fund Seksioni Juridik pranoi se ky ishte një precedent i pazakontë në arenën ndërkombëtare qoftë për faktin e dhënies së shtetësisë në mënyrë kolektive, qoftë edhe për shkakun se nuk ka patur me pare një kërkesë të till nga ana e çamëve. Në fund ky dekret hyri në fuqi dhe të gjithë ata të cilët nuk dëshironin marrjen e nënshtetësisë shqiptare duke ditur pasoja që kjo mund të sillte në raport me pronat e tyre në Çamëri, u ndoqën e përndoqën penalisht nëpër burgjet e regjimit komunist.

³³ Mentor Nazarko “Lufta e fundit, pronat e shqiptareve ne Greqi” fq.72

³⁴ Arkivi Qendror I Shtetit (AQSH)

Kjo ishte nje “dhurate” per Greqine e cila me ligjet e mepasshme legjitimioj veprimtarine e saj ne dem te pornave te cameve. Ne vitin 1972 u aprovua ligji nr.1108 i 28.01.1972 “Mbi rikthimin e pasurive te patundshme te pasurive bujqesore te konfiskuara”³⁵. E vecanta e ketij ligji ishte se parashikonte kthimin e pronave edhe per personat qe kishin bashkepunuar me nazifashizmin, Ne pamje te pare duket sikur nga ky ligj camet do te perfitonin. Mirepo nuk rezulton keshtu, sepse ligji parashikonte dhenien e ketyre pasurive persomnave te lartpermendur te cilet e kishin shtetesine greke ne vitin 1972. Keshtu per kategorine e pare te cameve , ate kategori prej 1930 vetash qe kishin bashkepunuar me nazifashizmin e te cileve u ishte konfiskuar pasuria , ky ligj nuk mund te zbatohej pasi ketyre personave u ishte hequr ne ate periudh edhe shtetesia, ndersa per camet e tjere te cilet pesuan genocidin ne kurriz , por qe nuk kishin asnje lloj denimin nga gjykatat greke , ky ligj nuk mund te zbatohej gjithashtu sepse cameve u ishte dhene ne vitin 1953 ne menyre kolektive e me dhune shtetesia shqiptare nga regjimi komunist i Enver Hoxhes. Perfituesit e vetem te ketij ligji ishin, familjen greke te cilet ishin ende ne Greqi , por qe paraardhesit e tyre kishin bashkepunuar me nazifashizmin. Nje tjetër ligj me nr.1540 miratohet ne vitin 1985 “Per riintegrimin e refugjateve politik”³⁶. Sipas ketij ligji konsideroheshin refugjate politike te gjithë shtetasit grek te cilet si pasoje e luftes civile kishin lene vendin pas vitit 1945. Sic mund te shihet edhe ne kete ligj camet nuk mund te konsideroheshin refugjat politik pasi nuk e kishin shtetesine greke dhe ne cdo ligj qe ka te beje me pronat te miratuar prej Greqise, permendja e terminologjive “passaporte, “toke e braktisur” , shtetesi greke” , shprehin qartesisht faktin e vetem se lufta e Greqise nuk ka qene kunder bashkepunetoreve te nazizmit, as per nje shtet te drejte e te denje , por qe nga viti 1923 shohim ligje, te cilet kerkojne me ngulm duke perfituar nga situata te ndryshme ne kohe te ndryshme , jo vetem perfitimin, zoterimin dhe posedimin e pronave te cameve musliman , por edhe largimin e tyre nga vendi i te pareve te tyre.

Organizatrat politike te cameve

Pas renies se diktatures, rihapet edhe ceshtja came. Ne 10 janar te vitit 1991 themelohet Shoqata Patriotike Politike Atdhetare Cameria, e cila ne themel kishte zgjidhjen e ceshtjes came. Shoqata nisi menjeher punen e saj duke

³⁵ “Lufta e fundit, pronat e shqiptareve ne Greqi” Mentor Nazarko

³⁶ Shih po aty...

sensibilizuar opinionin mbareshqiptare si ate publik ashtu edhe ate politik. Ardha e Kryeministrit Micotaqis ne Shqiperi, rindezi camet. Ne Tirane ne vitin 1992 Micotaqis “deklaroi se ekziston mundesia e njohjes se pronave te tyre(cameve)” . Kjo deklarate vjen ne saj te nje kembemgulje te madhe te homologut shqiptare edhe si pasoje e presionit te ardhur nga Shoqata³⁷ . Puna e kesaj OJF-je , vazhdoj ku ne vitin 1994 Parlamenti i Shqiperise shpalli me *ligjin nr.7839 date 30.06.1994* “Per shpalljen ne kalendarin kombetar te dates 27 qershor si ditën e genocidit shovinist grek ndaj shqiptareve te Caamerise³⁸. Ne 1 nentore 2000 Shoqata “Cameria” i drejton zyrtarisht nje kerkese Presidentit Republikes se Shqiperise,Rexhep Meidanit , *shfuqizimin e dekretit nr.1654/1953* me anen e te cilit sic e pame,camet ishin kthyer ne menyre kolektive shtetas grek nga regjimin komunist. Argumenti i perdorur nga Shoqata ishte se ky akt perbente nje shkelje themelore te te drejtave te njeriut duke qene se nga camet nuk ka patur nje kerkese paraprake per nje veprim te tille. Presidenca e refuzoj kerkesen e cameve me argumentimin se si ne legjislacionin europian ashtu edhe ne ate kombetar , kusht per heqje dore nga shtetesia shqiptare perbente pranimi zyrtare i nje nenshtetesis tjetere, ose garancia zyrtare e nje shteti tjetere per dhenien e nenshtetesis.³⁹ Takimet e shumta me krere te OSBE-se, dhe veprimtaria do te ishte e zjarrete e shoqates, derisa ne vitin 2004 Shoqata me ndihmen e disa deputeteve depoziton ne Kuvend per miratim nje rezolute per ceshtjen came e cila ne seancen parlamentare te dates 26 mars 2004 Kryetari i Kuvendit Servet Pellumbi deklaroi se mbi bazen e votimit te deputeteve (53Pro, 4 Kunder dhe 55 Abstenim) kjo rezolute nuk miratohej. Protestat e medha dhe pakenaqesia e komunitetit cam arriti deri ne krijimin e nje partie politike. Ne vitin 2012-2013 Partia Drejtësi Integrim Unitet e cila mbron te drejtat e komunitetit cam, depozitoj nje rezolut per miratim, ku nga hetimet parlamentare rezultoj se rezoluta came ne vitin 2004 ishte miratuar jo me rezultatin e dhene nga Kryetari i Kuvendit te kohes , por me 53 vota Pro, 3 kunder dhe 44 abstenim⁴⁰. Megjithese rezoluta rezultoj e miratuar dhe hyri ne fuqi plot 9 vjet me vone, eshte e pakonceptueshme se si 47 deputet te kuvendit te Shqiperise nuk votojne pro jo vetem ne mbeshtetje te aspiratave kombetare , por mbi te gjitha ne mbeshtetje te plot te lirive dhe te drejtave themelore te njeriut per pronat, jeten dhe levizjen e lire. Ne vitin 2013 PDIU arrin te marre 5 mandate deputetesh dhe ne 2016 pas kontaktimin me nje studio ligjore birtanike dhe me Prokurorin e mirenjohur te Gjykates Nderkombetare Penale Karim Khan, pranoj avancimin e

³⁷ Revista “Cameria” qershor 2014

³⁸ Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 7839 date 30 qershor 1994

³⁹ Gazeta “Koha Jone” 20 shtator 2000 dhe 24 shkurt 2001

⁴⁰ Pamjet filmike te TV “Ora News” 2013

ceshtjes came ne rruge ligjore. Ne 4 qershor te vitit 2016 ne Kongresin e PDIU, ne prani te deputeteve , Kryeministrit Rama dhe te cameve , Khan theksoj se ndjekja ne rruge ligjore eshte plotesisht e mundur, megjithese kerkon mbeshtetjen maksimale shtetere qofte ne raportin politik ashtu edhe me venien ne levizje dhe bashkepunim te plote em Avokatin e Shtetit te Shqiperise. Nder te tjera Khan i cilesoj pretendimet e cameve si pretendime te drejte, e drejte e cila duhet luftuar qe te fitohet dhe per te cilat njerezimi nuk duhet te hesht kurre⁴¹ . Pas ketij viti situata politike e ketyre dy organiozatave ne mbrojtje te cameve erdhi duke u zbehur si pasoje e shume faktoreve te brendshem dhe te jashtem.

Zgjidhja e mundshme e ceshtjes came

Problemi cam u perkeqesua me teper pas vitit 1953 kur ne menyre te dhunshme , pa asnje kerkese per heqjen dore nga shtetesia greke, duke shenuar nje precedent nderkombetar iu imponua me dhune , force dhe kolektivisht shtetesia shqiptare. Ne kete moment, shqiptaret e Camerise automatikisht u bene subjekt i Ligjit te Forces i cili sekuestroj pasurite armike te shtetasve shqiptare. Problemi cam dhe i pronave te shqiptareve te Camerise ndahet ne 4 faza

- Faza e pare , eshte faza e shpronesimeve pas vitit 1923, ku pati nje pervetesim te padrejte te pronave te cameve nga shteti grek, kjo per t'i ardhur ne ndihme refugjateve nga Turqia

- Faza e dyte konsiston me konfiskimin dhe heqjen e shtetesisë per bashkepunetoret e nazizmit, ku u denuan 1930 cam.

- Ne fazen e trete perfshihen kategoria e cameve per te cilet nuk ka patur denime penale nga ana e gjykata greke, por qe i jane sekuestruar pronat me ligje add hoc nga ana e shtetit grek

- Faza e katert eshte ajo e diteve te sotme, kur shteti grek nuk lejon kalimin ne kufij te shtetasve shqiptare te cilet ne passaporten e tyre kane te shkruajtur “vendlindja: Cameri”

Le te nisim nje shqyrtim sado modest nga kjo e fundit. Shume shtetas shqiptare me origjine nga Cameria, nuk jane lejuar te kalojne ne Republikën e Greqise me arsyetimin e organeve kompetente se keta shtetas jane te rrezikshem per shtetin grek, kane qene bashkepunetor te nazizmit dhe per shkak te toponimit

⁴¹ Pamjet filmike te TV “Ora News” 6 qershor 2016

te vendeve te cilat tashme ka ndryshuar (sic mund te jene fshatrat e Camerise te quajtur si Kuc, Varfanj, Arpice, Vole, dhe qe shteti grek u ka ndryshuar emrat ne Polineri, Parapotamos, Perdika, Syvota etj). Nje nder pretendimet greke eshte se keta shtetas te cilet ne passaportene tyre kane vendlindjen “Cameri” , jane pasardhes te krimineleve te luftes.

Greqia eshte vend anetar i Bashkimit Evropian , ratifikues i Konventave nderkombetare, sic eshte Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut. Ne kete kuptim Greqia jo qe nuk eshte nje vend demokratike , por tregon ne pah parime te vendeve diktatoriale, te cilat gjykojne pasardhesit per fajet e paraardhesve. Realiteti eshte se nga 30 mije cam te debuar per ne Shqiperi, vetem 1930 cam u denuan si bashkepunetor te nazizmit, ose 6 % e popullsisë. Megjithese persa i takon vendimit te gjykates ka shume pikepyetje duke nisur qe nga fakti se kjo gjykate perbehej jo nga gjyqatare, por nga pjestera zerviste, pra nga pale ne proces te cilet mundesuan ne mungese kete vendim. Mirepo le te marrim te mirqene faktin hipotetik te denimin si bashkepunetor te nazizmit te te gjithë cameve pa dallim.

Pyetja qe lind eshte si mundet sot pas 80 vjetesh, te denosh femijet e atehershem te cilet kane qene 2, 5 apo 7 vjec , e qe sot jane mbi 80 vjec me arsyetimin komunist se jane pasardhes te nazistëve, e te mos i lejosh te kalojne ne kufij e te hyjne ne Greqi , kur passaporta e ketyre shtetasve eshte teper e rregullt per te gjitha shtetet e tjera dhe askush nga shtete e tjera nuk ka hapur nje problem te till?

Si eshte e mundur kur Bashkimi Evropian ka nenshkruar liberalizimin e vizave me Shqiperine per te gjithë shtetasit e saj, ne menyre qe te levizin lirshem ne Evrope, Greqia te shkel kete marreveshje per kete kategori njerezisht , kur kjo kategori njerezisht e pajisur me passaporte te Republikës se Shqiperise, duke u bazuar ne liberalizimin e vizave te nenshkruar ne 2010 nga Shqiperia dhe BE , levizin kudo lirisht , pa asnje penegese ne cilindo shtet te BE-se , nderkohe qe ne Greqi jo ? Ne kete kuptim si ratifikuese e KEDNJ, Greqia ka shkelur jo vetem 1 nene te kesaj konvete, por te gjithë konventen, duke shkelur ne rradhe te pare qellimin e saj , objektin e saj dhe parimin themelor te saj, i cili eshte respektimi i te drejtave themelore te njeriut. Konkretisht Greqia shkel nenin 1 te KEDNJ, nenin 7 i cili thekson qarte se NUK KA DENIM PA LIGJ, nenin 14 i cili ndalon diskriminimin e qe ne kete rast kemi diskriminim krahinor, etnike , fetar⁴² , nenin

⁴² Konventa Evropiane e te Drejtave te Njeriut (KEDNJ)

2 te Protokollit nr.4 te KEDNJ⁴³ i cili i siguron cilitdo levizjen e lire. Nder te tjera Greqia shkel Karten e OKB-se si dhe nenet 2,3, 16, 17,20 te Paktit Nderkombetar te te Drejtave Civile dhe Politike⁴⁴, ku shkelet dhe nuk njihet personaliteti juridik i individit, nderi dhe reputacioni i tij ne menyre te paligjshme.

Zgjidhja juridike

Ne lidhje me kete eshte e udhes ngritja e nje padie me baze ligjore ne nenin 33 te KEDNJ ,nga shteti shqiptare perpara Gjykates Evropiane te te Drejtave te NJerit (GJEDNJ) kunder Greqise , per shkelje te vazhdueshme te KEDNJ , diskriminim e ndalimin e levizjes se lire te shtetasve shqiptare , pa asnje arsye juridike. Po ashtu sipas KEDNJ ne nenin 34 cdo individ ka te drejte ti drejtohet gjykates kundrejt shkeljeve te Konventes nga ana e shteteve ratifikuese te saj.

Ne fazen e trete ku perfshiheshin camet per te cilet nuk ka denime penale ndaj tyre, ka nje situatë edhe me te veshtire, per arsye se koha e gjate e moszgjidhjes se ceshtjes, ligjet add hoc te Greqise, harresa 50 vjecare e shtetit shqiptare gjate regjimit komunist kane bere punen e vete. Mirepo keta cam u bene subjekt te ligjit te forces se vitit 1940, ku sic e theksuam pas marrjes arbitrarisht te shtetesise shqiptare ne vitin 1953, pasurite e tyre automatikisht konsiderohen nga Greqia “si pasuri te shteteve armike” Ne te njejten kohe dime qe Ligji i Luftes eshte ne fuqi, vendim ky i cili eshte bere i ditur ne forme zyrtare edhe nga Ministria e Jashtme e Greqise dhe ky ligj. Duke qene se Greqia e ka ratifikuar KEDNJ ne 1953 dhe Shqiperie ne vitin 1966 dhe ne kete menyre nuk mund te kete nje padi nga ana e Shqiperise te bazuar ne nenin 33 te Konventes sic e permendem me siper, per shkelje te saj dhe dhunim te vazhdueshme te se drejtes se pronesisë, pasi nuk kemi te bejme me fuqi prapavepruese e ne kete kuptim Shqiperia ka te drejte te ngreje padi vetem pas vitit 1966 , nderkohe qe pas vitit 1945 ne Cameri situata demografike ndryshoj rrenjesisht me debimin e shqiptareve cam te fese muslimane. Duke pare edhe situaten qe tashme camet jane shtetas shqiptare dhe subjekt te Ligjit te Luftes atehere do te ishte e udhes qe sic e kemi permendur, te hiqej ligji i luftes se bashku me efektet e tij. Megjithë heqjen e tij , kjo kerkon opinion doktrinar dhe mendime te eksperteve te jurisprudences ne lidhje me pronat te cilat shteti grek i ka fituar me parashkrim fitues duke rikthyer

⁴³ Protokollit nr.4 I Konventes

⁴⁴ Nenet 2,3,16,17,20 te Paktit Nderkombetar te te drejtave Civile dhe Politike

ketu ne kujtese, ligjet qe u bene per te ashtuquajturat “toka te braktisura” dhe sipas ligjit, “toka te braktisura” cilesoheshin, tokat e shtetasve greke (cam) qe ishin larguar nga vendi pa marre passaporten. Por jo vetem ligji i vitit 1953, por edhe ligjet e mevonshme te refugjateve politik ,apo ligji i vitit 1972 i cili i rikthente pronen e konfiskuar bashkepunetoreve te nazizmit te cilet ishin ende shtetas grek. Shohim se me keto ligje shteti grek eshte kujdesur per te mos lene hapësira per pretendimin e marrjes se titullarit te prones se tyre , pronareve te vertete. Dhe pyetjes se a ka zgjidhje per ceshtjen came ? Pergjigjja eshte Po

- 1-E para eshte abrogimi total i ligjit te luftes me te gjitha efektet e tij juridike. Pyetjes se cfare pasojash do te sjell per pronaret e sotem te ketyre pronave te shqiptare, eshte vertete nje problem ne vetevete per shtetin grek ne rast se ndodh kjo gje. Pasi ne rast te nje abrogimi te ketij ligji sipas menyres se permendur ateherë pronaret e ketyre pronave te cilet mund te jene qytetare te tjere grek apo Kisha greke , do duhet te lirojne keto prona te cilat jane shperndare me ane te ligjeve te kohes dhe per te cilat shteti grek ishte bere titullar i tyre dhe kishte bere cfare te donte me ato.

- 2-Shqiptareve te Camerise u eshte hequr shtetesia ne menyre arbitrare ne vitin 1953 dhe heqja e shtetesisë ne kete lloj forme duke perbere nje precedente te pazkonte nderkombetar ne shkellen e nenin 15, pika 2 te DUDNJ⁴⁵ kerkon interpretim gjyqesor te nje pyetjeje: A eshte i drejte vendimi i qeverise shqiptare ne vitin 1953 per heqjen e shtetesisë greke, shtetasve grek me kombesi shqiptare ne menyre kolektive kur keta te fundit nuk e kane kerkuar kete gje ? Sigurisht qe kjo eshte nje pyetje te ciles vetem Gjykata Nderkombetare e Drejtesise mund t’i jape pergjigje. Duke ditur se GJND vihet ne levizje nga shtetet dhe subjekt mund te jene vetem shtetet, duke ditur vendimet e GJND mund te jene fakultative ose te detyrueshme , duke ditur se GJND jep vendime dhe mendime konsultative ne lidhje me ceshtje te ndryshme, ateherë kete pyetje Shqiperia duhet t’a adresoj ne Asamblene e OKB-se ose ne Keshillin e Sigurimit (duke marre parasysh edhe kostot per anetaresimin ne BE). Per dhenien e mendimeve konsultative GJND vihet ne levizje nga Asambleja e OKB-se , KS dhe organizata e specializuara te saj (ILO, UNESCO, FAO, ICAO, IBRD, IMF, ITU, WHO, IMCO, WMO, IFC, IDA, IAEA)⁴⁶ . Ne kete kendveshtrim dhenia e kesaj pegjigje do te sqaronte Shoqaten “Cameria” e cila disa vite me pare i kishte kerkuar Presidentit te Republikës shfuqizimin e dekretligjit 1654/1953 , shtetin shqiptare dhe do te

⁴⁵ Neni 15 I Deklarates Universale te te Drejtave te njeriut(DUDNJ)

⁴⁶ Kapitulli IV “Mendimet konsultative” te statutit te GJND-se

ndergjegjesonte organizatat nderkombetare. Ne kete menyre shteti shqiptare mund qe edhe te merrte nje rruge tjetër pas sqarimit dhe shterimit te cdo pyetjeje ne lidhje me shtetesine, duke i kerkuar shtetit grek demshperblimin per ndihmen ekonomike per kaq shume vjet ndaj shtetasve te tyre.

● 3-Padia e Shqiperise kundrejte Greqise per genocid ne GJND, eshte nje tjetër forme e zgjidhjes se ceshtjes came. Ngerci juridik ketu qendron ne faktin se per te vene gjykatën ne levizje dhe per te pranuar vendimin e saj, nuk mjafton vetem vullneti i SHqiperise , por duhet nenshkrimi i marreveshjes se kompromisit midis dy vendeve i cili dakordeson vendet per konfliktin midis tyre , lenden dhe objektin⁴⁷. Ky do te ishte kompromisi qe ceshtja came te merrte zgjidhje ligjore. Per cdo kend ketu mund te lindin dy pyetje:

a) A eshte kompetente GJND per ceshtje qe kane ndodhur perpara themelimit te saj , pra perpara vitit 1945 ?

b) A do te ishte dakord Greqia te nenshkruante marreveshjen e kompromisit e cila do t'i drejtohej GJND-se e do ti jepej asaj kompetenca per dhenien e nje vendimi ligjor e per zgjidhjen njehere e pergjithmon te ceshtjes came ?

Per t'i dhene pergjigje pyetjes se pare mjafton te shohim se OKB eshte nje “vazhdimesi” e Lidhjes se Kombeve e cila ishte themeluar ne vitin 1920 dhe qe mbledhjen e saj te fundit e mbajti me 18 prill 1946, mbledhje e cila vendosi qe te gjitha te mirat e saj (ndertesat, arkivat , bibliotekat) do te kalonin ne organizaten e re. Nderkohe GJND filloj punen e saj duke zevendesuar keshtu Gjykatën e Perhershme Nderkombetare te Drejtesise e cila kishte funksionuar qe nga viti 1922. Keshtu rrjedhimisht mund te themi se patjeter qe GJND ka kompetence te gjykoje ceshtjen came me kusht te nenshkrimin te marreveshjes se kompromisit midis dy shteteve. Kjo gje pranohet gjegjesisht edhe ne nenin 36 te Statutit te GJND-se i cili thekson se Kompetenca e Gjykates shtrihet ne te gjitha ceshtjet qe do t'i parashtrohen nga palet. Per t'u bindur qe GJND ka funksion ne gjykimin e ceshtjes came , genocidi i te ciles njihet zyrtarisht me ligj nga shteti shqiptar ne daten 27 qershor 1944, mjafton te shohim vendimin e GJND-se ne vitin 1960 ne lidhje me kontestin midis Nikaraguas dhe Hondurasit per “Vendimin e arbitrazhit te dhene nga Mbreti i Spanjes ne 23 dhjetor 1906” ku Nikaragua kundërshtonte kufirin e vendosur mes saj dhe Hondurasit, e per te cilen vendet rane dakord qe t'i drejtoheshin GJND-se , e cila shqyrtoj ceshtjen dhe vendosi qe Nikaragua duhej te

⁴⁷ Kapitulli III “Procedura” neni 40 I statutit te GJND-se

zbatonte vendimin e Mbretit te cilin vete e kishte pranuar si arbiter ne traktatin e vitit 1894 midis te dy vendeve ku ne nje nene thuhej se per pikat kufitare te pazgjdhura vendimin duhej t'a merrte qeveria e Spanjes⁴⁸. Persa i takon pjeses se dyte, duke pare situaten nder vite e dekada ku Greqia eshte perpjekur me domosdoshmeri qe t'a cilesoj ceshtjen came si te mbyllur qe ne vitin 1944 -45, duket e veshtire qe te pranoj qe kjo ceshtje te zgjidhet nga GjND

Demshperblimi

Nje tjetër zgjidhje e mundshme e ceshtjes came eshte demshperblimi i shqiptareve te Camerise per shpronесimet ndaj pronave te tyre me vleren e sotme te tregut, per shfrytezimin e pronave per afro 80 vjet, per demin ekonomik e psikologjik te kryer gjate genocidit te vitit 1944-45, si dhe demshperblimin e shtetit shqiptare i cili ka dhene ndihmesen e tij ekonomike kundrejt ketyre individeve te cilet deri ne 1953 kane qene shtetas grek. Qe te vij kjo zgjidhje duke pare situaten ekonomike te Greqise dhe duke menduar se kjo do te conte ne nje krize te thelle ekonomike greke, ndoshta edhe falimentimin e saj, duket paksa e pamundur.

Zgjidhja politike

Nje zgjidhje e cila eshte perfolur shpesh, por e cila ka qene e papranueshme per shqiptaret e Camerise ka qene ajo e nje demshperblimi simbolik ndaj ceshtejs came, pjesetareve te ketij komuniteti dhe shtetit shqiptare. Ne cdo rast sic mund te shihet, eshte patjetër e nevojshme pranimi nga ana e Greqise se ka nje mosmarreveshje, se ekziston nje ceshtje e tille dhe se eshte kryer genocid nga ana forcave zerviste te kohes me mbeshtetjen e plote te shtetit grek. Vetem duke lene pas te shkuaren, me metodat e zgjidhjes dhe ndertimit te urave te bashkepunimit midis dy vendeve dhe duke mos i ngarkuar brezave te rinj ceshtjet madhore, te pazgjdhura te historise, do te ndertohet nje e ardhme me e begate midis dy vendeve duke shuar njehere e pergjithmone padrejtesite, pakenaqesite dhe merite.

⁴⁸ Official page of International Court of Justice : "Arbitral Award Made by the King of Spain on 23 December 1906 (Honduras v. Nicaragua)

Perfundimi dhe rekomandimet

Shqiperia dhe Greqia jane karakterizuar nga nje klime e cila shpesh here edhe nga deklaratat nuk i ka sherbyer fqinjesise se mire. Perpjekjet e vazhdueshme kane rezultuar te kota dhe ky deshtim vjen si pasoje e fuqise ne tryezen diplomatike qe njera pale ka. Del qarte nga cilido studim historik te autoreve shqiptare dhe autoreve grek, megjithese autoret grek i japin nje terminologji me te zbutte masakrave ne Cameri duke i konsideruar si “spastrim etnik”, ne fakt rezulton se eshte kryer nje genocid i pashembullt, me 5800 shtepi te shkaterruara ne 68 fshtara, 102 xhami te djegura, 2771 civil te masakruar dhe 3000 te tjere qe vdiqen rrugeve gjate shtetetimit te tyre per t’i shpetuar plumbave dhe mbi 30 mije te debuar qe te gjithe shqiptare musliman te krahines se Camerise, jane tregues te qarte te permasave te nje genocid te ndermarra nga forcat nacionaliste EDES, te Zerves te mirerekomanduara edhe nga shteti grek.

Arsyeja se perse ceshtja came nuk zgjidhet, nuk eshte vetem ceshtja e humbjeve te jeteve njerezore, por ceshtja e pronave dhe megjithese nuk eshte permendur ne punim, por me te njejtat menyra qe u “grabiten” pronat e cameve, jane grabitur dhe kryer te njejtat krime edhe ndaj sllavo-maqedonase, edhe ndaj hebrenjve te cilet kane qene nje komunitet mjaft i madh ne Selanik ku mbi varrin masiv te te cileve eshte ngritur Universiteti i Selanikut. Megjithese per t’u rikthyer ceshtjes came, ishte e dukshme dhe teresisht objektiv konkluzioni qe jo vetem te kryerjes se nje genocidi, apo grabitjes se pronave, por edhe te ligjeve te mepasshme te cilat pamundesonin marrjen e pronave nga ana e shqiptareve cam. Kujtojmë ketu qe shteti grek denoj 1930 cam si bashkepunetor te nazizmit duke u hequr shtetesine dhe duke i konfiskuar pronat. Si bashkepunetor nazist u denuan edhe shtetas te tjere grek, por pa iu hequr shtetesia. Ne vitet e mepasshme, shteti grek miratoj ligje te cilat iu mundesonin edhe bashkepunetoreve te nazizmit marrjen mbrapsht te pronave te konfiskuara, te vetmit qe nuk perfitonin ishte ai grupi i 1930 cameve te cilet nuk kishin shtetesine greke ne ate sepse iu ishte hequr nga Greqia. Per grupin tjeter te cameve, ata te cilet nuk kishin asnje denim, Greqia u kujdes qe me ligjet ku terminologjia e perdorur mbi passaporten, pronat e braktisura, te pamundesonte zgjidhjen e ceshtjes came duke ia shtuar edhe me shume dozen e padrejtesive kesaj ceshtje e ketyre njerezve.

Eshte e rendesishme te thuhet edhe qe sistemi komunist i Enver Hoxhes me aktin e vete te paprecedent, ate te heqjes se shtetesise, rendoj zgjidhjen e ceshtjes came. Megjithese Greqia e mohon ekzistencen e kesaj ceshtje, eshte e

Pas ndalimit të një luftëje, dalin në pah tre mundësi: ose armata është mundur, është fituese, ose është pajtuar në një ndalim të armëve. Parimet e drejtësisë mund të aplikohen pastaj në çdo situatë. Orend prezanton një përmbledhje të dobishme të parimeve të jus pas bellum: parimi i diskriminimit duhet të përdoret për të shmangur ndëshkimin e pafajshëm të të pafajshëmve ose jo-pjesëmarrësve në luftë; të drejtat ose traditat e të pësuarve duhet të

¹ Lisa Kemmerer, “Just War and Warrior Activists”, 2009, Fq.25

respektohen; pretendimet e fitores duhet të jenë proporcionale me karakterin e luftës; pretendimet kompensuese duhet të moderohen nga parimet e diskriminimit dhe proporcionalitetit; dhe, në mënyrë kontroversiale, duhet të merret në konsideratë nevoja për rehabilitimin ose riedukimin e një agresori.²

Lufta e drejtë në histori

Lufta e Parë Botërore (1914-1918) ishte e planifikuar të ishte “lufta për të përfunduar të gjitha luftërat”, një konflikt përfundimtar për të vendosur cilat kombësi ishin më të fuqishmet. Pjesërisht si rezultat, pothuajse 10 milionë ushtarë vdiqën në luftë. Ata që arrinin në frontin e betejës ishin mostly burra të thjeshtë të rinj që kishin lënë shkollën vetëm pak kohë më parë. Charles Alexander, nga Oxfordi, Anglia, ishte 18 vjeç kur ishte midis miliona të thirrur për të luftuar. Gjatë Luftës së Parë Botërore, trupat nga të dyja anët luftonin nga kapanone të gjata dhe të ngushta të zakonshme të thellësuar në tokë.³

Tradita agustiniane

Tradita agustiniane e mendimit për luftë të drejtë ishte një aplikim i teorisë politike mesjetare me rrënjë në antikitet që u pjek në shprehjen klasike gjatë Luftërave të Besimeve. Kjo teori politike para-Prosveshjes bazohet në idenë se ligji natyror ekziston dhe duhet të udhëheqë rendin shoqëror dhe politik njerëzor për të përmbushur aspiratat morale natyrore të njeriut; se sovraniteti do të thotë përgjegjësi për mirëqenien e përbashkët; dhe se drejtësia duhet të udhëheqë shtetet për të përdorur forcën për të mbrojtur dhe për të ndihmuar në mirëqenien e përbashkët. Në këtë kontekst, shkak i drejtë për luftë kuptohet si përfshirje jo vetëm e mbrojtjes së vetvetes, por edhe mbrojtja e drejtësisë dhe paqes, mbrojtja e të pafajshmeve dhe ndëshkimi i të ligëve—sipas standardeve teleologjike të pranuar përgjithësisht të ligjit natyror.⁴

Luftërat e hershme moderne është koha e luftës që vijoi pas luftës mesjetare. Kjo periudhë është e lidhur me fillimin e përdorimit të gjerë të barutit

² <https://iep.utm.edu/justwar/#H4> Aksesuar më 24.04.2024

³ Geoff Barker, “War” Mankato, Minn. : Smart Apple Media, 2010, Fq. 8

⁴ <https://erlc.com/resource-library/articles/the-history-and-purpose-of-just-war-doctrine/>
Aksesuar më 24.04.2024

dhe zhvillimin e armëve të përshtatshme për përdorimin e shpërthimit, duke përfshirë artilerinë dhe armët zjarri; për këtë arsye, kjo periudhë quhet gjithashtu epoka e luftës me barut (një koncept I prezantuar nga Michael Roberts në vitet 1950). Kjo periudhë e tërë është e përfshirë brenda Epokës së Fluturimit, e cila dominonte taktikat detare të kohës, duke përfshirë përdorimin e barutit në artileri detare.⁵

Ligjet ndërkombëtare të luftës

Rregullat e luftës, ose ligji ndërkombëtar humanitar (siç njihet formalisht) janë një set rregullash ndërkombëtare që përcaktojnë çfarë mund të bëhet dhe çfarë nuk mund të bëhet gjatë një konflikti të armatosur.

Qëllimi kryesor I ligjit ndërkombëtar humanitar (LNH) është të mbajë një pjesë njerëzore në konfliktet e armatosura, duke shpëtuar jetë dhe duke zvogëluar vuajtjen.

Për të kryer këtë, LNH rregullon mënyrën si luftohen luftërat, duke e balancuar dy aspekte: dobësimin e armikut dhe kufizimin e vuajtjes.

Rregullat e luftës janë universale. Konventat e Gjenevës (që janë elementi kryesor I LNH) janë ratifikuar nga të gjitha 196 shtetet. Shumë pak traktate ndërkombëtare kanë këtë nivel mbështetje.

Të gjithë që luftojnë një luftë duhet të respektojnë LNH, si forcat qeveritare ashtu edhe grupet armike jo-shtetërore.

Nëse rregullat e luftës shkelën, ka pasojat. Krime lufte dokumentohen dhe hetohen nga shtetet dhe gjykatat ndërkombëtare. Individët mund të ndjekën penalisht për krime lufte.⁶

⁵ https://en.m.wikipedia.org/wiki/Early_modern_warfare#/languages Akseluar më 24.04.2024

⁶ Artikull <https://www.icrc.org/en/document/what-are-rules-of-war-geneva-conventions> Akseluar më 25.04.2024

Krimet e luftës

Disa shembuj të veprimeve të ndaluara përfshijnë: vrasjen; mutilimin, trajtimin e rëndë dhe torturën; marrjen e pengjeve; drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër popullsisë civile; drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër ndërtesave të dedikuara për religjion, arsim, art, shkencë ose qëllime bamirësie, monumenteve historike ose spitalet; rëndom; dhunën seksuale, skllavërinë seksuale, shtatzëninë e detyruar ose çdo formë tjetër të dhunës seksuale; verberimin ose rekrutimin e fëmijëve nën moshën 15 vjeç në forcë të armatosura ose grupe ose përdorimin e tyre për të marrë pjesë aktivisht në armiqësi.⁷

Intervenimet humanitare

Intervenimi humanitar është një term që u bë i zakonshëm gjatë viteve 1990 për të përshkruar përdorimin e forcës ushtarake nga shtetet ose organizatat ndërkombëtare në përgjigje të genocidit, “përthyerjes etnike” dhe tjera horrre të përjetuara nga popujt në duart e qeverive të tyre. Por rastet e ndërhyrjeve të armatosura nuk janë të reja. Disa herë gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë pushtetet evropiane intervenuan ushtarakisht në disa provincat e Perandorisë Osmane për të mbrojtur enklavat kristiane nga masakra ose shtypja (Bass).⁸

Detyra morale për ndërhyrje forcohet edhe më tej nga një trup i madh filozofie politike që argumenton se shtetet që kryejnë sistematikisht krime kundër qytetarëve të tyre janë përgjegjës për komunitetin ndërkombëtar. Siç theksoi filozofi gjyqësor hollandez Hugo Grotius, “mbretërit, dhe ata që kanë të drejta të barabarta me ato të mbretërve, kanë të drejtën për të kërkuar ndëshkim jo vetëm për shkak të lëndimeve të kryera kundër tyre ose nënshtetasve të tyre, por edhe për shkak të lëndimeve që nuk i prekin drejtpërdrejt ata, por shkelin në mënyrë të tepërt ligjin e natyrës ose të kombit në lidhje me çdo person të çfarëdo natyre”.⁹

Edhe pse rregulli i mos-ndërhyrjes shpesh mbrohet si një garanci e rendit ndërkombëtar, përkushtimi i paepur për të nuk mund të justifikohet moralisht kur

⁷ Artikulli I OKB <https://www.un.org/en/genocideprevention/war-crimes.shtml> Aksuar më 25.04.2024

⁸ Artikull <https://iep.utm.edu/hum-mili/> Aksuar më 25.04.2024

⁹ Artikull <https://www.e-ir.info/2012/01/30/humanitarian-intervention-an-exploration-of-its-justification-and-best-practices/> Aksuar më 25.04.2024

qeveritë kryejnë ose lejojnë atrocitetet në territorin e tyre. Në raste të tilla, ndërhyrja është e lejuar dhe madje mund të jetë detyruese. Duke u bazuar në idetë e Rousseau, Kantit, dhe në një masë më të vogël Hegelit, ky artikull shqyrton bazat e argumentit për ndërhyrjen humanitare, duke treguar se ndërhyrja është në parim jo vetëm e lejuar, por edhe e detyrueshme kur konsiderohet filozofikisht. Drejta për të ndërhyrë mund të mbështetet në moralin e përbashkët, mbrojtjen e sovranitetit dhe forcën e drejtësisë. Detyra për të ndërhyrë bazohet në një respekt për njerëzimin dhe marrëdhënien konceptuale midis të drejtave dhe detyrave. Duke konsideruar këto dy linja argumentuese tregon se ndërhyrja humanitare mund të konceptohet si një detyrë që shtetet mund të kërkojnë me arsye të bëjnë.¹⁰

Evoluimi i luftës-ese

Lufta ka qenë pjesë e pandarë e historisë së njerëzimit, duke formuar shoqëritë, ekonomitë dhe politikat për mijëra vjet. Nga betejat antike të luftuara me shkop dhe shpata deri te konfliktet moderne të luftuara me teknologji të avancuar, zhvillimi I luftës reflekton kërkesën e vazhdueshme të njerëzimit për pushtet, burime dhe dominancë. Ky ese eksploron fazat kryesore në zhvillimin e luftës, duke ndjekur transformimin e saj nga konfliktet primitive në përplasje gjeopolitike komplekse. Arti I luftës u kodifikua në tekste si “Arti I Luftës” I Sun Tzus, që thekson strategjinë, mashtrimin dhe manovrën në fushën e betejës.

Gjatë periudhës mesjetare, lufta pësoi ndryshime të konsiderueshme me ngjytjen e feudalizmit dhe dominancën e kalorësve dhe kalasheve. Zotëritë feudale formuan ushtri të kalorësve dhe ushtarëve për të mbrojtur territoret e tyre dhe për të zgjeruar domenin e tyre përmes pushtimit. Lufta e shthurjes u bë më e zakonshme, me kalashe që shërbenin si fortesa fortifikuese që ishin të vështira për tu thyer. Introdiktimi I barutit në periudhën e vonë mesjetare e transformoi luftën përsëri, duke çuar në zhvillimin e topave dhe armëve zjarri që revolucionizuan taktikat e sulmit dhe strategjitë në fushën e betejës.

Periudha e hershme moderne pa shpërndarje të gjerë të armëve me barut dhe shfaqjen e ushtrive profesionale qëndrore. Zbulimi I mushkërive dhe topave

¹⁰ Artikull <https://www.cambridge.org/core/journals/review-of-international-studies/article/abs/duty-to-oppose-violence-humanitarian-intervention-as-a-question-for-political-philosophy/D17FEEE687217373620FA73F96C4972F> Aksesuar më 25.04.2024

ndryshoi natyrën e luftës, duke bërë betejat më vdekjeprurëse dhe vendimtare. Lufta e Tridhjetë Vjetëshe dhe Luftat Napoleonike treguan ndikimin shkatërrues të zjarrit në fushën e betejës, si dhe rëndësinë e logjistikës, strategjisë dhe udhëheqjes në fushatat ushtarake. Luftarët detarë gjithashtu parashikuan përparimin e taktikave detare gjatë kësaj periudhe.

Revolucioni industrial bëri hyrjen në një epokë të re të luftës, e cila karakterizohet nga prodhimi masiv, mekanizimi dhe lufta totale. Lufta Civile Amerikane dhe Lufta Botërore e Parë treguan kombinimin vdekjeprurës të teknologjisë industriale dhe taktikave moderne, me mitralozë, artileri dhe tanke që riformuan fushën e betejës. Regjimet totalitare si Gjermania Naziste dhe Rusia Sovjetike përfituan nga teknologjia moderne për ambiciet e tyre ushtarake, duke çuar në gjithë përmasat e Luftës së Dytë Botërore.

Në erën pas Luftës së Dytë Botërore, lufta ka vazhduar të zhvillohet me avancimin e teknologjisë, komunikimit dhe strategjisë. Konkurrenca e Luftës së Ftohtë midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik çoi në zhvillimin e armëve bërthamore dhe konceptit të shpërndarjes. Rritja e luftës asimetrike dhe aktorëve jashtë shtetit ka sfiduar konceptet tradicionale të luftës, duke hedhur poshtë kufijtë midis luftëtarëve dhe civilëve. Lufta e Gjirit, Lufta kundër Terrorizmit, dhe konfliktet në Afganistan dhe Irak kanë treguar rëndësinë e armëve të drejtuar me saktësi, teknologjisë së dronit, dhe luftës informative në operacionet ushtarake moderne.

Zhvillimi I luftës është një dëshmi e kapacitetit të njerëzimit për inovacion, adaptim, dhe shkatërrim. Nga betejat antike të luftuara me armë primitiv deri te konfliktet moderne të luftuara me teknologji të avancuar, natyra e luftës ka ndryshuar dramatikisht në kohë.

Pacifizmi dhe lufta jo e dhunshme

Pacifizmi është një besim ose ideologji që kundërshton dhunën dhe luftën si mjet për zgjidhjen e konflikteve. Ai shpesh propozon rezistencën paqësore dhe zgjidhje paqësore për mosmarrëveshjet. Ky koncept ka rënjë të thella historike dhe shpesh lidhet me besime fetare ose etike. Mund të shfaqet në forma të ndryshme, nga objektimi I ndërgjegjshëm I individëve deri te lëvizjet e organizuara që përhapin paqen dhe zhdukjen e armatimit. Disa figurat e njohura të lidhura me pacifizmin përfshijnë Mahatma Gandhin, Martin Luther King Jr., dhe Bertha von Suttner. Ka interpretime të ndryshme dhe nivele përkushtimi ndaj

pacifizmit, duke filluar nga refuzimi absolut për të marrë pjesë në çfarëdo forme dhune deri te qasje më pragmatike që e paraqesin strategjinë paqësore por mund të pranojnë përjashtime në rrethana të jashtëzakonshme.

Në religjionet ku refuzimi është nënshtruar një pranimi themelor të depozitit të besimit ose Kerygma, ky I fundit është I prirur për zhvillim organik dhe të vazhdueshëm. Si ky zhvillim përparon, elementët e refuzimit kanë tendencë të bëhen pronë e veçantë e minoriteteve, qofshin ato sektare ose monastike. Fundja, atje ku nuk ka refuzim, një religjion zhvillohet përmes zgjerimeve të thjeshta, ekstrapolimeve dhe elaborimeve ligjore.

Me fjalë të tjera, në masën që bota refuzohet absolutisht, një fe mbetet në mënyrë të pashmangshme besimi I një pakice, ndërsa në shkallën që bota pranohet, fetë kanë mënyra të ndryshme të përshtatjes me shumicën.¹¹

Në shekullin 21, pacifizmi është mbajtur gjallë nga një sërë lëvizjesh dhe organizatash që punojnë për paqen dhe zhdukjen e dhunës. Këto përfshijnë organizata të ndryshme të shoqërisë civile, si dhe individë dhe grupime që promovojnë metoda paqësore për zgjidhjen e konflikteve dhe parandalimin e luftës. Përdorimi I teknologjisë dhe rrjeteve sociale ka lehtësuar komunikimin dhe mobilizimin e pacifistëve dhe aktivistëve për paqen në nivel global. Megjithatë, sfidat e shekullit 21, si konfliktet ndërkombëtare, terrorizmi, dhe përhapja e armëve të shkatërrimit masiv, vazhdojnë të sjellin sfida për pacifistët dhe për qëllimin e tyre për paqe.

Lufta e drejtë në epokën digjitale

Gazetarët kanë përshkruar invazionin e Ukrainës si “luftën e parë e TikTok-ut në botë”, “luftën më të aksesueshme në histori në internet” dhe “luftën më virale në histori në mediat sociale”. Por ky lloj euforie na tregon vetëm aq shumë për impaktin real të teknologjisë dixhitale në konfliktin aktual.

Deri më tani, tre tendenca dixhitale të rëndësishme janë dalë nga lufta në Ukrainë. Së pari, inovacioni teknologjik ka ndihmuar Ukrainën të kompensojë avantazhin ushtarak konvencional të Rusisë, veçanërisht duke rritur pjesëmarrjen

¹¹ Martin David.A, “Pacifism; an historical and sociological study”, New York, Schocken Books, 1966, Fq 203

e qytetarëve të zakonshëm. Së dyti, pasi këta qytetarë janë përfshirë në mënyrë unike në luftën dixhitale, vijat midis aktorëve civilë dhe ushtarakë janë zbehur.¹²

Tani që Rusia ka pushtuar Ukrainën dhe ka kërcënuar SHBA-në dhe NATO-n, duhet të kuptojmë se lufta kibernetike mund të përbëjë rreziqe të gjera. Ka të ngjarë që nuk do të ketë asnjë ushtar të vetëm rus në territorin e SHBA, por kjo nuk do të thotë se rrjeti ynë elektrik dhe infrastruktura kritike janë të sigurta. Ashtu si një grup krimi me bazë në Rusi mendohet se ka ndërprerë furnizimin me gaz të vendit gjatë hakimit të gazsjellësit kolonial në vitin 2021, ai komb ose individë brenda territorit të tij mund ta bëjnë këtë në një shkallë më të madhe me rrjetin elektrik, furnizimet me gaz ose të tjera thelbësore.

Fakultetet në disa universitete gjermane janë ankuar në faqet e mediave sociale për ndërprerjen e emailit të tyre për disa orë. Ndërsa origjina e këtyre problemeve është e paqartë, çështja nxjerr në pah dobësitë e komunikimeve bazë dhe nevojën për vigjilencë personale kundër malware, sulmeve të phishing dhe heqjes së ransomware.¹³

Përfundime dhe rekomandime

Ndryshimet në teknologjinë dixhitale dhe natyra e re e konflikteve kanë sjellë sfida të reja për praktikën dhe perceptimin e “e drejtës së luftës”, duke rritur nevojën për një përshtatje të vazhdueshme të ligjit ndërkombëtar humanitar për të adresuar këto sfida.

Luftrat dixhitale kanë shkaktuar bllofime të linjave tradicionale midis sferave të luftës dhe paqes, duke nxitur nevojën për një përcaktim të qartë të aktorëve dhe veprimeve që janë të lejuara në këtë kontekst.

¹² <https://warontherocks.com/2022/12/disentangling-the-digital-battlefield-how-the-internet-has-changed-war/> Aksesuar se fundmi me 28.04.2023

¹³ <https://www.brookings.edu/articles/surviving-digital-war/> Artikull Aksesuar më 28.04.2024

E drejta e luftës duhet të ndryshojë për të përfshirë kufizimet dhe rregullat e reja për konflikteve të reja, përfshirë sulmet dixhitale, përdorimin e robotëve ushtarakë, dhe mbrojtjen e infrastrukturës dixhitale.

Në një botë ku shkatërimi I armëve të masës dhe lufta cibernetike janë në rritje, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbrojtja e ligjit humanitar është thelbësore për parandalimin e konflikteve të mëtejshme dhe për mbrojtjen e popullatave civile.

Përparimi I teknologjisë dhe përdorimi I armatimit dixhital rrisin nevojën për reflektim të thellë mbi etikën dhe moralitetin e përdorimit të forcës, dhe për rritjen e përpjekjeve për të promovuar paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Aktualizimi I ligjit ndërkombëtar: Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare duhet të përshtaten me kushtet e reja të konflikteve, duke përfshirë luftrat dixhitale dhe përdorimin e teknologjisë së avancuar ushtarake. Kjo përfshin rivlerësimin dhe përditësimin e konventave dhe protokolleve ekzistuese për të reflektuar realitetin aktual.

Ndërtimi I kapaciteteve: Investimet në trajnime dhe teknologji të specializuara për forcat ushtarake dhe personelin juridik janë të nevojshme për të siguruar që operacionet ushtarake të përputhen me standardet e drejtës së luftës dhe të shmangin dëmtimin e civilëve.

Përcaktimi I përgjegjësisë: Shtetet duhet të bëjnë përpjekje për të identifikuar dhe ndëshkuar ata që shkelin ligjin humanitar ndërkombëtar, përfshirë sulmet e qëllimshme ndaj objekteve dhe personelit civil, si dhe sulmet dixhitale që shkaktojnë dëme të konsiderueshme.

Promovimi I dialogut dhe bashkëpunimit: Komuniteti ndërkombëtar duhet të punojë në mënyrë të ngushtë për të zgjidhur konflikte dhe për të parandaluar eskalimin e tensioneve, duke promovuar negociatat dhe zgjidhjet paqësore në mënyrë të barabartë dhe të ndershme.

Edukimi dhe sensibilizimi: Është e rëndësishme të sensibilizohet opinioni publik dhe personeli ushtarak për rregullat dhe parimet e drejtës së luftës, duke përfshirë mbrojtjen e popullatave civile dhe respektimin e rregullave humanitare në çdo kohë.

Burimet

1. Lisa Kemmerer, “Just War and Warrior Activists”, 2009, Fq.25
2. Geoff Barker, “ War” Mankato, Minn. : Smart Apple Media, 2010, Fq. 8
3. Martin David.A ,“Pacifism; an historical and sociological study”, New York, Schocken Books, 1966, Fq 203
4. Artikull <https://www.icrc.org/en/document/what-are-rules-of-war-geneva-conventions> Aksesuar më 25.04.2024
5. Artikulli I OKB <https://www.un.org/en/genocideprevention/war-crimes.shtml> Aksesuar më 25.04.2024
6. Artikull <https://www.cambridge.org/core/journals/review-of-international-studies/article/abs/duty-to-oppose-violence-humanitarian-intervention-as-a-question-for-political-philosophy/D17FEEE687217373620FA73F96C4972F> Aksesuar më 25.04.2024
7. <https://warontherocks.com/2022/12/disentangling-the-digital-battlefield-how-the-internet-has-changed-war/> Aksesuar se fundmi me 28.04.2023
8. <https://www.brookings.edu/articles/surviving-digital-war/> Artikull Aksesuar më 28.04.202

DISKRIMINIMI GJINOR NË MARRËDHËNIET E PUNËS

PhD Candidate Ardijana Stafai

Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”, Fakulteti Juridik “Justinijani i Parë”

PhD Candidate Ardijan Stafai

Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”, Fakulteti Juridik “Justinijani i Parë”

Inordinar Prof.D-r. Argëtim Saliu

Fakulteti Juridik, Universiteti “Nënë Tereza”-Shkup

Abstrakt

Liria e shprehjes së vullnetit në zgjedhjen e një profesioni, mosdiskriminimi i kësaj zgjedhjeje për shkak të gjinisë, njohja e të drejtave dhe detyrimeve që gëzon çdo shtetas pavarësisht nga gjinia e tij/saj, niveli i mbrojtjes së rasteve abuzive të ndërprerjes së marrëdhënies së punës pa shkaqe të arsyeshme, si dhe larmishmëria e rrugëve dhe mjeteve të kësaj mbrojtjeje, janë ndër parimet më të rëndësishme, zbatimi i të cilave rrit numrin e garancive të shtetasve, jo vetëm për të punuar, por edhe për të gëzuar të mirat e fituara apo akumuluar prej saj.

Barazia gjinore mbetet një nga çështjet qëzakonisht trajtohet në marrëdhëniet familjare e bashkëshortore, apo në ato pronësore e pasurore, por nuk duhet harruar që një vend të rëndësishëm duhet të zërë ky trajtim edhe në marrëdhëniet e punës.

Barazia gjinore i referohet barazisë midis grave dhe burrave në lidhje me trajtimin e tyre, me mundësitë për punë, me të ardhurat ekonomike, si dhe arritjet sociale. Koncepti i ndarjes gjinore është parë më shpesh i lidhur me disa mendësi të krijuara për llojin e profesionit dhe vendin e punës dhe sidomos i parë lidhur ngushtë me karrierën.

Megjithatë koha po punon pozitivisht në këtë drejtim, se tabutë lidhur me këto ndasi po vijnë duke u ulur, ndonëse ritmet e uljes janë të vogla dhe ecin ngadalë. Paralelisht me këto shkaqe na

rezulton, se ndonëse ekzistojnë realisht shkaqe të tjera, si diskriminimi për shkak të gjinisë apo për shkak të përkatësive politike apo fetare, përsëri rezulton se nuk është e lehtë t'i gjesh këto lloj shkaqesh të evidencuara në faqet e dosjeve gjyqësore apo në tekstet e vendimeve gjyqësore. Shkaqet e mirëfillta me natyrë diskriminuese politike, apo me natyrë diskriminuese gjinore, mbeten në nënsipërfaqjen e gjykimit, dhe mund të dalin nga komentet dhe intervistat e punëmarrëseve dhe nga kontaktet me subjekte

të lidhura drejtpërdrejt me proceset gjyqësore me objekt marrëdhëniet e punës, të tilla si shoqatat e fokusuara në mbrojtje të të drejtave të grave.

Mënyra se si zgjidhen pasojat e një gjykimi mbetet interesante, se në varësi të natyrës së marrëdhënies së punës, kontraktore apo administrative, me një status të posaçëm apo për punëmarrës të zakonshëm, shihen edhe specifikat ligjore dhe faktike të mundësisë për t'u kthyer apo jo në punë, nëse ndërprerja ka qenë bërë për shkaqe jo të drejta, apo mundësia e marrjes së dëmshpërblimit për këtë ndërprerje.

1.Kuptimi i diskriminimit dhe i barazisë

Që të japësh shpjegimin e termit dhe të konceptit të diskriminimit, do të nisemi nga ekundërta e tij që është barazia. Në vazhdim do të japim disa koncepte të rëndësishme që lidhen me barazinë gjinore në marrëdhëniet e punës.

Kjo për faktin se bashkohen së bashku dy nga të drejtat e rëndësishme të njeriut: e drejta për punë dhe për zgjedhjen e profesionit, nga njëra anë, dhe e drejta për të qenë të barabartë e për të mos u diskriminuar për shkak të gjinisë, racës, bindjeve fetare e politike, e të tjera.

1.1 Barazia- është një term relativ, i cili lidhet me krijimin e një lidhjejemidis dy ose më shumë kategorive. Nisur nga logjika, dallimet në mes të kategorive apo objekteve që krahasohen potencialisht ekzistojnë, sepse sado të ngjashme të gjitha kategoritë e sendeve, njerëzve, ngjarjeve, praktikave gjyqësore, vendimeve gjyqësore, secila prej tyre mbart specifikat e veta, që e bëjnë të dallohen nga grupi i të njëjtit lloj.

Megjithatë, kur flasim për vendosjen e barazisë, na duhet një karakteristikë e përbashkët potenciale që mbart thelbin e secilës prej kategorive që duam të krahasojmë. Kështu, nëse do të marrim të analizojmë kategorinë e “grave” dhe kategorinë e “burrave” në një shoqëri të sotme bashkëkohore, për të gjithë ne është e qartë se secila prej tyre gëzon të drejta specifike që lidhen me anatominë fizike të ndryshme të tyre në disa elementë, me shtatzaninë, me format dhe masën trupore, me risqet që vijnë nga sëmundje të ndryshme, e të tjera.

Kështu, si qenie njerëzore, ata gëzojnë njëlloj të drejtat me natyrë kushtetuese, që lidhen me punën, familjen, krijimtarinë, organizimin profesional apo të llojeve të tjera, e kështu me radhë.

Sa më shumë rriten përpjekjet për të patur ngjashmëri midis dy gjinive me qëllimin që të kenë barazi teorike dhe faktike në të gjitha aspektet e jetës së tyre, aq më tepër kohë duhet të kalojë. Disa shoqëri të Europës Perëndimore e Veriore, të Shteteve të Bashkuar të Amerikës, Kanadasë, etj, kanë ecur me ritme më të shpejta në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të grave nga diskriminimi në fushën e punës dhe me gjerë, në familje, jetë sociale, politike, etj.

Në disa shoqëri të tjera, ky proces ka qenë më i ngadalshëm. Gruaja është bërë e barabartë me burrin në punë, në të drejtën për të zgjedhur çdo lloj profesioni apo dhe për të ushtruar të drejtën e votës, etj, në një periudhë të mëvonshme.

1.2 Barazia në punësim- Brenda fushës së diskriminimit në punësim, barazia evidentohet në tre drejtime kryesore:

Së pari, barazia në punësim fillon që nga momenti i krijimit apo lindjes së marrëdhënies së punës, nga kriteret përzgjedhëse, nga procedurat që ndiqen për përzgjedhje, nga përjashtimet e kategorive të caktuara nga pjesëmarrja në konkurrim, për shkak të gjinisë, por edhe brenda gjinisë ka raste diskriminimi për shkak të moshës. Kështu ka profesione që preferohet mosha më e re e grave në raport me moshat që kalojnë 20 vjet punë, në pozicione të tilla si sekretare, asistente, etj, preferohen femrat më shumë se meshkujt në pozicione shërbimi, si sekretare, shitëse, etj. dhe preferohen meshkujt në pozicione drejtimi.

Së dyti, barazia në punësim vijon me mënyrën e përmbushjes së marrëdhënies së punës, me kushtet që krijohen, nga madhësia e pagës, nga përshkrimi i punës, detyrave dhe kompetencave, nga dhënia e lejeve, nga trajtimi i shtatzënisë, etj. Një nga elementët e cënimit të të drejtave të grave në

marrëdhënien e punës është shkelja e etikës nga ana e punëdhënësit, si dhe rastet e ngacmimeve seksuale;

Së treti, barazia në punësim vërehet edhe në mënyrën e mbarimit apo ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ku vërehet se gratë konsiderohen kategori që janë më të brishta dhe shpesh e humbasin më lehtë vendin e punës, krahasuar me burrat, nisur nga të njëjtat shkaqe, si për shembull në rast të shkurtimit të vendeve të punës, të ristrukturimeve të punëdhënësit, etj. Për gratë shkelen më lehtë edhe rregullat e njoftimit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, duke u mjaftuar vetëm me njoftimin e menjëhershëm

për ndërprerjen e punës, pa shkaqe të ligjësuara dhe të arsyeshme.

Nëse diskriminimi vjen si një politikë e diktuar nga struktura apo hallka hierarkike më të larta, atëherë ndeshemi me termin "udhëzim për të diskriminuar", që është një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura ligjore.

Pasojat e një diskriminimi shënojnë edhe gjurmë tek viktimat që pësojnë prej tij. "Viktimizimi" është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin eparimit të barazisë.¹

1.3 Diskriminimi në paga- Fillimisht parimi i mosdiskriminimit është aplikuar për shkak të diskriminimit në baza gjinore në lidhje me një page jo të barabartë për gratë dhe burrat për punë të njëjtë. Koncepti i "pages së barabartë" i është dhënë një përkufizim më i gjerë, jo thjesht për pagën neto që merret çdo muaj, por edhe për pagesat për shërbimet, shpërblimet, bonuset, përfitimet nga sigurimet shoqërore, etj, e duke vijuar deri tek pensionet. Edhe në vendet më të zhvilluara europiane², koncepti i barazisë në pagë për punë të njëjtë midis burrave e grave erdhi pasi u punua fort për të edukuar mentalitetin se për të promovuar pagë të barabartë duhet të dëshmojmëse të dyja gjinitë janë të njëjta dhe nuk ka gjini më të zonjën apo më të kualifikuar thjesht për shkak të

¹ Për hollësi shihni vendimin nr.11232 (527), datë 04.06.2013, ku gjykata ka vendosur se ka diskriminim të drejtpërdrejtë në formën e përzgjedhjes dhe trajtimit të punëmarrësve. Po ashtu, gjykata konkludon se ka viktimizim në formën e trajtimit të disfavorshëm, si reagim ndaj një procedimi që synon të zbatojë parimin e barazisë gjinore.

² (Direktivat specifike ku kërkohet trajtim i barabartë në sigurimet shoqërore janë: Direktiva e Këshillit 79/7/EEC, Direktiva e Këshillit 86/378/EEC dhe Direktiva e Këshillit 96/97/EC, si dhe në drejtim të personave të vetëpunësuar Direktiva 86/613/EEC)

gjinisë.³ Megjithatë, ndeshim ende raste kur seleksionimet dhe preferencat profesionale në aspektin e gjinisë shkojnë në favor të meshkujve, të cilët preferohen në vendet e punës me profesione elitare ku kryesisht apo ekskluzivisht pushtohen nga kjo gjini

2.Llojet e diskriminimit

Kufizimet e parimeve të trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit u njohën për herë të parë dispozitat e Direktivës së vitit 1976 dhe pastaj në Nenin 141 (4) të Traktatit të KE-së, (tani Neni 157) lidhur me pranimin e praktikave dhe kuotave pozitive, megjithëse me

një fushëveprimi të kufizuar lidhur me të ashtuquajturin “diskriminim pozitiv”, i cili duhet të veprojë vetëm atëherë kur gruaja është e nënperfaqësuar në një punë apo pozicion të caktuar.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka qenë veçanërisht e ndjeshme për përdorimin e kuotave si një formë e veprimit të diskriminimit pozitiv. Ajo ka vendosur që punëdhënësit mund të favorizojnë përzgjedhjen e një gruaje mbi një person të gjinisë tjetër, në rastin kur të dy janë të kualifikuar në mënyrë të barabartë, por vetëm në rastet kur gratë janë të nënperfaqësuar brenda klasës. Përmes jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (ECJ), parimi i trajtimit të barabartë për gratë dhe burrat u deklarua të mos jetë kryesisht një element ekonomik, por një objektiv social i Komunitetit dhe për këtë arsye, ai fitoi statusin e një parimi themelor të Komunitetit Evropian. Megjithatë, ndalimi i diskriminimit në bazë të gjinisë u interpretua për të mbuluar diskriminimin në bazë të gjinisë apo orientimit seksual.⁴

2.1 Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë_ janë dy forma të diskriminimit që sjellin në të dyja rastet të njëjtat pasoja. “*Diskriminimi i drejtpërdrejtë*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme, sesa një person tjetër, apo

³ (Parimi “pagë e barabartë për punë me vlerë të barabartë” u sanksionua në Direktivën e Këshillit 75/117/EEC, zbatimi në praktikë i së cilës çoi në zhvillimin e sistemeve të tilla të vlerësimit të punës që synojnë të përjashtojnë hapësirat për diskriminimit për gjinor.)

⁴ (Të dy gjykatat ndërkombëtare, edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë (ECJ), edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) në vendimet e tyre pas miratimit të Direktivës së Këshillit 2006/54/EC, janë orientuar nga argumentimi se diskriminimi shtrihet edhe për të mbuluar rastet e barazisë për grupet transgjimore).

një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak ligjor.

”Diskriminimi i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

2.2 Mbrojtja nga diskriminimi- Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

2.3 Diskriminimi dhe negociatat kolektive- Çështjet e diskriminimit gjithashtu mund të adresohen përmes *negociatave kolektive*. Negociatat kolektive janë atribut i bashkimeve sindikale, por që nuk janë aktive dhe të forta në mbrojtje të interesave të punëmarrësve, dhe aq më tepër të të punësuarave gra.

Në nivel europian, partnerët socialë kanë luajtur një rol kyç me anë të miratimit të marrëveshjeve kuadër, si ato që rregullojnë punën me kohë të pjesshme, punën me kohëtë plotë me afat të caktuar, lejet që burojnë nga marrëdhëniet e punës dhe kohën e lejes prindërore. Një nga objektivat më të rëndësishme të marrëveshjes kolektive është edhe synimi për të luftuar diskriminimin, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore femra, si edhe zgjerimin e përfitimeve të tyre në mënyrë të barabartë me të punësuarit meshkuj.⁵

⁵ (me miratimin e Direktivës së Këshillit 1999/70/EC e 28 qershorit 1999, e cila ndalon tek rregullimi i dispozitave për orarine punës, dhe bazohet në një marrëveshje kornizë të konkluduar nga partnerët socialë europianë)

3.Puna shtëpiake

Shpesh ngrihen diskutime dhe shtrohen pyetje lidhur me kufijtë e organizimit familjar të punëve të përditshme dhe punës së mirëfilltë jashtë shtëpisë⁶.Teoria dhe praktika, dëshmojnë se në familje dhe në martesë,pavarësisht nga vala e feminizmit dhe numri i madh i grave që lëvizin në tregun e punës së paguar, punët e shtëpisë vijojnë të konsiderohen si punë e grave.

Gratë vazhdojnë të marrin përgjegjësinë për punën brenda shtëpisë dhe vazhdojnë të bëjnë më shumë punë në familje. Ndërkohë,për grate ka një komponent emocional të lidhur me këtë veprimtari në shtëpi, sepse atoi bëjnë punët e shtëpisë si një shprehje e kujdesit për partnerët dhe fëmijët, ose për të shmangur konfliktin,icili mund të rrezikojë marrëdhënien e tyre. Shumë përpjekje janë bërë që punët e shtëpisë tëkonceptohen nën këndvështrimin e teorisë së këmbimit duke marrë në konsideratë aspektet e fuqisë fizike,energjisë e vitalitetit trupor që gëzon secila prej gjinive.

Mashkullishihet si më i fortë fizikisht dhe i aftë të përballojë punë më të vështirafizike në shtëpi, prandaj shpesh punë të tilla që lidhen me ngritje peshash konsiderohen si punë për burra, ndërsa pjesa tjetër që përfshin punë më delikate, fine apo cilësore, si gatimi, pastrimi, kujdesi përveshjen e fëmijëve, etj, iu lihen grave.

Feministët materialistë kanë argumentuar se gratë dhe burrat janë klasa sociale të cilat zënë pozicione të kundërta strukturore në regjimin e brendshëm të prodhimit.

Nga kjo perspektivë si martesë,ashtue dhe bashkëjetesa janë identike përse i përket marrëdhënieve të punës në shtëpi, kugruaja jep kontributin e punës së saj për mirëmbajtjen ekonomike dhe financiare të familjes dhe shtëpisë.⁷ Në kontrast me këtë argumentim, teoria e perspektivës gjinore merr një pamje më dinamike dhe argumenton se punët e shtëpisë prodhojnë raporte gjinore, permes

⁶ Shqipëria ka ratifikuar Konventën e ILO-s,177 “Përpunën në shtëpi”me ligjin nr8909/6.6.2002,por edhe në raportet eShqipërisë në OKB nënvizohet se”gratë punojnë në shtëpi, pornuk janë të qartakushtet në të cilat atoushtrojnë aftësitë dhe kualifikimet e tyre”.. Për hollësira shihni: “Shadow report on the implementation of the CEDAW Convention in Albania”, Submitted by the Gender Alliance for development Center (GADC), the Albanian Women Empowering Network (AWEN),the Network Against Gender-Based Violence and Trafficking, submitted to the United NationsCEDAW Committee, përgatitur nga Prof. Arta Mandro, Prof. Aurela Anastasi, Mirela Arqimandriti dhe Vera Lesko, qershor 2010.

⁷ (Delphy dhe Leonard 1992 , p 265)

një jetese të përditshme, ku evidentohet miratimi i nënshtrimit të njëres gjini ndaj tjetres, që shfaqet përmes sjelljeve të tjera me natyrë gjinore.

Në traditën shqiptare ka pasur gjithmonë disa ndarje rolesh mes gjinive. Shpesh burri është quajtur “*shtylla e shtëpisë*” dhe gruaja “*zonja e shtëpisë*”. Këto kanë tingëlluar gjithmonë si një lloj ndarje hierarkike e punëve të shtëpisë, ku terminologjia mbartte në fakt pozitivizëm.

Megjithatë, me qenë se aspekti financiar jashtë e brenda shtëpisë u takonte burrave, “zonja e shtëpisë” kishte të drejta administrimi mbi punët e përditshme brenda shtëpisë, ku përfshiheshin edhe aspekte të përditshme financiare apo administrimi dhe ndarja e punëve midis grave të tjera, vajzave, djemve, mbesave, nipërve, etj.

“Gratë mbajnë pjesën më të madhe, në mos të gjithë barrën e padukshme të punës së papaguar për kujdesin për fëmijët, të sëmurët dhe të moshuarit, pastrimin, gatimin dhe të tjera punë në familje”. Kjo është e vërtetë si për gratë që kanë një punë jashtë shtëpisë, në tregun formal ose joformal, ashtu edhe për gratë që janë tërhequr nga tregu i punës.

Neni 23 i Ligjit për Barazi Gjinore merret me vlerësimin e punës së papaguar.

Sipas paragrafit 2 të këtij neni, ata që kryejnë punë të papaguar në familje do të përfitojnë nga shërbimet komunitare, politikat e punës dhe të punësimit, si dhe të formimit profesional në bazë të legjislacionit në fuqi⁸ 11

Përfundimi

Nga ky punim seminarik me temë: “Diskriminimi I gjinisë në marrëdhëniet e punës” përfundojmë se shohim se kemi shfletuar ligje të cilat na japin të kuptojmë se shoqëria dhe drejtësia po luajnë rolin e tyre në procesin e mbrojtjes së marrëdhënieve të punës dhe në forcimin e rolit të gruas në punë, shoqëri e familje.

⁸ (“Shadow report on the implementation of the CEDAW Convention in Albania”, Submitted by the Gender Alliance for development Center (GADC) The Albanian Women Empowering Network (AWEN), The Network Against Gender-Based Violence and Trafficking, submitted to the United Nation’s Committee on the Convention on the elimination of all forms of discrimination against women”, përgatitur nga Prof. Arta Mandro, Prof. Aurela Anastasi, Mirela Arqimandriti dhe Vera Lesko, qershor 201)

Gratë vijnë e sensibilizohen gjithmonë e më tepër për të drejtat e tyre dhe rrugët e mbrojtjes së tyre. Megjithatë mbetet shumë për të bërë në drejtim të ndryshimit të mentalitetit se gratë janë inferiore në raport me burrat në punë e familje.

Mbetet shumë për të bërë në drejtim të forcimit të strukturave publike që kanë rolin e vëzhguesit, parandaluesit dhe ndëshkuesit të shkelësve të të drejtave të grave punëmarrëse. Mbetet shumë për të bërë në sensibilizimin e meshkujve në shoqëri, që të shohin tek gratë një partnere apo një kolege të aftë e të zonjën njëlloj sa ata vetë.

Mbetet shumë për të bërë për të edukuar brezat e rinj, fëmijët e shoqërisë së sotme me ndjenjën e barazisë në jetë e punë.

Është e rëndësishme që të ceket edhe një dukuri interesante ku lidhur me kufirin e moshës së daljes në pension vërejmë se shumë gra që punojnë në arsim, shëndetësi, etj, detyrohen të dalin në pension edhe kur nuk duan, ndonëse ndihen plotësisht të afta për të vijuar punën.

E theksojmë këtë dukuri, për shkakun se ka diferencë moshe pensioni të grave me kolegët e tyre burra, për të njëjtën lloj pune. Për këtë arsye, sugjerojmë që pjesë e përmirësimeve ligjore të jetë edhe barazimi i moshës për pension, si për burrat ashtu edhe për gratë që kryejnë lloje të njëjta pune.

Literatura

1. Direktiva e Këshillit 79/7/EEC, Direktiva e Këshillit 86/378/EEC dhe Direktiva e Këshillit 96/97/EC
2. Gjykata Europiane e Drejtësisë (ECJ), edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR)
3. Miratimin e Direktivës së Këshillit 1999/70/EC e 28 qershorit 1999
4. Shadow report on the implementation of the CEDAW Convention in Albania
5. Submitted by the Gender Alliance for development Center (GADC), the Albanian Women Empowering Network (AWEN)
6. Based Violence and Trafficking, submitted to the United Nations CEDAW Committee, përgatitur nga Prof. Arta Mandro, Prof. Aurela Anastasi, Mirela Arqimandriti dhe Vera Lesko, qershor 2010.

ARSIMI NË FILLIM TË SHEK. XXI DHE ROLI I MËSUESIT

Doc. dr. Albana Hodaj

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

a.hodaj14d@eust.edu.mk

albanahodaj7@gmail.com

Hyrje

Termi "shekulli XXI" është bërë pjesë integrale e të menduarit dhe planifikimit arsimor për të ardhmen. Mësuesit dhe drejtuesit në arsim po kërkojnë mënyra për të përgatitur nxënësit për të ardhmen dhe sistemi arsimor global po përparon më shpejt se kurrë më parë. Pavarësisht transformimeve ekonomike, politike, teknologjike e sociokulturore të shekullit XXI, ajo që nuk ka ndryshuar mbetet roli i mësuesit në procesin mësimor- edukativ dhe nevoja e vazhdueshme e shkollës për reformim.

Megjithatë, pavarësisht nga të mësuarit rreth aftësive që nxënësit do të duhet të zhvillojnë për t'u bërë të suksesshëm në shekullin XXI si dhe për çfarë besimesh rreth arsimit mund të jenë të vlefshme, shkollat dhe mësuesit janë duke u përpjekur të kuptojnë rolin e tyre në edukimin e nxënësve të shekullit XXI. Kohë më parë roli i mësuesit ishte të përgatiste nxënësit për detyrat specifike që duhej të plotësoheshin, qoftë tregtia, zanati ose profesioni. Komunitetet ishin gjithashtu shumë më homogjene, vlera dhe kultura specifike duhet të transmetoheshin dhe praktikoheshin për të siguruar mbijetesën e këtyre besimeve.

Në ditët tona, ne nuk jetojmë më në të njëjtën botë. Shoqëria e shek. XXI është një përzierje e shumë besimeve dhe kulturave të ndryshme. Globalizimi ka hapur botën dhe ka lejuar njerëzit të lidhen në mënyra të reja dhe emocionuese. Ne përziejmë traditat dhe krijojmë sisteme unike besimi që nuk mësohen në asnjë klasë, por zhvillohen përmes përvojave dhe pasioneve tona të jetës. Ne i transmetojmë vlerat dhe kulturat tona pa prituri që ato të miratohen nga audiencia jonë - e pranuar vetëm prej tyre.

Nuk ka dyshim se mësuesi i shekullit XXI është i vëmendshëm, kurajoz, i gatshëm të zbulojë dhe gjithmonë shikon drejt së ardhmes. Ai është gjithmonë në

ndryshim, një hap me zhvillimet bashkëkohore teknologjike, i gatshëm të shërbejë si misionar, me profilin e tij shumëpërmasor e me vetëdijen se e ardhmja duhet të mbërrihet përmes edukimit dhe arsimimit e të jesh misionar i tillë, kjo mbetet sfidë e çdo shekulli.

Ç’do të thotë të jesh mësues i shekullit XXI dhe cili do të ishte synimi ynë për këtë kohë?

Në morinë e shekujve edukatorëve e mëdhenj të arsimit lanë vepra me përmbajtje arsimore që kanë rëndësi edhe sot për shkollat në të gjithë botën e sidomos në Evropë mes të cilave mund të përmendim: Erazmin, Jam Amos Comeniusin, Xhon Lokun, Zhan Zhak Rusoin, Johan H. Pestalocin, Johan Friedrih Herbartin, Friedrich Frobelin, Alfred Binetin, John Djuin, Maria Montesorin, Anton Makarenkon, Jean Piagetin, Lev S. Vigotskin. Ata hodhën bazat e arsimit dhe pedagogjisë botërore. Ideve të tyre mbi edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, u referohet shkenca dhe filozofia e sotme e arsimit dhe edukimit jo vetëm të fëmijëve, por formimit për gjatë gjithë jetës¹.

Mendimtarët e historisë në edukim u bënë apostuj të dijes nga Mesjeta obskurantiste në modernitetin e sotëm, duke hedhur themelet e arsimit nga njëri shekull në tjetrin, mbi baza shkencore dhe vizion themelor për njerëzimin.

Shekulli XXI mbart pikëpamje që ngrihen mbi idetë e tyre. Komeniusi kërkonte *krijimin e një filozofie arsimore*², që do t’i përfshinte çështjet e arsimit në një sistem të gjerë. Për herë të parë u kërkua që në qendër të procesit mësimor të ishte nxënësi. Parashtrroi metodën ciklike, që është ideja themelore e çdo didaktike (bazohet tek cikli i shkollimit, moshën dhe aftësitë e nxënësve).

Krijimi i organizmave ndërkombëtare për lëvizjen arsimore, për t’i universalizuar idetë mbi edukimin, ishin ide që përshkruan filozofinë e tyre të mendimit mes epokave dhe sot vijojnë të mbeten parime që prijnë jetën arsimore, pedagogjike për rritjen dhe formimin e gjeneratave. Po si ka ndryshuar rolin dhe figurën e mësuesit dhe edukatorit në kohën ku jetojmë?

Mësuesi i shekullit XXI është vigjilent dhe gjithmonë shikon drejt së ardhmes. Ai është gjithmonë një hap me ndryshimet teknologjike dhe është në një vijë me atë që e ardhmja do t’i sjellë edukimit dhe arsimimit. Po ashtu ai është i vëmendshëm ndaj sfidave dhe mundësive të reja që do t’u paraqiten nxënësve të

¹ Frabboni, F. & Minerva, F. P. (2022). Hyrje në pedagogjinë e përgjithshme. Luisprint: Durrës. Vol. III.

² Byroja ndërkombëtare e Edukimit. Unesco (2008). Mendimtarët për edukimin. Plejad: Tiranë.

tij gjatë viteve të ardhshme dhe gjithmonë kontribuon në avancimin e të menduarit dhe planifikimit të arsyeshëm. E gjithë kjo nënkupton se mësuesi i shekullit XXI patjetër duhet të përdorë strategji të ndryshme të mësimdhënies, për të qenë i sigurt se fokusi i arsimimit ndodhet në përgatitjen e fëmijëve të sotëm për të ardhmen ku ata do të jetojnë dhe punojnë dhe jo për botën tonë aktuale.

Nga ana tjetër, teknologjia në klasë është duke u zhvilluar gjithnjë e me një hov të madh. Teknologjia në klasë, qoftë për ligjërata, detyra apo nota, u vjen në ndihmë nxënësve për të mësuar më mirë dhe më shpejt dhe kontribuon që ora mësimore të jetë më efektive.

Mësuesi efektiv i shekullit XXI duhet të qëndrojë në raporte proporcionale me teknologjinë dhe duhet të jetë i vetëdijshëm se teknologjia në klasë mund të ndihmojë në zhvillimin arsimor të nxënësve. Ai duhet të dijë se cilët janë mjetet më të mira dhe si e ku t'i përdorë ato.

Mësuesi i mirëfilltë patjetër duhet të jetë në gjendje për të punuar mirë në grupe. Bashkëpunimi me të tjerët është një aftësi mjaft e rëndësishme e shekullit tonë. Kohës së fundit, bashkëpunimi efektiv në vendet e punës është zhvilluar mjaft. Kështu, të mësuarit konsiderohet më efektiv kur i ndan idetë dhe diturinë tënde me të tjerët. Shkëmbimi i ekspertizës dhe përvojës, komunikimit dhe mësimit nga të tjerët, është një pjesë e rëndësishme në procesin mësimor.

Mësuesia përbën një profesion, suksesi i të cilit ka ndryshuar shumë dekadave të fundit. Me kalimin e kohës mjetet kanë ndryshuar, por edhe praktika mësimore. Mësuesi i shekullit XXI është në gjendje të përshtatë gjithçka që i vjen në duar. Ai vetë është në ndryshim dhe zhvillim të përhershëm.

“Çelësi i dijës qëndron tek nevoja për të ditur më shumë...Kur individi, shoqëria dhe kombet e shohin këtë si nevojë të brendshme, atëherë kjo i çon përpara duke ndryshuar dhe përmirësuar vetveten³”.

Ai duhet të shikojë në praktikën e tij dhe ta përshtatë atë sipas nevojave të nxënësve. Është më se e nevojshme që ta përshtatë mënyrën e mësimdhënies nga situata e caktuar, në mënyrë që të përfshijë forma të ndryshme të edukimit dhe arsimimit: ta përshtatë situatën kur ndonjë shpjegim dështon, të përshtatet ndaj teknologjisë së re...⁴ Ai patjetër duhet t'i përshtatet edhe planprogramit mësimor

³ Plaku, A. Aspekte të menaxhimit dhe lidërshiptit në arsim. Durrës, 2021 fq.:13.

⁴ Musai, B. Mësimdhënia dhe të nxënët ndërveprues. Tiranë, 2005.

dhe kërkesave të ndryshme arsimore dhe të jetë në gjendje ta përdorë imagjinatën e tij, në mënyrë që ta mbjellë dhe kultivojë kreativitetin te nxënësit.

Mbi të gjitha, një mësues i shkëlqyer i shekullit XXI duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë arsimimit gjatë tërë jetës. Ai nuk synon që vetëm nxënësit e tij të arsimohen gjatë tërë jetës, por gjithashtu tenton që edhe ai të qëndrojë aktual dhe në majë të asaj që është më e re në arsimim. Edhe pse ndoshta ende përdor të njëjtat plane mësimore si të vitit të kaluar, përsëri ai di si të ndryshojë në mënyrë që të jetë aktual me planet e reja.

Baza e suksesit të mësuesit, qëndron në transformimin dhe reformimin e unit të tij njerëzor. Me këtë, do të vetëdijësohemi se mësuesi e përgatit të nesërmen e tij/shoqërisë dhe se po ai mbetet përgjegjës kryesor për atë çfarë ndodh. Vizioni, objektivat dhe projektet që synon të përmbushë, janë rruga ku ai ndërton të ardhmen e gjeneratave.

Suksesi kërkon prej mësuesit që ai t'i përcaktojë qartë prioritetet e tij jetike dhe për realizimin e tyre të vendosë një plan dhe kohë të caktuar, duke marrë në konsideratë domosdoshmërinë e lidhjeve të vlefshme dhe konstruktive me njerëzit që e rrethojnë, të ngritura mbi vlera morale si dhe duke i ripërtërirë vazhdimisht energjitë.

Po cili është roli i edukimit dhe mësuesit në shekullin XXI?

Reformat synojnë suksesin e gjeneratës së shekullit XXI ku bën pjesë dhe reformimi i figurës së mësuesit. Kjo kohë kërkon që mësuesit të largohen nga vetëkënaqësitë në profesion si mësimdhënës dhe të motivuar të shohin drejt së ardhmes së shekullit XXI, duke dalë mbi kufijtë virtualë, mbi barrierat dhe pengesat e trashëguara, duke u bërë nismëtarë të mendësisë së re, si vizionarë globalë në dobi të kombit e vendit ku japin kontributin e tyre çdo ditë.

Roli i edukimit është të përgatitë nxënësit që të bëhen aktorë të suksesshëm dhe të kontribuojnë në shoqëri. Thelbi i rolit të arsimit nuk ka ndryshuar. Megjithatë, ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që duhet marrë në konsideratë.

Shoqëria ka ndryshuar. Ne nuk mund t'i përgatitim nxënësit për shoqërinë që ekziston sot ose do të ekzistojë nesër, nëse vazhdojmë t'i përgatitim për shoqërinë që ekzistonte dje. Për të përgatitur nxënësit për të luajtur rolin e tyre në shoqërinë e shekullit XXI, ne jemi pjesë e disa gjëra duhet të merren parasysh kur të vendosim se si arsimit do të duket në shkollat dhe klasat tona.

Mësimdhënia dhe mësimnxënia duhet të kenë në qendër nxënësin.

Mësimi i përqendruar tek nxënësit është nxitur fuqishëm në shekullin XXI, kjo nuk do të thotë që mësuesi nuk mund të japë mësim në orën mësimore, por që ai të mos jetë qendra e procesit mësimor.. Në vend të kësaj, kjo do të thotë se burimi kryesor i njohurive në klasë nuk duhet të jetë mësuesi. Arsimi nuk është më për të dëgjuar fjalimin e mësuesve dhe për të thithur informacionin. Për të kontribuar në shoqëri, nxënësit duhet të jenë në gjendje të fitojnë njohuri të reja. Ata duhet të lidhin informacionin e ri me njohuritë që tashmë kanë dhe ta zbatojnë atë për zgjidhjen e problemit në fjalë. Ata nuk të kenë një mësues sa herë kanë pyetje, kështu që do të duhet të kenë 'mësuar se si të mësojnë' vetë.

Në vend që të marrin informacione pasive, nxënësit do të mbledhin informacionin, nën drejtimin e mësuesit të tyre. Stilet e ndryshme të të nxënësve inkurajohen dhe nxënësit kanë një ndjenjë të zgjeruar të motivimit dhe përgjegjësisë⁵. Ata angazhohen në shumë lloje të ndryshme aktiviteteve, si dhe tregojnë mësim në shumë mënyra të ndryshme. Mësimi është rreth zbulimit, jo memorizimit e fakteve. Nxënësi nxitet të kërkojë zbulojë prova, fakte, njohuri duke shprehur pasionin dhe aftësitë e tij.

Mësuesi duhet të nxitë bashkëpunimin.

Nxënësit duhet të mësojnë se si të bashkëpunojnë me të tjerët. Shoqëria sot ka njerëz që bashkëpunojnë në të gjithë globin. Si mund të pritët që nxënësit të punojnë me njerëz nga kultura të tjera, me vlera të ndryshme nga vetë, nëse nuk janë në gjendje të punojnë me njerëzit që shohin çdo ditë në klasën e tyre?

Nxënësit duhet të inkurajohen që të punojnë së bashku për të zbuluar informacionin, për ta bashkuar atë dhe për të ndërtuar kuptimin. Bashkëpunimi gjithashtu duhet të jetë dinamik. Nxënësit duhet të mësojnë se si të njohin pikat e forta dhe talentet e ndryshme që secili person mund të sjellë në një projekt dhe të ndryshojë rolet në varësi të atyretributeve.

Shkollat gjithashtu duhet të bashkëpunojnë me institucionet e tjera arsimore në botë për të shkëmbyer informacion dhe për të mësuar rreth praktikave ose metodave të ndryshme që janë zhvilluar. Ata duhet të jenë të gatshëm për të ndryshuar metodat e tyre mësimore në dritën e risive të vazhdueshme.

⁵ Marsh, J. Cohen, (2009) Koncepte kryesore për të kuptuar kurrikulumin, CDE, Tiranë

Mësuesi udhëheq, organizon dhe ndihmon nxënësit.

Nxënësi në qendër të procesit mësimor nuk do të thotë që mësuesi të heqë të gjithë kontrollin e klasës. Ndërsa nxënësit motivohen të mësojnë në mënyra të ndryshme, mësuesi jep udhëzime për aftësitë që duhet të fitohen. Mësuesi mund të bëjë një pikë për t'i ndihmuar nxënësit të kuptojnë se si aftësitë që ata po ndërtojnë mund të zbatohen në jetën e tyre. Nxënësit do të jenë shumë më të motivuar për të mësuar diçka që ata mund ta shohin vlerën.

Mësuesi mbetet figurë e rëndësishme e orës së mësimi që organizon dhe udhëheq nxënësit përgjatë veprimtarisë mësimore dhe edukative, larg të qenit arrogant dhe autoritarist, por si një lider i dashur e bashkëpunues që frymëzon sukses për nxënësit e tij. *“Mësuesit janë pjesë e të gjitha aspekteve komplekse që lidhen me mësimdhënien e përditshme si dhe janë përgjegjës për një shumëllojshmëri në klasë dhe në orën e mësimi.”*⁶

Sot mësuesi shihet si organizator dhe menaxhues i procesit mësimor, i cili transmeton dijet duke përdorur burime të ndryshme informacioni: median, internetin, bibliotekën apo literaturën. Ai në këto burime duhet t'i orientojë nxënësit të shuajnë kureshtjen dhe nxitin mendimin kritik për dije e njohuri të reja mbi botën dhe shoqërinë.

Vizioni i shkollës ideale

Shkollja është si familja. Formohet e rritet me kohën, ndryshon e zhvillon brenda saj dëshirat dhe nevojat e pjesëtarëve, me rregulla herë të forta, herë të zbutura e ndonjëherë dhe pa rregulla fare, ku ka vend për secilin familjar e mbi të gjitha, motiv është dashuria! Në emër të saj zgjohemi e ngrihemi çdo ditë duke menduar se gjithçka bëjmë është në dobi dhe në emër të njerëzve që duam fort. Kjo është shkolla ideale! Vendi jo thjesht dhe vetëm ku punohet përkundrejt një page, një profesioni të zgjedhur rastësisht apo qoftë dhe i dëshiruar, por një familje e madhe që udhëhiqet nga qëllimi më i lartë :harmonia e përbashkët nxënës-prind-shkollë.

⁶ Marsh, J. Cohen, Koncepte kryesore për të kuptuar kurrikulumin, CDE, Tiranë 2009 fq.:212

Vizioni më i parë i çdo organizate sikurse është dhe shkolla, duhet të burojë nga dashuria, si vlera më e epërme e shoqërisë njerëzore që ngjizet në familje e duhet të vazhdojë kultivimin në bankat e shkollës, me mësues që frymëzojnë e ndërtojnë së bashku me nxënësit e tyre ëndrrat shumëngjyrëshe të një bote globale, të hapur e shumëkulturore.

Shkolla ideale shihet si vendi ku të gjithë zhvillohen e ndihmojnë njëri-tjetrin, për të arritur synimet e përbashkëta dhe individuale, ku të gjithë janë të qartë në vlerat e skuadrës dhe me përkushtim e ndershmeri përpiqen çdo ditë t'i ndajnë, të rriten profesionalisht e të përmbushin qëllimet që u takojnë. Në fund të fundit, nuk mendohet se ka shkollë ideale, por ideale është të shohësh sesi mësues të motivuar kultivojnë dije, vlera e dinjitet dhe mrekullohen nga arritjet e secilit nxënës. Arritja, ky koncept fuqiplotë për gjithëpërfshirjen, sepse në një shkollë ideale gjithkush mund të arrijë dhe t'ia dalë.

Në një shkollë mbeten ideale ëndrrat dhe mosha e të rinjve që ulen në banka, prandaj integriteti personal i mësuesve dhe drejtuesve, përcaktimi i objektivave të qarta dhe të matshme, zbatimi i detyrave dhe marrja e përgjegjësisë, shkëmbimi i mendimeve dhe përvojave mes stafit, respektimi i diversitetit ndërkulturor e mbi të gjitha, mbajtja gjallë e pasionit të mësimdhënies e nxënies, janë rruga sesi vizioni i një shkolle të motivuar si një familje, bëhet realitet.

Mësuesit si personalitete me etikë të lartë profesionale-pedagogjike.

Figura të shquara të kulturës dhe personalitete të rëndësishme në arsim përgjatë shekujve, kanë dhënë një ndihmesë të vyer në periudha të ndryshme të zhvillimit kombëtar si modele atdhetarie, mësuesie dhe etike profesionale. Të tillë mësues dhe edukatorë të mëdhenj të kombit kanë qenë Prof. Dr. Hasan Tahsini, vëllezërit Frashëri, mësuesi i madh Jeronim de Rada, mësuesi i shuqar, aktiv, krijues që përgatiti mësuesit e rinj Petro Nini Luarasi, mësuesi model atdhetarie Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, profesori i madh i mësuesve shqiptarë, modeli i mësuesit ideal, Migjeni, i thjeshti i Vrakës, poeti dhe edukatori i rrallë apo Jani Minga e qindra mësues në gjenerata të mëvonshme, kanë hedhur themelet jo vetëm teorike të etikës së profesionit të mësuesit, por dhe kanë lënë pas modelet e tyre të personalitetit si mësues dhe edukatorë, si patriotë e vizionarë për dijen dhe edukimin e Kombit.

Etika e sotme në profesionin e mësuesit në Shqipëri, në këtë kohë të re të botës globale, ka një shtrat të ngritur mbi gjakun dhe sakrificat e këtyre figurave të larta të kombit, ku rritja e nivelit shkencor, aftësitë komunikuese, pasioni i madh për punën, standardet e larta cilësore, janë si urdhëresat e George Polya-s, nevojë dhe detyrë kombëtare, por brenda përtej kornizave të kodeve si dokumente administrative, mbajnë dhe peshën e madhe të atdhetarisë pikërisht edhe për specifikat e mbijetesës së gjuhës dhe kombit tonë nëpër histori. Pikërisht dhe për rëndësinë e jashtëzakonshme të këtyre personaliteteve në gjuhën, zhvillimin dhe formësimin e identitetit tonë kombëtar si një popull që ka vendin e tij në zhvillimet e sotme arsimore, politike dhe kulturore në këtë botë të hapur për të gjithë.

Të jesh sot mësues i shek.XXI duhet të jetë global, i aftë ta kuptojë botën me zhvillimin e saj të vrullshëm, i aftë ta bëjë dhe ndiejë vetën pjesë të këtyre ndryshimeve dhe të përpiqet për nxënësit apo studentët e tij duke vepruar drejt e me profesionalizëm duke ua bërë jetën arsimore e botën e tyre më të drejtë e më të mirë.

Kërkesa më parësore për një mësues bashkëkohor është mjeshtëria e mësimitdhënies, duke njohur përvojën e mësipërme më të sukseshmen në traditën mësimitdhënëse shqiptare, në zbatim të kurrikulës shkollore bashkëkohore, të jetë i aftë të zgjedhë metodat e duhura, duke qenë krijues në përcaktimin e këtyre mjeshtërive për modernizimin e procesit mësimitdhënës e mësimitnxënës. Përdorimi i teknologjive e sjell atë në lidhje me botën dhe risitë e njohurive shkencore si dhe krijon rrugë të reja komunikimi në gjetjen dhe përcimin e informacionit.

Shqetësuese në shoqëritë e sotme janë rastet e rënda të dhunës që raportohen nga mediat apo rrjetet sociale. Kodet etike bien dhe hapen kodet penale për të marrë në gjykim një mision të dështuar arsimor. Po le të ndalemi te disa nga format e moszbatimit të kodit etik në institucionet arsimore.

Moskrijimi i një mjedisi të ngrohtë e miqësor

Një mësues që nuk krijon një klimë ku secili të ndihet i lirë të shprehet pa iu shmangur pikëpamjeve të veta dhe pa u ndikuar nga mendimi apo qëndrimi i mësuesit, në këtë rast ka një devijim nga kodi i etikës profesionale ku dhuna e mendimit apo imponimi, behen shkak për këtë etiketim.

Nuk siguron zhvillimin intelektual të nxënësve

Misioni i përditshëm në punën e mësuesit është zhvillimi intelektual i nxënësit, ku pritshmëritë e mësuesit për arritjet e nxënësve varen nga niveli i lartë profesional e shkencor i dijeve të mësuesit. Nëse kjo përpjekje e mësuesit për të rritur veten intelektualisht dhe për të nxitur tek nxënësit besimin se sukcesi është për ta është qëllim ditor, si parim i lartë etik e pedagogjik, edhe misioni përmbushet, edhe nxënësit i është dhënë shërbimi i vyer i rritjes intelektuale dhe psikomotore. Nëse nuk ka një sedër profesionale, një mirëpërgatitje me plan dhe ditor shembullor, dijet e cinguar do të keqformojnë edukimin shkencor të brezave. Kjo mbetet një nga shkeljet e rënda etike në profesionin e mësuesit që nuk dëmton vetëm nxënësin dhe një brez, por gjenerata të tëra e shoqëri kudo ku ata do jenë pjesë në botën e globalizuar.

Ai, nuk frymëzon diskriminimin, krijon për nxënësit me aftësi të kufizuara kushte të barabarta pjesëmarrjeje, kultivon tek ata, përmes shembullit të tij, edukatën dhe kulturën e punës.

Mjedisi agresiv si sjellje joetike

Mësuesi është formues i personalitetit të nxënësit. Sic thoshte Prof. Hasan Tahsini dhe Mit-hat Frashëri apo dhe pedagogë të shquar botërorë, lulet, shpendët, kafshët, ndikojnë tek fëmijët, tek nxënësit dhe i zbutin, i qetësojnë, ua ulin agresivitetin brezave që merren me to. A nuk janë librat plot me të tilla dije e mundësi për ta njohur e prekur botën? Pikërisht është mësuesi që nuk duhet të fyej, me apo pa dashje nxënësin, pa bërë dallime social-kulturore. Pavarësisht nga vijnë e ç'origjinë kanë, mësuesit duhet t'i trajtojnë me fjalor të kujdesshëm dhe me butësi. Mësuesi duhet t'i njohë që në fillim të vitit mësimor nxënësit që i janë besuar, duke u treguar i kujdesshëm në fjalorin që përdor, duke nxitur me sjellje respektin e tyre për njëri-tjetrin dhe duke e kthyer klasën në një mjedis të hapur ku ka vend për të gjithë e ku të gjithë janë po njëjloj të rëndësishëm.

Konflikti i interesit me nxënësit si sjellje joetike.

Mësuesi nuk duhet të lejojë konfliktin e interesit me nxënësit e tij. Synimet psikopedagogjike dhe kërkesat akademike duhet ta udhëheqin në punën profesionale dhe jo interesa që deformojnë misionin e tij. Kurset private apo nxitja

e nxënësve në fushata apo veprimtari politike, raste të krijimit të raporteve përfituese me prindër të nxënësve, janë forma të shkeljes së kodit etik të mësuesit.

Mungesa e respektit për kolegët apo drejtuesit.

Mësuesi global sot njih hapësirën e tij ligjore, institucionale dhe kufijtë e pushtetit të tij profesional në institucionin ku punon dhe në organizmat ku merr pjesë. Instrumenti bazë i etikës në këto raporte sa njerëzore, aq dhe institucionale e administrative, mbetet kultura e komunikimit. Interesi më i lartë në IA është ai i nxënësit, kështu që e gjithë fuqia e komunikimit mes kolegëve duhet të ketë si qëllim këtë prioritet. Mosmarrëveshjet ndërmjet mësuesve nuk duhet të çënojnë procesin mësimor apo figurën dhe personalitetin e mësuesit dhe as klimën në shkollë.

Organizmat brenda shkollës jo pak herë kanë shqyrtuar raste të rënda të konflikteve mes mësuesve edhe në mjediset e shkollës, madje dhe në prani të nxënësve, duke u bërë shembuj jo vetëm të shkeljes së rëndë të kodit dhe dispozitave normative në arsim, por edhe objekt debatesh e reagimesh të ashpra publike e sociale.

Qëllimet, objektivat dhe synimet që mësuesi i vë vetes në raport me objektivat e shkollës, kërkojnë prej tij përgjegjshmëri të lartë personale kurse mosrealizimet, kërkojnë reflektim e jo fajësim e kacafytje me kolegët.

Vënia në zbatim e parimeve të kodit etik jo vetëm ndihmon në mbarëvatjen e procesit mësimor –edukativ në institucionet arsimore, por rrit figurën e personalitetin e Mësuesit në shoqëri me gjithë madhështinë që meriton të ketë.

Vlerësimet e padrejta, diskriminuese dhe subjektive

Të jesh etik me nxënësit në vlerësim, do të thotë që format e larmishme të vlerësimit sipas standardeve të kërkuara, t'i kthesh në instrumente motivuese për nxënësit që sjellin jo vetëm identifikim të niveleve të dijeve, por dhe motivim e synime të qarta për ku duhet mbërritur. Mësuesi duhet të vlerësojë objektivist dhe me paanësi. Mësuesi nuk duhet të paragjykojë dhe të jetë real në vlerësim.

Mënyrat dhe format e vlerësimit, u bëhen të qarta nxënësve/studentëve që në fillim të vitit shkollor apo akademik sipas programeve lëndore. Vlerësimet

përmbledhësë dhe të vazhduara si: provimet, punët e pavarura, detyrat e shtëpisë, punët praktike, duhet të vlerësohen në kohë dhe me përgjegjësi profesionale, duke i njohur nxënësit me rezultatet për t'iu lënë mundësi reflektimi dhe vlerësohen me seriozitet u bëhen të ditura nxënësve në kohën e duhur, duke qartësuar çfarë kanvendosje objektivash në vijimësi. Kjo mënyrë vlerësimi dhe informimi jo vetëm e nxënësve, por edhe e prindërve, ka krijuar një raport të ri të eikës profesionale të mësuesit në marrëdhënien mësues/nxënës dhe mësues/prindër ku së bashku këta aktorë brenda dhe jashtë shkollës diagnostikojnë problematika dhe vendosin synime pritshmërie për ku duhet mbërritur. Etika e të qenit profesional, i drejtë dhe objektiv në vlerësim është jo vetëm zbatim i rregullave dhe normave të shkruara, por dhe pjesë e personalitetit të mësuesit.

Mësuesi i shek. XXI planifikon orë të qarta, me synime e qëllime se ku do të arrijë në orën e mësimit, me strukturë të përzgjedhur të orës mësimore, me ndërthurjen e teorisë me praktikën si parime themelore të didaktikës dhe pedagogjisë, duke siguruar një pikëbashkim të interesave të tij dhe të nxënësve brenda procesit mësimor-edukativ. Ai është aty i njëjlojtë në figurën dhe misionin që përfaqëson, pavarësisht etnisë, shtetit apo individit që arsimon. Ai, Mësuesi, vjen si personalitet në detyrën dhe misionin e tij, me domosdoshmërinë e “kostumit etik” pa të cilin asnjë mësimdhënës në botë nuk mund të mishërojë qëllimet dhe arritjet arsimore. Pa të do të korniza kurrikulare do të ishte një pasqyrë e thyer që deformon atë të cilën duhet të shohin e mësojnë gjeneratat në këtë botë ku barrierat arsimore kanë rënë para kufijve zyrtarë.

Hulumtimi veprues në shkolla.

Të jesh në pozita vetëreflektimi për përmirësimin e punës si mësues është e rëndësishme të zhvillosh minihulumtime për problematika të ndryshme që dalin gjatë zbatimit të kurrikulës në shkolla. *“Esposito dhe Smith përdorin shprehjen ‘nga mësues ngurrues te një mësues i fuqizuar hulumtues’ për të përshkruar pjesëmarrjen në hulumtime gjatë procesit të punës⁷”*. Në këtë mënyrë mësuesi jo vetëm i jep zgjidhje problemeve shqetësuese për të dhe nxënësit, por dhe nuk ngelet zbatues pasiv i kurrikulimit.

⁷ Marsh, J. Cohen, Koncepte kryesore për të kuptuar kurrikulumin, CDE, Tiranë 2009.

Shkollat duhet të integrohen me shoqërinë.

Për të përgatitur nxënësit për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm, ne duhet të modelojmë atë që është një qytetar i përgjegjshëm. Shkollat shpesh do të punojnë në arritjen e kësaj duke krijuar ngjarje për komunitetin e shkollës, duke motivuar nxënësit që të marrin pjesë në projekte shkollore dhe duke ndihmuar herë pas here komunitetin rreth tyre me aktivitete të tilla si pastrimi ose gjelbërimi i lagjeve, ndihma për të moshuarit tashmë edhe në kuadër të qasjes “*Shkolla si qendër komunitare*”⁸.

Zhvillimi i shkathtësive të mësuesit të shek. XXI nënkupton zhvillimin profesional të mësimit të mësimdhënësve, duke i nxitur ata të përdorin teknologjinë për mësimnxënie më efektive tek nxënësit. Teknologjia e mësimit është veçuar tashmë si disiplinë e rëndësishme që siguron realizimin e procesit mësimor me efektivitet maksimal, në përputhje me synimet e përgjithshme të mësimit dhe edukimit të nxënësve⁹.

Me kompetencat e teknologjisë dhe internetit, nxënësit e sotëm mund të bëjnë edhe më shumë për komunitetin që nuk është më vetëm zona e hapësirës ku ndodhet shkolla, por shumë më gjerë akoma.

Arsimi duhet të ndihmojë nxënësit të marrin pjesë në këtë komunitet global dhe të gjejnë mënyra për të ndikuar më shumë sesa vetëm lagjen e tyre. Kjo nuk do të thotë se ata nuk kanë nevojë të mësojnë vlerën e ndihmës për të tjerët rreth tyre dhe për të mbrojtur mjedisin e tyre, por duhet të mësojnë e mendojnë se si mund të ndajnë vlera universale si qytetarë globalë.

Shtetet dhe shoqëritë duhet të vazhdojnë të investojnë fuqishëm jo vetëm në kurrikula, tekste, teknologji e infrastrukturë, por mbi të gjitha në zhvillimin profesional dhe forcimin e figurës së mësuesit në arsimin dhe edukimin e brezave.

Përfundime

Arsimi në shek. XXI ka kaluar përmes transformimesh të mëdha. Ai sot shihet si proces i përvetësimit të njohurive, aftësive, besimeve dhe vlerave. “*Dija ka bashkudhëtuar historikisht me njerëzimin, duke i dhënë racës njerëzore forcën*”

⁸ MASR. Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët, Tiranë, 2014.

⁹ Udhëzuesit për arsimin Izha.edu.al

dhe mbijetesën, në përballje me vështirësitë apo ulje-ngritjet që shoqëria njerëzore ka kaluar, kalon dhe do të kalojë akoma.¹⁰”

Metodat arsimore janë të larmishme dhe përfshijnë jo vetëm mësimdhënien, por dhe trajnimin, diskutimin dhe hulumtimin. Arsimi vazhdon të bëhet nën drejtimin e mësuesve, megjithatë nxënësit gjithashtu mund të vetësimohen. Ata sot janë qendra e procesit mësimor dhe zhvillimi i aftësive të nxënësve mbetet qëllimi kryesor i veprimtarive dhe institucioneve arsimore formale e joformale.

Etika e mësuesit si profesionist, mësimdhënës dhe edukator, misionar dhe personalitet i dijes dhe qytetarisë, është një dimension i ri global i mirëpërcaktuar në rlin dhe detyrën e mësuesit në shoqëritë e shek.XXI ku gjithçka nuk është si më parë e ku liritë e të drejtat e individëve e pupujve

Në shek.XXI shtetet e fuqishme kanë investuar shumë në forcimin e sistemit arsimor-edukativ përmes reformash ku është përfshirë edhe sistemi arsimor shqiptar. Shtetet me arsimin më cilësor janë njëkohësisht edhe shtetet më të fuqishme nga aspekti ekonomik, kulturor dhe politik. Investimi në arsim padyshim është investim në të ardhmen dhe është thelbësor për punësimin dhe përparimin e përgjithshëm shoqëror. Një shoqëri e cila investon në edukim, mund të zhvillohet dhe përparojë.

Zhvillimet shoqërore të shek.XXI kanë diktuar një ridimensionim të rolit dhe figurës së mësuesit në shkollë dhe shoqëri, duke i lënë mbi supë barrën e përgatitjes së gjeneratave me zotësi e vlera që garantojnë një shoqëri më të mirë për të jetuar. Është në dorën e mësuesit të sotëm që nxënësit e tij të jenë qytetarë më të mirë përmes arsimimit dhe shoqëria duhet t'i japë gjithçka që mësuesi ta përmbushë këtë mision të lartë e fisnik

LITERATURA

1. Plaku, A. Aspekte të menaxhimit dhe lidërshiptit në arsim. Durrës, 2021.
2. Frabboni, F. & Minerva, F. P. Hyrje në pedagogjinë e përgjithshme. Luisprint, Durrës 2022. Vol. III.
3. Byroja ndërkombëtare e Edukimit. Unesco. Mendimtarët për edukimin. Plejad, Tiranë 2008.
4. Musai, B. Mësimdhënia dhe të nxënësit ndërveprues. Tiranë, 2005.

¹⁰ Plaku, A. Aspekte të menaxhimit dhe lidërshiptit në arsim. Durrës, 2021

5. Marsh, J. Cohen, Koncepte kryesore për të kuptuar kurrikulumin, CDE, Tiranë 2009.
6. MASR. Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët, Tiranë, 2014.
7. Udhëzuesit për arsimin Izha.edu.al
8. Musai, B. Metodologji e mësimdhënies. Tiranë, 2003.
9. Musai, B. Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies. Tiranë, 1996.
10. Musai, B. Mësimdhënia me në qendër nxënësin. Tiranë, 2005.
11. Webliografia
12. <https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Arsimi>
13. <https://ëëë.vorae.org/sq/a/rendesia-e-arsimit>
14. <ëëë.portalishkollor.al/neës/une-si-njeri-dhe-une-si-mesues-synimi-im-per-shekullin-xxi>
15. https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Zhvillimi_i_shkatht%C3%ABsive_t%C3%AB_shekullit_21

MARRJA NË PYETJE E TË DYSHUARIT NGA ANA E POLICISË

Prof. Dr. Emin Huseini

HYRJE

Me të drejtë është konstatuar se krimi si fenomen negativ ka qenë prezent që në kohërat më të lashta, por me zhvillimin e teknikës, teknologjisë, pajisjeve më moderne dhe më të sofistikuara elektronike, është mundësuar që të kryhen me një shpejtësi më të madhe dhe të problematizohet çështja e zbulimit të tij. Në bazë të të dhënave statistikore të shteteve të ndryshme dhe të organizatave ndërkombëtare që merren me parandalimi dhe luftimin e kriminalitetit, shihet qartë se kriminaliteti si fenomen me rrezikshmëri të lartë shoqërore është në rritje permanente. Duke pasur parasysh efektet negative që lindin nga këto veprime të rrezikshme, është paraqitur si nevojë e domosdoshme e të gjitha shoqërive nga ato primitive deri te ato bashkëkohore, që të ndërmarrin masa sa më efikase për të parandaluar dhe luftuar atë. Në këtë dimension rol vendimtar luan Kriminalistika si dhe Procedura Penale. Kur arrijmë deri te dyshimi i bazuar se kemi veprë penale që ndiqen në bazë të detyrës zyrtare, organet e policisë janë të detyruar, në bazë të kodit penal të ndërmarrin të gjitha veprimet për ta zbuluar rastin. Këta veprime që ndërmarrin pjesëtarët e policisë janë të cilësuar si veprime kriminalistike dhe procedurale penale. Një ndër qëllimet esenciale të forcave të policisë është të arrijë te zbulimi i atij që posedon informacion për veprën penale dhe për autorin e saj, informacioni i cili shpeshherë na shërben si bazë fillimisht indiciuale dhe më pas si provë për ndriçimin e rastit. Në këtë drejtim dëshmia e të dyshuarit është e një rëndësie të veçantë, kur është në pyetje verifikimi i versioneve të tjera, marrja e informacioneve për autorin dhe rrethana të tjera. Këto të dhëna duhet ta vërtetojnë ose ta hedhin poshtë dyshimin që ekziston lidhur me një veprë të caktuar penale. Procesi i marrjes në pyetje nga ana e policisë mund të rezultojë i suksesshëm, por edhe jo. Por, nëse nisemi nga ajo se qëllimi final i marrjes në pyetje është gjetja e të vërtetës materiale, në këtë rast pjesëtarët e policisë duhet t'i respektojnë të gjitha porositë taktike, teknike dhe metodike të kriminalistikës, që të kemi një përfundim të suksesshëm të procesit të marrjes në pyetje të të dyshuarve. Për të pas sukses në punën e saj, organet e policisë duhet të

përgatiten si në aspekt teknik, ashtu edhe të avancimit profesional. Mossuksesi eventual në gjetjen e të vërtetës, si pasojë mund të ketë akuzimin si dhe gjykimin e personave të pafajshëm si kryerës të veprës penale, ose procesi penal do të mbetet i papërfunduar për shkak të 9 mungesës së provave. Në të dy rastet kryerësi i veprës penale do të mbetet i pazbuluar dhe i lirë, duke qenë i gatshëm dhe i inkurajuar që të kryejë vepër tjetër penal dhe në këtë mënyrë në vazhdimësi do të jetë rrezik potencial për shoqërinë. I dyshuari gjatë marrjes në pyetje, zakonisht tenton që ta fsheh të vërtetën, por ai kur ka parasysh se mund të ballafaqohet me dënimin, ai padashur dhe në mënyrë të pavetëdijshme ndryshon në reaksionet fiziologjike. Personi zyrtar duhet të jetë profesionalisht i përgatitur që t'i vërejë këto shenja dhe t'i kuptojë në mënyrë të drejtë. Mospasja njohuri nga fusha e kriminalistikës do të jetë shkak që procesi i marrjes në pyetje i të dyshuarit të rezultojë i pasuksesshëm. Në këtë situatë ne nuk do arrijmë që të marrim asnjë informacion lidhur me veprën dhe, në këtë mënyrë i dyshuari do ta llogarisë veten të përgatitur, për ta fshehur të vërtetën. Kjo gjendje atij do t'ia rrisë vetëbesimin për të kryer vepër të re penale. Marrja në pyetje përbëhet nga tri faza: faza përgatitore, faza gjatë marrjes në pyetje dhe përfundimi. Çdo fazë është e rëndësishme dhe mban në vetvete disa porosi që duhet të respektohen, në të kundërtën nuk do të kemi realizim të suksesshëm të saj. Mund të ndodhi që i dyshuari gjatë marrjes në pyetje të pranojë akuzën me të cilën rëndohet. Megjithatë, ky pranim mund të jetë i rrejshëm. Personi zyrtar që të arrijë të kuptojë se a kemi të bëjmë me dëshmi të rrejshme apo jo, duhet të ketë informacion për faktorët dhe motivet që e kanë detyruar të dyshuarin të japë dëshmi të rrejshme. Procesi i marrjes në pyetje është proces sa i vështirë po aq edhe me përgjegjësi. Vështirësia buron nga ngarkesat që kanë punonjësit e policisë për të zbuluar të vërtetën, kurse përgjegjësia buron nga detyrimi kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Gjatë kësaj faze gjithmonë duhet ta kemi në konsideratë parimin e prezumimit të pafajësisë, i cili thotë: 'çdokush është i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij'. Fajësinë e gjithkujt ligjërisht ka të drejtë ta vendos vetëm gjykata me aktgjykim të formës së prerë. Kështu pra, objekti i punimit trajton të gjitha problemet komplekse që kanë të bëjnë me aspektin kriminalistik dhe procedural penal të marrjes në pyetje të të dyshuarit nga ana e policisë.

MARRJA NË PYETJE E TË DYSHUARIT NGA ANA E POLICISË

– NOCIONI DHE KARAKTERISTIKAT BAZË

Marrja në pyetje e të dyshuarit nga ana e policisë është materje që është objekt trajtimi i Ligjit të Procedurës Penale, por pjesa më e madhe e këtyre funksioneve është e regulluar me Ligjin për Policinë. Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e policisë, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e saj. Ligji i ka të sanksionuar në mënyrë taksative parimet mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e policisë. Në nenin 2 të Ligjit të Policisë të R.Kosovës janë të shprehura këto parime:

1. Veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

1.1. trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave;

1.2. respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

1.3. paanshmëria dhe neutraliteti lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike të personave;

1.4. integriteti, ndershmëria dhe përgjegjësia në shërbimin publik;

1.5. transparenca – ofrimi i informatave për qytetarët dhe të qenit të hapur ndaj publikut; 1.6. legjitimiteti, përshtatshmëria dhe proporcionaliteti;

1.7. përkushtimi ndaj punësimit, avancimit dhe caktimit të detyrave në mënyrë gjithëpërfshirëse, meritore dhe pa diskriminim, duke reflektuar karakterin shumetnik në Republikën e Kosovës dhe duke i njohur parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të parapara në Kushtetutë¹.

2. Zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligjet e tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës të hartuar nga Policia e Republikës së Kosovës dhe të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme².

¹ Shih: Ligji për Policinë, R.Kosovës, Ligji Nr. 04/ L-076, 2 mars, 2012.

² Shih: Po aty.

3. Kodi i Etikës duhet të jetë në përputhje me parimet e lartpërmendura dhe me Kodin Evropian të Etikës Policore³.

Neni 12 po i këtij ligji kërkon nga zyrtari policor të zbatojë parimet e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit si një kufizim në ushtrimin e autorizimeve policore, ky përkufizim është bërë për arsye se një pjesë e konsiderueshme e detyrave dhe autorizimeve të policisë prek liritë dhe të drejtat e qytetarit.

Në këtë nen thuhet:

1. Zyrtari policor zbaton parimet e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit si një kufizim në ushtrimin e autorizimeve policore⁴.

2. Kur ndërmerr masa parandaluese për ta kufizuar lirinë e personit, zyrtari policor duhet ta ketë parasysh maturinë, shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e kryerjes së veprës penale në atë situatë, për ta përcaktuar shkallën e kufizimit të lirisë së personit në pajtim me ligjin⁵.

3. Autorizimet e policisë ushtrohen vetëm atëherë kur është e domosdoshme, dhe vetëm deri në atë nivel që nevojitet për t'i arritur objektivat ligjor të policisë me pasoja sa më pak të dëmshme dhe për kohë sa më të shkurtër të mundshme⁶.

Në nenin 14 të Ligjit të Policisë të R.Maqedinisë thuhet se punonjësit e policisë do të ndërmarrin masa për ndjekjen e kryesëve të veprave penale, vetëm atëher kur të ekzistojë baza e dyshimit se personi është kryerës i veprës penale⁷. Ekziston bindja dhe besimi, se kur ndodh që të kryhet një vepër penale, policia me këqyrjen e kujdesshme dhe të vëmendshme të vendit të ngjarjes, do këtë mundësi që të zbulojë ndonjë gjurmë me të cilën do të zbulohet kryerësi i veprës penale dhe do të dëshmohet fajësia e tij. Fatkeqësisht, në të shumtën e rasteve kryerësi i veprës penale nuk do ta pranojë fajin e tij. Mundësia e zbulimit të veprave penale dhe autorëve të tyre edhe përkundër zhvillimit të dukshëm të shkencës dhe teknikës dhe implementimin e tyre në fushën e kriminalistikës, ende nuk është në atë nivel që çdoherë të mundësojë zbulimin e gjurmëve materiale, mbi të cilat do të mbështetet fajësia e tyre. Gjithashtu, ekzistojnë vepra penale të atilla, si vepra

³ Shih: Po aty.

⁴ Shih: Po aty.

⁵ Shih: Po aty.

⁶ Shih: Po aty.

⁷ Shih: Zakon za Policia na R.M. (Ligji për Policinë i R.Maqedonisë), Slluzhben Vesnik na Republika Makedonia, broj, 114, 3 noemvri, 2006.

penale e spiunazhit dhe shpifja, nga kryerja e të cilave nuk kemi prova material, kështu që në këto raste një mënyrë e zbardhjes së tyre është marrja e deklaratave nga persona që kanë informacion për këtë. Deklaratat e këtilla do të vërtetojë ose demantojë faktet që janë të rëndësishme për zbardhjen e një vepre penale dhe do të argumentonin fajësinë e kryerësve të saj. Veç kësaj, ato deklarata në mënyrë të suksesshme do të na shërbejnë për të zbuluar edhe prova të tjera materiale që kanë lidhje me një vepër të caktuar penale. Në rastet kur do të posedonim edhe prova personale edhe materiale, këto në mënyrë të ndërsjellët dhe të argumentuar do të plotësonin ose demantonin njëra tjetrën, dhe kjo në mënyrë të sigurt do të na çonte drejt zbulimit të të vërtetës në një proces penal. Deri te këto deklarata do të arrihet me anë të kontakteve të drejtpërdrejta të zyrtarëve të policisë, me ata persona që posedojnë njohuri relevante për ato çështje.

Nenin 17 i Ligjitë të Policisë përcakton:

1. Zyrtari policor mund ta thërrasë personin për të dhënë informacione nëse ka arsye të bazuar se personi i caktuar ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitimë të policisë. Përgjigjja ndaj një ftese të tillë është vullnetare nga personi që e pranon ftesën.

2. Zyrtari policor është i autorizuar që ta thërrasë gojarisht personin e caktuar për intervistë në polici, nëse ekziston arsye e bazuar se ai ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitime të policisë.

3. Zyrtari policor duhet ta njoftoj personin lidhur me arsyen e thirrjes, dhe nëse personi pajtohet, zyrtari policor e shoqëron atë për në lokalet e policisë. Në raste urgjente, kur vonesa shkakton rrezik ose janë thirrur shumë njerëz, atëherë thirrja mund të publikohet në mediat publike.

4. Zyrtari policor është i autorizuar që me shkrim ta thërrasë personin e caktuar për intervistë në polici, nëse ekziston arsyeja e bazuar se personi ka informacione të rëndësishme për arritjen e objektivave legjitime të policisë. Fletëthirrja do të përmbajë titullin, adresën dhe vendin e organit policor që bën kërkesë për prezencën e personit, arsyen për thirrje, vendin dhe kohën ku duhet të paraqitet personi i thirrur.

5. Intervista policore për të miturit zhvillohet vetëm atëherë kur prindi ose kujdestari ka nënshkruar fletëthirrjen dhe e ka miratuar atë dhe vetëm në praninë e prindit ose të kujdestarit. Përgjigjja ndaj fletëthirrjes është vullnetare nga personi i thirrur.

6. Zyrtari policor lëshon fletëthirrje që personi i kërkuar të paraqitet për intervistë policore vetëm gjatë orarit ditor të punës, me përjashtim kur vonesa e thirrjes paraqet rrezik për personin, pronën, ose për arritjen e objektivave legjitime të policisë.

7. Vetëm sipas urdhrorit të gjykatës dhe vetëm në pajtim me ligjin e aplikueshëm, zyrtari policor mund ta përdorë forcën për ta mbajtur personin e thirrur dhe për ta sjellë në stacionin policor ose në ndonjë vend tjetër. Nëse përdoret forca gjatë procesit të thirrjes, personi i thirrur informohet në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, se ka të drejtë të hesht, ta konsultoj mbrojtësin dhe ta kontaktoj një person familjar apo ndonjë person tjetër të besueshëm, siç parashihet në Kodin e Procedurës Penale⁸.

Biseda informative, si njëra nga mënyrat e mbledhjes së dëshmive mund ta definojmë si lloj komunikimi midis organeve të policisë në njërën anë dhe qytetarëve në anën tjetër. Ky komunikim është i karakterit joformal, sepse ligji nuk ka të shkruar asnjë përkufizim lidhur me vendin, kohën dhe mënyrën e realizimit të tij, kurse deklaratat e marra në mënyrë të këtyllë nuk kanë vlerë provuese, por ekskluzivisht do të përdoren për qëllim operativ. Ndërkaq, kur flasim për bisedat informative me personat e dyshuar (që është objekti i këtij punimi), këtu detyrimisht kemi të bëjmë me respektim të rregullave formale, që do të thotë se deklaratat e këtyllë të marra në këtë mënyrë do të posedojnë vlerë provuese. Në këto raste në përputhje me përkufizimin ligjor, ky proces emërtohet marrje në pyetje e të dyshuarit. Domethënë, para fillimit të bisedës i dyshuari duhet të njoftohet se gjatë marrjes në pyetje ka të drejtë të ketë mbrojtësin (avokatin) e vet.

Nëse i dyshuari në prezencë të mbrojtësit të vet pranon të japi deklaratë, organi i punëve të brendshme do ta dëgjojë në harmoni me dispozitat e Ligjit të Procedurës Penale, që shërbejnë për dëgjimin e të dyshuarve dhe në këto raste deklarata e fituar mundet të përdoret si dëshmi në procedurë penale. Këto biseda tani më nga takime joformale që bëhen me qytetarët në përgjithësi, kanë karakter të bisedave formale me të dyshuarit e një veprë penale. Në rastet kur biseda informative e punonjësve të policisë me të dyshuarin realizohet në prezencën e mbrojtësit, në vend të emërimit "bisedë informative me të dyshuarin", duhet të përdoret emërtimi "marrja në pyetje i të dyshuarit" dhe kjo, për shkak të arsyes se

⁸ Shih: Ligji për Policinë, R.Kosovës, Ligji Nr. 04/ L-076, 2 mars, 2012.

Ligji i Procedurës Penale nuk njih termin bisedë informative, por marrje në pyetje i të dyshuarit.

Në rastet kur në marrjen në pyetje e të dyshuari nga ana e policisë nuk do të marri pjesë edhe mbrojtësi, në këto raste ky proces do ta humbte karakterin formal dhe do të emërtohet bisedë informative me të dyshuarin e jo dëgjim i të dyshuarit. Në këto raste shikuar në aspekt formal, kjo bisedë nuk dallon nga bisedat informative me personat e tjerë (viktima, dëshmitarët okular) dhe deklaratat e marra nuk do të kishin vlerë provuese.

Përveç dallimit formal, e përbashkëta midis bisedës informative me të dyshuarin dhe dëgjimit të të dyshuarit është qëllimet për të cilat ky proces ndërmerret, dhe këto qëllime janë:

- Eliminimi i të dyshuarve të pafajshëm dhe pranimin e fajësisë nga ana e të dyshuarit të vërtet.
- Vërtetimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të veprës penale.
- Vërtetimin e identitetit të të gjitha pjesëmarrësve.
- Sigurimin e informacioneve për zbulimin e sendeve dhe provave që kanë lidhje me veprën penale.
- Zbulimin e informacionit për vepra të tjera penale dhe për aktivitete tjera kriminale.
- Zbulimin e të dhënave që do të na shërbejnë si bazë për dëgjim plotësues dhe të ardhshëm.
- Zbulimin e burimeve tjera të informimit⁹.

Edhe një herë gjatë përfundimit mundemi të konstatojmë se duhet të bëjmë dallim midis bisedës informative me të dyshuarin (deklaratat e marra nga kjo bisedë nuk kanë vlerë provuese) dhe marrja në pyetje e të dyshuarit (deklaratat e fituara nga kjo mënyrë posedojnë vlerë provuese). Gjegjësisht, ky dallim është i karakterit formal, ndërsa dallim esencial midis tyre nuk ka, sepse gjatë zbatimit të të dyjave pjesëtarët e policisë do të përdorin njohuritë dhe porositë e njëjta kriminalistike. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se prezenca e mbrojtësit

⁹ Shih: Krstic, O., Praktikum za kriminalistiku-taktiku, Policiska akademija, Beograd, 2002, fq. 159.

mundet në masë të konsiderueshme të dirigjohë punë e dëgjimit të të dyshuarit dhe të ndikojë në deklarimin e tij.

Marrja në pyetje e të dyshuarit është njëra nga punët më delikate që ndërmarrin punonjësit e policisë në procesin e zbulimit të veprave penale dhe kryeseve të tyre. Për arsye se ky proces gjithmonë mbart me vete edhe riskun për gabimet e mundshme që mund të ndodhi, ku çdo hap i hedhur gabimisht gjatë këtij procesi do të na çojë drejt dështimit. Situata dhe atmosfera gjatë dëgjimit është e tendosur, sepse mbi të dyshuarin qëndron autoriteti i shtetit me rregullat dhe rutinë e veprimit, nga të cilat rregulla zakonisht buron edhe dominim i marrësit në pyetje mbi të dyshuarin. Marrja në pyetje e të dyshuarve në të njëjtën kohë është edhe proces për rekonstruim edhe proces për seleksionim. Proces rindërtimi është nga arsyeja se është objekt i dëgjimit të një ngjarje që ka ndodhur më parë. Për arsye të ligjeve të psikologjisë njerëzore, njeriu nuk mundet të kujtohet plotësisht dhe objektivisht për një ngjarje që ka ndodhur në të kaluarën, në bashkëpunim me ekspertët e fushës së kriminalistikës dhe fushave tjera bashkërisht do mundohen që të bëjnë rindërtimin e ngjarjes që ka ndodhur më parë. Kurse proces seleksionimi është për arsye se atë që deklaron i dyshuari nuk është gjithmonë e vërtetë dhe me relevancë për trajtim kriminalistik dhe procedural penal.

Gjërat që janë me rëndësi për procesin i dyshuari mundet me vetëdije ose pavetëdije t'i shmang ose t'i ketë harruar, kurse atë që është e parëndësishme ta vë në dukje apo ta nënvizojë. Kjo do të thotë se personi që merr në pyetje patjetër duhet të njohë disa mekanizma psikologjik të caktuar, personalitetin e personit që merret në pyetje dhe të gjitha rrethanat relevante të ngjarjes. Standardet demokratike kërkojnë që policia në ushtrmin e funksioneve të saja të jetë transparente dhe llogaridhëse¹⁰.

Policimi demokratik kërkon që policia të jetë dhe ta konsiderojë veten e përgjegjshme përpara: qytetarëve, eporëve, shtetit dhe ligjit. Prandaj, veprimtaritë e tyre, duke përfshirë:

- strategjitë për operacione policore;
- procedurat e emërimit; ose

¹⁰ Shih: Udhërrëfyesin për Policim Demokratik nga Këshilltari i Lartë Policor i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Vjenë, Maj 2008, botimi i dytë.

· menaxhimin e buxhetit duhet të jenë të hapura për monitorim nga një sërë institucionesh mbikëqyrëse¹¹. Gjithashtu, një tipar qendror i policimit demokratik është që të kuptohet se pëlqimi i publikut është i domosdoshëm. Parakushte për të fituar mbështetjen e publikut janë: transparenca në operacionet policore dhe kultivimi i komunikimit dhe i mirëkuptimit të ndërsjellët me publikun të cilit policia i shërben dhe mbron.

PERGATITJET PROFESIONALE DHE PERSONALITETI I KRIMINALISTIT

Asnjë profesion tjetër nuk kërkon kaq shumë njohuri dhe dije nga fushat e shkencave të ndryshme kështu si është rasti me profesionin e kriminalistit. Nëse kihet parasysh se puna e marrjes në pyetje e të dyshuarit për nga natyra e saj është delikate dhe konfliktuoze, është e domosdoshme posedimi i njohurive të ndryshme, por edhe cilësive të përshtatshme të personalitetit të kriminalistit. Puna e marrjes në pyetje nuk pranon asnjë lloj shablloni, për shkak se çdo marrjes në pyetje ka specifikat e veta që e dallojnë nga të tjerët të realizuara më herët. Realizim efikas të marrjes në pyetje të të dyshuarit paraqet kombinim të shkathtësive dhe artit¹².

Domethënë, dëgjimi efikas paraqet shkathtësi, sepse punonjësi operativ do t'i zhvillojë këto shkathtësi, për të drejtuar marrjen në pyetje në mënyrë të njëjtë si mësohet për të drejtuar automjetin, pra sa më shumë kohë të ketë drejtuar aq më i shkathët do të jetë. Kurse në anën tjetër, marrja në pyetje e të dyshuarit paraqet edhe art për arsye se punonjësi operativ duke lexuar literatura lidhur me këtë çështje, apo duke shkuar në trajnime të ndryshme dhe nga vetë përvoja e vete, ai krijon një stil të veçantë. Duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e procesit të marrjes në pyetje, me të drejtë parashtrohet pyetja se cilat janë ato cilësi, dije dhe shkakësi që duhet t'i posedojë kriminalisti që të mundet me efikasitet ta marrë në pyetje personin e dyshuar. Njëra nga kualitetet themelore që kriminalisti duhet ta posedojë që të mundet, jo vetëm me efikasitet të drejtojë marrjen në pyetje, por edhe të ndërmerret edhe veprime tjera që janë në kompetencë të organit të punëve të

¹¹ Shih: Udhërrëfyesin për Policim Demokratik nga Këshilltari i Lartë Policor i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Vjenë, Maj 2008, botimi i dytë.

¹² Shih: Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002, fq 76. e thene sipas: Gudjonsson, G. The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons, London, 1992, fq. 264.

brendshme, është mirë që t'i njohë njerëzit dhe të dijë të sillet me ata. Kjo njohje ka të bëjë me personalitetin e tyre, temperamentin, anët e dobëta dhe të forta të tyre, të njohë psikologjinë e tyre për të vendosur komunikimin me ato etj. Esenca për të njohur mirë njerëzit, mbështetet në kombinimin e dy faktorëve: përvojës jetësore dhe njohjes së psikologjisë së personave¹³. Përvoja jetësore arrihet nga kontakti i shumtë me njerëzit, si në jetën profesionale, ashtu edhe në atë private. Në anën tjetër njohurit lidhur me psikologjinë e personave arrihen nëpërmjet procesit të arsimimit (para se gjithash në akademitë policore). Për sukses në marrjen në pyetje të të dyshuarit e domosdoshme është edhe durimi dhe këmbëngulësia. Domethënë, në numrin më të madh të rasteve i dyshuari lehtësisht nuk do të pranojë fajësinë e tij, për të cilën edhe dyshohet. Shpeshherë kriminalistit, për të arritur deri te fitimi i pranimit do t'i duhet mjaft kohë dhe durim. Mungesa e durimit apo ngutja që procesi sa më shpejtë të mbyllet, zakonisht ka rezultuar në fund si jo i suksesshëm. Domethënë, në atë moment kur i dyshuari do të kuptojë se kriminalisti nuk është i durueshëm dhe se ngutet, ai do të inkurajohet për të rezistuar edhe pak, duke menduar se fundi i marrjes në pyetje është afër. Përveç kësaj, humbja e durimit dhe pamundësi që të realizohet qëllimi i marrjes në pyetje, mundet për pasojë të ketë ndonjëherë edhe përdorimin e dhunës, kanosjes dhe metodave tjera të ndaluara nga punonjësi operativ. Për këtë shkak, nga kriminalisti kërkohet që të jetë emocionalisht stabil dhe person i ekuilibruar. Urrejtja, nervozizmi apo agresioni në asnjë mënyrë nuk guxon të jenë prezent tek punonjësi operativ gjatë procesit të marrjes në pyetje. Gjithashtu, ndonjëherë personi i dyshuar do të jetë edhe i pafajshëm, prandaj kërkohet durim që nëpërmjet provave të tjera të mundet të vërtetohet pafajësia e tij.

Në lidhje të ngushtë me durimi është edhe këmbëngulësia e kriminalistit. Autorët Inbau dhe Reid me të drejtë theksojnë se “asnjëherë nuk duhet të përfundojmë procesin e marrjes në pyetje, nëse do të ndihemi të dekurajuar dhe të gatshëm për ta lënë, por atë do të duhet ta vazhdojmë edhe pak – së paku 10 deri 15 minuta”. Këta autorë na tregojnë për rastet kur personat kanë pranuar veprën, në momentet kur punonjësi operativ ka vendosur ta lë. Shkak për këtë dukuri është fakti se koha kur kriminalisti dekurajohet, zakonisht përputhet me kohën kur i dyshuari plotësisht e sheh të padobishme mashtrimin e vet të mëtejshëm⁶⁸. Qëndrimet e caktuara negative, paragjykimet, dyshimet rreth racës, përkatësisë kombëtare, religjioze, në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë prezente te kriminalisti, sepse ata janë në kundërshtim me parimin e objektivitetit, i cili është i një rëndësie

¹³ Shih: Po aty, fq. 265.

të veçantë për të vërtetuar të vërtetën. Çdo njeri është personalitet i veçantë, i cili në shumë aspekte të jetës psikologjike dallohet nga njerëzit tjerë.

Njerëzit e ndryshëm posedojnë edhe botëkuptime të ndryshme dhe, këto dallime janë si pasojë e nivelit arsimor, profesioneve të ndryshme dhe të ngjashme. Kriminalisti detyrimisht duhet të jetë në gjendje që me çdonjërin nga këto të vendosi komunikim të mirë, për të pasur sukses në punën e tij. Gjithashtu, kriminalisti duhet të posedojë inteligjencë të mirë, perceptim të shkathhtë dhe të sigurt, aftësi të mirë memorizimi, konstatim logjik, të jetë bindës dhe me mençuri të parashtrijë pyetje¹⁴.

Gjithashtu, për grumbullim të drejtë dhe të suksesshëm të informacioneve nga kriminalisti kërkohet, midis tjerash: njohje solide të shkencës së kriminalistikës dhe përvojë të përshtatshme në këtë punë, afinitet dhe dashuri ndaj profesionit, aftësi për vetëkontrollim, elasticitet, mendjemprehtësi, aftësi për të mbajtur mend dhe riprodhim, aftësi për analizë abstrakte e konkrete dhe rezonim logjik, vetiniciativë e sakrificim në punë, qasje metodike dhe aftësi planifikimi, këmbëngulësi në punë (e cila nuk duhet të shndërrohet në kokëfortësi), operativitet dhe aftësi për reagim të shpejtë dhe marrje të vendimit, thellim në punë, vlerësim kritik të gjykimit, vetëkritik dhe gatishmëri për përmirësim të gabimeve personale, objektivitet në punë, aftësi për punë në grup, aftësi për bashkëpunim dhe koordinim, ekonomikitet në punë, i kujdesshëm dhe diskret, respektim të plotë dhe të saktë të etikës profesionale, etj¹⁵.

Autorët Inbau, Reid dhe Beckly mbajnë qëndrim se drejtimi me sukses i marrjes në pyetje bënë pjesë në fushën e specializimit të lartë të veprimeve policore, si dhe kërkon kualitete të larta për hetim. Për këtë shkak këto autorë ndajnë bindjen se në njësinë organizative të policisë duhet të ekzistojnë punonjës të specializuar për të drejtuar marrjes në pyetje, dhe të merren vetëm me këtë veprimtari brenda policisë¹⁶.

Mundemi që të konstatojmë, se do të jetë e pamundur që te personaliteti i kriminalistit të jenë prezent të gjitha këto kërkesa në masë të plotë. Gjithashtu, fakt është se shkathhtësitë për të drejtuar dëgjimin nuk janë “dhunti”, por ato duhet

¹⁴ Shih: Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996, fq. 189-190.

¹⁵ Shih: Yeschke, C.: The art of investigative interviewing, Butterworth- Heinemann, USA, 2003, fq. 157-158.

¹⁶ Shih: Gudjensson, G.: The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons Ltd, London, 2012, fq. 59.

të mësohen dhe ushtrohen. Disa do të kenë më shumë talent se të tjerët për këtë detyrë, dhe me vetë këtë, këto shkathtësi do t'i zotërojnë dhe t'i përvetësojnë më lehtë. Gjithashtu, fakt është se vetëm një pjesë e shkathtësive të marrjes në pyetje e të dyshuarit mësohet nga librat, ndërsa pjesa tjetër vjen apo mësohet nga vetë përvoja.

Perfundimi

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik.

Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të Shtetit. Policia do të përforcojë demokracinë, ligjshmërinë, dhe rendin juridik në një shtet, nëse në aktivitetin e tyre të përditshëm do t'u përgjigjen nevojave të publikut, dhe do të përdorin autoritetin e shtetit në interes të popullit.

Ky organ është manifestim më i dukshëm i autoritetit shtetëror dhe detyrat e tyre parësore janë:

- ruajtja e rendit dhe ligjit, dhe qetësisë publike,
- ruajtja dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut,
- parandalimi dhe luftimi i kriminalitetit, dhe
- dhënia e ndihmës dhe shërbimi ndaj publikut (neni 10)¹⁷.

Në ushtrimin e detyrave të veta policia duhet të demonstrojë etikë, profesionalizëm, dhe integritet, sepse ato posedojnë pushtet të veçantë për të hequr përkohësisht lirinë e qytetarëve, të kufizojnë liritë dhe të drejtat e tyre, dhe në rrethana të veçanta të përdorin edhe forcën. Prandaj punonjësit e policisë këto

¹⁷ Shih: Ligji i Policisë së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-076, 2 mars 2012.

detyra duhet t'i përmbushin në harmoni me standardet universale mbi të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të drejtave politike. Kudo në botë policia është nën presionin e luftimit të kriminalitetit, dhe kërcënimeve që i kanosen sigurisë ndërkombëtare dhe kombëtare nga ai. Megjithatë, policia është e obliguar të operojë në përputhje me ligjet vendore, dhe standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut¹⁸. Legjislacioni dhe rregulloret që rregullojnë detyrat dhe veprimtarinë e policisë duhet të jenë të qarta, të sakta, dhe të hapura për publikun, sepse vetëm atëherë do të mbyllim mundësinë që policia të abuzoj dhe t'i tejkalojë kompetencat e veta, të cilat tejkalime do të ishin në dëm të lirive dhe të drejtave të njeriut. Policia në çdo rast është e detyruar të zbatojë ligjin pavarësisht nga pozita shoqërore, apo përkatësia politik e një të dyshuar

Literatur

1. Ligji i Policisë së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-076, 2 mars 2012.
2. United Nations, International Covenant of Civil and Political Rights (shenimi 5), neni A 3; CSCE, Conference of Security and Cooperation in Europe. Final akc, Helsinki, 1975, Kreu 1, Neni VII.
3. Gudjonsson, G.: The psychology of interrogations, confessions and testimony, John Wiley & Sons Ltd, London, 2012.
4. Yeschke, C.: The art of investigative interviewing, Butterworth-Heinemann, USA, 2003.
5. Maver, D.; Defence strategies and techniques of interrogation. V: Policing in central eastern Europe, College of police and security studies, Ljubljana, 1996.
6. Zullavski, D., Wicklander, D., Practical aspects of interview and interrogation, second edition, CRC Press, 2002.
7. Udhërrëfyesin për Policim Demokratik nga Këshilltari i Lartë Policor i Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Vjenë, Maj 2008, botimi i dytë.
8. Zakon za Policia na R.M. (Ligji për Policinë i R.Maqedonisë), Slluzhben Vesnik na Republika Makedonia, broj, 114, 3 noemvri, 2006.

¹⁸ Shih: United Nations, International Covenant of Civil and Political Rights (shenimi 5), neni A 3; CSCE, Conference of Security and Cooperation in Europe. Final akc, Helsinki, 1975, Kreu 1, Neni VII, Fq. 7.

THE ELECTORAL SYSTEM OF THE PRESIDENT IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA-THE LATEST

PHD CAND. MR.FAHRI BAJGORA

Abstract

2-e dyta-sipas asaj se kjo organizate është zoteruese e monopolit te forces fizike si monopol, si i vetmi ne shoqerine e caktuar .

Ne tashe e pame cka është organizata –bashkesia shoqerore ne te cilen ekziston ndarja e punes ne baze te rregullave te nxjerra perpara, keshtu ce te gjithë personat ce i perbejne organizaten perpara e dine se cka duhet te punojne.

Gjithashtu , ekzistojne personat e vecante ce kujdesen ce secili ne organizate te kryeje detyren e vete dhe te cilet perdorin sanksionin kunder atyre ce nuk e kryejne detyren e vete etj..

Llojet e formave te shtetite

Sice shihet ,organet shteterore munde te perbehen nga lloje te ndryshme personash. ata ndermjet tyre munde te jene ne marredhenje te ndryshme. Me ne fund,ata munde te jene ne marredhenje te ndryshme dhe me popullin , perkatesishte me popullin e shtetit .varesisht nga te gjitha keto elemente , thuhet se shtetet jane te organizuara ne menyra te ndryshme , perkatesishte se ekzistojne forma te ndryshme te organizimit shteteror ose, me shkurtimisht,forma te ndryshme shteterore ose format e shtetit.Nga kjo del se forma e shtetite është menyra ne te cilin është organizuar ai dmth. prberja dhe lidhja e organeve te tij, si midise tyre ashtu edhe me popullin.

-Forma te shtetite ka bukur shume dhe ato nuk varen drejteperdrejte nga prberja klasore e shtetit perkates .Deshmia me e mire per kete është fakti se nje forme e njejte munde te aplikohet ne te gjitha tipat e shtetitdhe,anasjelltas, nga tipi i njejte klasore munde te jet ne forma te ndryshme.Keshtu psh.,ce te kater tipate klasor te shtetit munde te jen sipase formes se sundimit republika-ndersa nje tip i njejte klasor mund te jete cofte republike cofte monarki,demokraci si dhe autokraci,federate si dhe shtet unitare etj.

Prandaj ,shtrohet ceshtja cilat jane shkacet ce ndikojne ce ne nje shtet te miratohet forma e ketill apo e atille. Per t iu pergjigjur me saktesi kesaj pyetjeje , duhet pasur parasysh se nje shtet i njejte , duke mos e ndryshuar tipin e vete klasor, mjafte shpesh mund te nderroje format e veta. sic shihet cartase vete struktura klasore e shoqerise nuk e shkaktone kete nderrim, sepse kryesisht

mbetet e njejte.Por, nese kjo eshte e sakte , me kete ende nuk eshte lidhur poshte cdo ndikim i strukture klasore dhe luftes se klasave.Struktura klasore eshte cenesishte dinamike , kurse raporti i forcave te klasave perkatese ne luften e klasave vazhdimisht nderrohet.Kjo lufte e klasave dhe raportet e forcave te klasave perkatese ,duke u nderruar,mund te shkaktojne ndryshimin e formave shteterore. Nga ana tjetere , me rëndesi shume te madhe jane luftrat dhe konfliktet brenda nje klase te njejte sunduese ndermjet grupeve e shtresave te ndryshme te saj, bartese te interesave te ndryshme. Ne cofte se bie fjala , ne nje shtet vendoset republika ne vende te monarkise , kjo ndodhe ngase ka mbizotruare ajo shtet e klases sunduese ce eshte kunder monarkise dhe asaj shtrese ce e mbrone monarkia. Pra, raportet e klasave dhe te shtresave brenda klasave perkatese ,vecanerishte brenda klases sunduese ,jan faktore i rëndesishem ne paraqitjen dhe ndrrimin e formave perkatese te shtetit.

Shume faktor i rëndesishem jane po ashtu edhe karakteristikat nacionale ,racore,fetare,ekonomike ,gjeografike, kulturore dhe karakteristikat e tjera te shumta te shteteve te ndryshme . Kjo eshte me rëndesi te vecante per format e rregullimit shteteror.

Keta faktore shpeshhere shkaktojne forma te ndryshme te decentralizimit ose te shtetit komplekse. Per ndikimin e ketyre faktoreve ,vecanerisht te dallimeve nacionale , ne krijimin e federates do te flasim kur do te shpjegojme ceshtjen e federates. Ketu edhe pozita gjeografike dhe posacerishte madhesia e shtetit luajne rol te rëndesishem.

Shkalla e zhvillimit ekonomik , perkatesisht menyra e prodhimit dhe, lidhur me kete,struktura klasore e shoqerise , kane ndikim genesore ne format e shtetit, edhe pse nuk jan te vetme e as kurdohere vendimtare.Ne ekonomin primitive , me teknik te pazhvilluar,me komunikacion ne shkalle te ulet etj, eshte i pamundshem centralizimi i fuqishem. Keta faktore jane me ndikim jashtezakonisht te madh ne regjimin politik. Demokracia eshte e mundeshme ce nuk do te thote se edhe ekziston domosdo-vetem ne shkallen e caktuar te zhvillimit ,perkatesisht mu ne kapitalizem.

Zhvillimi historik ,traditat,zakonet, ndikimet e jashtme ,varesia me e madhe ose ma e vogel nga bota e jashtme, karakteri i banoreve etj.- te gjitha keto ndikojne ne pervesimin e ketyre apo atyre formave te organizimit shteteror.Veprimtaria politike i faktoreve te ndryshem politik, ne shtetin modern , para se gjithashe e partive politike,po ashtu ushtron nje ndikim te rëndesishem.

-Nga format e shumta shtetore ketu do te parcesim vetem kater lloje kryesore , te cilat permbajne disa nenelloje . Kjo do te jete e mjaftueshme per te njohur ate ce eshte themelore ne organizimin e cdo shteti . Keto kater lloje kryesore jane forma te sundimit ,te caktuara sipas organizimit te kryetarit te shtetit, forma e regjimit politik , te caktuara sipase raportit te aparatit shtetore ndaj shumices se popullit , format e rregullimit shtetor, te caktuare sipase raportit midise organeve shtetore cendrore dhe jo cendrore dhe, me ne fund, format e pushtetit shtetor, te caktuara sipas raportit midis legjislacionit ,administrates dhe gjykatave .me kete raste duhet permendur se kjo terminologji nuk eshte pranuar ne teresi.

Ka dy forma te sundimit –monarkia dhe republika. ka dy forma te regjimit politik demokracia dhe autokracia. Gjithashtu , ka dy forma kryesore te regjimit shtetore-shteti i thjeshte-format e te cilit jane,centralizmi dhe decentralizmi-shteti i perber⁵ ose kopleks-format e te cilit jane Konfederata dhe Federata⁶ .Me ne fund,ekzistojne gjithashtu dy forma kryesore te pushtetit shtetor-Uniteti i pushtetit dhe Ndarja e pushtetit etj.

Forma e Sundimit

Sice eshte cekur ,forma e sundimit varet nga oganizimi i kryetarit – shefit⁷-presidentit te shtetit.andaj me par duhet konstatuar se cili organ eshte kryetari i shtetit-Kryetari i shtetit duhet dalluare nga organi shtetore sovran ose suprem-edhe pse munde te ndodhe ce nje organ i njejte njekohesisht te jete kryetar shteti e edhe organ sovran suprem.kurse organ suprem eshte organi ce ushtron pushtetin shtetor sovran , ce eshte me i larti e ce me asgje nukeshite i kufizuar.

Kryetari i shtetit eshte organ i cili persifikon shtetin ,dmth. ce e perfaceson si subjekte te vecante , si nje teresi , si dicka te idividualizua etj.

Ky perfaqesim behet kryesishte ne dy drejtime-ndaje botes se jashtme si dhe brenda shtetite..

Kryetari i shtetit , duke perfaqesuar shtetin ne arenen nderkombetare-hyne ne marredhenje me shtetet e tjera , lidhe traktate etj. Duke e perfaqesuar

⁵ Lukic R. Kosutic-Fillet e se drejtes,Prishtine 1986,fq.303 perkthime..

⁶ Lukic; Teorija derzhave I prava,I, Beograd.1995,fq.350.

⁷ Saliu Kurtesh-Edrejta Kushtetuese , libri I-Prishtin,1999,fq.235.

shtetine brenda , kryetari i shtetit eshte edhe komandante suprem –si organ me i rendesishum edhe i shtetite.

Ka raste kur nje organe i ushtrone dy funksione –sic-ku eshte te rasti te Monarkia absolute –ku monarku absolute njekoheishte eshte edhe shef i shtetit e edhe Organ Suprem-mirepo me vone e kemi monarkin moderne e cila eshte me e zhvilluare se ajo absolute-kur mbreti paracitej si vete shteti ndersa tani kompetencat dhe te dretat i ka me te kufizuara e diku vece formale etj.

2.Monarkia

Nocioni i Monarkise

Ne cofte se konsiderojme se monarkia dhe republika caktohen sipase organizimit te kryetarit te shtetit . monarkia munde te caktohet si ajo forme e sundimit ne te cilin kryetari i shtetit eshte person me privilegje te jashtezakoneshme , ce e vene mbi cytetarine e rendomte duhet kuptuar se keto privilegje nuk jane ne pushtetin e tij, te cilin , ai e ushtron si organ shteterore , por jane te lidhura me personalitetin e tij, e ce ne njefare menyre e vene mbi ligjin dhe te drejten ne pergjithhesi etj.-perkundrazi , ne republika , kryetari i shtetite eshte person ce nuk ka kurefare privilegje personale , por vetem shkallen me te larte apo me te ulet te pushtetit.se privilegjet personale ce e konkretizojne monarkin nuk kane kurefare lidhjeje me vellimin e pushtetite shteteror ce e ushtron ai me se miri shihet nga fakti se eshte e mundeshme dhe ndodhe shpesh ce monarku te kete pushtet shume te vogel se kryetari i republikes ,por,megjithate,ai eshte monark , sepse i ka privilegjet personale te lartepmendura etj.

Privilegje cenesopre i monarkut eshte mosepergjegjesia e tij, ce do te thote se nuk u neneshtrohet kurrefare padive juridike-perkatesishte se juridikishte te beje cdo gje ce deshirone, sepse cka do ce te beje ndaj tij nuk munde te aplikohen kurrefar sanksionesh .-Kjo mosepergjegjesi , domethen fakti se monarku nuk u neneshtrohet sanksioneve , nuk do te thote se per monarkun nuk munde te percaktohen norma juridike, e te cilave eshte i detyruare tu neneshtrohen etj.

Normat e tilla shpeshere ekzistojne e edhe monarku eshte i detyreshem tu neneshtrohet-Monarkia e kufizuar⁸.

Keshtu p.sh. edhe per monarkun vlejne te gjitha normat e pergjitheshme juridike –te themi ,norma se eshte e ndaluare te vraseshe etj, mirepo , edhe ne coftese monarku e shkel kete norme ndaj tije nuk munde te aplikohet kurrefare sanksioni , ai nuk munde te merret ne pergjithesi –Gjithashtu per monarkun munde te percaktohen normat e vecanta, ce kan te bejne vetem me ate-e ce rregullojn vetem sjelljen e tije- duke ia kufizuar zakonishte pushtetin e tije ..

Keshtu , monarkut mund ti ndalohet ce, per shembulle, ta shperndaje parlamentine-mirepo ne disa raste e bene kete nuk do te pergjigjet –ndaj tij nuk munde te aplikohet kurrefare sanksioni –mece nuk pergjigjet –ne shumicen e rasteve etj.

Republika

Pasi me pare e dheme definicionin e monarkise , tani nuk eshte veshtire te japim edhe nocionin e Republikes –kjo caktohet si dicka e kunderte me monarkine.

Ne republik kryetari i shtetit –ce zakonisht cuhet kryetari i republikes – nuk ka kurrefare privilegjesh personale –nuk eshte personalitet sovran ashtu sic eshte ne raste –raste monarku etj.

Ai ka pergjegjesi te dyfishte , ate politike dhe penale ndersa monarku eshte i liruare si nga pergjegjesia politike e po ashtu edhe nga ajo penale etj.

Pergjegjesia politike e kryetarit te shtetit ne republik cendron ne faktin se pergjigjet per politiken ce udhehece domethene per ter drejtimin e vet te ushtrimit te pushtetit etj

Ai, per politik te dobet ai munde te nderrohet nga pozita edhe para skadimit te mandatite te vete etj.

edhe sikuresse cdo cytetare tjetet penalisht pergjigjet per te gjitha veprimet e veta e ce figurojne vepra penale etj.

⁸ Lukic R. ,, Teorija derzava I pravo , libri I, Beograd,1995,fq.316.

Edhe ky ka disa privilegje , por keto privilegje nuk arrijne kurre shkallen e privilegjeve te monarkut ,pra privilegjin e mosepergjegjesise penale etj.

Kryetari i shtetit ne republik eshte i zgjedhur gjithemone me ane te zgjedhjeve etj.

-Ne republiken moderne ka dy menyra te zgjedhjes se kryetarit te republikes-Amerikane dhe Evropiane. Sipas sistemit amerikan, kryetarin e zgjedhe populli –ndonese formalisht as kjo nuk eshte plotesishte e sakte per shba mece ekziston sistemi indirekt i zgjedhjeve nepermjete te ashtucujturit,,te zgjedhur,, ce drejteperdrejte i zgjedh populli-e sipas atij Evropian –parlamenti etj.

Ka lloj lloj republika –ne do ti permendim vetem dy kryesore duke u bazuar sipase kriterit te njejte sikuresse per monarkite-

1.Se pari, ekziston republika e kufizuar dhe e pa kufizuar, dmth. republika ne te cilin shefi i shtetit nuk eshte njekoheishte edhe organ sovran dhe republik ne te cilen eshte. Ne kete pikepamje nuk ka kurrefare dallimi te vertet midise monarkise dhe republikes , pervece faktit se edhe ne kete raste kryetari i republikes gjithemon mbetet pergjegjes pert aktet e veta dhe politikisht dhe penalisht etj⁹.

ne praktik , kjo nuk ndodhe shpesh.-Sa i perket te shkalla e sovranitetit te kryetarit te republikes kurre nuk mund te jete ace i larte si mund te jete ajo e monarkut.

Kryetari i shtetit ne republik eshte gjithemon pergjegjes dhe zgjedhet sipase rregullit-e kjo do te thote se i neneshtrohet kushtetutes etj.

Kurse kualifikimi i dyte i republikes eshte sipase numrit te personave – nga te cilet perbehet shteti perkatesishte kryetari i republikes-ky organ ne te vertet, mund te jet individual ose kolektive- ndersa ne kohet e fundit mbizoteron organi individual etj..

⁹ Osmani Ismajl,,Fillet e se drejtes ,,Prishtine 2012,fq.67.

Nocioni i formes se Regjimit Politik

Sic dihet forma e regjimit politik caktohet sipase raportite ndermjet aparatit shteteror dhe shumices se popullit , perkatesisht popullesise etj.-Kjo forme caktohet sipase asaje se kush eshte bartes politik i pushtetit shteteror sovran-populli ose ndokush tjetër – shumica ose pakica e popullit dhe si-

demokracia eshte forme e regjimit politik ne te cilen pushteti i takon popullit –perkatesisht shumices-domethen ku bartes politik i sovranitetit eshte populli ndersa autokracia eshte form e regjimit politik ne te cilin pushteti i takon pakices se popullit etj.

problem themelor me rastin e caktimit te formes se regjimit politik eshte pikerisht fakti se a eshte fare e mundeshme te flitet per format e „thjeshta,, te regjimit te till-domethene Demokracia e thjeshte , perkatesisht autokracin e thjeshte. Duket se do te mund te flitej per autokracin e thjesht, por jo edhe per demokracinj e thjeshte etj.

Keshtu ce populli respektivisht shumica , kurre, ne te vertet , nuk mund te sundoje.gjithemon sundon pakica , ce e perben organizaten shteterore dhe demokracia dallohet nga autokracia vetem nga se kjo pakice ,dmth. organizata shteterore –aparati i detyrimit –sundon ne emere te popullit,domethene te shumices , ndersa ne autokraci ajo vendose ne emere te vetevetes ose te ndonje pakice tjetër etj.

Derisa ekziston shteti , sic e kemi pare , ai eshte bartes i pushtetit shteterore sovran-domethene bartes eshte organizata e tij,organizata e forces, etj.

Lidhur me kete gjithashtu duhet pasur parasysh se edhe edhe demokracia gjithemon do te thote sundim i nje klase – ose klasave –ndaj klases tjetër-ose klasave.

Demokracia

Me par kemi thene se nocioni i demokracise eshte mjaftë i nderlikuare dhe kontradiktor .ka shume elemente te demokracise dhe eshte veshtir te vendoset nje raport i sakt midis tyre etj.

Demokracia emeri i saj vjen nga fjala greke „demos-popull dhe„kratein-sundoj-sundimi i popullit ce praktikisht do te thote sundim i shumices.demokracia perkufizohet si pavaresi e popullit cve tregon edhe emeri i saj etj.

-Sepse duhet perkufizuar pikerisht sundimin e popullit ,

-Ne kete drejtim ekzistojn disa perkufizime –thene me saktesisht disa elemente te saj .

Pra,c do te thote sundimi impopullit.

1.Se pari , te perkujtojme se kjo nuk do te thote sundim i popullit, por sundim i shumices perkatesisht i klases –ose klasave- ce ka shumicen etj.

Prandej te gjitha shtetet e tjera –sllavopronare , feudale,borgjeze –jane ne te vertet sundim i pakices , domethen jo demokratike , autokratike..

Mece demokracia eshte sundim i popullit , perkatesishte i shumices , kjo ndo te thote se nepermjet demokracise realizohet vullneti i ketij populli perkatesisht i shumices etj.

Vullneti do te thote se populli ka cellime te caktuara ce ia parashtron shtetit dhe kerkon nga ai ce do ti realizoje .

Dhe del se demokracia –si dhe autokracia –ka dy elemente themelore – vullnetin politik te popullit ,si bartes politik i pushtetit , dhe realizimin e saj nepermjet lidheshmerise se till te organozates shteterore me popullin ce siguron zbatimin e vullnetit te popullit , elementi i pare i demokracise eshte elementi i saj i mbrendeshem , esencial , i dyte eshte formal ,elementi i jashtem etj.

Nese nuk ekziston elementi i brendeshem , esencial domethene i vullnetit i caktuar te popullit, atehere nuk ka demokraci ne kuptimin e plote, e edhe nese ekziston elementi i saj i jashtem etj. vullneti i popullit eshte nje faktore shoqeror-politik, pjes e realitetit shoqerore , e kurresesi ndonje form e organizes shteterore.

Me fjale te tjera ,shteti duhet te organizohet ashtu qe jo vetem te mos pengoje , por edhe te nxite krijimin e vullnetit te popullit etj. te organizoje ashtu organet shteterore dhe punen e tyre ce ato te plotesojn vullnetin e

popullit .-per kete cellim perpara duhet parashikuare mjetet me ndihmen e te cilave ky vullnet mund te shprehet qartas etj..

Autokracia

Fjala autis-vete¹⁰-tregone se pushtetin e ushtron pakica ,pakica e popullit.pra autokracia eshte trajte e regjimit politik e kunderte me demokracine.eshte ceverisje e pakices ndaj shumices se popullsesise etj.

Populli te kjo forme nuk i zgjedh organet perfaqesuese e4 as i shkarekon ato etj.

vlen te ceket se ne te gjitha shtetet skllavopronare , feudale i kan pasure autokraci formale pasi ce ne keto shtete s ka ekzistuale as demokracia formale etj.

Kjo do te thote se klasa sunduese kan mundure ti gezojne te drejtate dhe lirit demokratike pra organet shteterore ne aspektin organizative mund te varen prej tyre etj.

Perkundrejte autokracise formale , cendrone autokracia e vertet – demokracia e tille pa marre parasyse se a ekziston edhe autokracia formale , vertet sundone pakica sic jane gjithenje shtetet skllavopronare dhe feudale gjithemone jane autokraci edhe te verteta sepse sundon dhe formale sepse nuk ka demokraci formale etj.

Autokracia formale sllavopronare dhe ajo feudale per klasen e shtypur kurdohere jane autokraci formale. ndersa per klasen sunduese kjo eshte demokratike –formale si dhe autokratike etj.

llojet e ndryshme te autokracise gjate historise kane marre emra te ndryshem .Keshtu , per autokracine ce ka kuptim me te gjere , shpeshhere perdoret termi diktature duke ia kundervene demokracise.

Se pari , diktatura perdoret si nje sinonim i shtetite-keshtu thuhet ce secili shtete eshte diktature e nje klase –si per shembulle diktatura e proletariatite, diktatura borgjeze etj.

Ne kuptimin me te ngushte diktature do te thote pushtet i pakufizuar i nje njeriu –diktature personale etj..

¹⁰ Ismajli Osman „Fillet e se drejtes, Prishtine-2012,fq. 84.

Ne Rome , ka lindre kjo fjali , diktature do te thote dorezim i pushtetit te perkoheshem nje njeriu ,diktatorite-kur shteti eshte ne rrezik etj. Me vone ne Rome diktatura u shenderruane diktature te pa ligjeshme etj.-diktatura e monit,e sulit.

Ndersa Aristokracia eshte nje lloje i autokracise ku sundon nje klase ose nje shtrese njerezish te cilave pushteti u takon ngase ato konsideroheshin me fisnike se te tjeret etj.

Ne feudalizem eshte Aristokracia tipike , ku sundone klsa feudale ,ce eshte fisnike ,eshte me rendesi se pushteti nuk i takon nje njeriu , por nje grupietj..

Përfundim

Nga tere mesimi per shtetin dhe te drejten munde te shihet se ato ne nje pikepikepamje jane nje, unitet tipik i kunderthenjeve. Nga nje ane , shteti eshte organizate e forces , madje organizate e forces me te egere , e forces fizike. Si i tille, shteti eshte nje e kece , nje institucion ce prishe dinjitetin e njeriut dhe vetevetiu ne nje mase pengon zhvillimin e metutjeshem te njeriut ne nje njeri me te larte e me te persosur, sepse ky zhvillim eshte i mundeshem vetem ne liri.

-Pervec kesaj , mu pse shteti eshte organizate me e rendesishme shocerore dhe njekohesishte organizate me e fucishme , ai ushtron edhe nje varg veprimtarish te tjera shoqerore ce nuk jane domosdo te lidhura me te, sepse kryhen pa dhune, por per to eshte me mire ce per arsye te caktuara te kryhen nga ana e shtetit.

Nga kjo del se shteti dhe e drejta zhduken medeomos kur krijohet perseri mundesia ce punonjesit ,prodhuesit e rendomte , te behen edhe drejtues si te procesit te prodhimit ashtu edhe te proceseve te tjera shoqerore.-Mirepo , per tu bere te ketille nevojitet ce prodhimi te pavaresohet asisoje ce me pak pun te mund te prodhohet shume produkte , keshtu qarte fitohet nje kohe relativishte e gjate e lire. Kjo kohe e lire atehere duhet te perdoret per ngritjen kulturore e politike te punonjeseve ce te aftesohen per te drejtuar ate pune ce deri atehere e kryenin specialistet per ceverisje ,te organizuar ne shtet.Kesodore , ne te vertet zhduket dallimi ndermjet punes se krahut dhe punes intelektuale, kurse vete prodhuesit behen drejtues.

Kjo nga ana tjetër, do të thotë se nuk ka me drejtues, perkatsisht se të gjithë njerezite janë edhe prodhues edhe drejtues, e në këtë mënyrë njekohesisht zhduken edhe dallimet klasore ndërmjet njerezve. U mor vesh se ky proces i riaftesimit të prodhuesve për drejtues zgjat relativisht shumë-madje edhe atëherë kur të jete krijuar baza perkatese ekonomike dhe të këtë filluar ngritja perkatese kulturore. Ky proces fillon në kapitalizëm, kur populli punonjës aftësohet për të marrë persiper caktimin e drejtimit themelor të veprimtarisë shtetërore dhe kështu vazhdonë me tutje në socializëm etj. Këtë është shumë me rëndësi të verëhet se vetë baza ekonomike nuk mjafton, perkatesisht se nuk sjell automatikisht aftësimin e punonjëseve për drejtues, por nevojitet edhe një punë perkatese shumë e mundësishme edukative.

-Por, përveç këtyre kushteve ekonomike dhe edukative, nevojitet edhe në organizata shtetërore të pershtatet ashtu në punonjësit dalëngadale të drejtojnë gjithënjë e më shumë shtetin, perkatesisht shoqërinë.-behët në mënyrë efikase edhe edukimi për qeverisje e ajo behët shkollë me e mirë e ceverisjes së masave punonjëse etj.

-Procesi i shuarjes së shtetit është i gjatë dhe zhvillohet gradualisht-në disa periudha ai është me i shpejtë, në të tjerat me i ngadaleshem.

Është me rëndësi të vihet në dukje se procesi i shuarjes së shtetit socialiste duhet të fillojë menjëherë pasë krijimit të tyre.

-Ata,,harrojnë,,të shtojnë se sipas marksit, pikeseperi, proletariatit i nevojitet vetëm një shtet që është në shuarje e sipër,dmth. në është rregulluarë asisojë në të mund të shuhet menjëherë dhe se ai patjetër duhet të shuhet.

-Vetë procesi i shuarjes së shtetit ka shumë forma –por kryesishtë ka tri forma.

1-Në e parë, disa punë shtetërore behen fare të panevojshme. Ato shkurte fikën dhe në shoqëri nuk i kryen me askush.edhe ato dispozita juridike që i rregullojnë këto punë po ashtu abrogohen. Këtë llojë punësh i përbejnë kryesishtë ato punë në kanë të bëjnë me marrëdhënjet ndërmjet eksploatuesve të gjeratëhershëm dhe proletariatit, e në në masën me të madhe karakterizoheshin nga përdorimi i detyrimit.Me ndertimin shkall-shkallë të socializmit zhduket objekti i këtyre punëve dhe ato dalëngadale zhduken, kështu në zhduken ose pakesohen edhe ato organe shtetërore në i kryenin.

2-Lloji i dyte, i puneve shteterore ende eshte i nevojeshem , por nuk ka me nevoje ce te kryejne pikerishte vet shteti , dmth. nje organizate e vecante, e shkeputur nga shoqeria ,qe ka mose perdorim te forces fizike. Prandej , keto pune fillojne te barten ne disa organizata shoqerore ose ne vet njerezite drejteperdrejte,pa ndonje organizate te vecante .Me fjalt te tjera , keto pune dalengadale humbin karakterin e puneve shteterore dhe behen pune shoqerore , qe kryhen nga organet shoqerore te cilat nuk disponojne kurrefare monopoli te fucise forces fizik as ce kane ndonje organizate te vecante.

Dispozitat juridike ce i rregullojne keto pune behen po ashtu dispozita te lira –shoqerore.

Nje pjese e konsiderueshme e puneve shteterore nuk do te zhduken kurre, por do te kalojne gradualisht ne punet shoqerore qe do ti kryejne organet shoqerore –Udhehecja e shoqerise –epara se gjithashe e procesit te prodhimit –ce dikur kryehet nga klasa sunduese dhe qe ajo mund ta kryente vetem me masa detyrimi per shkak te konfliktit te klasave , kalon ne duarte e shoqerise dhe keshtu dalengadale nuk do te kete me nevoje per perdorimin e forces per ket udhehecje etj.etj.

Bibliografia

1. 1-Kepuska Avni ‘‘Qenesia e territorit dhe Kufijve Etnik, Autoktone te kosoves,, bot. i Trete –Prishtine 2004 etj.
2. 2-Martin Van Gelderen Cuentin skiner,EDS,Republikanizmi-Nje Trashigimi e Perbashket Evropiane IV ,1, Republikanizmi dhe kushtetutizmi ne Evropen e hershme,Moderne.Kembrixh.Cambridge University press.
3. 3-Eric Gojosso,le Concept De Republicue En France-XVi e Siccle.Etjmarseile ,1998.
4. 4-James Hankins ‘ Republikanizmi Eksluzivisht dhe Republikanizmi, kembrixh,CambridgeUP ,1990 etj.
5. 5-Frederse Mongra ,Lidee De Republicue et Jurisprudenic du Conseil Constitutionme.LGGJ. PANS .
6. 6-Paula . Rahe-Republices Acient And Modern Ciassical Republicomism and the american revolution 3 v .Chapel Hill.u. Of North Carolina Pres 1992, 1994 In DJU..
7. 7-Sarah Barber ,Regicide and Republicanisan –Politices and etnices in the English Republic 1649-

8. 8-Joyce Appleby , Ed .Nenur,,Republikanizmi,, i Amerikan Cuartly –fall 1985 inDGJJU.
9. 9-Republic] Definition Of Republic By The Oxford English Dictionary-Oxford english Dictanary.
10. 10-Max Weber,,Politika si profesion-1919EDGJJU.
11. 11-Manual per Arsimin Per te Drejtat e Njeriut , Bot. universiteti i Prishtines 2014 etj.
- i. Editor-Wolf Gang Bener-wien-Graz..
12. 12-Saliu kurtesh,, E Drejta kushtetuese –ksa-1999.
13. 13-Qerimi Qerim dhe Zyberi Gentian ,, E drejta Nderkombetare e te drejtave te Njeriut-Prishtine 2015 Bot.Grafoben-Prishtine.
14. 14-Gruda Zejnullah,,Mbrojtja Nderkombetare e te Drejtave te Njeriut - 2000-Prishtine..
15. 15-Saliu Ismet ,, E drejta Penale –Pjesa e Pergjitheshme –bot. Fama-Prishtine 2012.
16. 16-Mark w. Janis
17. Richard S. Kay
18. Anthony W. Bradley,, E drejta Evropiane e Te Drejtave te Njeriut-2002-Prishtine.
19. 17-Bajrami Arsim,,Sistemi kushtetues i Republikes se kosoves-Bot. Universiteti i kosoves-2011-Prishtine.

POZITA JURIDIKE E FEMIJËVE JASHTËMARTESORË

Doc.Dr Rudina Kaja

Universiteti Nderkombetar I Strugës

Apstrakt

Martesa është bashkëjetesë ligjore, e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza të unitetit në familje. Neni 2 i Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë familjen e përkufizon si bashkësi jetësore të prindërve, fëmijëve dhe të personave të tjerë në gjini, nëse jetojnë në një familje të përbashkët. Në këtë studim do të vendoset në pah çështja kryesore që ka të bëjë me poziten juridike të femijeve jashtmartesore që lindin në një bashkësi jashtmartesore. Martesa, përbën bazën e ligjshme të familjes, prandaj një nga detyrat më të rëndësishme të shtetit dhe shoqërisë është kujdesi për forcimin e martesës. Bashkësia martesore është bashkësi e lirë, solemne e jetës së një burri dhe një gruaje, me të cilën vendosin për jetë të përbashkët dhe krijimin e familjes, sipas kushteve për lidhjen, pasojat dhe zgjidhjen e saj të paraparë me dispozita ligjore. Bashkësia jashtmartesore është bashkësi faktike midis burrit dhe gruas. Qëllimi themelor i formimit të saj është jetesa e përbashkët, e cila duhet të ketë zgjatur një periudhë të konsiderueshme kohore dhe të jetë e vazhdueshme. Sipas ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë me bashkësinë jashtmartesore kuptojmë bashkësinë e një burri dhe një gruaje e cila nuk është themeluar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe e cila ka zgjatur së paku një vjet, është e barabartë me bashkësinë martesore sa i përket të drejtës së mbajtjes reciproke dhe pasurisë së fituar gjatë kohëzgjatjes së asaj bashkësie¹.

Fjalë kyçe: *bashkësia jashtmartesore, bashkësia martesore, familje, femijet jashtmartesor, etj*

¹ Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.80/92. Neni 13, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.80/92.

Abstract

Marriage is a legal cohabitation, which is based on the moral and legal equality of the spouses, on love, respect and understanding, as basis of family unity. Article 2 of the Family Law of the Republic of Macedonia defines the family as the life community of parents, children and other persons of the same sex, if they live in a joint family. This study will highlight the importance of legal position of illegitimate children born in an illegitimate community. Marriage constitutes the legal basis of family, therefore one of the most important duties of the state and society is to take care of the strengthen marriage.

Marriage is a free solemn communion of a man and a woman, with whom they decide to live together and create a family, according to the conditions for the relationship, its consequences and its resolution provided by legal provisions. Cohabitation is a de facto union between a man and a woman.

The basic purpose of its formation is the common life, which must have lasted a considerable period of time and be continuous. According to the family law of the Republic of Macedonia, extramarital union means the union of a man and a woman which was not established in accordance with the provisions of this law and which lasted at least one year, is equal to the marital union in terms of the right of mutual maintenance and property acquired during the duration of that community.

Key words: extramarital union, marital union, family, illegitimate children, etc.

HYRJE

Kuptimi i bashkësisë jashtëmartesore, në shoqëritë moderne, është gjithnjë e më i madh dhe më i theksuar, sepse përfaqëson një formë apo lloj të krijimit të një familjeje, e cila ka të njëjtat nevoja jetësore dhe realizimin e të njëjtave si familja e bazuar në martesën formale ligjore. Mirëkuptimi dhe pranimi i familjes së paligjshme, përgjatë shekujve të zhvillimit shoqëror, nuk ishte i lehtë, madje u stigmatizua dhe u la plotësisht jashtë kujdesit të bashkësisë shoqërore. Kundërshtarët më të mëdhenj të bashkësisë jashtëmartesore ishin institucionet dhe organizatat fetare, duke e konsideruar të kuptuarit e tyre të martesës si të vetmen bashkim të lejuar midis një burri dhe një gruaje.

Bota moderne po e ndryshon këtë marrëdhënie dhe bashkë me të po ndryshon edhe statusi i bashkësisë jashtëmartesore, i cili ka filluar të pranohet qartë në legjislacionet e shteteve, duke ofruar disa të drejta për partnerët jashtëmartesorë (si p.sh. e drejta në pronë, e drejta në trashëgimi dhe të drejta të tjera), edhe pse barazimi i plotë i dy bashkësive nuk është vendosur, as në jurisprudencën aktuale të shteteve të caktuara. Njëkohësisht, ky qëndrim për legalizimin e bashkësisë jashtëmartesore, i shprehur në rregullimin ligjor, është reflektuar në mënyrë të favorshme në praktikën e gjykatave, me synimin për zgjidhjen e drejtë dhe të duhur të mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga ekzistenca e një afati me te gjate e bashkësisë jashtëmartesore.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mbrojtja e marrëdhënieve juridike që rrjedhin nga bashkësia jashtëmartesore në sferën e mbajtjes parashihet - me Ligjin për familjen², fitimin e pronës - me Ligjin për pronën dhe të drejtat tjera sendore³ dhe kompensimin e dëmit në rast vdekja ose paaftësia e rëndë e njërit nga partnerët jashtëmartesor - me Ligjin për marrëdhëniet e detyrueshme⁴.

Gjate ekzistimit të bashkësisë jashtëmartesore, kemi edhe lindjen e fëmijëve, ku Maqedoninë e Veriut vetëm 13,7 për qind e fëmijëve kanë lindur në lidhje jashtë martesore, për dallim nga Evropa Perëndimore dhe Veriore ku më shumë se gjysma e fëmijëve të lindur janë nga prindër të pamartuar, tregon analiza e portalit statistikor “Landgeist”, bazuar në të dhënat e Eurostat.

Të drejtat prindërore, të cilat i takojnë babait dhe nënës në mënyrë të barabartë, konsistojnë në të drejtat dhe detyrat e prindërve për t'u kujdesur për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre të mitur dhe fëmijëve mbi të cilët janë shtrirë të drejtat prindërore. Nëse njëri prej prindërve është i vdekur, i panjohur, i privuar nga e drejta prindërore ose nëse për shkaqe të tjera pengohet të ushtrojë të drejtën prindërore, të drejtat prindërore i ushtron prindi tjetër.

Pra, subjektet e marrëdhënies prindërore janë: nëna, babai dhe fëmija dhe kjo marrëdhënie, si dhe vetë e drejta prindërore, lindin nga momenti i lindjes së

² Neni 193 i Ligjit për Familjen

³ Neni 81 i Ligjit për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Moldavisë nr. 18/2001; 31/2008; 92/2008;139/2009; 35/2010

⁴ Neni 190, paragrafi 4 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Moldavisë nr. 18/2001; 78/2001; 4/2002; 59/2002; 5/2003; 84/2008; 81/2009; 161/2009; 23/2013; 123/2013; 215/2021.

fëmijës, pra birësimit. Në varësi të mënyrës se si rregullohet statusi social i fëmijëve në Ligjin për Familjen, fëmijët mund të jenë:

1. Fëmijët e njohur nga të dy prindërit, të martuar (fëmijë martesor) dhe që jetojnë me të dy prindërit ose vetëm me njërin prind, nëse lidhja martesore është prishur;

2. fëmijët e njohur nga të dy prindërit që nuk janë të martuar (fëmijë jashtëmartesor), prindërit e të cilëve mund të jetojnë së bashku (në bashkëjetesë) ose jo;

3. fëmijët me të cilët njihet njëri prind (fëmijë jashtëmartesor);

4. fëmijët të cilëve nuk u njihet asnjëri nga prindërit (themeluesit);

5. fëmijët, prindërit e të cilëve janë të vdekur ose të zhdukur (jetimë);

6. Fëmijët e braktisur (fëmijë nën kujdestari - të përshkruar në numrin 4., 5. dhe 6.); dhe

7. fëmijët e birësuar.

1. Nocioni i fëmijeve jashtëmartesorë

Fëmijët jashtëmartesorë për një kohë të gjatë janë lënë në mëshirën e fatit. Pozita e tyre ka qenë juridikisht e parregulluar. Si rezultat i ushtrimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve, që po rritet kohëve të fundit, në pjesën dërrmuese të vendeve të botës pozita e fëmijëve jashtëmartesorë tani është përmirësuar dukshëm.

Fëmijës nuk i lejohet e drejta e punës, pa e arritur moshën përkatëse minimale, në asnjë mënyrë nuk i jepet shkas apo nuk i lejohet të ushtrojë një profesion apo veprimtari që cënon shëndetin apo edukimin e tij, apo që pengon në zhvillimin e tij shoqëror, shpirtëror dhe fizik (neni 9 i Parimeve të Deklaratës mbi të drejtat e fëmijës, 1959).

Në të drejtën tonë fëmijët jashtëmartesorë janë barazuar plotësisht me fëmijët martesorë, si në pikëpamje të të drejtave ashtu edhe të detyrimeve. Fëmijë jashtëmartesorë quajmë:

- Çdo fëmijë jashtëmartesor që e ka lindur gruaja e pamartuar,

- Çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e ve, dmth. gruaja e martuar pas zgjidhjes së martesës dhe pas kalimit të afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës,

- Çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e martuar gjatë martesës apo shpalljes së saj të pavlefshme, ose atësia e fëmijës është kundërshtuar gjyqësisht me aktgjykim të formës së prerë, ose brenda afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës. Është e domosdoshme të vërtetohen prindërit, që barazia e fëmijëve të realizohet⁵. Vërtetimi i marrëdhënieve prindërore jashtëmartesore bëhet në këto mënyra: a) me njohjen e amësisë, b) me njohjen e atësisë dhe c) me njohjen e atësisë dhe të amësisë me vendim gjyqësor.

a) Njohja e amësisë - është një veprim i njëanshëm juridik i një gruaje, e cila shpreh vullnetin e lirë ligjërisht se ajo është nëna e fëmijës të lindur jashtëmartesor. Njohja e amësisë paraqitet rrallë në praktikë si dukuri, sepse nëna shumë vështirë vendos ta braktisë fëmijën e vet. Për këtë arsye shumë vende të botës nuk e kanë rregulluar me dispozita konkrete ligjore çështjen e njohjes së amësisë, ky problem i njohjes së amësisë nuk është i rregulluar as me dispozitat e LFK-së.

b) Njohja e atësisë - sikurse njohja e amësisë, edhe njohja e atësisë është një akt i njëanshëm juridik me anë të të cilit mashkulli shpreh në mënyrë valide vullnetin e vet se ai është i ati i fëmijës jashtëmartesor. Për dallim prej njohjes së amësisë e cila është e rregulluar shumë pak me ligje, njohja e atësisë është e rregulluar me dispozita ligjore pothuajse në shumicën e vendeve të botës. Atësia mund ti njihet mashkullit i cili ka aftësi të veprimit dhe i cili ka arritur moshën 16-vjeçare, si dhe personit i cili pjesërisht ka qenë i zhveshur nga zotësia për të vepruar, nëse është në gjendje të kuptojë përmbajtjen e deklaratës për njohjen e atësisë (neni 102 i LFK-së). Atë i fëmijës së lindur jashtë martese është personi madhor që e njuh fëmijën për të vetin. Dallimi midis legjislacionit të Kosovës dhe atij të Shqipërisë është se legjislacioni i Kosovës ia njuh të drejtën për njohjen e atësisë edhe mashkullit të mitur i cili ka mbushur moshën 16 vjeçare.

Mashkulli i cili dëshiron ta njoh fëmijën jashtëmartesor për të vetin, duhet të bëjë deklarinimin e vullnetit personalisht. Deklarata për njohjen e atësisë nuk mund të jepet përmes përfaqësuesit me prokurë (neni 103 par. 4 i LFK-së). Njohja është gjithashtu akt individual dhe moral sepse përcakton atësinë e fëmijës të

⁵ Vojislav Bakic: vepër e cituar, fq. 247

lindur jashtëmartesor. Njohja e atësisë duhet të bëhet veç e veç për çdo fëmijë. Kjo do të thotë se njohja nuk është e lejueshme të bëhet me një deklaratë dhe njëkohësisht për shumë fëmijë

Procedura për njohjen e atësisë – procedura është mjaft e thejshtë, personi i cili veten e konsideron atë të fëmijës mund ta pranojë atësinë në njërin nga këto mënyra:

- Duke deklaruar në procesverbal para ofiqarit se e njih atësinë e fëmijës jashtëmartesor,

- Duke deklaruar se e njih atësinë e fëmijës jashtëmartesor para organit të kujdestarisë,

- Me testament.

Njohja e atësisë në këto mënyra është paraparë me dispozitën e nenit 103 të LFK-së. Sipas nenin 51 të LFM-së njohja e atësisë përveç përpara ofiqarit, qendrës për punë sociale mund të bëhet edhe përpara gjyqit. Kushtet për njohjen e atësisë – janë të rregulluara me dispozita ligjore. ⁶Megjithatë ka rëndësi të theksohet se kur është fjala për njohjen e atësisë nuk vërtetohet nëse mashkulli i cili e pranon fëmijën për të vetin është edhe atë natyror i fëmijës ⁷. Ligji i familjes i Kosovës ka paraparë këto kushte për njohjen e plotëfuqishme të fëmijës: a) lindja gjallë e fëmijës, b) pëlqimi i nënës së fëmijës, c) pëlqimi i fëmijës dhe ç) zotësia për të vepruar.

Efektet juridike të njohjes së atësisë – edhe me njohjen e atësisë shkaktohen ato efekte juridike sikurse me vërtetimin e atësisë. Me rastin e vërtetimit të atësisë vendosen marrëdhëniet prindërore mes atit dhe fëmijës jashtëmartesor të cilat në të vërtetë kanë ekzistuar nga lindja e fëmijës. Poashtu krijohen edhe marrëdhëniet juridike mes fëmijës jashtëmartesor dhe gjinisë së atit, atësia e të cilit është vërtetuar me njohjen e atësisë.

Njohja e atësisë regjistrohet në regjistrat amë të të lindurve. Anulimi i atësisë së njohur – mund të bëhet në qoftë se me rastin e njohjes së fëmijës jashtëmartesor nuk kanë qenë të plotësuar kushtet ligjore. Duke marrë për bazë kushtet ligjore të detyrueshme për njohjen e atësisë së plotëfuqishme mund të thuhet se anulimi i atësisë mund të jetë absolut dhe relativ.

⁶ Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.207

⁷ Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.208

Kundërshtimi i atësisë së njohur –me njohjen e atësisë vërtetohet atësia dhe vendosen marrëdhëniet prindërore midis atit dhe fëmijës⁸. Padia për kundërshtimin e atësisë mund të paraqitet nga personi i cili veten e konsideron atë natyror të fëmijës. E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e një viti nga regjistrimi i atësisë në regjistrin e gjendjes civile (neni 188, par. 3 i KFSH-së).

2. Vërtetimi i amësisë me vendim të gjykatës

Me vërtetimin e amësisë me vendim gjyqësor gjithashtu vendosen marrëdhëniet prindërore midis nënës dhe fëmijës jashtë martesë, me vendim të gjyqit. Edhe pse shtatëzania dhe lindja e fëmijës, janë ngjarje të dukshme, ndërsa nëna vështirë vendos ta braktis fëmijën e vet, ngase ka ndjenja të fuqishme emocionale të fuqishme, prapëseprapë, në teorinë juridike sundon mendimi se vërtetimi i amësisë me vendim gjyqësor është i arsyeshëm. Arsyeshmëria qëndron në faktin se në shërbimet e maternitetit ndodhin raste të ndërrimit të foshnjave, qoftë me dashje apo në mënyrë të pavullnetshme. Si pasojë, lind konflikti rreth të drejtës së amësisë mes nënës natyrore e cila ka lindur fëmijën, dhe një gruaje tjetër e cila pretendon se fëmija është i saj.

Dukuria e trafikimit të fëmijëve duke i shëndërruar ata në objekt tregtie, po zmadhohet e cila është në kundërshtim me nenin 9 të parimeve të Deklaratës për të drejtat e fëmijës (1959). Janë të njohura rastet e simulimit të lindjeve dhe të shitblerjes së fëmijëve të huaj qysh në lindjen e tyre⁹. Do theksuar se, me gjithë rëndësinë që merr e drejta e vërtetimit të amësisë me vendim gjyqësor, prapëseprapë procedura e vërtetimit të amësisë nuk është e rregulluar me norma ligjore të Ligjit për familjen të Kosovës. Gjykata në mungesë të normave ligjore, të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e amësisë zbaton në mënyrë analoge dispozita ligjore, të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e atësisë me vendim të gjyqit.

Shumë më e thjeshtë dhe shumë më e shpejtë është procedura e njohjes së amësisë, sesa ajo e vërtetimit të amësisë me vendim të gjykatës. Si kriter bazë për vërtetimin e amësisë gjykata merr parasysh shtatëzaninë dhe lindjen e fëmijës, si ngjarje të dukshme, duke qenë se nënë e fëmijës konsiderohet gruaja e cila e ka lindur fëmijën.

⁸ Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.209

⁹ Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.209

E rëndësishme është se me vërtetimin e atësisë me vendim të gjykatës vendosen marrëdhëniet prindërore mes nënës dhe fëmijës, sikurse edhe marrëdhëniet juridike të fëmijës me gjininë e nënës.

Theksojmë se fëmija edhe më tutje mban statusin e fëmijës jashtëmartesor, por me këtë rast ai e ndryshon statusin familjar, për aq sa tani amësinë e ka të vërtetuar¹⁰.

3.Vërtetimi i atësisë me vendim te gjykatës

Fëmija ka të drejtë natyrore të rritet dhe të jetojë me të dy prindërit e vet. Duke marrë përparësi mbrojtjen e interesave të fëmijëve, e drejta moderne lejon vërtetimin e atësisë me vendim të gjykatës në të gjitha rastet duke synuar ndalimin e çfarëdo forme të diskriminimit të fëmijëve jashtë martese dhe barazimin e tyre në pikëpamje të të drejtave dhe detyrimeve me fëmijët martesorë.

Me dispozitën e nenit 189 KFSH-ja vërtetimin e atësisë së fëmijës së lindur jashtë martese e rregullon shprehimisht. Atësia e një fëmije të lindur jashtë martese mund të vërtetohet me vendim të gjykatës, në rast se gjatë gjykimit provohet se në kohën e zënies së fëmijës i ati bashkëjetonte me nënën e fëmijës, ose ka kryer marrëdhënie seksuale me apo pa dhunë, ose i ka premtuar martesë se nga një gjykim penal apo civil rezulton në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi atësia e fëmijës së lindur jashtë martese, si dhe kur dihet publikisht se ai e ka njohur fëmijën si të vetin (neni 189 i KFSH- së). Në teorinë juridike mbizotëron mendimi se vërtetimi i atësisë së fëmijës të lindur jashtë martese me vendim të gjykatës mund të bëhet vetëm pasi të ketë lindur fëmija.

E drejta e paraqitjes së padisë- E drejta e paraqitjes së padisë për vërtetimin e atësisë së fëmijës të lindur jashtë martese me vendim të gjykatës u njihet këtyre subjekteve: nënës së fëmijës, fëmijës, personit i cili pretendon se është ati i fëmijës por ka qenë i penguar për njohjen e atësisë dhe organit të kujdestarisë.

E drejta e paraqitjes së padisë për vërtetimin e atësisë të një fëmije të lindur në marrëdhëniet jashtëmartesore i njihet nënës së fëmijës gjithmonë derisa ajo ushtron të drejtën prindërore¹¹.

¹⁰ Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.210

¹¹ Santhipi Begeja, vepër e cituar, faqe 168

Ajo, si subjekt i së drejtës prindërore, këtë të drejtë e ushtron në mënyrë të pavarur. Nëna e fëmijës mund të paraqesë padinë për vërtetimin e atësisë në emër të vet dhe në emër të fëmijës¹², ose njëkohësisht edhe në emër të vet po edhe në emër të fëmijës, si përfaqësues ligjor i fëmijës¹³. Kur nëna ka vdekur ose nuk e ushtron më të drejtën prindërore, sepse ajo i është hequr apo për çfarëdo shkakuj tjetër është në pamundësi që ta ushtrojë atë, e drejta e paraqitjes së padisë i kalon kujdestarit. Kujdestari, sipas dispozitës së nenit 110 par. 3 të LFK-së, padinë mund ta paraqesë vetëm me lejen e organit të kujdestarisë. Organi i kujdestarisë mund ta paraqesë padinë për vërtetimin e atësisë me vendim të gjykatës në qoftë se nëna e fëmijës, me rastin e paraqitjes së lindjes së fëmijës ka shënuar emrin e personit të cilin ajo e konsideron atë të fëmijës dhe nuk ka ushtruar padinë për vërtetimin e atësisë, duke lënë pas dore mbrojtjen e interesave të fëmijëve. Konsiderohet se nëna ka lënë pas dore mbrojtjen e interesave të fëmijëve nëse ka kaluar afati ligjor e ajo nuk e ka paraqitur padinë në gjyq.

Vetëm pas kalimit të afatit, organi i kujdestarisë ka të drejtë të paraqesë padinë në gjyq për vërtetimin e atësisë së fëmijës të lindur jashtë martesë me vendim të gjykatës.

Po ashtu, fëmija ka të drejtë të paraqesë padinë për vërtetimin e atësisë me vendim të gjykatës. Derisa fëmija është i mitur apo nuk ka zotësinë për të vepruar, padinë në emër të tij mund ta paraqesë nëna, si përfaqësuese ligjore e fëmijës, apo në kushte të caktuara si më lartë, padinë mund ta paraqesë edhe kujdestari. Edhe personi i cili veten e konsideron atë të fëmijës ka të drejtë të paraqesë padinë për vërtetimin e atësisë me vendim të gjykatës. Personit, i cili konsideron të jetë atë i fëmijës, rregullativa ligjore ia njeh të drejtën e padisë vetëm në rastet kur i është pamundësuar njohja e atësisë jashtë martesë, e jo edhe atëhereë kur ai ka qenë i gatshëm për ta pranuar fëmijën për të vetin, por ka dëshiruar që në procedurë gjyqësore duke marrë të gjitha provat e nevojshme materiale, të vërtetojë se ai është në të vërtetë ati i fëmijës¹⁴. Efektet e vërtetimit të atësisë jashtëmartesore- Si në rastin e njohjes së atësisë, ashtu edhe kur është fjala për vërtetimin e atësisë së fëmijës të lindur jashtë martesë, kemi të bëjmë me vendosjen e marrëdhënieve prindërore mes fëmijës jashtëmartesor dhe të atit, të cilit atësia i është vërtetuar me vendim të gjykatës.

¹² Dr. Nerimana Traljic, dr. Suzana Bubic: vepër e cituar faqe 128

¹³ Dr. Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr. Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.212

¹⁴ Dr. Nerimana Traljic, dr. Suzana Bubic: vepër e cituar faqe 128

Pra, edhe me këtë rast krijohen marrëdhëniet juridike mes fëmijës jashtëmartsor me gjininë e atit të vërtetuar me vendim të gjyqit.

Fëmija vendoset në familjen e atit të vërtetuar. Ai ka të drejtë ta lërë mbiemrin e nënës, të cilën e mbante deri atëherë, dhe ta marrë mbiemrin e të atit. Statusi i fëmijës nuk ndryshon- statusin jashtëmartsor të cilin fëmija e kishte fituar me lindje, do ta mbajë edhe më tutje .

Aktgjykimi mbi vërtetimin e atësisë së fëmijës jashtëmartsor ka efekte absolute, ai vepron ndaj ta mbajë edhe më tutje të gjithëve “erga omnes”, dhe të gjithë kanë detyrë ta respektojnë.

4. Kuptimi i të drejtës prindërore

Të drejtën prindërore e përbëjnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve që të kujdesen për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre të mitur dhe fëmijëve mbi të cilët është vazhduar e drejta prindërore. E drejta prindërore është pjesë përbërëse e së drejtës familjare, ajo merret me studimin e marrëdhënieve midis prindërve dhe fëmijëve dhe të marrëdhënieve midis personave të tjerë në gjini. E drejta prindërore është tërësi rregullash juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, midis birësuesit dhe të birësuarit, midis kushërinjëve dhe ndaj personave tjerë në gjini. E drejta prindërore u takon në masë të njëjtë edhe nënës edhe babait. Nëse njëri nga prindërit është i vdekur ose nuk është i njohur ose i është marur e drejta prindërore ose për shkaqe të tjera është penguar që të ushtrojë të drejtën prindërore, atëherë të drejtën prindërore e ushtron prindi tjetër.

E drejta prindërore është pjesë përbërëse e sistemit juridik të vendit.

Marrëdhënia prindërore përmban dy elemente kryesore: elementin natyral dhe elementin juridik (të përgjithshëm)¹⁵. Elementi natyral biologjik është konstant, gjithmonë i pandryshuar dhe manifestohet me lindje. Marrëdhëniet prindërore zgjasin deri në mbushjen e moshës madhore të fëmijës. Vetëm në rastet e parapara me ligj ato mund të vazhdohen edhe pas mbushjes së moshës madhore. Mund të konkludojmë se jo të gjitha marrëdhëniet prindërore mbarojnë mes prindërve dhe fëmijëve, kur këta të fundit e fitojnë moshën madhore. Elementi juridik, përkatësisht komponentja e përgjithshme imponon nevojën e

¹⁵ Lilana Cpirovik-Terpenovska, vepër e cituar, faqe 146

vërtetimit të lidhjes biologjike të fëmijës me prindërit veç e veç ¹⁶. Posaçërisht kjo gjen shprehje në rastin e vërtetimit të atësisë ose amësisë. Rregullat juridike me të cilat rregullohen këto marrëdhënie janë të përfshira në Ligjin për familjen.

Është e kuptueshme se fëmija lind në familje dhe marrëdhëniet e prindërve dhe të fëmijëve krijohen në momentin e lindjes së tyre, ndonëse në doktrinën juridike ka mendime se këto marrëdhënie krijohen edhe më herët, madje me vetë zënien e fëmijës.

5. Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve

Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve të mitur janë të dylojshme:

- a) Të drejtat dhe detyrat personale të prindërve ndaj fëmijëve
- b) Të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj pronës së fëmijëve.

Të drejtat dhe detyrat personale të prindërve ndaj fëmijëve- të drejtat prindërore janë të lidhura ngushtë me personalitetin e prindit. Askush nuk ka të drejtë të përzihet në marrëdhëniet mes fëmijëve dhe prindërve, përderisa prindërit të drejtat dhe detyrimet i ushtrojnë në interes të fëmijëve.

Mund të thuhet se e drejta prindërore njëkohësisht është edhe e drejtë absolute e prindërve. Ata kanë të drejtë të kërkojnë nga organet shtetërore të merren masa ndaj çdo personi që ata i pengon në ushtrimin e të drejtave prindërore. Këto të drejta nuk mund t'i kalojnë një personi tjetër e as të trashëgohen¹⁷. Prindërit I ushtrojnë të drejtat prindërore me marrëveshje. Në ushtrimin e tyre janë plotësisht të barabartë, dmth. kanë të drejta, detyra dhe përgjegjësi të njëjta. Prindërit kanë të drejtë dhe obligim që t'i ushqejnë fëmijët e tyre të mitur, të kujdesen për jetën dhe shëndetin e tyre, t'i përgatisin për jetë dhe punë të pavarur, të kujdesen për edukimin e tyre, shkollimin dhe aftësimin profesional.

Fëmijët e mitur kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre. Prindi me të cilin nuk jeton fëmiju, ka të drejtë në mbajtjen e lidhjeve personale me fëmijën e vet. Prindërit poashtu kanë të drejtë dhe janë të obliguar t'i përfaqësojnë fëmijët e tyre. Të drejtat dhe detyrat prindërore nuk janë të përhershme. Ato mbarojnë kur

¹⁶ Po aty, faqe 146

¹⁷ Santhipi Begeja: vepër e cituar, faqe 205

fëmija mbush moshën madhore, kur bëhet i aftë të kujdeset për vete, për të drejtat dhe interesat e veta.

Të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj fëmijëve janë:

1. Caktimi i emrit,
2. Ruajtja dhe mirërritja,
3. Arsimimi dhe edukimi,
4. Mbajtja,
5. Përfaqësimi.

Caktimi i emrit- emri personal përbëhet nga emri dhe mbiemri. Cdo fëmijë I lindur ka të drejtë të ketë emrin personal. Me marrëveshje prindëit i zgjedhin dhe i caktojnë fëmijës emrin personal. Në qoftë se nuk arrihet marrëveshja, atëherë fëmijës i zgjedh dhe i cakton emrin organi i kujdestarisë, pasi të ketë dëgjuar të dy prindërit lidhur me këtë çështje.

Fëmijës së gjetur, kur nuk i dihen prindërit, gjithmonë emrin i cakton organi i kujdestarisë.

Ashtu sikurse me rastin e caktimit të emrit edhe mbiemrin e caktojnë të dy prindërit me marrëveshje. Në qoftë se ndodh që prindërit të kenë mbiemra të ndryshëm, fëmija merr mbiemrin e njërit apo të të dy prindërve . Kur prindërit nuk mund të arrijnë marrëveshje lidhur me caktimin e mbiemrit, gjithashtu edhe mbiemrin e cakton organi i kujdestarisë, pasi të ketë dëgjuar të dy prindërit. Sipas nenit 171 Të KFSH-së, fëmija i lindur jashtë martesës e merr mbiemrin e prindërit, amësia ose atësia e të cilit është vendosur më parë.

Sipas kësaj dispozite nëse amësia dhe atësia vendosen në të njëjtën kohë, prindërit vendosin me marrëveshje se cilin mbiemër do ta mbajë fëmija. Në rast mosmarrëveshjeje, fëmija merr mbiemrin e të atit.

Pas ndryshimeve statusore të familjes, fëmijës së mitur mund t’i caktohet mbiemri i ri. Sipas dispozitës së nenit 132 të LFK-së, mund të lejohet caktimi i mbiemrit të ri brenda afatit prej dy muajsh, pas ndryshimeve statusore të familjes. Pëlqimi i fëmijës është i nevojshëm, nëse fëmija është mbi moshën dhjetë vjeçare (neni 132 par. 2 i LFK –së).

Ruajtja dhe mirëritja e fëmijëve- Prindërit kanë për detyrë që bashkërisht të përkujdesen për jetën dhe shëndetin e fëmijëve ¹⁸. Kjo nënkupton se detyrë e prindërve është që fëmijët e tyre të mitur t'i mbrojnë prej çfarëdo rreziku që atyre u kanoset.

Në rast të sëmundjes apo dëmtimit të shëndetit, prindërit kanë për detyrë përkujdesjen për shërimin e fëmijëve të mitur, duke u siguruar ayre shërbimet e nevojshme mjekësore në institucione të specializuara shëndetësore. Ata poashtu kanë të drejtë të zgjedhin mjekun dhe institucionin shëndetësor në të cilin fëmija do të shërohet ¹⁹. Të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh a kanë lindur brenda bashkësisë martesore apo jashtë saj, gëzojnë mbrojtje të njëjtë sociale dhe shëndetësore ²⁰.

Prindërit kanë detyrë që fëmijën ta mbrojnë nga gabimet, të cilat mund të vijnë si pasojë e moshës së re të tij. Sipas nenit 125 të LFK-së, fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër, ndërsa ata që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë ta takojnë rregullisht prindin me të cilin nuk jetojnë së bashku. Prindërit e kryejnë më mirë detyrimin e ruajtjes dhe të mirëritjes së fëmijëve kur i kanë në familje, pranë vetës. Megjithatë, këtë detyrë ata mund t'ia besojnë edhe një institucioni ose një personi të tretë.

Fëmijët me zhvillim të metë mental apo fizik kanë të drejtë në kujdes të posaçëm, që t'u sigurohet jetë e dinjitetshme dhe pjesëmarrje aktive në aktivitete shoqërore (neni 125 par.3 i LFK-së). Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e fëmijëve të cilët mbahen në mënyrë të paligjshme nga një person tjetër.

Arsimimi dhe edukimi- Çdo fëmijë ka të drejtë në arsimim dhe edukim. Prindërit kanë për detyrë që të kujdesen për arsimim dhe edukim të drejtë të fëmijëve të mitur, ashtu që ata të përvetësojnë nga sistemi i vlerave pozitive të shoqërisë.

Prindërit kanë të drejtën prindërore që të zgjedhin llojin e shkollimit, i cili do t'u ofrohet fëmijëve, duke marrë parasysh aftësitë, prirjet dhe dëshirat e tyre. Përveç prindërve dhe familjes, në edukimin dhe arsimimin e shëndoshë të brezit të

¹⁸ Vojislav Bakic: vepër e cituar, fq. 297

¹⁹ Asbjern Eide dhe Eénche Barth Eide, Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut, botuar në Holandë, faqe 552

²⁰ Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.225

ri marrin pjesë edhe institucione të ndryshme shoqërore dhe shtetërore, duke filluar prej atyre parashkollore e deri te ato shkollore, organi i kujdestarisë, shërbimet profesionale, pedagogjike etj.

Kur fëmijët kanë sjellje të këqija, mund të njoftohet organi i kujdestarisë, i cili ka për detyrë të ndërmarrë masa të nevojshme dhe të intervenojë për mënjanimin e mangësive në edukimin e fëmijëve.

E drejta e mbajtjes- Çdo fëmijë ka të drejtë në mbajtje nga prindërit e vet. Me mbajtje duhet kuptuar të gjitha shpenzimet e nevojshme për ushqim, veshmbathje, banim, edukim, shkollim dhe shërim të fëmijëve. Për plotësimin e këtyre nevojave të fëmijëve, dy prindërit janë të detyruar të sigurojnë të mirat materiale, pavarësisht nga ajo se a janë apo jo duke jetuar së bashku. Lartësinë e shpenzimeve për ushqim dhe mbajtje të fëmijëve gjykata e cakton duke marrë parasysh mundësitë materiale të prindërve dhe nevojat e fëmijëve.

E drejta e fëmijëve për mbajtje mbaron me plotësimin e kushteve ligjore për pushimin e saj: me vdekje ose shpallje të fëmijës të zhdukur për të vdekur apo të prindërve të tij, me arritjen e moshës madhore ose me emancipimin e fëmijës.

Nëse fëmija i moshës madhore nuk është në gjendje të punojë për shkak të sëmundjes, të metave fizike dhe mentale dhe ai nuk ka sasi të mjaftueshme të mjeteve financiare për shpenzimet e tij financiare, prindërit kanë për detyrim të sigurojnë ndihmën financiare derisa një situatë e tillë të mbarojë (neni 294 i LFK-së).

Përfaqësimi- Dy prindërit janë të autorizuar ligjorë për përfaqësimin e fëmijëve të tyre të përbashkët në të gjitha veprimet juridike. Për shkak se autorizimet e prindërve për përfaqësimin e fëmijëve burojnë nga vetë ligji, prindërit quhen përfaqësues ligjorë.

Theksojmë se fëmija i mitur deri në moshën 14-vjeçare nuk ka zotësinë për të vepruar. Për këtë, në emër e në llogari të tij veprimet juridike i ndërmerr prindi ose kujdestari.

Të miturit të cilët kanë mbushur moshën 14-vjeçare, disa veprime juridike mund t'i ndërmarrin vetë, por që ato të jenë të plotëfuqishme kërkohet leja e prindërve apo e organit të kujdestarisë.

Prindërit nuk mund të përfaqësojnë fare fëmijët në veprimet juridike të cilat janë të lidhura ngushtë me personalitetin e tij, siç janë p.sh. lidhja e martesës, njohja e atësisë etj²¹.

6. Të drejtat dhe detyrat e fëmijeve

Detyrimet e prindërve janë në raport korelativ me të drejtat e fëmijëve, secili detyrim i prindërve në të njejtën kohë është edhe e drejtë e fëmijëve . Nga kjo rrjedh se prindërit janë të detyruar të kujdesen për ruajtjen dhe mirërritjen, emrin personal, edukimin dhe shkollimin, administrimin e pasurisë, përfaqësimin, kurse fëmijët kanë të drejtë të kërkojnë prej prindërve realizimin e këtyre të drejtave.

Është e qartë se edhe fëmijët kanë detyra ndaj prindërve të cilat janë dy llojesh:

a) Detyrat ligjore – fëmijët kanë detyra themelore ligjore që të kujdesen dhe t'i ndihmojnë prindërit e tyre, sidomos kur ata janë të pa aftë për punë dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë, kur janë të sëmurë ose për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore osmateriale nuk mund të kujdesen për vete dhe të sigurojnë mirëqenie sociale.

Fëmijët madhorë e kanë për detyrë të përkujdesen për prindërit, gjithashtu edhe fëmijët e mitur e kanë për detyrë që të përkujdesen për prindërit. Nga mosha 15 – vjeçare e tutje, fëmija i cili fiton të ardhura me punën e tij është i detyruar që financiarisht të kontribuojë për mbajtjen e tij dhe nëse është e nevojshme edhe për kontribut të arsyeshëm për mbajtjen e familjes me të cilën jeton.

Fëmijët kanë detyrim t'i mbajnë financiarisht prindërit e tyre, nëse ata nuk janë të aftë për punë dhe nuk kanë të ardhura minimale për të jetuar (neni 297 par. 1 i LFK-së). Gjykata mund ta lirojë fëmijën nga përmbushja e këtij detyrimi ligjor nëse konstaton se përkundër mundësive financiare, prindi nuk i ka ofruar mbajtje financiare fëmijës, ngase kjo do të paraqiste një padrejtësi të hapur ndaj fëmijës.

Që mbi fëmijët e mitur të rëndojë kjo detyrë, duhet të plotësohen dy kushte:

- Që fëmija të ketë mbushur 15 vjet dhe të realizojë të ardhura me punë personale,

²¹ Vojislav Bakic: vepër e cituar, fq. 306

- Që i mituri të ketë pasuri dhe të ardhura nga pasuria. Mungesa e pasurisë dhe të ardhurave nuk e liron fëmijën e mitur nga detyrat ndaj prindërve, për shkak se ai ka për detyrë që t'i inkurajojë prindërit dhe t'i përkrahë ata duke i vizituar p.sh. në qendra spitalore edhe në qoftë se nuk ka mjete materiale.

b) Detyrat morale –pjesa dërrmuese e detyrimeve që kanë fëmijët ndaj prindërve kanë karakter moral dhe rregullohen në bazë të rregullave të moralit . Respektimi i prindërve është element pozitiv dhe një detyrë themelore për secilin fëmijë. Kanë detyrë që të sillen në mënyrë korrekte ndaj prindërve si fëmijët martesorë ashtu edhe fëmijët e lindur jashtë martese. Mirësjellja ndaj prindërve është detyrë e të gjithë fëmijëve.

7. Marrëdhëniet pasurore juridike të prindërve dhe fëmijëve

Këta marrëdhënie lindin në bashkësinë familjare midis prindërve dhe fëmijëve dhe kanë specifikat e tyre të veçanta që nuk i posedojnë marrëdhëniet tjera pronësore brenda familjes.

Neni 219 i LF të RM-së parasheh: "Fëmijët minorenë mund të kenë pasurinë e tyre të cilën do ta fitojnë sipas ligjit dhe në bazë ligjore. Me këtë pasuri, përveç që i mituri e ka fituar me punën e tij, deri në arritjen e moshës madhore me këtë pasuri do të administrojnë dhe do të disponojnë prindërit e tij". Mëtej neni 220 parasheh: "Nëse prindërit nuk jetojnë bashkërisht, me pasurinë e fëmijës do të administrojë prindi me të cilin jeton fëmija, nëse Qendra për Punë Sociale me propozim të prindit tjetër, nuk ka vendosur ndryshe"²².

Të gjithë të hyrat që burojnë nga pasuria e të miturit, prindërit mund t'i përdorin fillimisht për mirëmbajtjen e fëmijës, edukimin dhe shkollimin e tij, si dhe nevojat e domosdoshme për bashkësinë familjare, nëse prindërit nuk disponojnë me mjete financiare dhe pasuri të tyre. Dhe së fundi, Ligji parasheh që prindërit me pajtueshmëri të Qendrës për Punë Sociale mund ta huazojnë apo ngarkojnë me veprime juridike pasurinë e fëmijës së tyre për shkak të mirëmbajtjes së tij, edukimit dhe shkollimit si dhe këtë nëse e kërkojnë interesat tjera të cilat janë të nevojshme për bashkësinë familjare. Kjo dmth. se ata nuk kanë liri absolute për sa i përket administrimit të pasurisë së fëmijëve të tyre të mitur.

²² Neni 219 dhe 220 i LF-së së RM-së

E drejta e administrimit të pasurisë së fëmijëve të mitur- pasurinë e fëmijës deri në moshën madhore të tij e administrojnë prindërit në dobi të fëmijës (neni 134 i LFK-së), që nënkupton se titullari i së drejtë mbi pasurinë e fëmijës së mitur është vetë fëmija. Fëmijët e mitur që kanë mbushur moshën 15 – vjeçare, me pëlqimin e prindërve mund të themelojnë marrëdhënie pune. Të ardhurat e realizuara me punën e vet ata mund t'i disponojnë e t'i administrojnë vetë në mënyrë të pavarur.

E drejta e pronësisë- Në praktikë janë të rallë rastet kur një fëmijë të ketë pasurinë e vet. Nuk ka dyshim se fëmijët gëzojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën e tyre të veçantë edhe kur prindërit, sipas dispozitave ligjore janë të autorizuar ta administrojnë atë. Kjo pasuri nuk hyn në pasurinë e prindërve ²³, sepse është e ndarë nga pasuria e tyre.

8. Marrëdhëniet pasurore martesore

Përveç të drejtave personale të cilat i posedojnë bashkëshortët me lidhjen e martesës, rëndësi të veçantë kanë edhe të drejtat pasurore apo marrëdhëniet pasurore që lindin midis bashkëshortëve në martesë. Këta marrëdhënie që lindin në jetën martesore rregullohen me dispozita ligjore të cilat i parasheh LF-ja. Kjo tërësi e normave ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të çiftit bashkëshortor në doktrinën juridike quhet regjim pasuror martesor. Regjimi pasuror si kategori juridike parashihet në forma të ndryshme në të drejtën komparative.

Kështu dallohen: regjimi i pasurisë së veçantë, regjimi i pasurisë së përbashkët dhe regjimi i kombinuar.

Regjimi i pasurisë së veçantë- nënkupton normat juridike që rregullojnë çështjen e pasurisë të veçantë nga martesja. Pra, flitet për pasurinë të cilën e ka zotëruar bashkëshorti para lidhjes së martesës dhe në këtë kontekst mund të shtojmë se titullari i kësaj pasurie të veçantë posedon dhe qeveris pronësinë e tij në mënyrë të pavarur nga bashkëshorti, pasi që nuk e ka fituar gjatë jetës martesore të përbashkët.

Regjimi i pasurisë së përbashkët- në të njëjtën mënyrë rregullohet me normat juridike të LF-së, por e veçanta e kësaj pasurie në krahasim me pasurinë e veçantë qëndron në faktin se kjo pasuri është fituar me punë të përbashkët midis

²³ Santhipi Begeja: vepër e cituar, faqe 217

dy bashkëshortëve në jetën martesore. Në pasurinë e përbashkët të dy bashkëshortët janë titullarë të përbashkët të të drejtës së pronësisë.

Regjimi i pasurisë të kombinuar-përfshin elemente të të dy regjimeve paraprake, të pasurisë të veçantë dhe asaj të përbashkët. Duke u nisur nga parimi i barazisë midis bashkëshortëve, synohet realizimi i barabartë i të drejtave të bashkëshortëve lidhur me administrimin dhe disponimin e pronësisë në mënyrë të barabartë. Legjislacionet moderne të disa shteteve parashohin kontratën si punë juridike me të cilën bashkëshortët vetë mund të zgjedhin njërin nga regjimet pasurore martesore. Nëse nuk lidhet kjo kontratë atëherë flasim për regjim ligjor që parashihet edhe në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë. Regjimi ligjor pasuror martesor parashihet në nenin 203 të LF-së të RM-së, sipas të cilit “Pasuria e çiftit bashkëshortor mund të jetë e veçantë dhe e përbashkët.

9. Marrëdhëniet pasurore në bashkësinë jashtëmartesore

Pasuria të cilën bashkëshortët jashtëmartesorë do ta fitojnë në bashkësinë jashtëmartesore llogaritet si pasuri e tyre e përbashkët. Gjatë ndarjes së asaj pasurie zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat për pjesëtimin (ndarjen) e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve marterosë²⁴.

Marrëdhëniet pasurore mund të lindin edhe në bashkësinë jashtëmartesore, pasi që edhe në këtë bashkësi krijohen dhe shpenzohen mjete materiale, fitohet pasuri si dhe themelohen detyrime. Vlen të potencohet se marrëdhëniet që lindin midis bashkëshortëve në bashkësinë jashtëmartesore deri vonë nuk kanë qenë të rregulluara me rregullativë ligjore, me çka ka munguar mbrojtja ligjore e marrëdhënieve pasurore midis këtyre bashkëshortëve.

Me reformimin e të drejtës familjare është rregulluar edhe çështja e bashkësisë jashtëmartesore, sidomos çështjes të ndërsjellë të ushqimit midis këtyre bashkëshortëve si dhe marrëdhënieve pasurore që rrjedhin nga pasuria e përbashkët jashtëmartesore.

Pasuria e krijuar në këtë bashkësi nga të dy bashkëshortët konsiderohet si pasuri e përbashkët. Kjo dispozitë ligjore mundëson që gjykatat t’ju japin mbrojtjen e nevojshme ligjore edhe marrëdhënieve pasurore që rrjedhin nga pasuria e përbashkët e bashkëshortëve jashtëmartesor. Gjatë ndarjes të pasurisë së

²⁴ Neni 203 i LF-së të RM-së.

përbashkët jashtëmartesore vlejné dispozitat identike me ata të ndarjes së pasurisë në martesën e rregullt.

Në praktikën gjyqësore mbrojtjen ligjore të bashkësisë jashtëmartesore mund ta gëzojë vetëm bashkësia jashtëmartesore e themeluar në mënyrë ligjore, që don të thotë që në momentin e themelimit të saj nuk kanë ekzistuar pengesa dhe ndalesa martesore dhe se kjo bashkësi ka zgjatur një kohë të gjatë. Afatet kohore për zgjatjen e kësaj bashkësie ligji nuk i parasheh, por gjykata do të shfrytëzojë standarde juridike që të vlerësoj specifikat e rastit konkret dhe të vlerësoj se kur është plotësuar ky kusht.

As në teorinë juridike nuk ka definicione të përgjithshme të pranura të nocionit bashkësi jashtëmartesore, pasi që mendohet se nuk ekziston një lloj i veçantë i bashkësisë jetësore.

Martesa është bashkësi jetësore vetëm mes një gruaje dhe një burri. Bashkësia e regjistruar jashtëmartesore, apo cilado formë tjetër e regjistruar e partneritetit jetësor është bashkësi jetësore vetëm mes një gruaje dhe një burri. Këtë e parashikon projekt-amandamenti i ri Kushtetues që Qeveria e parashtrroi deri te Kuvendi.

Gjithashtu me ligjin aktual për familje, bashkësia jashtëmartesore definohet, ajo bashkësi jashtëmartesore e cila zgjat më shumë se një vit me çka barazohet me bashkinë martesore në pikëpamje të financimit të ndërsjellë dhe pronën e fituar në kohëzgjatjen e bashkësisë jashtëmartesore”.

10. Marrëdhëniet pasurore midis prindërve dhe fëmijëve

Këta marrëdhënie lindin në bashkësinë familjare midis prindërve dhe fëmijëve dhe kanë specifikat e tyre të veçanta që nuk i posedojnë marrëdhëniet tjera pronësore brenda familjes. Neni 219 i LF të RM-së parasheh:”Fëmijët minorenë mund të kenë pasurinë e tyre të cilën do ta fi jnë sipas ligjit dhe në bazë ligjore. Me këtë pasuri, përveç që i mituri e ka fituar me punën e tij, deri në arritjen e moshës madhore me këtë pasuri do të administrojnë dhe do të disponojnë prindërit e tij”. Mëtej neni 220 parasheh: “Nëse prindërit nuk jetojnë bashkërisht, me pasurinë e fëmijës do të administrojë prindi me të cilin jeton fëmija, nëse Qendra për Punë Sociale me propozim të prindit tjetër, nuk ka vendosur ndryshe”.²⁵

²⁵ Neni 219 dhe 220 i LF-së së RM-së.

Të gjithë të hyrat që burojnë nga pasuria e të miturit, prindërit mund t'i përdorin fillimisht për mirëmbajtjen e fëmijës, edukimin dhe shkollimin e tij, si dhe nevojat e domosdoshme për bashkësinë familjare, nëse prindërit nuk disponojnë me mjete financiare dhe pasuri të tyre. Dhe së fundi, Ligji parasheh që prindërit me pajtueshmëri të Qendrës për Punë Sociale mund ta huazojnë apo ngarkojnë me veprime juridike pasurinë e fëmijës së tyre për shkak të mirëmbajtjes së tij, edukimit dhe shkollimit si dhe këtë nëse e kërkojnë interesat tjera të cilat janë të nevojshme për bashkësinë familjare. Kjo dmth. se ata nuk kanë liri absolute për sa i përket administrimit të pasurisë së fëmijëve të tyre të mitur.

E drejta e administrimit të pasurisë së fëmijëve të mitur- pasurinë e fëmijës deri në moshën madhore të tij e administrojnë prindërit në dobi të fëmijës (neni 134 i LFK-së), që nënkupton se titullari i së drejtë mbi pasurinë e fëmijës së mitur është vetë fëmija.

Fëmijët e mitur që kanë mbushur moshën 15 – vjeçare, me pëlqimin e prindërve mund të themelojnë marrëdhënie pune. Të ardhurat e realizuara me punën e vet ata mund t'i disponojnë e t'i administrojnë vetë në mënyrë të pavarur.

E drejta e pronësisë- Në praktikë janë të rallë rastet kur një fëmijë të ketë pasurinë e vet. Nuk ka dyshim se fëmijët gëzojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën e tyre të veçantë edhe kur prindërit, sipas dispozitave ligjore janë të autorizuar ta administrojnë atë. Kjo pasuri nuk hyn në pasurinë e prindërve, sepse është e ndarë nga pasuria e tyre.

PËRFUNDIMI

Ushtrimi i të drejtës prindërore nënkupton ndërmarrjen e veprimeve që përbushin përbajtjen e të drejtave dhe detyrave të prindërve ndaj fëmijëve të tyre të mitur, dhe fëmijëve mbi të cilët janë shtrirë e drejta prindërore. Të drejtat prindërore ushtrohen nga prindërit bashkërisht dhe me marrëveshje, edhe kur për arsye të caktuara fëmija kujdeset dhe rritet nga njëri prej tyre. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet prindërve për ushtrimin e të drejtës prindërore vendos qendra për punë sociale. Gjithashtu, në rastet kur prindërit nuk jetojnë së bashku, ose janë të martuar dhe jetojnë të ndarë, ose janë të divorcuar, ose jetojnë jashtë martese dhe kanë fëmijë të lindur jashtë martese, atëherë vendosin reciprokisht mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve personale dhe kontakte të menjëhershme me fëmijën. Nëse prindërit e fëmijës nuk arrijnë marrëveshje brenda maksimumit

dy muajsh, atëherë qendra për punë sociale ndërhyjnë dhe merr vendim për ruajtjen e marrëdhënieve personale dhe kontakteve të drejtpërdrejta me fëmijën.

Në dekadat e fundit, në të gjitha vendet evropiane, sipas disa autorëve, kanë ndodhur ndryshime të shpejta revolucionare në disa sfera të marrëdhënieve martesore dhe familjare. Të njëjtat transformime po ndodhin në të gjitha vendet evropiane: numri i divorceve po rritet, numri i martesave po zvogëlohet, lindshmëria po zvogëlohet, numri i bashkimeve jashtëmartesore dhe përqindja e fëmijëve të lindur jashtë martese po rritet, numri e prindërve të vetëm po rritet dhe familjet ribashkohen, përqindja e grave të punësuara rritet dhe lindshmëria bie në mënyrë dramatike.

Sipas Eurostrat, në vitin 2016 janë lidhur 2.200.000 martesa në vendet e Bashkimit Evropian dhe ka pasur 1.000.000 divorce. Në të kundërt, në vitin 1960 numri i divorceve ka qenë gjashtë herë më i ulët dhe ka arritur në 170.000. Viteve të fundit numri i martesave të divorcuara është në rritje në Maqedoni, kështu që në vitin 1995 kishte 710 shkurorëzime, në vitin 2005 ishin 1552, ndërsa në vitet e fundit numri i shkurorëzimeve në Maqedoni është më i madh se 2000. Nga ana tjetër, rritja dramatike e numrit të martesave të divorcuara, që mbulon të gjitha vendet evropiane, nuk është i vetmi transformim në marrëdhëniet martesore dhe familjare. Një fenomen tjetër domethënës, i cili kontribuoi shumë në një transformim dramatik në marrëdhëniet familjare për të cilin folem me lartë, është rritja e numrit të njerëzve që jetojnë në një bashkësi jashtëmartesore, për shkak të të cilit në Evropë martesa nuk është më baza e vetme për jetën familjare, siç ishte në periudhën së mëparshme. Gjithnjë e më shumë çifte në vendet evropiane jetojnë në bashkime jashtëmartesore që kanë karakter të përhershëm dhe në të cilat lindin, kujdesen dhe rriten fëmijët. Në shoqërinë moderne, përveç rritjes së numrit të bashkimeve jashtëmartesore, ndryshon edhe natyra e tyre.

Hulumtimet tregojnë se bashkësia moderne jashtëmartesore, në shumë raste, nuk është më hapi i parë drejt martesës, por përfaqëson një alternativë reale ndaj martesës, sepse një numër i madh i partnerëve jashtëmartesorë nuk martohen kurrë, por jetojnë në një bashkësi jashtëmartesore që mund të zgjasë me vite, madje edhe për dekada. Rritja e numrit të bashkimeve jashtëmartesore lidhet edhe me rritjen e përqindjes së fëmijëve të lindur jashtë martese, kështu që në vitin 2016 42% e fëmijëve të lindur në BE ishin jashtë martese (në Francë edhe 60% e fëmijëve të lindur në 2016 kanë lindur jashtë martese, në Slloveni dhe Bullgari 58%, në Suedi 55%, në Danimarkë 54%).

Për shkak të këtyre ndryshimeve dinamike, në dekadat e fundit në vendet evropiane janë kryer një numër i madh i hulumtimeve sociologjike për drejtimin e ndryshimeve, ndikimin e tyre në marrëdhëniet martesore dhe familjare dhe pasojat e ndryshimeve tek bashkëshortët, fëmijët dhe komuniteti më i gjerë.

Ndryshe nga të gjitha vendet evropiane, përfshirë edhe fqinjët tanë, të cilët bënë reforma të thella në të gjitha segmentet e sistemeve juridike familjare për të harmonizuar rregullimin ligjor të martesës dhe marrëdhënieve familjare me transformimet që ndodhin në jetën reale, në Maqedoni që nga viti 1992 nuk kemi pati një reformë serioze në të drejtën familjare.

Tani kemi liberalizimin e shkurorëzimit, po liberalizohet edhe bashkësia jashtëmartesore, e cila në masë të madhe po i afrohet martesës për sa i përket pasojave ligjore. Po përmirësohet edhe pozita e fëmijëve jashtëmartesor. Baza e të gjitha reformave është që të ketë mbrojtje më të madhe të të parëve dhe interesave të fëmijëve. Sot, pjesa kryesore e së drejtës familjare nuk është e drejta e martesës, por e drejta prindërore. Fokusi nuk është në çift, por mbi të gjitha tek interesi i fëmijës. Në të gjithë legjislacionin evropian, shumica e reformave në këtë sferë synojnë mbrojtjen më të madhe të të drejtave dhe interesave të fëmijëve.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Aliu, Abdulla, Gashi Haxhi, E Drejta Familjare, Prishtinë 2007
2. Allinçiq, Mira dhe Bakariç-Mihanoviç, Ana, Porodiqno pravo, Zagreb, 1980
3. Amram, M., D'Angelo, A., . La famiglia e il diritto fra diversità nazionali el'iniziative dell'Unione Europea, Milano: Cedam, 2011
4. Ardian, Nani, E Drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë 2009
5. Babiç, Ilija, "Komentar Porodicnog Zakona", Sluzbeni Glasnik, Beograd, 2014
6. Begeja, Santhipi, "E drejta familjare e Shqipërisë", Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 1985
7. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut , 1991
8. Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.80/92.
9. Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.83/04.
10. Ligji për trashëgimi i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.47/96.
11. Ligji për pronësi dhe të drejtar e tjera sendore i Republikës së Maqedonisë, gazeta zyrtare nr.18/96, 92/08 dhe 139/08.
12. <http://ëëë.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>

13. Draft Recommendation on the rights and legal status of children and parental responsibilities, Strasbourg, 27.05.2010, преземено од:
http://ëëë.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/FAMILY/CJ-FA-GT3%20_2010_%202%20Rev%203E%20-%20draft%20instrument%20October%20meeting%20LA.pdf

DALLIMI MIDIS KONTRATËS SË RENTËS JETORE DHE KONTRATAVE TË TJERA

MSc. Endi Kalemaj

Specialist at the National Youth Agency endikalemaj2000@gmail.com

Abstrakt

Ky punim synon të sjellë te lexuesi një analizë studimore teorike, por gjithashtu të pasuruar me praktikën ndërkombëtare. Nëpërmjet këtij shkrimi ofrohet mundësia e një përmbledhje dhe krahasimi të mirëfilltë të një kontrate e cila ende nuk është zhvilluar dhe dhënë rëndësia e duhur në legjislacionin shqiptar. Kontrata e rentës jetore është një institut i lindur në periudhën e mesjetës, e më pas u zhvillua duke marrë rëndësi të veçantë në disa shtete të juridiksionit civil. Kontrata e rentës jetore po bëhet gjithnjë e më e përdorur në disa shtete sidomos në ato me zhvillimit të madh ekonomik. Kontrata e rentës jetore është një kontratë me origjinë të lashtë, e cila paraqet një rëndësi të madhe studimore dhe praktike, megjithatë kjo kontratë në shqipëri është zbehur me kalimin e viteve. Instituti është konsideruar shpesh si një relikte historike e cila nuk përdoret më, kjo vërejtur edhe nga mungesa e praktikës në jurisprudencën tonë. Jurisprudenca shqiptare për sa i përket kësaj kontrate është e pakët në numër, dhe mungon doktrina dhe studimet e mirëfillta. Ky fakt vërehet edhe nga mungesa e kësaj tipi kontrate në regjistrat noterial shqiptar. Kontrata e rentës jetore dhe mbajtja jetore nga ana tjetër është gjithashtu një kontratë që nuk parashikohet nga legjislacioni në fuqi, por është një mekanizëm tepër i dobishëm për kategori të caktuara shoqërore. Krahasimi i rentës jetore me mbajtjen e përjetshme paraqet rëndësi konceptuale dhe praktike, e cila i bën ato kontrata më të prekshme nga subjektet e ligjit, gjë që synon të rrisë përdorimin e tyre në praktikë.

Nisur nga sa më sipër, mund të konkludojmë se pavarësisht se zbatimi i kësaj kontrate në shqipëri është i pakët, studimi dhe zbatimi i saj ka një rëndësi të veçantë. Duke marrë në studim doktrinën e vendeve si Franca dhe Italia, ku kontrata e rentës është mjaft e zbatueshme mund të kuptojmë më shumë për problematikën që has kjo tip kontrate në legjislacionin tonë. Nëpërmjet këtij punimi ne synojmë të ofrojmë mundësi studiuesve të së drejtës të kenë një përmbledhje të dhënash dhe një material bazë për të zhvilluar më tej këtë kontratë.

Fjalët kyçe: *renta jetësore, kontrata e dhurimit, kontratë konsensuale, reale, dhurimin me barrë, parimi i pensionit jetor etj.*

Abstract

This paper aims to bring to the reader a theoretical study analysis but also enriched with international practice. This article offers the possibility of a literal summary and comparison of a contract which has not yet been developed and given due importance in Albanian legislation. The life annuity contract is an institute born in the Middle Ages, and then developed to take special importance in some states of civil jurisdiction. The life annuity contract is becoming more and more used in some countries, especially in those with great economic development. The life annuity contract is a contract of ancient origin, which represents great academic and practical importance, however, this contract in Albania has faded over the years. The institute is often considered as a historical relic which is no longer used, this is also noticed by the lack of practice in our jurisprudence. Albanian jurisprudence regarding this contract is few in number, and genuine doctrine and studies are lacking. This fact is also observed by the absence of this type of contract in the Albanian notarial registers. The contract of life annuity and life maintenance on the other hand is also a contract that is not foreseen by the legislation in force, but it is a very useful mechanism for certain social categories. The comparison of life annuity with perpetual holding presents conceptual and practical importance, which makes those contracts more tangible by the subjects of the law, which aims to increase their use in practice.

Based on the above, we can conclude that despite the fact that the implementation of this contract in Albania is scarce, its study and implementation is of particular importance. Studying the doctrine of countries such as France and Italy, where the annuity contract is quite applicable, we can understand more about the problems encountered by this type of contract in our legislation. Through this paper, we aim to provide opportunities for legal researchers to have a summary of data and a basic material to further develop this contract.

Keywords: *life annuity, donation contract, consensual, real contract, donation with lien, life annuity principle, etc.*

Hyrje

Kontrata e rentës jetore sigurisht që ka një origjinë të lashtë. Kjo kontrata ka origjinë të hershme që nga e drejta romake, por zhvillimin më të madh e mori në Mesjetë ku renta jetore konsistonte në shitblerjen e një sendi të luajtshëm a të paluajtshëm ose të kalimit të një shumë parash në favor të një enti kishtar a personi dhe ky, debitori detyrohet kundrejt tjetërsuesit një prestim në para apo shërbime vjetor, gjatë gjithë jetës së tij (tjetërsuesit) ¹.

Ligji Romak e konsideronte atë më shumë sesa për marrëdhëniet që pasuan, veçanërisht për biznesin që ishte burimi i tij.

Nga ky këndvështrim, u bë një dallim midis një trashëgimisë dhe përcaktimit të një pensioni, ndërsa kohëzgjatja e marrëdhënies mbeti e pasigurt, e cila mund të ishte si proporcionale në raport me jetën e përfituesit ashtu edhe e përjetshme. Përcaktimi i fundit i kohëzgjatjes ishte i preferuar dhe një pension vjetor të cilit një term nuk i jepej shprehimisht do të konsiderohej i përjetshëm. Për të shmangur këtë pasojë, u krijuan masa të veçanta, të ndryshme sipas burimit të të ardhurave.

Në çdo rast, në të drejtën romake disiplina e rentës jetore ishte fragmentare dhe e paorganizuar ndërsa ishte më sistematike në epokën vijuese.

Në mesjetë ajo u zhvillua dhe përparoi në figurën e pasigurisë, e cila konsistonte në tjetërsimin e një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm ose transferimin e një shume parash në një organ kishtar i cili, në konsideratë, e detyroi veten ndaj tjetërsuesit për një performancë vjetore gjatë gjithë jetës së saj.

Renta jetore ka një histori të gjatë në Shqipëri, e cila daton që nga kohërat e vjetra kur marrëveshjet financiare kishin për qëllim sigurimin e jetesës për personat e moshuar apo ata që nuk ishin më në gjendje të punonin. Këto marrëveshje tradicionalisht ishin të lidhura me pronësinë e tokës dhe të drejtën për të përdorur të ardhurat që rridhnin prej saj. Me kalimin e kohës dhe me ndryshimet e mëdha ekonomike që ka përjetuar Shqipëria, sidomos pas rënies së sistemit komunist dhe kalimit në një ekonomi të tregut të lirë, forma dhe funksioni i rentës jetore kanë evoluuar ndjeshëm.

¹ *“Le rendite vitalizie. Principi generali e disciplina delle fattispecie“ Domenico Riccio marrë nga nga faqja e internetit :www.AmbienteDiritto.it publikuar më02/11/2005.*

Në periudhën e tranzicionit, institucionet financiare dhe ligjore u përballën me nevojën për të krijuar mekanizma të rinj dhe më të qëndrueshëm për të garantuar mbrojtjen sociale dhe financiare të qytetarëve. Ky proces përfshinte krijimin e ligjeve dhe rregulloreve të reja që do të rregullonin kontratat e rentës jetore, duke siguruar që ato të ishin të qëndrueshme dhe të besueshme.

Në kuadrin e zhvillimeve ekonomike dhe juridike të Shqipërisë, kontrata e rentës jetore përfaqëson një mekanizëm të rëndësishëm për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përballimin e sfidave ekonomike të individëve. Kjo formë kontrate, e cila garanton të ardhura të vazhdueshme për një periudhë të caktuar kohore ose për gjithë jetën, është bërë një komponent kyç në strategjitë e planifikimit financiar personal dhe të sigurimeve sociale. Në kontekstin e një ekonomie në zhvillim, ku stabiliteti financiar dhe mbrojtja sociale janë objektiva të rëndësishme, rëndësia e rentës jetore bëhet edhe më e evidente.

Renta jetore dhe kontrata e dhurimit.

Kontrata e rentës jetore është ajo kontratë me anë të së cilës një person merr përsipër t'i paguajë një personi tjetër, për të gjithë jetën e tij ose të një të treti, shuma parash, në intervale të rregullta kohe². Sipas përkufizimit të dhënë nga Kodi Civil, renta jetore mund të krijohet kundrejt shpërblimit (me titull barrësor) nëpërmjet tjetërsimit të një pasurie të luajtshme ose të paluajtshme ose të një shume parash, në ndryshim nga kontrata e dhurimit e cila ka për objekt jo vetëm sendet e luajtshme dhe të paluajtshme por edhe të drejtat reale. Gjithashtu, ajo mund të krijohet edhe me anë të dhurimit³ ose testamentit. Në lidhje me krijimin e rentës jetore nëpërmjet kontratës së dhurimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në një vendim⁴ të tij ka arritur në përfundimin se: “Detyrimi që duhet të përmbushet nga debitori i rentës dhe përfitimi që vjen nga renta jetore duhet të jetë konkret, si në rastin e detyrimit për shlyerje të rentës me këste pagesash, ashtu edhe në rastin e veprimeve ose kategorive të veprimeve të kujdesit. Këto të fundit duhet të jenë të identifikueshme e të dallueshme në mënyrë që kujdesi i parashikuar në kontratë të synojë e të sjellë pasoja dhe përfitime konkrete, jo fiktive, aq më tepër jo objektivisht të pamundura për t'u përmbushur.”

² Georges Vermelle, “E drejta civile. Kontratat”, Pjesa e Posaçme, Papirus, 2006, fq. 87

³ Vendimi nr. 795, datë 14.06.2007 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë

⁴ Vendimi nr. 52, datë 22.01.2013, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë

Kontrata e dhurimit dhe renta jetore, si dy kontrata tipike, të parashikuara shprehimisht nga Kodi Civil, kanë mjaft të përbashkëta dhe ndryshime ndërmjet tyre. Një element i përbashkët që spikat është fakti se të dyja janë veprime juridike inter vivos, që i sjellin pasojat e tyre ndërmjet të gjallëve. Renta jetore i prodhon pasojat gjatë gjithë jetëgjatësisë së marrësit të rentës. Me vdekjen e marrësit shuhen edhe detyrimet. Kodi Civil, në nenin 1068 të tij parashikon se: Nëse kontrata e rentës jetore e krijuar në favorin e një personi, i cili në kohën e kontratës kishte vdekur, është e pavlefshme.

Nëse marrim në analizë karakteristikat e rentës jetore, mund të themi se ajo është një kontratë konsensuale, e dyanshme, me ose pa shpërblim, mund të lidhet edhe në dobi të një personi të tretë. Renta jetore mund të jepet për të gjithë jetën e përfituesit ose të një personi tjetër, për gjithë jetën e një ose disa personave. Është *kontratë konsensuale* për vetë faktin se i sjell efektet e veta në momentin në të cilin lidhet kontrata dhe nuk kërkon dorëzim sendi për tu perfeksionuar, ndërsa kontrata e dhurimit si rregull është *kontratë reale*, me përjashtim të rasteve kur ka për objekt sendet e paluajtshme, sendet e luajtshme të cilat kërkojnë regjistrim dhe të drejtat reale, në të cilën do jetë ky moment i marrjes së karakterit real të kësaj kontrate.

Një ndryshim tjetër ndërmjet këtyre dy kontratave përkon me faktin se dhurimi si kontratë tipike është e *njëanshme*, por në rastin në të cilin kontrata e dhurimit është e ngarkuar me barrë, përfituesi ngarkohet me të vetmin detyrim, përmbushjen e barrës. Ndërsa kontrata e rentës jetore është një kontratë tërësisht e *dyanshme* pasi përmban një sërë të drejtash dhe detyrimesh reciproke për palët, ku çdo të drejte i përgjigjet një detyrim dhe anasjellas.

Dhuruesi ose trashëgimtarët e tij mund të kërkojnë zgjidhjen e kontratës nëse përfituesi nuk e përmbush barrën, si dhe mund të revokojnë këtë kontratë në qoftë se vërtetohen kushtet e parashikuara në ligj për revokimin. Ndryshe ndodh në kontratën e rentës jetore ku dhënësi i rentës mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe shpërblimin e dëmit nëse përfituesi nuk ka dorëzuar sendin.

Kontrata e rentës zakonisht është kontratë *me shpërblim*, por nëse renta është pa shpërblim, në këtë rast kjo kontratë është e ngjashme me dhurimin dhe do të zbatohen rregullat e formës dhe përmbajtjes që karakterizojnë kontratën e dhurimit. Edhe kontrata e rentës jetore mund të krijohet sipas skemës dhe mënyrës së kontratës në dobi të personit të tretë, së cilës mund t'i bashkëngjiten në të

njëjtën kohë edhe detyrimi ushqimor si kontratë atipike në favor të personit të tretë.

Renta jetore nuk është një dhurim (megjithëse mund të duket kështu), por një marrëdhënie juridike e lindur midis palëve, ku secila mbart të drejta dhe detyrime⁵. Me fjalë të tjera, shuma nuk përbëhet vetëm nga paratë, por nga angazhimi për të siguruar kujdesin moral dhe material të të marrë përsipër nga palët. Nga njëra anë ekziston transferimi i një të mire, nga ana tjetër një shërbim ekonomik dhe i mirëqenies i cili, në raste të caktuara, mund të jetë gjithashtu në shuma parash.⁴

Renta jetore e bërë me anë të dhurimit është një nga format e rentës jetore pa shpërblim.⁶ Në këtë rast, palët të cilët janë pjesë e kontratës lidhin objektin dhe përcaktojnë përmbajtjen e kontratës sipas parashikimeve të dispozitave të Kodit Civil për institutin e dhurimit. Me dhurimin, renta jetore i jep kredi-rentierit të drejtën për të tjetërsuar të drejtën e tij .

Transaksioni ligjor në fjalë mund të vendoset me një dhurim të thjeshtë ose me anë të modusit (me barrë) ose mund të jetë një transaksion i përzier me dhurim . Në rastin e fundit, serioziteti i marrëdhënies është i rëndësishëm në lidhje me ekzekutimin e një dhurimi të konstituuar nga renta jetore. Sidoqoftë, duke qenë se kontrata e rentës jetore është një kontratë aleatore, palët nuk duhet të bëjnë parashikime të një rreziku të lartë apo në disproporcion me palët midis tyre⁷.

Gjithashtu, renta jetore mund të përbëhet edhe nga dhurimi indirekt . Me këtë, pjesa përfituese e dhurimit nuk pëson asnjë detyrim, por vetëm pasurohet.⁸

Renta jetore në krahasim me Dhurimin me Barrë

Shprehja e dhurimit "modus", pra e ngarkuar me barrë, i referohet një forme të veçantë të dhurimit me të cilën një person i dhuron një pasuri një tjetri, duke futur një klauzolë në vepër, sipas së cilës përfituesi merr përsipër të kryejë një aktivitet specifik ("modusi" ose barra) në favor të dhuruesit.

⁵ https://www.laleggepertutti.it/180958_casa-dietro-vitalizio

⁶ *Po aty.*

⁷ <https://www.consulenzalegaleitalia.it/rendita-vitalizia/>

⁸ [Avv. Tassitani Farfaglia – diritto civile e contrattuale](#)

Qëllimi i lartpërmendur ndryshe mund të ndiqet përmes përcaktimit të një rente "mirëqenie", e cila sipas jurisprudencës së vazhdueshme, është kontrata me të cilën një palë, me pagimin e shitjes së një prone, ndërmerr, gjithashtu për trashëgimtarët ose pasardhësit e saj në titull , për të siguruar tjetrin, për tërë kohëzgjatjen e jetës së tyre, me ndihmë të plotë morale dhe materiale, duke siguruar të gjitha nevojat e tyre.⁹

Një element i përbashkët për të dy rastet, përveç qëllimit, është pasiguria, pasi nuk dihet për sa kohë do të vijë shërbimi i ndihmës, pasi afati i jetës së dhuruesit është i pasigurt. Një element dallues është serioziteti / paaftësia e titullit, pasi dhurimi është një akt falas, i karakterizuar nga "fryma e liberalitetit" në favor të të dhuruarit, ndërsa renta zakonisht merret në konsideratë në bazë të një detyrimi që ka debi-rentieri kundrejt kredi-rentierit.

Kontrata e rentës jetore dhe Kontrata e sigurimit

Kur flasim për lloje të ndryshme kontratash, por jo vetëm, është evidente që të përcaktojmë ngjashmëri apo ndryshime të tyre. Konkretisht, duke qenë se ne studimin e kontratave të rentës jetore dhe asaj të sigurimit do të hasim mjaft ngjasime dhe hera herës konfonduese për subjekte që ndoshta nuk arrijnë të bëjnë ndryshimin , do të trajtojmë elementet dalluese dhe specifike të secilës.

Në lidhje me objektin e kontratës së sigurimit të personit Kodi Civil përcakton se objekt i kësaj kontrate janë ngjarjet që kanë të bëjnë me jetën dhe aftësinë për punë të të siguarit.¹⁰ Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kontrata e sigurimit të jetës mund të lidhet vetëm për dy raste: Së pari: Për ngjarje të cilat kanë të bëjnë me jetën e personit dhe në këtë rast jemi para sigurimit të jetës së personit; Së dyti: Për ngjarje të cilat kanë të bëjnë me aftësinë për punë të të siguarit dhe në këtë rast kemi të bëjmë me sigurimin e shëndetit të personit.

Renta jetore është një kontratë që krijohet mes dy apo më shumë personave ku përfituesi i rentës në vend të çmimit të plotë që mund të marrë nga tjetërsimi i një pasurie të luajtshme, të paluajtshme ose të një shume parash që cedon, preferon që këtë çmim, shpërblim ta marrë nga blerësi periodikisht për tërë jetën e tij.

⁹ *Donazione modale e vitalizio assistenziale- Notai.it*

¹⁰ *Neni 1150, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*

Subjektet e kontratës së sigurimit janë përcaktuar shprehimisht në ligj dhe janë; siguruesi dhe i siguruari dhe në raste të caktuara edhe personi i tretë. I siguruari është personi *fizik* ose juridik, vendas apo i huaj, i cili siguron pasurinë/*jetën e tij*, duke paguar primin e sigurimit dhe i cili ka të drejtë që të marrë shumën e sigurimit nga siguruesi, në rast se vertetohet ngjarja e sigurimit e parashikuar në kontratë. Subjekte të kontratës së rentës jetore zakonisht janë kredi-rentieri(it. vitaliziato) dhe debi-rentieri (it. vitaliziante) ku i pari është personi fizik a juridik i cili tjetëron një send të luajtshëm a të paluajtshëm a një shumë parash kundrejt përfutimit, marrjes periodike të një rente (shumë parash a send të luajtshëm të konsumueshëm), gjatë gjithë jetës së tij ose gjatë gjithë ekzistencës së tij ligjore (për personat juridik) . Ndërsa debi-rentieri është person fizik a juridik, në favor të të cilës tjetërohet sendi i luajtshëm, i paluajtshëm a shuma e parave kundrejt të cilës detyrohet të paguaj rentën ose të jap sendet te tjera të luajtshme e të konsumueshme për kredi-rentierin në mënyrë periodike gjatë gjithë jetës së kredi-rentierit. Duhet thënë që në kontratën e sigurimit të jetës legjislacioni ynë përcakton një kategori subjektsh të cilët përgjithësisht refuzohen të merren në sigurim nga shoqëritë e sigurimit¹¹. Karakteristikë e përbashkët e tyre është fakti që të dyja kontratat janë kontrata konsensuale dhe të kategorizuara si kontrata aleatore, pra në momentin e lidhjes së kontratës palët nuk e dinë nëse ngjarja e parashikuar në kontratë do të ndodhë apo në cilat rrethana dhe shkaqe do vijoje kjo ngjarje e parashikuar.

Si kontrata e rentës jetore edhe ajo e sigurimit janë kontrata të tipit *intuitu personae*, që karakterizohen nga karakteri ngushtësisht personal i subjektit, palë në kontratën përkatëse.

Parimi i pensionit jetor

Pensioni i jetës (e thënë ndryshe renta jetore) është një produkt i cili funksionon në bazë të një parimi të cilin e gjejmë ndryshe në kontratën e sigurimit të personit/jetës. Parimi i tij i funksionimit është si më poshtë: Kredi-rentieri vendos një kapital drejt debi-rentierit dhe në këmbim merr një pension vjetor, përgjithësisht mujor (ose në varësi të kohës së rënë dakord midis palëve në kontratë), deri në vdekjen e tij, pavarësisht nga mosha në të cilën ndodh.

¹¹ *Kuptimi i kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil në fuqi- Luan Hasneziri, fq 53*

Ky produkt është një zgjidhje ideale për njerëzit që kanë nevojë për pension shtesë.¹² Duke qenë se kemi të bëjmë me një marrëdhënie juridike inter-vivos, ky parim vlen vetëm në rastin e rentës jetore, dhe nuk e gjejmë të aplikueshme tek sigurimi i personit.

Meqenëse një kontratë e rentës jetore garanton të ardhura për jetën, kostoja e saj, bazuar në vdekshmërinë, tarifat dhe kthimet e investimeve, është e detyruar të jetë e shtrenjtë.¹³

Ndryshimet midis kontratës së rentës jetore dhe policës së sigurimit.

Kontrata e rentës jetore është e kundërta e policës së sigurimit.

Kontrata e rentës jetore likuidon gradualisht fondet e akumuluar ndërsa kontrata e sigurimit të jetës siguron akumulim gradual të fondeve. Si sigurimi i jetës ashtu edhe renta jetore janë produkte fleksibël, por fleksibiliteti zakonisht ndodh në kohë të ndryshme.¹⁴

Në kontratën e rentës jetore në përgjithësi, pagesa ndalet në momentin e vdekjes së përfituesit, megjithatë ka një avantazh të madh: ofron siguri për përfituesin e saj i cili sigurohet të marrë të ardhura të garantuara deri në fund të jetës së tij. Kjo është edhe më e rëndësishme me rritjen e jetëgjatësisë. Ndërsa në sigurimin e jetës pagesa zakonisht jepet në momentin e ndërrimit të jetës, pra me njoftimin e shoqërisë së sigurimit dhe vërtetimit të ngjarjes.¹⁵

3. Kontrata e rentës jetore siguron të ardhura për kredi-rentierin apo edhe për persona të tretë. E njëjta gjë mund të parashikohet edhe në kontratën e sigurimit, e cila mund të lidhet për veten apo në dobi të një të treti, por ndryshon fakti që shpërblimi i'u takon përfituesve, *pas vdekjes* së të siguruarit.¹⁶ Të dyja këto kontrata përmirësojnë programin ekonomik të një individi nga fillimi në fund.¹⁷

¹² <https://www.infoprimes.com/fr/rente-viagere-et-assurance-vie-comment-cela-fonctionne-t-il/>

¹³ <https://www.infoprimes.com/fr/rente-viagere-et-assurance-vie-comment-cela-fonctionne-t-il/>

¹⁴ <https://www.insuranceandestates.com/life-insurance-vs-annuity/>

¹⁵ *Kuptimi i kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil në fuqi*- Luan Hasneziri, fq 66

¹⁶ *Difference Between an Annuity and a Life Insurance Policy*- Chris Joseph

¹⁷ <https://www.infoprimes.com/fr/rente-viagere-et-assurance-vie-comment-cela-fonctionne-t-il/>. *The Pros and Cons of Annuities* Derek Silva, CEPF® JUL 10, 2020

Avantazhet e Rentës Jetore.

Fakti që shpesh herë ndodhemi përpara dilemave dhe zgjedhjeve, na bën që të mos përcaktojmë sa duhet dhe si duhet se cila do jetë alternativa më e mirë e zgjedhur për ne. Pikërisht, janë këto rastet të cilat këshillohet në të mirën tonë testi i ashtuquajtur check and balance. Duke përcaktuar dhe patur të qartë gjërat, rrjedhimisht do të arrijmë në një konkluzion i cili do ketë përfitime të konsiderueshme për ne.

Pasi u morëm me studimin dhe trajtimin e temës së ndryshimeve midis rentës jetore dhe sigurimit të jetës apo kontratës së dhurimit është parë e arsyeshme dhe nxjerrja në pah e avantazheve të secilës prej tyre, në kuadër kjo, të mos-konfondimit dhe dijeninë e pasojave para se të vendosim të lidhim qoftë një kontratë apo tjetrën. Përfitimet që sjell renta jetore mund të luajnë një rol të rëndësishëm në jetën dhe të ardhmen financiare, veçanërisht kur sigurimet shoqërore dhe pagesat e pensioneve mund të mos jenë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet minimale të jetesës.

Përfitimet që marrim në rastin e një kontrate të rentës jetore.⁵⁷

Pagesa të Rregullta.

Tipari më themelor (dhe avantazhi më i madh) i një rente është që përfituesit marrin pagesa të rregullta nga debi-rentieri. Këto pagesa sigurojnë të ardhura shtesë gjatë përfitimit të rentës dhe mund të ndihmojnë nëse lind frika se nuk kemi kursyer sa duhet për të mbuluar shpenzimet tona të rregullta.

Renta vjetor fikse ofron norma të garantuara të kthimit.

Gjithmonë ka një nivel të caktuar të rrezikut kur investoni para. Sidoqoftë, çdo kontratë që nënshkruhet për një rentë vjetore fikse duhet të përfshijë disa garanci për t'ju parandaluar humbjen e parave. Anuitetet fikse garantojnë një përqindje të caktuar të investimit tuaj kryesor. Kjo përqindje është zakonisht mjaft e ulët, por kjo do të thotë që fitimi të jetë më shumë se shuma e investimit origjinal.

Personalizohet lehtësisht

Ka shumë plane, terma dhe variacione në dispozicion, në varësi të situatës dhe rrethanave unike. Përfitimet e rentës jetore mund të kombinohen me produkte

të orientuara drejt rritjes për të formuar pjesë të një plani të larmishëm investimesh për të zbutur rrezikun.

Minimizon efektet e inflacionit

Pagesat e indeksuara të të ardhurave ndihmojnë në kompensimin e inflacionit (maksimumi 4% për pasuritë e regjistruara dhe 6% për pasuritë e paregjistruara).¹⁸ Një pension mund të indeksohet në mënyrë që të ardhurat të rriten me një shumë të caktuar çdo vit për të ndihmuar të ardhurat e një klienti të ecin me inflacionin.

Taksimi më i favorshëm

Këto pagesa mund të ndihmojnë në minimizimin e përfitimeve të zbatueshme të qeverisë pasi që vetëm një pjesë e pagesës së pensionit konsiderohet si e ardhur neto për qëllime tatimore.

Sigurimi i jetëgjatësisë dhe rreziku i tregut

Një pension vjetor mund të garantojë një të ardhur të qëndrueshme dhe të parashikueshme për jetën, pavarësisht nga kushtet e tregut ose luhatjet e normës së interesit.

Pagesat e rentës jetore tregtohen si më të sigurta (më pak të rrezikshme) sesa fondet e tjera.

Cilat janë të metat e rentës?

Asgjë në sferën financiare nuk është immune ndaj disavantazheve, dhe renta jetore nuk bën përjashtim. Për shembull, tarifat e ngarkuara së bashku me disa pensione mund të jenë tepër mbizotëruese. Përveç kësaj, siguria e një pensioni është tërheqëse, por kthimet e tyre ndonjëherë mund të jenë më të pakëta se ato që mund të fitohen përmes investimeve tradicionale.

Renta mund të jetë e kushtueshme

Renta jetore mund të jetë shumë e shtrenjtë. Megjithatë, sa herë që merret parasysh një kontratë e tillë, duhet të kuptohen të gjitha tarifat që vijnë me të për të qenë të sigurt që zgjidhja është bërë për qëllimet dhe situatën personale të secilit nga palë.

Praktikat e shitjes

¹⁸ <https://lifeannuities.com/benefits.html>

Shumica e agjentëve të sigurimeve janë profesionistë etikë që duan më të mirën për klientët e tyre. Por pensionet, në veçanti, ofrojnë vend për abuzim. Palët paguajnë komisione relativisht të larta dhe shitësit nuk kanë nevojë domosdoshmërisht për licenca të letrave me vlerë ose mbikëqyrje rigorozë për të shitur këto produkte. Plus, tarifat dhe komisionet shpesh janë të padukshme. Ndërkohë, agjentët mund të mos ju tregojnë se sa po fitojnë ose me çfarë shkëmbimesh përballeni kur blini një produkt me komision të lartë.¹⁹

Përfundime dhe rekomandime.

Në përfundim të këtij punimi të shkurtër, theksojmë se kontrata e rentës jetore, por edhe kontrata të tjera të humbura në Kodin Civil aktual, i vijnë në ndihmë subjekteve në qarkullimin civil. Megjithatë, asnjëra prej tyre nuk ka gjetur vëmendjen e duhur si në doktrinë ashtu edhe në praktikë.

Sugjerimi ynë i parë, do të ishte të elaborohet më tepër doktrina e kontratës së rentës jetore. Në këtë mënyrë, subjektet e ligjit do të njohin më mirë veçoritë e kësaj kontrate, së bashku me avantazhet që kjo e fundit gëzon përkundrejt kontratave të tjera në Kodin Civil në fuqi.

Së dyti, mendojmë se është e domosdoshme që kontrata e rentës së përhershme të rikthehet në Kodin Civil aktual për shkak të veçorive që paraqet kjo kontratë dhe duke pasur parasysh që renta jetore nuk i përmban të gjitha aspektet e nevojave, që mund tu lindin subjekteve, që dëshirojnë të hyjnë në një marrëdhënie kontraktore me njëra-tjetrën.

Mund të konkuldojmë që pavarësisht se renta e përhershme, mund të konsiderohet si një institut i vjetruar në ditët e sotme, i mbetur në kodin e vjetër, ia vlen të studiohet dhe diskutohet përsa kohë që një pjesë e doktrinës, e konsideron atë një mungesë me peshë në Kodin Civil aktual.

Renta Jetore edhe pse gjen rregullim të shprehur në Kodin civil ajo është një kontratë e përdorshme dhe praktika gjyqësore ka shumë pak raste ose raste të cilat kontrata e rentës jetore ngatërrohet me kontratën e dhurimit.

¹⁹ Annuities: Advantages and Disadvantages - <https://www.thebalance.com/annuities-overview-315086>

Së treti, gjykojmë se është e domosdoshme që subjektet e ligjit të familjarizohen me kontratën e mbajtjes së përrjetshme, për shkak të avantazheve që kjo e fundit ofron në raport me rentën jetore, duke pasur parasysh spektrin e gjerë e të larmishëm të shërbimeve që subjektet mund të sigurojnë në këtë mënyrë, si dhe sigurinë juridike që iu ofrohet në raport me mënyrat alternative ligjore që mund të zgjedhin për të përfutur këto shërbime.

Bibliografia

1. *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;*
2. *Kuptimi i kontratës së sigurimit sipas Kodit Civil në fuqi- Luan Hasneziri;*
3. *Difference Between an Annuity and a Life Insurance Policy- Chris Joseph ;*
4. *“Le rendite vitalizie. Principi generali e disciplina delle fattispecie” Domenico Riccio marrë nga nga faqja e internetit :www.AmbienteDiritto.it publikuar më 02/11/2005;*
5. *Georges Vermelle, “E drejta civile. Kontratat”, Pjesa e Posaçme, Papirus, 2006;*
6. *Vendimi nr. 795, datë 14.06.2007 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë;*
7. *Vendimi nr. 52, datë 22.01.2013, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë;*
8. *Donazione modale e vitalizio assistenziale- Notai.it*
9. *https://www.laleggepertutti.it/180958_casa-dietro-vitalizio ;*
10. *<https://www.consulenzalegaleitalia.it/rendita-vitalizia/> ;*
11. *Avv. Tassitani Farfaglia – diritto civile e contrattuale ;*
12. *<https://www.infoprimes.com/fr/rente-viagere-et-assurance-vie-comment-cela-fonctionne-t-il/> ;*
13. *<https://www.insuranceandstates.com/life-insurance-vs-annuity/> ;*
14. *The Pros and Cons of Annuities Derek Silva, CEPF® JUL 10, 2020 ;*
15. *<https://lifeannuities.com/benefits.html> ;*
16. *Annuities: Advantages and Disadvantages - <https://www.thebalance.com/annuities-overview-315086>*

THE IMPACT OF THE RECAPITALIZATION OF THE GREEK BANKING SECTOR IN THE REAL ECONOMY.

PhD. EMILJAN MUSTAQE

,Department of Finance and Accounting, Faculty of Economy and Agribusiness. Agricultural *University of Tirana, Albania*, *emustaqe@ubt.edu.al*

Abstract

In this paper we review the Greek economic crisis focusing on the banking system. It is recalled that in the memorable years 2012-2016, three bank recapitalizations were carried out by the Greek State -through the HFSF-, which cost a total of around 43 billion euros. The first (2012-2013) cost the Greek taxpayers 25.5 billion euros, while private individuals also participated with 3 billion euros. The result was that the HFSF acquired a percentage of more than 80% in the 4 systemic banks, without, however, securing important administrative rights, such as the choice of administrations. Banks were slow to reduce non-performing loans (NPLs), which peaked at 48.9% of gross loans, because of their limited capital buffers. The second recapitalization (of 8.3 billion euros) took place in 2014, mainly by private investors, which led to a serious dilution of the State's position. At the same time, additional measures were taken, such as supporting the banks with guarantees (bonds), consolidating banks (Agrotiki, Postal Savings Bank, Proton) and restructuring the banking system through acquisitions and mergers. It is noted that, despite the significant recapitalizations and the concentration of the sector in four systemic institutions, the massive outflow of deposits continued from the domestic credit system, reaching 87 billion euros, with the recipient mainly foreign banks. As the IMF pointed out in its report in 2015, "further capital injections could be needed in the future, in the absence of a radical solution to the governance issues that are at the root of the problems of the Greek banking system". Government guarantees for securitizations were finally the key for NPLs to decline close to European averages. Banks' capital buffers have improved through internal profitability but remain below European averages. Lending to the real economy is low but

recovering, and banks' exposure to the sovereign is again increasing. At least, did the taxpayer lose or gain from the recapitalization?

Introduction:

The economic crisis that Greece experienced from 2008 onward was one of the deepest and most protracted globally in the past half-century. Real GDP per capita declined from €22,500 in 2007 to €16,830 in 2014, a cumulative drop of 25.2%. During that period, the unemployment rate rose from 8.4% to 26.5%.¹ Recovery has been sluggish as well: real GDP per capita was essentially flat from 2014 to 2016, and grew cumulatively by only 5.2% over the next three years. We examine the period from 2008 until July 2023, which is when the first and largest recapitalization of Greek banks was completed. That period can be divided into two phases. During the first phase, which lasted until September 2009, the global financial crisis affected banks worldwide. Greek banks were significantly affected, primarily through a liquidity channel. Their liquidity problems spilled over into the real economy and stretched the sovereign's finances, which were already quite stretched. During the second phase, the worst of the global financial crisis was over, but the EZ sovereign crisis began. Greece lost market access in May 2010 and embarked in drastic fiscal consolidation as part of its bailout program. Its default in 2012 rendered all Greek banks insolvent because they were holding large positions in Greek government bonds, partly as the result of government pressure. In order the State to get its money back, the stock market value "of the four systemic banks would have to be 1,383% higher than it was on 6/10/2023². That is, about 14.83 times higher". The Greek government will receive back just 3.6 billion euro, which is considered a sell-out by the experts. Compared to the bank rescue programs in other countries, such as the USA and the UK, pointing out that the USA made a profit of +13.7% from the investments of the TRAP program in the banks, while for the UK there were small losses of the rescue program, of the order of -17% of the initial investment.

The areas impacted by the economic crisis in Greece

¹ The data on real GDP come from Eurostat and the data on unemployment from the World Bank.


² The price of equities on that date has been used as the base for selling the shares of the systemic banks held by the Greek government.

Impact on the Banking Sector:

Greek banks bore the brunt of the crisis, grappling with a toxic mix of liquidity shortages, rising non-performing loans (NPLs), and dwindling investor confidence.


Liquidity Crunch:

The crisis triggered a run on Greek banks as depositors withdrew their funds amid fears of a banking collapse. This mass exodus exacerbated liquidity pressures, forcing banks to rely on emergency liquidity assistance (ELA) from the European Central Bank (ECB) to stay afloat.



Rising NPLs:

As the economy contracted and unemployment soared, borrowers struggled to repay their loans, leading to a surge in NPLs. Greek banks found themselves saddled with bad debts, eroding their capital buffers and undermining their stability.



Capital Shortfalls:

The deterioration in asset quality and the need for provisioning against NPLs depleted banks' capital reserves, exposing them to solvency risks. Recapitalization efforts were initiated to shore up banks' capital adequacy and restore market confidence.

The purpose and objectives of the work

The purpose of the paper is to make a modest contribution in terms of understanding the impact of the measures taken by the Greek government and the ECB during the Greek crisis and the impact of these measures on the banking sector. The final goal of the study is to analyze banking policy measures that negatively influence the normal performance of banks and therefore the level of state implication to these institutions.

Other objective of the paper is to create a theoretical basis for the description of the Greek debt crisis and the influencing factors in banking sector.

Methodology

The paper consists of a secondary data research, which were obtained from the Ministry of Finance of Greece, World Bank, IMF, ECB, books, and scientific

articles. Descriptive analysis, multivariable regression and case study were used to analyze the data. The study includes the banks operated in Greece.

The hypotheses raised in relation to this model are as follows:

H1: There is a positive relationship between the level of recapitalization and the level of loans to real economy (businesses and individuals).

H2: There is a positive relationship between the NPL-s level and the recapitalization effects.

H3: There is a positive relationship between business solvency and the level of business income declaration for tax effects.

Results and Discussion

The analysis of the regression results presents the following results in relation to the hypotheses.

| Hypotheses | Affirmed/R ejected |
|--|-----------------------|
| H1: There is a negative relationship between the level of recapitalization and the level of credit to real economy (businesses and individuals). | VERIFIED |
| H2: There is a negative relationship between the NPL-s level and the recapitalization effects. | VERIFIED |
| H3: There is a positive relationship between the level of recapitalization and the level of banks' capital adequacy and restore market confidence. | VERIFIED |

The descriptive analysis of the research results as follows:

The main results of the research are given below:

- Regarding the relationship between the level of the recapitalization and the level of credit to real economy (businesses and individuals) ,from the figure below we can see that the money borrowed to the banks in order to credit the real economy were not used to by the banks for crediting the businesses and

individuals, but were kept by the banks in deposits in ECB accounts and other banks abroad ,receiving interests.

Figure 3 – Level of mortgage loans disbursed from Greek banks for the period 2010 – 2023.

| <i>(amounts in mln euro)</i> | Mortgage Balance | Mortgages Net Flow | Total Loans Private Sector | Loans Net Flow of |
|------------------------------|-------------------------|---------------------------|-----------------------------------|--------------------------|
| Dec. 2010 | 80.155 | -262 | 257.474 | 33 |
| Dec. 2011 | 78.026 | -2.310 | 248.146 | -8.126 |
| Dec. 2012 | 74.268 | -2.633 | 227.263 | -9.975 |
| Dec. 2013 | 70.685 | -2.476 | 217.518 | -8.806 |
| Dec. 2014 | 69.042 | -2.144 | 211.637 | -6.724 |
| Dec. 2015 | 67.223 | -2.449 | 203.927 | -4.163 |
| Dec. 2016 | 61.026 | -2.336 | 194.749 | -2.964 |
| Dec. 2017 | 58.441 | -1.854 | 183.562 | -1.600 |
| Dec. 2018 | 56.393 | -1.677 | 169.886 | -2.050 |
| <i>Total Flow 2010-2018</i> | -- | <i>-18.141</i> | -- | <i>-44.375</i> |
| <i>(amounts in</i> | Mortgage | Mortgages | Total Loans | Loans |

| <i>mln euro)</i> | Balance | Net Flow | Private Sector | Net Flow of |
|------------------------------|----------------|-----------------|-----------------------|--------------------|
| Dec. 2019 | 52.335 | -1.900 | 153.786 | -991 |
| Dec. 2020 | 45.761 | -1.434 | 141.405 | 5.387 |
| Dec. 2021 | 30.520 | -1.379 | 109.225 | 1.872 |
| Dec. 2022 | 29.380 | -1.115 | 115.093 | 6.875 |
| Dec. 2023 | 28.082 | -1.050 | 118.003 | 4.170 |
| <i>Total flows 2019-2023</i> | -- | -6.878 | -- | <i>18.304</i> |

Source: Bank of Greece

- Regarding the relationship between the level of the recapitalization and the NPL-s level and the recapitalization effects, Banks were slow to reduce non-performing loans (NPLs), which peaked at 48.9% of gross loans, because of their limited capital buffers. Banks' capital buffers have improved through internal profitability but remain below European averages.

- Regarding the relationship between the level of the recapitalization and the level of banks' capital adequacy and restore market confidence, the cost imposed by the State on the banks with the haircut of the bonds (PSI) in 2012 exceeded 50 billion euros, even claiming that there is an additional benefit to the Exchequer from the "huge dividends received from the BoG due to the ELA funding line". It is recalled that the state forced domestic banks to participate in the PSI, which resulted in the "cutting" of bonds by 53.5%. The loss suffered by the banks from the loss of the value of the securities they had in their investment portfolios amounted to 37.7 billion euros. This loss resulted not only in the loss of all bank shareholders' capital, but in the banks recording negative equity of €15

billion, which forced the recapitalization of the sector in order to remain viable and not lose deposits of the citizens.

Conclusions and recommendations

From the control of all the data received among the main recommendations of the study can be mentioned: the loans disbursement should be increased together with the level of the deposits in Greece. As stated from the Governor of the Bank of Greece “*it is necessary to return to a savings rate of 9% of GDP from the -4% we are today in order to contain the external debt, reduce the current account deficit and be able to maintain high growth rates with national resources. The so-called 'savings gap', in other words the deficit of savings in relation to investments, reflects the structural weaknesses of the Greek production model and the country's high dependence on external financing. Throughout the last 25 years, the level of savings as a percentage of GDP in Greece has been one of the lowest in the euro area*”. More specifically measures to be taken : (i) Combating tax evasion.(ii) Enhancing banking competition in the sector – increasing interest rates on time deposits.(iii) Enhancing saving through capital market development.(iv) Strengthening the capitalization of the first and third pillar of the insurance system (social insurance and private insurance).(v) Actions to strengthen financial literacy.

Conclusion:

The Greek debt crisis left an indelible mark on the country's banking sector, reshaping its landscape and highlighting the imperative for reform. While challenges persist, Greece's commitment to fiscal discipline and structural adjustment bodes well for the sector's long-term resilience. Moving forward, sustained efforts to strengthen regulatory oversight, promote financial stability, and foster economic growth are essential to rebuild trust and confidence in Greek banks.

References

1. Becker, Gary S. (1968). *Crime and Punishment: An Economic Approach*. In *Essays in the Economics of Crime and Punishment*. Edited by Gary S.

- Becker and William M. Landes. New York: Columbia University Press; repr. 1974. Pages 1–54.
2. Battistini, Niccolo, Marco Pagano and Saverio Simonelli, 2014, “Systemic Risk, Sovereign Yields and Bank Exposures in the Euro Crisis,” *Economic Policy*, 29, 203-251. Available at: <https://academic.oup.com/economicpolicy/article-abstract/29/78/203/2918380?redirectedFrom=fulltext>
 3. European Banking Authority, 2021, “EBA dashboard: Data as of Q4 2021” Available at: https://www.eba.europa.eu/sites/default/documents/files/document_library/Risk%20Analysis%20and%20Data/Risk%20dashboard/Q4%202021/1029360/EBA%20Dashboard%20-%20Q4%202021%20for%20publication.pdf
 4. European Central Bank, 2022, “ECB Statistical Data Warehouse, Composite cost of borrowing indicator for non-financial corporations,” March. Available at: <https://sdw.ecb.europa.eu/reports.do?node=1000004935>.
 5. Ministry of Finance, Hellenic Republic, 2023, Hellenic Republic Public Debt Bulletin, March. Available at: https://www.minfin.gr/documents/20182/18489751/18-5-2023+++++Bulletin+No_105.pdf/ebacf805-ac3c-40e7-bf7c-2e99d268314a.
 6. Artavanis, Nikolaos and Ioannis Spyridopoulos, 2022, “Collateral Enforcement and Strategic Behavior: Evidence from a Foreclosure Moratorium in Greece,” Working Paper, Tulane University. Available at: https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2946595
 7. European Central Bank, 2015, “ECB finds total capital shortfall of €14.4 billion for four significant Greek banks,” Press Release, 31 October 2015. Available at: <https://www.bankingsupervision.europa.eu/press/pr/date/2015/html/sr151031.en.html>
 8. Fakos, Alexandros, Plutarchos Sakellaris and Tiago Tavares, 2022, “Investment Slumps During Financial Crises: The Real Effects of Credit Supply,” *Journal of Financial Economics*, 145, 29-44. Available at: <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0304405X2200080>

THE CIRCULAR ECONOMY AND REGULATORY FRAMEWORKS IN ALBANIA

MSc. Besmira Botusha

Faculty of Political Sciences, UAMD (botushabesi87@gmail.com)

MSc. Monika Kolleshi

Consulcesi Group (monikakolleshi1@outlook.com)

Abstract

This study aims to examine the complex dynamics of Albania's economic system and the pivotal role of legal regulations within it. Addressing environmental concerns such as resource reduction, waste management, and climate change has fostered greater recognition among governments and policymakers of the necessity to move toward a green economy model.

Through a theoretical analysis, this research seeks to understand the intersection of circular economy principles with Albania's regulatory frameworks, assessing how the nation's legislation can support enhanced utilization of natural resources, waste recovery, and innovation to foster a more sustainable economy. The study further delves into the identification of the main determinants of circular economy efficiency in Albania, including infrastructure, monetary and fiscal policies, as well as socio-economic factors. In addition, it examines the existing regulatory framework and the challenges facing their implementation, including issues of corruption, ambiguity, and uneven enforcement.

In conclusion, by assessing current policies and identifying challenges, this study aims to provide recommendations for strengthening the legal and institutional framework through targeted and effective reforms, using international best practices, and fostering stakeholder collaboration to cultivate a favorable business environment and sustainable economic progress in Albania.

Keywords: *Green economy, Circular economy, Regulatory entities, Legal frameworks, Investment, Risk.*

Hyrje

Studimet parashikojnë një rritje të popullsisë globale në 9 miliardë deri në vitin 2030 dhe një rritje të mbetjeve urbane me 70 për qind deri në vitin 2050. Me rritjen e popullsisë rritet edhe kërkesa për lëndë të para. Fondacioni Ellen MacArthur tregon se në sektorin e mallrave të konsumit, rreth 80 për qind e vlerës së tyre humbet çdo vit. Të gjendur drejt një mungese burimesh dhe kufizimesh, bota po kalon drejt një ekonomie më miqësore me mjedisin, duke zëvendësuar modelin linear "merr-prodho-hidh" me ekonominë qarkulluese. Kjo ekonomi përfshin 7R-të (ridizajnim, reduktim, ripërdorim, riparim, rinovim, rikuperim dhe riciklim), duke zgjatur ciklin e jetës së produkteve. Kjo qasje mund të kursejë para dhe të mbrojë mjedisin, ndërsa ofron përfitime si: minimizimi i presioneve mjedisore, rritja e sigurisë së furnizimit me lëndë të para, rritja e konkurrencës, inovacionit dhe zhvillimit ekonomik. Ky model ekonomik gjithashtu mund t'u sigurojë konsumatorëve produkte më të qëndrueshme dhe inovative, duke kursyer para dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës.

Shqipëria, një vend në zhvillim në Evropën Juglindore, përballet me sfida të mëdha mjedisore dhe ekonomike për shkak të menaxhimit joefikas të mbetjeve, infrastrukturës së kufizuar të riciklimit dhe degradimit mjedisor. Urbanizimi dhe rritja e shpejtë ekonomike kanë theksuar këto probleme, duke krijuar një nevojë urgjente për praktika të qëndrueshme. Ky punim analizon gjendjen aktuale të ekonomisë qarkulluese në Shqipëri, kornizën rregullatore dhe potencialin për zhvillim në të ardhmen.

Objektivat kryesore të këtij punimi janë:

Të vlerësohet koncepti i ekonomisë qarkulluese dhe impakti i saj në nivel kombëtar, rajonal dhe global.

Të identifikojë mangësitë dhe sfidat në zbatimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese.

Të rishikohet dhe vlerësohet mjedisi rregullator ekzistues në lidhje me ekonominë qarkulluese në Shqipëri dhe çfarë pritet në të ardhmen.

Të propozojë rekomandime strategjike për rritjen e adoptimit dhe efektivitetit të praktikave të ekonomisë qarkulluese në Shqipëri.

Rishikimi i Literaturës

Ekonomia qarkulluese rrjedh nga zhvillimi i qëndrueshëm i cili është një zhvillim ekonomik, mjedisor dhe social që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar nevojat e brezave të ardhshëm (Baumgartner & Rauter, 2017). Sipas Peter Lacy, ekonomia qarkulluese është një qasje sistematike ndaj zhvillimit ekonomik që përpiket të mbajë burimet në përdorim produktiv për aq kohë sa të jetë e mundur në ekonomi, duke shkëputur njëkohësisht rritjen nga konsumi i burimeve të pakta. (Lacy, et al., 2020).

Tranzicioni i gjelbër, është sa i pashmangshëm aq edhe sfidues për politikëbërësit. Duhet menduar përtej mandateve dhe të nxitet bashkëpunimi për planet afatgjata të investimeve. Kjo mund të sinjalizojë fundin e tranzicionit politik dhe ekonomik të Shqipërisë dhe fillimin e një faze të re zhvillimi (R. Koci & R. Gjoka, 2022). Nëse shfrytëzimi i burimeve vazhdon me ritmet aktuale, do të nevojiten tre planetë për të përmbushur nevojat e ardhshme. Prandaj, kalimi në një ekonomi me zero karbon, të qëndrueshme, pa toksina dhe plotësisht qarkulluese është thelbësore (I. Paloli, 2021).

Europa, pavarësisht burimeve të saj të kufizuara, mund të zhvillojë teknologji për të ndërtuar një shoqëri me mbeturina zero, duke krijuar vende pune dhe rritje ekonomike duke arritur qëllimet klimatike, sipas Jan Huitema nga "Renew Europe". Aktualisht, rreth dy të tretat e materialit të nxjerrë nga planeti përfundon si mbetje dhe vetëm 9 për qind e materialeve riciklohen (Kunzig, 2020). Ekonomia qarkulluese, synon mbetjet pothuajse zero, duke favorizuar burimet e rinovueshme dhe modelet restauruese.

Entet rregullatorë kanë një rol vendimtar në lehtësimin e tranzicionit në ekonomi qarkulluese përmes metodave të ndryshme qeveritare, duke përfshirë kornizat ligjore, taksat, stimujt, zhvillimin e infrastrukturës. Qeveria është nxitësi që kërkon nga industritë të ndjekin disa praktika të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve, në të kundërt mosrespektimi i tyre mund të rezultojë në inspektime shtesë, ndëshkime, gjopa për kompanitë (Rantaa, et al., 2018). Menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve në Shqipëri mbetet në një nivel relativisht të ulët. Aktualisht, rreth 69 për qind e popullsisë merr shërbime të menaxhimit të mbetjeve; vetëm 30 për qind e mbetjeve dërgohen në vendgrumbullim, ndërsa pjesa tjetër hidhet në venddepozitime joadekuate. Për sa i përket infrastrukturës dhe llojit të landfilleve, nuk ka landfille të projektuara për të përmbushur

standardet e BE-së. Pjesa më e madhe e mbetjeve depozitohet në landfille lokale dhe ilegale. (ENV 2021)

Edhe pse ka pasur disa përpjekje të vogla nga bashkitë për të ruajtur një mjedis më të pastër, janë infrastruktura e dobët e venddepozitimeve, pamjaftueshmëria e mjeteve të grumbullimit të mbetjeve dhe zbatimi i dobët i ligjit që pengojnë përmirësimin e situatës.

Metodologjia e kërkimit

Për të patur një analizë të plotë të peisazhit të ekonomisë qarkulluese në Shqipëri u zhvillua një analizë gjithëpërfshirëse kualitative duke përfshirë:

1. Rishikimin e literaturës akademike, dokumenteve të politikave dhe raporteve mbi ekonominë qarkulluese dhe kornizave rregullatore.

2. Analizën e politikave ekzistuese, nëpërmjet ekzaminimit të ligjeve, rregulloreve dhe strategjive lidhur me ekonominë qarkulluese në Shqipëri.

3. Studimin e rasteve, duke analizuar iniciativat e suksesshme të ekonomisë qarkulluese dhe praktikave më të mira nga vende të tjera që mund të përshtaten me kontekstin shqiptar.

4. Intervista me palët e interesuara, duke përfshirë zyrtarët e qeverisë, drejtuesit e industrisë dhe OJQ-të mjedisore, për të kuptuar sfidat dhe mundësitë praktike.

Impakti i Ekonomisë Qarkulluese në Nivel Kombëtar, Rajonal dhe

Global

Tranzicioni në një ekonomi qarkulluese në Shqipëri ofron potencial transformues në nivel kombëtar, rajonal dhe global. Ky model i qëndrueshëm ekonomik, i cili thekson efikasitetin e burimeve, reduktimin e mbetjeve dhe përdorimin e vazhdueshëm të materialeve, mund të forcojë ndjeshëm qëndrueshmërinë mjedisore dhe ekonomike të Shqipërisë. Megjithatë, zbatimi i suksesshëm i parimeve të ekonomisë qarkulluese në Shqipëri varet shumë nga mbështetja rregullatore, iniciativat e qeverisë dhe bashkëpunimet publiko-privat. Në nivel kombëtar, adoptimi i praktikave të ekonomisë qarkulluese mund të reduktojë ndjeshëm varësinë e Shqipërisë nga lëndët e para duke nxitur riciklimin,

ripërdorimin dhe riprodhimin. Për shembull, sektori i bujqësisë në Shqipëri mund të përfitojë nga kompostimi i mbetjeve organike, duke i kthyer ato në pleh të vlefshëm, i cili do të përmirësonte shëndetin e tokës dhe do të reduktonte nevojën për inpute kimike. Qeveria, nëpërmjet Këshillit Kombëtar të Territorit, ka miratuar Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në 1 Janar 2020. Parimet e ekonomisë qarkulluese në Shqipëri janë të referuara në draftin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (2018-2023) dhe gjithashtu në dokumentin e Politikës Strategjike dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035 me synim kalimin nga ekonomia lineare në atë qarkulluese. Megjithatë, Shqipërisë i mungon plani dhe infrastruktura për të menaxhuar mbetjet në një mënyrë miqësore me mjedisin për reduktimin, ripërdorimin, ndarjen e grumbullimit të mbetjeve dhe riciklimin, të konsideruara si praktikë më ekologjike. Tendencat e përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve është depozitimi i tyre në landfille të drejtuara nga bashkia dhe ato ilegale, djegia e tyre në ajër të hapur kryesisht mbetjet shtëpiake dhe inceneratorë.

Angazhimi i Shqipërisë për një ekonomi qarkulluese shtrihet përtej kufijve të saj nëpërmjet bashkëpunimeve rajonale dhe globale. Rrjeti i Menaxhimit të Mbetjeve të Ballkanit Perëndimor është një shembull i dukshëm i bashkëpunimit rajonal. Ky rrjet përfshin Shqipërinë dhe vendet e saj fqinje, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën, në përpjekje për të standardizuar praktikën e menaxhimit të mbetjeve dhe për të ndarë praktikën më të mira. Një bashkëpunim i tillë rrit efikasitetin e menaxhimit të mbetjeve, redukton ndotjen e mjedisit dhe nxit zhvillimin ekonomik përmes infrastrukturës së përbashkët të riciklimit. Një projekt tjetër rajonal nisi për parandalimin e mbetjeve detare në vitin 2018, duke përfshirë aktorë vendas dhe kombëtarë në industrinë e mbetjeve dhe riciklimit në Shqipëri, Mal të Zi dhe Bosnje-Hercegovinë. Fokusi i tij është bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i njohurive ndërmjet institucioneve kombëtare, komunave dhe kompanive. Projekti promovon një kuadër rregullator për reduktimin dhe ndalimin e artikujve plastikë njëpërdorimësh (GIZ, 2018).

Në skenën globale, lëvizja e Shqipërisë drejt një ekonomie qarkulluese përputhet me angazhimet ndërkombëtare të qëndrueshmërisë, të tilla si Marrëveshja e Parisit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDGs). Duke u pozicionuar si një model për praktikën e ekonomisë qarkulluese, Shqipëria mund të tërheqë investime të huaja dhe inovacione teknologjike, duke u integruar më tej në ekonominë e gjelbër globale. Gjithashtu Shqipëria përfiton nga partneritetet me organizata si Programi i Kombeve të

Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Projekti i PNUD për ekonominë qarkulluese mbështet Shqipërinë duke ofruar programe trajnimi për bizneset vendase mbi praktikat e qëndrueshme dhe efikasitetin e burimeve. Këto bashkëpunime globale ndihmojnë Shqipërinë të përafrojë praktikat e saj me standardet ndërkombëtare, të tërheqë investime të huaja dhe të integrohet në tregjet globale për materialet e ricikluara.

Ekonomia Qarkulluese në Shqipëri

Shqipëria, vecanërisht në 10 vjecarin e fundit ka iniciuar disa projekte që mishërojnë parimet e një ekonomie qarkulluese, si:

Projekti për riciklimin e mbetjeve plastike dhe letrës, i cili ka nisur në vitin 2018, i mbështetur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe kompanitë e riciklimit.

Projekti i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane, i cili është iniciuar në vitin 2020 si pjesë e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve për periudhën 2020-2035. Një nismë tjetër është ‘ECO Tirana’, një partneritet publik-privat që synon rritjen e grumbullimit dhe riciklimit të mbetjeve në kryeqytet, në landfillin e Sharrës. Nëpërmjet vendosjes së koshave të riciklimit, fushatave ndërgjegjësuese të publikut dhe bashkëpunimeve me bizneset vendase, ECO Tirana ka arritur të rrisë normat e riciklimit dhe të reduktojë mbeturinat urbane. Këto përpjekje jo vetëm që nxisin një mjedis urban më të pastër, por gjithashtu nxisin rikuperimin e burimeve të vlefshme.

Projekti për energjitë e ripërtëritshme i cili ka nisur në vitin 2016 me miratimin e Ligjit Nr. 138/2013 "Për Energjinë e Rinovueshme" dhe zbatimin është mbështetur nga investimet ndërkombëtare dhe donatorët.

Projekti për trajtimin e ujit të pijshëm dhe ujit të ndotur i cili filloi në vitin 2019 me mbështetjen e Bankës Botërore dhe Bashkimit Evropian.

Projekti për agrikulturën e qëndrueshme i cili ka nisur në vitin 2017 në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Bujqësisë 2014-2020.

Projekti për Menaxhimin e Mbështetjeve Elektronike (e-waste) i cili ka filluar në vitin 2020, me mbështetjen e fondeve të BE-së dhe organizatave të specializuara në menaxhimin e mbetjeve elektronike.

Projekti për transportin e qëndrueshëm i cili është iniciuar në vitin 2018 me mbështetjen e qeverisë dhe organizatave ndërkombëtare si Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD). Si pjesë e programit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në Ankand të Energjisë së Rinovueshme në Shqipëri, qeveria shqiptare do të nisë një tender për 300 Megavat (MW) energji diellore. Kjo do të japë një kontribut të madh në furnizimin e ardhshëm të vendit me energji të rinovueshme dhe do të reduktojë ndjeshëm emetimet e gazrave serrë, në përputhje me objektivat e tij klimatike.

Gjithashtu ka patur edhe projekt pilote të ndryshëm si, ai zbatuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për mbështetjen e minimizimit të mbetjeve dhe promovimin e 3R në Republikën e Shqipërisë. Disa kompani private në Shqipëri kanë nisur të deklarojnë raportin e qëndrueshmërinë së tyre kjo si një nisëm e gjelbër që kalon përtej veprave formale, për të dëshmuar angazhimin solid të tyre për qëndrueshmërinë mjedisore dhe përgjegjësinë sociale. Gjithashtu ato kanë investuar shumë për të implementuar teknologji që minimizojnë mbetjet, që riciklojnë produkte, si për shembull përdorimi i automjeteve 100% elektrike etj.

Miratimi i parimeve të ekonomisë qarkulluese në Shqipëri paraqet përfitime të shumta në dimensione ekonomike, mjedisore dhe sociale.

Rritja ekonomike:

Krijimi i vendeve të punës: Shfaqja e industrive të reja në riciklimin, riprodhimin dhe menaxhimin e mbetjeve gjeneron mundësi punësimi. Kjo mund të ndihmojë në uljen e papunësisë.

Efikasiteti i burimeve: Duke optimizuar përdorimin e materialeve dhe energjisë, bizneset mund të ulin kostot dhe të rrisin konkurrencën.

Ekonomia qarkulluese promovon zhvillimin e teknologjive dhe praktikave të reja që mund të nxisin inovacionin dhe konkurrueshmërinë e bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Mbrojtja e mjedisit:

Reduktimi i mbetjeve: Përmirësimi i praktikave të riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve ulin përdorimin e landfillëve dhe ulin nivelet e ndotjes.

Ruajtja e biodiversitetit: Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve ndihmon në parandalimin e degradimit të mjedisit, duke mbrojtur habitatet natyrore dhe ekosistemet.

Përfitimet sociale:

Shëndeti Publik: Menaxhimi i përmirësuar i mbetjeve çon në mjedise më të pastra, duke reduktuar rreziqet shëndetësore që lidhen me ndotjen.

Angazhimi i Komunitetit: Ndërgjegjësimi i publikut dhe pjesëmarrja në iniciativat e qëndrueshmërisë nxisin një kulturë të kujdestarisë mjedisore.

Pavarësisht përfitimeve të qarta, Shqipëria përballet me disa sfida në tranzicionin e saj drejt një ekonomie qarkulluese.

Sfidat rregullatore:

Politikat joadekuate: Rregulloret ekzistuese mund të mos mbështesin plotësisht parimet e ekonomisë qarkulluese, duke u munguar stimujt specifikë dhe mekanizmat e zbatimit.

Pengesat burokratike: Proceset komplekse administrative mund të pengojnë zbatimin e projekteve të ekonomisë qarkulluese.

Kufizimet financiare:

Kostot fillestare të investimit: Kostot e larta fillestare për ngritjen e objekteve dhe infrastrukturës së riciklimit paraqesin barriera të rëndësishme financiare.

Financimi i kufizuar: Mbështetja e pamjaftueshme financiare si nga qeveria ashtu edhe nga sektori privat kufizon shkallën dhe shtrirjen e nismave të ekonomisë qarkulluese.

Ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut:

Barrierat kulturore: Mungesa e ndërgjegjësimit publik dhe rezistenca ndaj ndryshimit mund të ngadalësojë adoptimin e praktikave qarkulluese.

Edukimi: Nevojiten fushata të gjera edukative për të informuar qytetarët dhe bizneset për përfitimet e një ekonomie qarkulluese.

Çështjet teknike dhe logjistike:

Mangësitë e teknologjisë: Qasja e kufizuar në teknologjitë e avancuara të riciklimit dhe përpunimit të mbetjeve pengon përparimin.

Mangësitë në infrastrukturë: Infrastruktura joadekuatë

Implementimi i një ekonomie qarkulluese në Shqipëri mund të sjellë përfitime të mëdha mjedisore, ekonomike dhe sociale. Megjithatë, kjo kërkon një angazhim të fortë nga qeveria, bizneset dhe qytetarët për të promovuar politika të qëndrueshme dhe praktika inovative që mbështesin një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë.

Kuadri Ligjor për Ekonominë Qarkulluese në Shqipëri

Në vitet e fundit, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt promovimit të ekonomisë qarkulluese. Ky angazhim reflektohet në një sërë ligjesh dhe strategjish që synojnë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve dhe mbetjeve, si dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme. Më poshtë janë disa nga aktet kryesore ligjore që mbështesin këto përpjekje.

Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"

Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri, duke promovuar praktikën e qëndrueshme dhe menaxhimin e mbetjeve.

Ligji Nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve"

Ky ligj harmonizon menaxhimin e mbetjeve me direktivat e BE-së dhe synon të promovojë parimin e hierarkisë së mbetjeve: parandalimin, reduktimin, ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin e energjisë nga mbetjet.

Ligji Nr. 9379, datë 28.4.2005 "Për eficientësin e Energjisë"

Ky ligj synon të promovojë përdorimin e energjisë së ripërtëritshme dhe eficientësin energjetike në sektorët publik dhe privat.

Ligji Nr. 138/2013 "Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme"

Ky ligj vendos kuadrin për zhvillimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme dhe promovon përdorimin e burimeve alternative të energjisë, si energjia diellore, e erës dhe e ujit.

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035

Ky plan strategjik synon të përmirësojë menaxhimin e mbetjeve në vend, duke përfshirë masa për reduktimin e mbetjeve, rritjen e riciklimit dhe promovimin e ekonomisë qarkulluese. Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për periudhën 2020-2035 është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Ky dokument strategjik mer parasysh zhvillimet planifikuese dhe infrastrukturore në sektorin e mbetjeve prej vitit 2011, në nivelet e qeverisjes vendore dhe qendrore, përfshirjen e biznesit privat dhe investime të shumta që janë realizuar në vendin tonë. Objektivat specifike të dokumentit të politikave strategjike synojnë të japin zgjidhje praktike për:

Adresimin e problematikave në sistemin e deritanishëm të menaxhimit;

Zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi;

Përgatitjet e nevojshme për të përmbushur detyrimet nga ndryshimet në direktivat e BE.

Ligji Nr. 27/2016 "Për Menaxhimin e Kimikateve"

Ky ligj rregullon menaxhimin e kimikateve në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga rreziqet që lidhen me përdorimin e kimikateve.

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2014-2020

Kjo strategji fokusohet në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha sektorët e ekonomisë, duke përfshirë masat për reduktimin e ndotjes, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe promovimin e ekonomisë së gjelbër.

Ligji Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura"

Ky ligj përcakton kuadrin ligjor për krijimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri, duke kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Rregulloret dhe Udhëzimet për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Urbane

Këto rregullore vendosin standardet dhe procedurat për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në qytete dhe komunitete, duke përfshirë grumbullimin, transportin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

Këto ligje dhe strategji përbëjnë kuadrin rregullator për mbështetjen dhe promovimin e ekonomisë qarkulluese dhe të gjelbër në Shqipëri, duke synuar një menaxhim më të qëndrueshëm të burimeve dhe mbetjeve, si dhe promovimin e energjisë së ripërtëritshme.

Parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve të percaktuara në direktivën në kuadër të menaxhimit të mbetjeve 2008/98 /EC që është transpozuar në ligjin nr.10463 datë 22.09.2011, “ Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar në ligjin nr. 10431 date 09.06.2011,“ Për mbrojtjen e mjedisit” janë:

Hierarkia e mbetjeve është parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve që ka si qëllim renditjen e mundësive të menaxhimit të mbetjeve sipas qëllimit se çfarë është më e mirë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe kalimin drejtë ekonomise qarkulluese;

Parimi integrues nënkupton që mbrojtja e mjedisit duhet të jetë pjesë integrale e çdo procesi të zhvillimit të politikave;

Parimi i eliminimit të mangësive që ndeshen në politikat mjedisore nënkupton zbatimin e praktikave aktuale evropiane që lidhen me fushën e menaxhimit të mbetjeve;

Parimi i përgjegjesisë së ndërsjelltë dhe i bashkëpunimit nënkupton që të gjithë aktorët e përfshirë në gjenerim dhe menaxhim duhet të jenë përgjegjës dhe duhet të bashkëpunojnë në të gjitha rastet;

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm nënkupton që brezi i sotëm në përpjekjen për të plotësuar nevojat e tij të mos çënojë aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duke qenë institucioni politikëbërës ka progres në hartimin dhe miratimin e kudit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve në përputhje me direktivat dhe rregulloret e BE. Një prej sfidave që buron nga legjislatiioni është zbatimi i plotë i tij, mungesa e zbatueshmërisë vjen si rezultat i mbivendosjes së kompetencave të institucioneve qendrore dhe vendore.

Megjithatë, kuadri rregullator shqiptar aktualisht paraqet nivele të përziera të mbështetjes për nismat e ekonomisë qarkulluese. Ndërkohë që ka disa masa

legjislativë që synojnë reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve, mungojnë politika gjithëpërfshirëse të përshtatura për ekonominë qarkulluese. Për shembull, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve (2020-2035) thekson reduktimin e mbetjeve, por ka nevojë për masa më konkrete për të promovuar zgjatjen e ciklit jetësor të produktit dhe rikuperimin e burimeve. Organet qeveritare dhe rregullatore duhet të rrisin mbështetjen e tyre duke zhvilluar dhe zbatuar politika specifike të ekonomisë qarkulluese. Kjo përfshin dhënien e stimuljeve për bizneset që të adoptojnë praktika qarkulluese, të tilla si lehtësime tatimore për kompanitë që përdorin materiale të ricikluara ose ndëshkime për prodhimin e tepërt të mbetjeve. Fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe programet arsimore janë gjithashtu thelbësore për të nxitur një kulturë të qëndrueshmërisë.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Zbatimi i një ekonomie qarkulluese në Shqipëri paraqet mundësi të rëndësishme, por edhe sfida të mëdha. Kornizat rregullatore aktuale në Shqipëri kanë bërë disa përparime drejt qëndrueshmërisë, por mbetet një hendek i konsiderueshëm midis politikës dhe praktikës. Një analizë e plotë tregon se ndërsa ka politika që synojnë promovimin e riciklimit, reduktimin e mbetjeve dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve, këto shpesh pengohen nga zbatimi i pamjaftueshëm, mungesa e infrastrukturës dhe ndërgjegjësimi i kufizuar publik. Për më tepër, kufizimet ekonomike dhe dobësitë institucionale paraqesin pengesa shtesë për zbatimin efektiv. Sidoqoftë, përfitimet potenciale të një ekonomie qarkulluese, si reduktimi i ndikimit mjedisor, përmirësimi i efikasitetit të burimeve dhe rritja ekonomike, theksojnë nevojën kritike që Shqipëria të forcojë dhe përshtasë kornizat e saj rregullatore për të realizuar plotësisht këto avantazhe.

Për të përparuar ekonominë qarkulluese në Shqipëri, është thelbësore të ndërmerren një sërë veprimesh të synuara:

Fuqizimi i Zbatimit Rregullator: Forcimi i zbatimit të rregulloreve ekzistuese mjedisore përmes monitorimit më të mirë dhe penaliteteve më të rrepta për mosrespektimin. Kjo mund të përfshijë rritjen e financimit për agjencitë rregullatore dhe përmirësimin e kapacitetit të tyre operacional.

Zhvillimi i Infrastrukturës: Investiminë infrastrukturë që mbështet aktivitetet e ekonomisë qarkulluese, si p.sh. objekte riciklimi, vende për kompostim dhe sisteme të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve. Partneritetet publike-private mund të jenë kyçe në këtë fushë.

Rritja e Ndërgjegjësimit Publik: Nisja e fushatave të gjera ndërgjegjësimi publik për të edukuar qytetarët dhe bizneset rreth përfitimeve të ekonomisë qarkulluese dhe rëndësisë së praktikave të qëndrueshme. Kjo mund të përfshijë bashkëpunime me shkolla, media dhe organizata komunitare.

Inkurajimi i Inovacionit dhe Investimeve: Krijimi i stimujve për bizneset për të inovuar në fushën e qëndrueshmërisë, si p.sh. ulje taksash, grante dhe kredi me interes të ulët për kompanitë që adoptojnë praktikën e ekonomisë qarkulluese. Mbështetja e kërkimit dhe zhvillimit në këtë sektor është gjithashtu thelbësore.

Forcimi i Kapacitetit Institucional: Përmirësimi i kapacitetit të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e politikave të ekonomisë qarkulluese përmes programeve të trajnimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Mësimi nga praktikat më të mira në vende të tjera mund të ofrojë njohuri të vlefshme.

Nxitja e Bashkëpunimit: Inkurajimi i bashkëpunimit midis qeverisë, sektorit privat dhe shoqërisë civile për të krijuar një qasje kohezive për zbatimin e ekonomisë qarkulluese. Platformat me shumë palë të interesuara mund të lehtësojnë dialogun dhe veprimet e koordinuara.

Duke adresuar këto fusha, Shqipëria mund të bëjë përparime të rëndësishme drejt një të ardhme të qëndrueshme, duke siguruar që kornizat e saj rregullatore jo vetëm të mbështesin, por edhe të nxisin aktivisht kalimin në një ekonomi qarkulluese.

Referencat

1. BOSHNJAKU, A., & DAFA, J. (2022). Circular economy for a sustainable growth: Albanian case. *CIRCULAR ECONOMY*, 198.
2. Chen, J. Z. (2009). Material flow and circular economy. *Systems Research and Behavioral Science: The Official Journal of the International Federation for Systems Research*, 26(2), 269-278.
3. Corvellec, H., Stowell, A. F., & Johansson, N. (2022). Critiques of the circular economy. *Journal of industrial ecology*, 26(2), 421-432.
4. Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, 2021. Raporti Mushkëri të Gjelbra, Tiranë: Co-PLAN.
5. Desantila, M. U. J. A. (2022). Empirical Evidence on Circular Economy and Economic Development in Albania. *CIRCULAR ECONOMY*, 876.
6. de Oliveira, C. T., & Oliveira, G. G. A. (2023). What Circular economy indicators really measure? An overview of circular economy principles

- and sustainable development goals. *Resources, Conservation and Recycling*, 190, 106850.
7. European Commission, 2019. The European Green Deal. [Online] Available at: file:///C:/Users/rodion_gjoka.COPLAN/Downloads/The_European_Green_Deal_sets_out_how_to_make_Europe_the_first_climate-neutral_continent_by_2050__boosting_the_economy__improving_people_s_health_and_quality_of_lif_e__caring_for_nature__and_leaving_no.pdf [Accessed 15 2 2022]. European Commission, 2020.
 8. European Commission, 2021. Albania Progress Report, Belgium: EC.
 9. European Environmental Agency, 2021. Air Quality in Europe 2021, Copenhagen: EEA.
 10. FESHTI, A. (2022). Circular economy in the Tourism Industry, Case of Albania. *CIRCULAR ECONOMY*, 210.
 11. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2019. [Online] Available at: <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-412-2019-menaxhimi-i-ajrit.pdf> [Accessed 22 January 2022].
 12. Geissdoerfer, M., Savaget, P., Bocken, N. M., & Hultink, E. J. (2017). The Circular Economy—A new sustainability paradigm?. *Journal of cleaner production*, 143, 757-768.
 13. GJACI, B., & TUSHAJ, A. (2022). Evaluating Potential Financial Instruments to implement Circular Economy in Albania. *CIRCULAR ECONOMY*, 245.
 14. Gura, K. S., Kokthi, E. L. E. N. A., Hodaj, N. A. T. A. S. H. A., & Zoto, O. L. T. J. A. N. A. Circular economy pathway influential factors in Albania through green products approximation. In 3rd international conference (p. 179).
 15. Haas, W., Krausmann, F., Wiedenhofer, D., & Heinz, M. (2016). How circular is the global economy? A sociometabolic analysis. *Social Ecology: Society-Nature Relations across Time and Space*, 259-275.
 16. Ibn-Mohammed, T., Mustapha, K. B., Godsell, J., Adamu, Z., Babatunde, K. A., Akintade, D. D., ... & Koh, S. C. L. (2021). A critical analysis of the impacts of COVID-19 on the global economy and ecosystems and opportunities for circular economy strategies. *Resources, Conservation and Recycling*, 164, 105169.
 17. IPCC Intergovernmental Panel on Climate Change, United Nations, 2021. <https://www.ipcc.ch/>. [Online] Available at: <https://www.ipcc.ch/report/sixth-assessment-report-working-group-i/> [Accessed 16 2 2022].
Ai pikësëpari qe burim i kolonizimit. Ndjenjat e forta patriotike, besimi në superioritetin kombëtar e racor si dhe murrja fisnore dhe glorifikimi i historisë e i kulturës ishin rrjedhojë e drejtpërdrejtë e nacionalizmit dhe njëkohësisht e siguruan terrenin për ekspansionizëm politik dhe ekonomik. Imperializmi është vetëm një pasardhës jolegjitim i këtyre shmangieve nacionaliste.

Nacionalizmi ishte arsye për kolonizimin dhe aktet barbare të kolonialistëve që kryheshin nën petkun e "nevojave kombëtare" dhe të "ringjalljes së madhësisë së atdheut".

Nacionalizmi ishte një forcë e madhe lëvizëse që mbështetej në frymën e kolonizimit. Ndezja e ndjenjave të forta nacionaliste dhe fryma e vetëflijimit për atdheun, gjithnjë e më tepër e rritnin motivin për kolonizime të reja, me ç'rast racave angleze, franceze dhe gjermane u jepej një shtytje e re për dominim në Azi e në Afrikë¹.”

Frensis Kuker, një mendimtar i njohur shkruan: "Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, pjesa dërrmuese e nacionalistëve e sidomos ata më fanatikët,

ishin të bindur dhe pohonin se kombet e përparuara kishin histori dhe kulturë të lartë si dhe superioritet racor dhe kombëtar; prandaj ata nuk kënaqeshin me kufizimin e talenteve të tyre vetëm brendapërbrenda kufijve të vendeve të tyre. Detyra e tyre kombëtare e patriotike nuk duhej të përmblihet vetëm në kuadër të mbrojtjes së pavarësisë dhe integritetit territorial të vendit, të cilit i takonin. Ata kishin një mision universal për përhapjen e rrezeveprimit të ndikimit kulturor, politik e kombëtar nëpër të gjitha pjesët e botës, dhe e tërë kjo bëhet në interes të njerëzimit; me qëllim që të japin kontributin e tyre për t'i qytetëruar vendet e prapambetura, madje edhe me anë të forcës e dhunës po qe se paraqitej nevoja"¹.

Dhe ky mendim përforcon ide ksenofobike mbas së cilës qëndrojnë nacionalistët ekstremist që veprimet e tyre janë të pakontrolluara globalisht dhe si e tillë nuk merret në përgjegjësi askush. Në fakt qëllimi i imponimit të një dobie ndaj një shoqërie, në vetvete paraqet diskriminim masiv, aty përfundon liria e zgjedhjes dhe të jetuarit sipas asaj që dikush dëshiron.

Në periudhën e pas luftës së parë dhe dytë botërore, zhvillimi i nacionalizmit të pakontrolluar ra në duart e Musolinit në Itali, Hitlerit në Gjermani, nga të cilët pasoi shkatërrimi i pashoq i pothuajse botës në tërësi. Ata mendonin se popujt e tyre ishin superior edhe mbi popujt e tjerë, prandaj meritonin ta qeverisnin botën me idet e tyre prej nacionalistëve ekstrem, dhe si rrjedhojë bota digjej në flakë.

Disa nga pasojat ose më mirë thënë të metat e nacionalizmi ekstrem, të pakontrolluar vazhdojnë edhe më tej të mbeten evidente, përkundër shtrirjes mjaftë të gjërë të demokracisë dhe zhvillimit kulturorë e intelektual në nivel global.

Thellon **ndarjen etnike** brenda një shtetit; ishte pikërisht parulla nacionaliste ajo që e shkatërroi dhe shpërbëri Perandorinë më të fuqishme të kohës, atë Osmane.

Lëvizja Turqit e Rinjë të mbështetur nga organizata Bashkimi dhe Përparimi ishin promotorët e ngjizjes së nacionalizmit turk brenda perandorisë, dhe me fuqizimin e tyre, me idenë se turqit kanë epërsi mbi kombësit tjera brenda perandorisë, ngjalli paknaqësi edhe tek kombësit tjera, serbe, bullgare e shqiptare.

Në fakt kjo ishte e dobishme për kombësit tjera ngase nga shpërbërja e Perandorisë Osmane u krijuan shumë shtete të pavarura etnikisht, por fakti është se ishte fatale për vetë perandorinë.

Edhe Federata Jugosllave filloi shpërbërjen e saj në mënyrën e njejt si të Perandorisë Osmane, trajtimi jo i duhur i etnive dhe diskriminimi i vazhdueshëm i tyre, qoi deri tek shpërbërja e federatës tek formimi i shteteve të pavarura etnike

Mos durimi etnik brenda një shtetit paraqet rrezik të thellimit të hendekut brenda etnive që më pastaj të shpërthej edhe në një konflikt qytetar dhe paknaqësi të llojit të tillë. Diçka e tillë është dhe Republika e Maqedonisë së Veriut e përbërë në shumë etni. Platformat politike dhe parullat nacionaliste mund të çrregullojnë sistemin demokratik dhe ta dobësojnë bashkëqeverisjen në shtet, prandaj është detyrë dhe përgjegjësi e subjekteve të mëdha politike që të ruajnë kohezionin politik dhe ti largohen retorikes nacionaliste që do të shpiejn në ndarje etnik për mos thënë konflikt ndëretnik.

Racizmi racor dhe gjuhësor, paraqet formën më të shpesht të nacionalizmit ekstrem. Përçmimi i racës njerëzore ka qënë shkak i shumë konflikteve në botë. Të menduarit e superioritetit të një race mbi një tjetër, shkakton diskrimin dhe segregacion me pasoja në shoqëri. Mendimi se i bardhi ka epërsi mbi atë të me ngjyrë, është pasojë e nacionalizmit ekstrem, që për pasojë shumë jetëra njerëzish kanë humbur.

Ndarja religjioze; paraqet formën më të vrazhdë të nacionalizmit fetar. Besimtarët e thjeshtë gjithmonë kanë qënë në qendër të vuajtjes së pasojavë të diskriminimit fetar dhe keqpërdorimeve klerikiane. Sot bota përballë ka konfliktet më të vrazhda religjioze me tendencë në rritje. Kjo si pasoj e mendimit ekstrem mbi religjionin.

Nuk mund të pajtohemi me idenë se nacionalizmi apo e drejta e shumicës është patjetër e drejtë ose se shumica me çdo kusht ka të drejtë kundrejtë pakicës, në të kundërtën bie poshtë Karta e të Drejtave të Njeriut.

Përfundimisht themi se nacionalizmi është një këdo që synon të mbushë zbrazëtirën e kushtrimit në një shoqëri e cila synon të realizoj qëllimet e tyre të caktuara, qoftë çlirimin e vendit, qoftë formimin epo krijimin e shtetit apo edhe ndonjë interes të veçant të ndonjë grupi shoqërore, siç ishin borgjezët në të kaluarën, por, megjithatë, është përdorur dhe keqpërdorur nacionalizmi dhe thirrja në të, shpeshherë në formën më të skrupullt dhe më të rrezikshme të mundshme.

Me sintagmën nacionalizëm, janë shkatërruar shoqëri e shtete, janë bërë diferencime e stratifikime të pa drejta, në emër të nacionalizmit shpeshherë me

dashje ose pa, është zhvilluar një masë e rrezikshme e ksenofobisë dhe diskriminimit racor saqë në disa vende e shtete janë bërë masakra e dëbime në emër të tij.

Ideja e epërsisë së një shtrese, grupi apo klase shoqëror qëndron mbi të tjerët, njëlloj nacionalizmin jo si term, por si veprimtari. Mos durimi racor e gjinor gjenë shprehje në të gjitha vendet e botës, dhe kjo si rezultat i trajtimit jo të drejtë dhe të pa kontrolluar të nacionalizmit.

NACIONALIZMI I DOMOSDOSHËM DHE RACIONAL

Nacionalizmi tek një popull sipas teoricientëve zhvillohet në tri faza:

“Faza A është “zgjimi” kulturor, gjatë së cilës disa intelektualë fillojnë të mbledhin e studiojnë kulturën popullore, faza B është aktivizimi politik dhe faza C është masivizimi i lëvizjes, gjatë së cilës ajo fillon të ndahet në grupime ideologjike.¹“

Për shembull, në rastin konkret tek shqiptarët, nacionalizmi shqiptar që u zhvillua brenda shtetit osman, ishte reaksion i nevojës për themelimin e shtetit kombëtar, si dhe dobësimin të vazhdueshëm të fuqisë osmane në Ballkan.

Koncepti i idesë së kombit shqipëtar ka ecur nëpër tri fazat e sipër përmendurs duke i dhënë formësim origjinal nocionit kombë, me fjalë të tjera lëvizja nacionaliste shqiptare fillon ta zhvillojë mendimin e vetë politik me kërkesat e tyre për të drejta më të mëdha kulturore dhe gjuhësore në kuadër të një autonomie nën shtetin osman, si rrjedhojë që në të ardhmën të organizoheshin në lëvizje serioze me kërkesat e tyre kombëtare.

Në Perandorinë Osmane, lëvizjet nacionaliste kanë qenë rezultat i:

Dobësisë së shtetit osman dhe paaftësisë së tij për t’i kontrolluar lëvizjet e mendimeve të ndryshme politike dhe ideologjike, si dhe i paaftësisë për t’i parandaluar këto rryma e kanë dëmtuar rëndë këtë shtet.

Daljes në skensë të patriotëve të ndryshëm që synonin të bashkonin etnitetin e tyre gjuhësor, kulturor dhe fetar në një çati.

Pakënaqësisë të popujve të ndryshëm brenda perandorisë me trajtimin e administratës apo shtetit, por edhe i keqtrajtimeve që iu që bëheshin grupeve apo popujve në hapsirën e perandorisë

Dobësimi real të perandorisë dhe paaftësisë për t'i mbrojtur kufijt e vet.

Shfaqjes së idesë për shtet demokratik, më pak teokratik, për një shtet me kushtetutë laike dhe jo një kushtetutë fetare siç ishte Perandoria Osmane, ku feja nuk do të jetë në rend të parë, por kombi.

Në rastin e shtetit osman, rol të theksuar drejt degradimit ka luajtur dhe dalja në skenë e turqëve të rinj, të cilët synonin ta mbanin shtetin osman kompakt por pa ligj fetar, me një kushtetutë laike të ardhur nga ligjet e ndryshme evropiane. Por kjo ju shkoj keq turqve të rinjë, ngase fryma e tyre nacionaliste i frymëzoi dhe popujt e tjerë brenda perandorisë për të menduar drejt idesë për bashkim kombëtar, shtoja kësaj dhe trajtimin jo të mirë që qeveria e turqve të rinj e bënte ndaj etniteteve të tjera kombëtare përbrenda shtetit osman, mes tjerash edhe ndaj shqiptarëve.

NACIONALIZMI EKONOMIK

Nacionalizmi lindi në fund të shekullit të 18-të, me zhvillimin e Revolucionin Francez, mirëpo fillet e para datojn edhe më herët, ndër to është mendimi ekonomik i Merkantilizmit në shekullin XV-XVII me iden e pasurimit të shtetit, me fjalë të tjera fillon zhvillim i nacionalizmit ekonomik ku duhet të pasurohet shteti përball vendeve të tjera, më vonë aplikohet Proteksionizmi ku do të ndërmeren të gjitha masat mbrojtëse për tu zhvilluar shteti, duke përfshirë masat kufizuese për tregtin ndërkombëtare, tatimet e ndryshme në lëvizjen e mallrave dhe kapitalit, si dhe shumë masa të brendshme për kontrollin e ekonomisë.

Nacionalizmin ekonomik u ka dhënë vendeve një avantazh konkurrues në kuadër të tregtisë ndërkombëtare, si psh Gjermania ka një avantazh në prodhimin e makinave, makinerive dhe pajisjeve, si dhe në industrinë kimike dhe teknologjinë mjekësore¹, Britania e Madhe ka një avantazh ndrkombëtarë në shërbimet financiare, shërbimet e biznesit dhe ato profesionale, IT dhe komunikimet, dizajnin dhe median, si dhe udhëtimin dhe turizmin¹, Franca ka shumë përparësi që e bëjnë atë të dallohet në botë, si aksesin në një treg të madh e të gjallë, infrastrukturë të shkëlqyer të transportit dhe komunikimit, një fuqi punëtore të kualifikuar dhe produktive, çmime konkurruese të energjisë dhe një sistem efektiv dhe të aksesueshëm të kujdesit shëndetësor¹, Kina ka një avantazh në koston e burimeve njerëzore, të dhënat tregojnë se avantazhet konkurruese të zbuluara të Ukrainës janë në prodhimin e metaleve me ngjyra¹, Italia krenohet me

një fuqi punëtore të aftë dhe të specializuar, e njohur për mjeshtërinë e saj dhe ekspertizën e modës, automobilave dhe dizajnit. Ky kapital njerëzor është një aset i rëndësishëm, duke nxitur inovacionin dhe cilësinë në industri të ndryshme¹.

Sot vendet edhe pse proklamojn liberalizimin e tregut dhe ekonomisë në përgjithësi, në vete përmban një dozë të caktuar të nacionalizmit ekonomik, ngase ajo paraqet një forcë latente për ta mbrojtur ekonominë kombëtare ndaj presionit të globalizimit. Edhe vendet të cilat janë pionere të liberalizimit, nuk e kanë “të vdekur” ndjenjen nacionale por “të fjetur” dhe në çdo moment kur të kërkohet nevoja ata zgjohen.

Prandaj sot vendet në zhvillim pos tjerash duhet të zhvillojnë politika ekonomike nacionale të harmonizuara me trendet e integritimeve globale. Ngajshëm do ta quante ”Ekonomi e përzier mes Socializmit dhe Liberalizmit” (David L.F.1995)

Secili sistem ekonomik i ka përparësit dhe të metat e tyre në kohë dhe vendë të caktuar, më pas këto vende i kanë ndryshuar programet ekonomike varësisht nevojës kohore.

Në vitet e 80-ta dhe 90-ta, përshka të presionit të madhë të ekonomis nacionalste klasike shumë vende e përkrahën liberalizimin, veçanarisht në kuadër të Bashkimit Evropian, sepse ekonomia e vendeve bëheshte e lirë duke u futur në një treg më të gjërë konkurues dhe nga kjo përfitimin më të madh e kishin qytetarët e BE-së, nga i përfitonin produkte/shërbime të lira dhe cilësore. Mirëpo si duket edhe ky sistem nuk do të jetë apsolutisht i përshtatshëm për të gjithë sepse përcjelllet me kriza të her pas hershme.

“Rritja e theksuar politike e nacionalizmit ekonomik pas krizës financiare të vitit 2008 ka forcuar argumentet e bëra në studimin e ekonomisë politike para krizës për rëndësinë e qëndrueshme të kësaj ideologjie dhe nevojën për më shumë studim të rëndësisë ekonomike të nacionalizmit dhe identiteteve kombëtare”¹. Po ashtu, Për ta mbrojtur Italinë, sipas Carlo Kalenda, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, ne duhet të mbrojmë veten dhe të kthehemi në nacionalizëm ekonomik.¹ Në ndërkohë vendet si rasti i Kosovës e cila me vështërsi po e konsolidon ekonomin e vet, duhet të zhvillon politika favorizuese në prespektivën e forcimit të shtetësis. Agim Shahini, kryetar i AKB-së thotë: “Konsumimi i prodhimeve vendëse nuk është vetëm vlerë ekonomike, por edhe vlerë kombëtare dhe që qytetarët duhet t’i japin prioritet konsumimit të prodhimeve vendore, nga

të cilat pos përfitimit dhe rritjes së prodhimtarisë vendore, rritet edhe mirëqenia qytetare, punësimi dhe zhvillimi ekonomik i shtetit”.¹

PËRFUNDIM

Duke parë se nacionalizmi paraqitet si lëvizje ideologjike që promovon vlerat më të spikatura të një etnije, me qëllim të ngulitjes së themeleve të një kombi në formim, mendojmë se në kuadër të promovimit të vlerave të tilla, edhe si fenomen është tejet i rëndësishem.

Rëndësia e nacionalizmit në shoqëri është fundamentale, sepse fundja, nuk ka kombë e shtet pa nacionalizëm, thjeshtë është domosdoshmëri në shoqërinë e sotëm.

Megjithatë, baza e nacionalizmit ka ndjeshmërinë e saj në thelb që shpeshherë është manipuluar dhe keqpërdorur, madje skajshmërisht.

Në kuadër të mundësive për të arritur qëllimet e caktuara të një shoqërie, apo përfitimi të një favoriti, nacionalizmi është metodë shumë shumë e qëlluar.

Duke parë që përgjatë historisë të bëmat e njerëzve, grupeve të caktuara në emër të nacionalizmit të skajshëm, konkludojmë se rreziku i manipulimit të tij, sa shkon e rritet, zaten me zhvillimin teknik e teknologjik, dhe ekonomik, merrë formë të ndryshme të përfitimit dhe monopolizimit në emër të tij. Prandaj, nuk është e vështirë të detektohet një lëvizje qoftë politike apo ekonomike, se ku dëshiron të arrij apo cili është caku përderisa thirret në emër të patriotizmit apo monopolizimit të tregut.

LITERATURA

1. Enis Sulstarova, *Ligjërime nacionaliste në Shqipëri dhe studime të tjera*, Tiranë 2015
2. Husamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, Logos, Shkup, 2010
3. [Islami Dhe Nacionalizmi! | PDF \(scribd.com\)](#)
4. Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Tiranë 2002
5. Erik Hobsbaum, *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780*, Toena, Tiranë, 2012
6. Milazim Krasniqi, *Nacionalizmi Shqiptar*, Logos, Shkup, 2017
7. Ndriçim Kulla, *Historia e Mendimit Shqiptar*, Tiranë, 2019

8. Charles dhe Barbara Jelavich, *Themelimi i Shteteve Kombëtare të Ballkanit 1804-1920*, Tiranë 2004
9. Dr. Sinan Ademaj, Historia e mendimit ekonomik, Fakulteti ekonomik, Prishtinë

SIGURIA E INFORMACIONIT

Denisa Hani

(d.hani@eust.edu.mk)

Abstrakt

Një shqetesim aktuale i ditëve të sotshme është siguria e informacionit. Masa me e madhe e informacioneve sot merret nga interneti. Por sa i sigurt eshte ky informacion?

Rrezk i informacioneve qe gjenden ne internet eshte se ato mundte te kene sulme te ndryshme kibernetike. Ka menyra te shumta mbrojtjeje nga kto sulme ne rrjet.

Google, wikipedia deri me tani ishin menytrat me te shpejta per te marre informacion.

Informacioni ne keto platforma munde te jete i sigurt ose jo.

Pervec platformave te larte permendura ne ditet e sotme kemi mundesi marrje informacioni nga chat box te ndryshem sic eshte ChatGPT. ChatGPT ne kete fushe ndihmon shume individe ne sfera te ndryshme profesionesh. Ne kete punim permenden avantazhet dhe disavantazhet e ChatGPT.

Informacioni qe munde te merret nga ChatGPT eshte i pergjithshem dhe siperfaqesor, ndryshe nga ai qe kemi ne platforma tjera qe munde te jete me i zgjeruar.

Fjalët kyçe: *Siguria e informacionit, sulmet kibernetike, ChatGPT.*

Hyrje

Siguria e Informacionit,¹ shkurtimeisht InfoSec, përcakton informacionin nga qasja(aksesesi)i paautorizuar, perdorimi, zbulimi, shkaterrimi, modifikimi,

¹ https://sq.wikipedia.org/wiki/Siguri_informacioni

leximi, inspektimi, regjistrimi apo shkatërrimi. është një term i përgjithshëm që mund të përdoret pavarësisht nga forma e të dhënave që mund të marim (elektronike, fizike, etj...)

Dy aspektet më të mëdha të Sigurisë së Informacionit janë:

- Siguria e IT: Ndonjëherë i referohemi si siguria kompjuterike, Siguria e Teknologjisë së Informacionit është siguria e informacionit e aplikuar në Teknologji (shpesh herë si formë e sistemit të kompjuterit). Është e vlefshme të shihet se me kompjuterat nuk do të thote domosdoshmerisht një Desktop Shtepie. Një kompjuter është çdo device me një Njësi Qendrore Procesuese dhe disa memorie (madje dhe një llogaritës). Specialistet e Sigurisë së IT janë pothuajse gjithmonë të gjendura në çdo ndërmarrje të mëdha për shkak të natyrës dhe vlerës së të dhënave brenda bizneseve të mëdha.. Ata janë përgjegjës për mbajtjen e të

gjithë teknologjinë brenda sigurisë së kompanisë nga sulmet kibernetike dashakeqe që shpesh përpiqen të shkelin informacion privat kritik apo për të fituar kontroll në sistemet e brendshme.

- 'Sigurimi Informacione': akti i sigurimit, të të dhënave që nuk kanë humbur, kur lindin çështjet kritike. Këto çështje përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: fatkeqësitë natyrore, mosfunksionim i kompjuterit / serverit, vjedhja fizike, ose ndonjë shembull tjetër, ku e të dhënat kanë potencialin për të qenë të humbura. Meqenëse informacioni në epokën tonë moderne, është i ruajtur në shumicën e kompjuterave të sigurimit të informacionit është trajtuar në mënyrë tipike me nga specialistët e sigurisë (IT). Një nga metodat më të zakonshme për të pasur Siguri të Informacionit është që të kemi një backup off-site e të dhënave në rast se lindin një nga çështjet e përmendura më lart.

Të gjitha përpjekjet për ruajtjen e informacionit mund të dështojnë, nëse sistemi i ruajtjes së të dhënave nuk menaxhohet në mënyrë efektive për të siguruar transparencë në lidhje me funksionimin e organizatës dhe mënyrën se si gjithçka përshtatet brenda strukturave dhe strategjive organizative.²

Standardi ISO/IEC 27014, Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë – Menaxhimi i sigurisë së informacionit ofron udhëzime mbi konceptet, objektivat dhe proceset për menaxhimin e sigurisë së informacionit, me anë të të cilëve organizatat mund të vlerësojnë, drejtojnë,

² https://dps.gov.al/sq/menaxhimi-i-sigurise-dhe-ruajtja-e-informacionit_p1444.html

monitorojnë dhe komunikojnë me anë të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS), duke u bazuar në standardin ISO/IEC 27001.

Standardi i përditësuar së fundmi shërben për të përmirësuar qartësinë dhe strukturën, e cila përmban informacione të reja. Standardi është përafëruar me standardin ISO/IEC 27001, Teknologjia e informacionit

- Teknikat e sigurisë
- Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit
- Kërkesat, që janë të rëndësishme për menaxhimin e sigurisë së informacionit të një organizate.

Standardi ISO/IEC 27014 do të bashkohet me disa standarde të tjera për sigurinë e informacionit, që do të hartohen nga i njëjti komitet ekspertësh. Standardet, që do të hartohen janë:

Standardi ISO/IEC 27002, Teknologjia e informacionit

- Teknika të sigurisë
- Kodi i praktikës për kontrollet e sigurisë së informacionit;

ISO/IEC TS 27110, Teknologjia e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë

- Udhëzime për zhvillimin e kornizës së sigurisë kibernetike;
- Standardi ISO/IEC TS 27100, Teknologjia e informacionit

- Siguria kibernetike
- Përmbledhje dhe koncepte;

Standardi ISO/IEC 27005, Teknologjia e informacionit

- Teknika të sigurisë
- Menaxhimi i rrezikut të sigurisë së informacionit.

Çfarë është siguria kibernetike?

Siguria kibernetike është tërësia e mjeteve ligjore, organizatave, teknike dhe edukative, me qëllim mbrojtjen e hapësirës kibernetike.³

Siguria Kibernetike është metodë praktike e mbrojtjes së sistemeve, rrjeteve dhe programeve nga sulmet digjitale.

Qëllimi i sulmeve kibernetike:

Sulmet kibernetike zakonisht kanë për qëllim aksesin, ndryshimin, ose shkatërrimin e informacionit të ndjeshëm duke vjedhur të dhënat, dëmtuar dhe ndryshuar ato me qëllimin kryesor të zhvatjes së parave ose ndërprerja e proceseve normale të biznesit duke i bërë shantazh apo për ta çuar në kolaps jetik duke i humbur besueshmërinë.

Procedurat⁴ e Backup and Disaster Recovery janë gjërat më të vlefshme që duhet të zbatohen. Më poshtë rendisim disa nga rreziqet kibernetike që ndihmon kjo procedure:⁴

- **Ransomware Mitigation:** kercenim kibernetik i cili enkripton të dhënat e një organizate, duke i bërë ato të paqasshme. Një sistem robust i rezervës (Backup) lejon organizatat të rikthejnë të dhënat e tyre pa pasur nevojë të paguajnë kërkesën për shpërbli.
- **Integriteti i të Dhënave:** Sulmet kibernetike mund të ndryshojnë, korruptojnë ose fshijnë të dhëna. Rezervat e besueshme sigurojnë se të dhënat origjinale mund të rikthehen, duke ruajtur integritetin e tyre.
- **Vazhdimësia e Biznesit:** Koha e ndaluar për shkak të një sulmi kibernetik mund të jetë e kushtueshme në terma të të ardhurave dhe reputacionit. Zgjidhjet e rimekembjes pas fatkeqesish lejojnë bizneset të rifillojnë shpejt operacionet pas një sulmi.
- **Ruajtja e Proves:** Pas një incidenti kibernetik, ruajtja e të dhënave mund të shërbejë si prove e gjendjes origjinale të të dhënave, e cila mund të jetë e esenciale për analizën hetimore dhe procedurat ligjore.

³ <https://kibernetike.al/elementor-320/>

⁴ <https://www.linkedin.com/pulse/mbrojtja-kibernetike-ervin-muca>

- Minimizimi i kercenimeve nga punonjesit : Punonjes te pakenaqur ose te padeshiruar mund te fshijne ose ndryshojne te dhena me qellim. Ruajtja e te dhenave mund te ndihmojne ne rikthimin e te dhenave dhe minimizimin e ndikimit te ketyre kercenimeve te brendshme.

- Operational Resilience: Pervec sulmeve kibernetike, ka edhe kercenime te tjera si defektet e pajisjeve, gabimet e softuerit dhe fatkeqesite natyrore. Nje strategji gjithepershires e Backup and Disaster Recovery ofron qendrueshmeri ndaj nje game te gjere te problemesh.

- Perputhshmeria sipas standarteve: Shume industri kane rregullore qe kerkojne ruajtjen e te dhenave per nje periudhe te caktuar. Nje sistem i qendrueshem i ruajtjes se te dhenave ndihmon ne sigurimin e perputhshmerise me keto kerkesa.

- Testimi dhe Permiresimi: Para se te vendosin permiresime te reja te sigurise ose perditesime te softuerit, organizatat mund t'i testojne ato ne te dhenat ose sistemet ruajtjes se te dhenave. Kjo ndihmon ne identifikimin e problemeve te mundshme software pa rrezikuar infrastrukturen kryesore.

- Besimi dhe Besueshmeria: Te diturit se te dhenat jane te ruajtura dhe se ka nje plan rikthimi, mund te ndertoje besim mes paleve te interesuara, klienteve dhe partnereve.

- Kursime te Kostove Operacionale: Kostoja e rikrijimit te te dhenave te humbura ose te ndertimit te sistemeve nga e para mund te jete shume me e larte se sa te mbajturit nje plan te strukturuar mire te Backup and Disaster Recovery.

Qe Backup and Disaster Recovery te jete efektive ne hapesiren kibernetike, testimi i rregullt eshte esencial. Kjo siguron se rezervat nuk jane vetem aktuale, por se ato mund te rikthehen shpejt dhe kur eshte e nevojshme. Me tej, vete procesi i ruajtjes se te dhenave duhet te mbrohet, duke perdorur enkriptimin dhe ruajtjen ne ambient te sigurt, me qellim sigurimin e mosprishjes apo demtimit.

Me shumë gjasë kjo gjeneratë është e fundit që e ka përdorur intensivisht “Google – Wikipedia” për të marrë informacione. Teknologjia ka kaluar në një nivel tjetër, tashmë përmes ChatGPT program kompjuteri i dizajnuar për të

simuluar bisedë me përdoruesit nëpërmjet internetit, që po merr vëmendje në opinionin botëror.⁵

Çka është ChatGPT?

ChatGPT është një mjet për përpunimin e gjuhës natyrore (NLP). Ai përdor inteligjencën artificiale (AI) dhe teknologjinë e të mësuarit të makinerive për të gjeneruar përgjigje ndaj hyrjeve të tekstit të përdoruesit.

Kjo do të thotë që ju mund të keni akses në një chatbot super të zgjuar të trajnuar në një grup të madh të dhënash. Mund t'i kërkonte ChatGPT të:

- Pergjigjet pyetjeve
- Krijoni vepra krijuese
- Angazhohet në biseda të sofistikuara
- Shumë gjëra të tjera

Kompania kërkimore e AI OpenAI krijoi ChatGPT. Emri i ChatGPT i referohet natyrës së mjetit të bazuar në chat dhe përdorimit të tij të teknologjisë së Transformerit të Para-trajnuar gjenerues (GPT) të OpenAI.

Cili është ndryshimi midis ChatGPT dhe një motori kërkimi?

ChatGPT është një chatbot bisedor i AI që u përgjigjet kërkesave në mënyrë dinamike.⁶ Një motor kërkimi është një indeks i kërkueshëm i informacionit të krijuar nga përdoruesit. ChatGPT krahasohet me motorët e kërkimit për shkak të ngjashmërisë në kërkimin si përdorues dy teknologji në botën reale. Por ka dallime të mëdha si në mekanizmat e tyre ashtu edhe në rastet e përdorimit optimal.

Kuptimi i ndryshimeve midis dy teknologjive ndihmon në përcaktimin e rasteve të përdorimit më të mirë të tyre. Për një kërkim të vetëm, ChatGPT të gjenerojë një përgjigje të vetme, koncize. Vëre, përgjigje nuk do të ketë një burim specifik. Kërkimi i të njëjtit pyetje në Google kthen informacion më të thelluar.

⁵ <https://www.gazetaexpress.com/chatgpt-programi-qe-po-e-con-marrjen-e-informacionit-ne-nje-nivel-tjeter/>

⁶ <https://involveus.ai/en/cfare-eshte-chat-gpt/>

ChatGPT është gjithashtu i aftë për detyra të tjera të ndryshme që teknologjia e motorit të kërkimit nuk mund t'i përsërisë. Për shembull, mund t'i kërkoni të gjenerojë vepra krijuese.

Avantazhet e ChatGPT

Siç e dimë Chat GPT7 është një chatbot gjenerues i trajnuar paraprakisht, kështu që ka një avantazh të madh për t'u përdorur, le të hedhim një vështrim avantazheve:

- Së pari ju merrni çdo lloj përgjigje për pyetjet tuaja në çast.
- Kur bëni ndonjë pyetje, Google ju sugjeron një listë të sajteve të internetit, por këtu Chat GPT do t'u japë një përgjigje të drejtpërdrejtë pyetjeve tuaja.
- Mund të merrni zgjidhjet tuaja në një kohë shumë të shpejtë.
- Është shumë efektiv dhe shumë efikas për çdo person apo çdo lloj kompanie nëse mund ta përdorë atë në mënyrën e duhur.⁷
- Si inteligjencë artificiale e trajnuar paraprakisht, mund të bëjë biseda të natyrshme dhe mund të kuptojë sjelljen njerëzore, kështu që është shumë e lehtë për t'u përdorur.
- Mund të japë përgjigjen më të përshtatshme për çdo pyetje.
- Ky chatbot mund të ofrojë përgjigje të personalizuar për pyetjet në mënyrë që shumica e përdoruesve të mund të marrin zgjidhje unike në mënyra të ndryshme.
- Është falas për t'u përdorur kështu që ka një çështje kostoje për përdorimin e tij.

Ka shumë më tepër avantazhe të Chat GPT, por le të përqendrohemi në faktorët kryesorë të kësaj.

Disavantazhet e ChatGPT

Pavarësisht se ka avantazhe, ka edhe disa kundër. Le t'i shohim:

⁷ <https://colibri.al/chatgpt/>

- Pavarësisht se jep përgjigje për pothuajse çdo pyetje, ka kufizimet e saj do të thotë se disa nuk mund të japin disa zgjidhje.
- Edhe pse kursen kohë, por gjithashtu pengon kreativitetin e njerëzve.
- Marrja e zgjidhjeve prej saj me lehtësi, i bën njerëzit të humbasin interesin e tyre për të punuar shumë.
- Në të ardhmen, mund të vërtetohet se është një kërcënim për reduktimin e aftësive të të menduarit të kujtdo.
- Pika më e rëndësishme e këtyre të këqijave është se mund të shkatërrojë ngadalë inteligjencën njerëzore.

Referencat

1. https://sq.wikipedia.org/wiki/Siguri_informacioni
2. https://dps.gov.al/sq/menaxhimi-i-sigurise-dhe-ruajtja-e-informacionit_p1444.html
3. <https://kibernetike.al/elementor-320/>
4. <https://www.linkedin.com/pulse/mbrojtja-kibernetike-ervin-muca>
5. <https://www.gazetaexpress.com/chatgpt-programi-qe-po-e-con-marrjen-e-informacionit-ne-nje-nivel-tjeter/>
6. <https://involveus.al/en/cfare-eshte-chat-gpt/>
7. <https://colibri.al/chatgpt/>

SIGURIA E TË DHËNAVE NË INSTITUCIONET FINANCIARE

Viola Beqo

(v.beqo@eust.edu.mk)

ABSTRAKT

Siguria e të dhënave luan një rol kritik në industrinë financiare, ku mbrojtja e të dhënave sensitive të klientëve dhe sistemeve financiare është e një rëndësie të madhe. Institucionet financiare përballen me kërcënime në rritje të karakterizuara nga sulme kibernetike gjithnjë e më të sofistikuar dhe shkelje të të dhënave. Ky studim shqyrton sfidat kryesore që kërcënojnë sigurinë e të dhënave në këto institucione dhe ofron një vështrim të detajuar mbi metodat dhe teknologjitë më të fundit për të adresuar këto sfida. Përmes analizës së praktikave më të mira dhe standarteve ndërkombëtare të sigurisë, studimi thekson rëndësinë e implementimit të kontroleve të avancuara të sigurisë, trajnimin e vazhdueshëm të stafit dhe përdorimin e teknologjive si enkriptimi, zbulimi i ndërhyrjeve dhe autentikimi multifaktor. Gjetjet e këtij studimi tregojnë se drejtuesit e institucioneve financiare mbrojnë sistemet e tyre të informacionit nga kërcënimet kibernetike duke menaxhuar në mënyrë efektive praktikatat e sigurisë së informacionit; zhvillimi i politikave të fuqishme të sigurisë kibernetike; identifikimin, vlerësimin dhe zbutjen e rreziqeve të sigurisë kibernetike. Mbrojtja e sistemeve të informacionit përmes reduktimit të kërcënimeve kibernetike mund të përmirësojë praktikatat e biznesit organizativ. Drejtuesit e institucioneve financiare mund të përdorin gjetjet e këtij studimi për të ndikuar në ndryshimet pozitive sociale duke ulur shkeljet e të dhënave, duke ruajtur informacionin konfidencial të konsumatorëve dhe duke reduktuar rreziqet dhe kostot e vjedhjes së të dhënave.

Fjalët kyce: *siguria e të dhënave, krim kibernetik, sulme, mbrojtja e të dhënave, institucionet financiare bankare*

Hyrje

Cyber: Sfera e sistemeve të rrjeteve kompjuterike nën autoritetin e vendeve dhe organizatave .

Sulmi kibernetik: Sulmet me qëllim të keq që konsistojnë në çaktivizimin e pajisjeve dhe rrjeteve kompjuterike, duke rezultuar në humbjen e të dhënave .

Krimi kibernetik: Krimet që përfshijnë pajisje kompjuterike, softuer dhe pajisje të tjera teknologjike për qëllime të paligjshme, të tilla si mashtrimi, vjedhja, sabotimi i automatizuar, shkelja e privilegjeve të pronave intelektuale dhe vjedhja e sistemeve dhe rrjeteve kryesore .

Siguria kibernetike: Mjetet, politikat, modelet e sigurisë, masat paraprake të sigurisë, strategjitë, taktikat e menaxhimit të rrezikut, aktivitetet, përgatitjet, praktikat më të mira, garancitë dhe teknologjitë e përdorura për të mbrojtur atmosferën kibernetike, institutet dhe të dhënat e përdoruesve .

Shkelja e të dhënave: Një shkelje e të dhënave është një shkarkim i qëllimshëm ose i pamenduar i të dhënave të mbrojtura ose private në një vend të pabesueshëm .

Hyrje Në epokën dixhitale të sotme, siguria e të dhënave ka marrë një rëndësi të jashtëzakonshme, veçanërisht për institucionet financiare që mbajnë dhe menaxhojnë sasi të mëdha të dhënash sensitive dhe konfidenciale. Ky informacion përfshin detaje personale të klientëve, transaksionet financiare, strategjitë e investimeve dhe të dhëna të tjera të ndjeshme që janë thelbësore për funksionimin e institucioneve si dhe për besimin e klientëve në sistemin financiar. Për shkak të natyrës së ndjeshme të këtyre të dhënave, institucionet financiare janë një objektivi i vazhdueshëm për sulmet kibernetike dhe aktivitete të tjera keqdashëse.

Siguria kibernetike është problemi kryesor për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia dhe natyra e industrisë. Edhe pse çdo industri është e kërcënuar nga sulmet kibernetike, sektori financiar, sidomos ai bankar, është më i ndjeshëm ndaj sulmeve të sigurisë për shkak të sensitivitetit të të dhënave që përpunon. Kërcënimet e sigurisë kibernetike ndaj institucioneve bankare rezultojnë në humbje të ndryshme, të cilat përbëjnë një ndikim serioz në stabilitetin ekonomik të tyre, humbjen e besimit të klientëve nga vjedhja e të dhënave dhe ndër të tjera kërcënim për reputacionin e bankës. Ato janë të formave të ndryshme, të jashtme ose të brendshme, në formën e punonjësve të pakujdesshëm, nga mungesa e

protokolleve të sigurisë ose firewalls, etj. Pasojat e shkeljeve të të dhënave në institucionet financiare mund të jenë të rënda. Ato jo vetëm që çojnë në humbje financiare, por gjithashtu humbin besimin e klientëve, dëmtojnë reputacionin e institucionit dhe madje mund të rezultojnë në pasoja ligjore dhe rregullatore. Prandaj, institucionet financiare duhet të investojnë në mënyrë proaktive në strategji gjithëpërfshirëse të sigurisë së të dhënave për të zbutur rreziqet dhe për të siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit sensitiv.

Elementet e Sigurisë së Informacionit

Procesi i menaxhimit të rrezikut nuk mund të kuptohet drejt përderisa nuk i është dhënë kahje e duhur trajtimit të sigurisë së informacionit. Në çdo organizatë, kompani apo institucion në përgjithësi në çdo entitet të çfarëdo madhësie ku ka sisteme të informacionit, menaxhimi i rrezikut të sigurisë së informacionit nuk mund të funksionojë si proces pa u kuptuar dhe trajtuar drejt siguria e informacionit. Menaxhimi i rrezikut të sigurisë së informacionit është një proces gjithëpërfshirës që në shikim të parë është proces burokratik me shumë hapa dhe faktor që duhet përcjelle. Prandaj, menaxhimi i rrezikut të sigurisë së informacionit duhet të kuptohet si një proces ku e tërë organizata apo kompania e ka të integruar një trajtësisht menaxhimin e rrezikut në proceset e menaxhimit të kompanisë; e jo vetëm për personelin e dedikuar që mirët me sistemet e informacionit apo edhe me sigurinë. Kështu që ekzistojnë disa parakushte që një kompani, organizatë apo institucion ta trajtojë informacionin si një aset të vlefshëm dhe që për rëndësinë që ka dedikon kohe, asete dhe e trajton siç duhet.

Disa nga elementet kryesore të sigurisë së të dhënave në institucionet financiare janë:

Vlerësimi i rrezikut

Institucionet financiare duhet të kryejnë vlerësime të rregullta të rrezikut për të identifikuar dobësitë e mundshme, për të vlerësuar kërcënimet dhe për të përcaktuar ndikimin e mundshëm të një shkeljeje të të dhënave. Ky vlerësim ndihmon në priorizimin e masave të sigurisë dhe shpërndarjen e burimeve në mënyrë efektive.

Kontrolli i aksesit

Kontrolli i aksesit në të dhëna sensitive është thelbësor në parandalimin e hyrjes së individëve të paautorizuar. Institucionet financiare duhet të zbatojnë masa të forta të kontrollit të aksesit, siç janë kontrollet e aksesit të bazuara në role, vërtetimi me shumë faktorë dhe administrimi i aksesit

të privilegjuar për të siguruar që vetëm personeli i autorizuar mund të ketë akses në informacione sensitive.

Ndërgjegjësimi dhe trajnimi i punonjësve

Institucionet financiare duhet t'i japin përparësi programeve të ndërgjegjësimit dhe trajnimit të punonjësve për të edukuar stafin për praktikën më të mirë të sigurisë së të dhënave, rëndësinë e mbrojtjes së informacionit të ndjeshëm dhe si të identifikohen dhe të përgjigjen ndaj kërcënimeve të mundshme të sigurisë, si sulmet.

Problematikat kryesore të sigurisë së të dhënave në Institucionet Financiare

Disa nga problematikat kryesore të sigurisë së të dhënave në Institucionet Financiare janë:

Kërcënimet e sigurisë kibernetike

Institucionet financiare janë objektivat kryesore për kriminelët kibernetikë për shkak të të dhënave të vlefshme që ata posedojnë. Hakerët përdorin teknika të sofistikuar për të shfrytëzuar dobësitë në sisteme, rrjete dhe aplikacione, duke çuar në shkelje të të dhënave dhe mashtrim financiar. Zbutja e kërcënimeve të sigurisë kibernetike është me rëndësi të madhe.

Pajtueshmëria rregullatore

Institucionet financiare u nënshtrohen kërkesave të rrepta rregullatore dhe kornizave të pajtueshmërisë për të mbrojtur të dhënat e klientëve. Pajtueshmëria me rregullore të tilla si Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR), Standardi i Sigurisë së të Dhënave të Industrisë së Kartës së Pagesave (PCI DSS) dhe të tjera paraqesin sfida të rëndësishme për sa i përket zbatimit, dokumentacionit dhe respektimit të vazhdueshëm.

Kërcënimet e brendshme

Shkeljet e të dhënave mund të vijnë edhe nga brenda institucioneve financiare. Kërcënimet e brendshme mund të lindin për shkak të qëllimit

keqdashës, neglizhencës ose veprimeve të paqëllimshme të punonjësve. Identifikimi dhe adresimi i kërcënimeve të brendshme përmes monitorimit efektiv dhe masave të kontrollit të aksesit është thelbësor.

Rreziku i palëve të treta

Institucionet financiare shpesh mbështeten te shitësit dhe ofruesit e shërbimeve të palëve të treta për funksione të ndryshme, të tilla si ruajtja në renë kompjuterike (cloud), përpunimi i pagesave dhe analitika e të dhënave. Megjithatë, këto marrëdhënie sjellin rreziqe shtesë, pasi masat e sigurisë të palëve të treta mund të mos përputhen me standardet e institucionit. Sigurimi i kujdesit të duhur, menaxhimi i kontratave dhe monitorimi i palëve të treta është thelbësor.

Reagimi dhe rikuperimi i incidentit

Pavarësisht masave parandaluese, institucionet financiare duhet të përgatiten për incidente të sigurisë. Të kesh një plan të mirëpërcaktuar reagimi ndaj incidentit, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e qarta, kanalet efektive të komunikimit dhe strategjitë rezervë dhe rikuperimi, është thelbësore për të minimizuar ndikimin e shkeljeve të sigurisë.

NEVOJA PËR CYBERSECURITY

Çfarë është Cybersecurity?

Siguria kibernetike i referohet praktikës së mbrojtjes së sistemeve kompjuterike, rrjetave, programeve dhe të dhënave nga sulmet dixhitale, aksesi i paautorizuar dhe dëmtimi ose vjedhja e informacionit. Ajo përfshin zbatimin e masave dhe teknologjive për të siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e aseteve dixhitale.

Në botën moderne të ndërlidhur, ku individët, organizatat dhe qeveritë mbështeten shumë në teknologjitë dixhitale, siguria kibernetike luan një rol vendimtar në ruajtjen e informacionit sensitiv dhe funksionimin e infrastrukturës. Ajo përfshin një gamë të gjerë praktikash, strategjish dhe teknologjish për të luftuar kërcënimet kibernetike dhe për të zbutur rreziqet.

Siguria Kibernetike është një tentim i vazhdueshëm për mbrojtjen e sistemeve dhe të gjitha informacioneve, nga përdorimi i paautorizuar apo përdorimi i dëmshëm i tyre. Në një nivel personal, çdo njeri duhet të mbron identitetin e tij, të dhënat, si dhe pajisjet teknologjike. Në një

nivel korporatash, mbrojtja e reputacionit, të dhënave dhe konsumatorëve të organizatës, është përgjegjësi e të gjithë pjesëmarrësve në atë organizatë. Në nivel shteti, siguria nacionale, siguria e qytetarëve, si dhe mirëqenia e tyre janë në rrezik.

Rreziqet në sigurinë kibernetike në sektorin financiar

Incidentet e sigurisë kibernetike që prekin firmat financiare, paraqesin rreziqe specifike në financim dhe likuiditet.

Më poshtë listohen katër "kanalet" nga të cilat këto rreziqe transmetohen, duke çuar në kriza sistemike.

1. Mungesa e zëvendësueshmërisë (financiare):

Sistemi financiar varet nga disa qendra kryesore, zakonisht firma ose shërbime të caktuara (p.sh. sisteme elektronike tregtare, shkëmbime), që kryejnë një funksion jetësor për të gjithë industrinë. Shembuj të këtyre funksioneve përfshijnë ruajtjen e letrave me vlerë, menaxhimin e kolateralit, konfirmimin dhe kryerjen e tregtisë, të cilat janë të gjitha procese të automatizuara me anë të teknologjisë.

2. Humbja e besimit

Sulmet në mënyrë të përsëritur ndikojnë tek konsumatorët pasi një "vjedhje me shtrirje më të gjerë mund të shkaktojë një humbje më të madhe të besimit". Humbja e besimit nuk mund të vijë vetëm nga vjedhja e të dhënave të një konsumatori, por nga një sërë sulmesh si sulme ndaj makinave ATM të cilat janë bërë të shpeshta kohët e fundit, dërgimi i emaileve kompromentuese (scam) nga bankierët ose shpërndarja e llogarive. Humbja e besimit të konsumatorëve ndikon tek biznesi i subjekteve financiare.

3. Integriteti i të Dhënave

Cilësia e të dhënave të konsumatorit të ruajtura në sistemet financiare mund të korruptohen nga ndërhyrjet kibernetike, duke bërë që sistemi të ndërpresë punën derisa të rikthehen të dhënat e ruajtura në backup, por kjo do të bente që konsumatorët të humbisnin besimin.

4. Mungesa e Zëvendësueshmërisë (TIK)

Sektori i financave varet nga sistemet dhe infrastruktura TIK. Pjesa më e madhe e ofruesve të shërbimeve cloud (korporata të IT) operojnë me të njëjtat

sisteme operative dhe aplikacione dhe varen nga të njëjtat protokolle themelore të Internetit, si TCP / IP ose DNS.

Ndaj nëse ndodh një ndërprerje lokale si pasojë e sulmit kibernetik do të ndërpriten shërbime financiare të një rajoni ose të disa industrive.

Risqet e sigurisë kibernetike në institucionet financiare

Risqet e sigurisë kibernetike në institucionet financiare janë të rëndësishme dhe mund të kenë pasojë serioze për të gjithë sektorin financiar dhe për konsumatorët. Në kohën e sotme, institucionet financiare operojnë në një mjedis gjithnjë e më të digitalizuar dhe të lidhur në internet, duke bërë që ata të jenë më të ekspozuar ndaj sulmeve kibernetike.

Risqet kryesore kibernetike që mund të ndikojnë në institucionet financiare janë:

Sulmet e hakerëve

Kriminelët kibernetikë mund të sulmojnë sistemet e institucioneve financiare për të vjedhur informacione të ndjeshme si të dhënat e klientëve, të dhëna të llogarive bankare, ose të hyjnë në infrastrukturën e tyre për të kryer aktivitete të dyshimta financiare.

Mashtrimi online

Institucionet financiare mund të përballen me sulme të cilat përpiqen të marrin informacione të identifikimit nga klientët. Këto sulme mund të jenë në formën e email-ave të rremë, faqeve të rreme të internetit, ose aplikacioneve .

Keqinformimi dhe dezinformimi

Nëpërmjet sulmeve të avancuara të kibernetikës, kundërshtarët mund të përhapin informacion të rremë për institucionet financiare, që mund të shkaktojnë humbje financiare të rëndësishme dhe goditje për reputacionin.

Shkatërrimi i infrastrukturës

Sulmet kibernetike mund të synojnë shkatërrimin e sistemeve të institucioneve financiare duke bllokuar ose përjashtuar ato nga funksionimi normal, duke shkaktuar ndërprerje të shërbimeve dhe humbje të mëdha financiare.

Parandalimi i paautorizuar

Sulmet kibernetike mund të bllokojnë ndërfaqen e aplikacioneve të institucioneve financiare ose të manipulojnë kodin e programit për të shfrytëzuar në mënyrë të paligjshme ndërfaqet dhe të hyjnë në sisteme të brendshme.

Për të minimizuar këto risqe, institucionet financiare duhet të ndjekin praktikat e sigurisë kibernetike të avancuara, të investojnë në mjete dhe teknologji të sigurisë, të krijojnë vetëdije dhe trajnim për personelin, dhe të kenë strategji të përshtatshme për përgjigjen ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike. Ndër institucioneve financiare është gjithashtu e rëndësishme të ketë bashkëpunim dhe ndarje të informacionit në mes tyre për të identifikuar dhe ndaluar sulmet kibernetike në nivel sektori.

SI TË NDËRTOHET NJË STRATEGJI E SIGURISË KIBERNETIKE

Njeriu është gjithmonë elementi më i dobët në çdo program të sigurisë kibernetike. Të gjitha kompanitë do të përjetojnë një lloj sulmi kibernetik, edhe nëse ekzistojnë kontrole të forta. Një sulmues do të shfrytëzojë gjithmonë lidhjen më të dobët dhe shumë sulme janë lehtësisht të parandalueshme duke kryer detyrat themelore të sigurisë, ndonjëherë të referuara si "higjiena kibernetike" (Hastings). Po ashtu, një ndërmarrje ka për detyrë të kryejë elementet bazë të kujdesit për sigurinë kibernetike të tilla si ruajtja e praktikave të forta të autentifikimit dhe mos ruajtja e të dhënave të ndjeshme aty ku është e hapur.

Llojet e sigurisë kibernetike

Qëllimi i sigurisë kibernetike është i gjerë. Fushat kryesore janë përshkruar më poshtë dhe çdo strategji e mirë e sigurisë kibernetike duhet t'i marrë të gjitha në konsideratë.

Siguria kibernetike mund të kategorizohet në lloje ose fusha të ndryshme, ku secila trajton aspekte specifike të mbrojtjes së sistemeve kompjuterike, rrjeteve dhe të dhënave nga aksesi, sulmet dhe shkeljet e paautorizuara. Këtu janë disa lloje të zakonshme të sigurisë kibernetike: Siguria e rrjetit Siguria e rrjetit fokusohet në mbrojtjen e rrjeteve kompjuterike nga aksesi, sulmet dhe ndërprerjet e paautorizuara. Ai përfshin zbatimin e firewall-eve, sistemeve të zbulimit të ndërhyrjeve (IDS), rrjeteve private virtuale (VPN) dhe teknologjive të tjera për të

siguruar infrastrukturën e rrjetit. Siguria e aplikacionit Siguria e aplikacionit i referohet masave të marra për të mbrojtur aplikacionet softuerike nga dobësitë dhe sulmet. Kjo përfshin praktikat e sigurta të kodimit, testimin e rregullt të aplikacioneve dhe zbatimin e kontrolleve të sigurisë si vërtetimi, kontrollet e aksesit dhe kriptimi. Siguria e informacionit Siguria e informacionit përfshin mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm dhe të vlefshëm nga aksesit, zbulimi, modifikimi ose shkatërrimi i paautorizuar. Ai përfshin zbatimin e politikave, procedurave dhe teknologjive për të mbrojtur konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave. Siguria në renë kompjuterike (cloud) Siguria në renë kompjuterike përqendrohet në sigurimin e të dhënave, aplikacioneve dhe infrastrukturës në mjediset kompjuterike cloud. Ajo përfshin mbrojtjen e burimeve cloud nga aksesit i paautorizuar, shkeljet e të dhënave dhe sigurimin e pajtueshmërisë me rregulloret e privatësisë së të dhënave. Siguria në pikat fundore Siguria në pikat fundore përfshin mbrojtjen e pajisjeve individuale kompjuterike si laptopët, desktopët dhe pajisjet celulare nga malware, aksesit i paautorizuar dhe shkeljet e të dhënave. Kjo përfshin zbatimin e softuerit antivirus, enkriptimin e pikës fundore dhe zbatimin e politikave të menaxhimit të pajisjes. Siguria e të dhënave

Siguria e të dhënave ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave gjatë gjithë ciklit jetësor, duke përfshirë ruajtjen, transmetimin dhe përpunimin. Ai përfshin klasifikimin e të dhënave, enkriptimin, kontrollet e aksesit dhe masat parandaluese të humbjes së të dhënave për të siguruar konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Siguria Operacionale Siguria operationale fokusohet në mbrojtjen e operacioneve të përditshme të sistemeve dhe infrastrukturës së IT të një organizate. Kjo përfshin zbatimin e kontrolleve të sigurisë, sistemet e monitorimit për anomali, kryerjen e trajnimeve për ndërgjegjësimin e sigurisë dhe menaxhimin e incidenteve. Rikuperimi i të dhënave nga fatkeqësitë Këto përfshijnë planifikimin dhe zbatimin e strategjive për të rikuperuar dhe vazhduar operacionet pas një incidenti të sigurisë kibernetike ose ndonjë ngjarje tjetër. Ajo përfshin rezervimin dhe restaurimin e të dhënave, sistemet e tepërta dhe planifikimin e reagimit ndaj incidentit. Inxhinieria Sociale Inxhinieria sociale i referohet teknikave të manipulimit psikologjik të përdorura nga sulmuesit për të mashtruar individët dhe për të fituar akses të paautorizuar në sisteme ose informacione të ndjeshme. Kjo përfshin taktika si phishing, pretext dhe imitim. Siguria e Internet of Things (IoT) Siguria e IoT merret me sigurimin e pajisjeve, sensorëve dhe sistemeve të lidhura në ekosistemin e Internetit të Gjërave. Ajo përfshin mbrojtjen

e pajisjeve IoT nga aksesi i paautorizuar, sigurimin e privatësisë së të dhënave dhe parandalimin e sulmeve të bazuara në IoT.

Qëllimi i strategjisë së mbrojtjes kibernetike

Qëllimi i Strategjisë së Mbrojtjes Kibernetike është mbajtja e një hapësire kibernetike të besueshme e të sigurt brenda një vendi në aspekt të TI-së. Zbatimi i Strategjisë së Mbrojtjes Kibernetike mbështetet në parimet bazë të mëposhtme: - Zhvillimi: Nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm dhe sistematik të aftësive, teknologjisë së komunikimit dhe informacionit dhe të masave të sigurisë është e mundur të mbrohem kundër kërcënimeve kibernetike; - Përgjegjësisë: Pakësimi i rreziqeve është i mundur vetëm nëse të gjitha strukturat dhe personeli i sigurisë kibernetike, janë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për pasojat që rrjedhin nga veprimi ose mosveprimi i tyre në pjesën për sigurinë që u përket atyre dhe në sigurinë e të tjerëve. - Bashkëpunimi: Mbrojtja efektive kundër kërcënimeve në hapësirën kibernetike, e pakufizuar nga ndarje administrative me institucione ose struktura të tjera të shtetit, është e mundur vetëm nëpërmjet bashkëpunimit në nivel kombëtar e ndërkombëtar. - Ligji dhe standardet: Mbrojtja kibernetike efektive realizohet nëpërmjet zbatimit rigoroz të përcaktimeve ligjore, politikave, standardeve dhe udhëzimeve përkatëse. - Kapacitetet: Realizimi i mbrojtjes kibernetike efektive arrihet duke pasur burimet e nevojshme njerëzore dhe ato të teknologjisë përkatëse. - Strategjitë: Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjia Ushtarake i vlerësojnë sulmet kibernetike si kërcënime, rreziqe dhe sfida jokonvencionale.

Masat e sigurisë Masat e sigurisë përfshijnë tërësinë e veprimeve, me qëllim rritjen e sigurisë së informacionit në sistemet e informacionit dhe disponueshmërisë e besueshmërinë e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimit në hapësirën kibernetike Masat në rast kërcënimi ose incidenti kibernetik janë: ➤ Paralajmërimet; ➤ Kundërmasat; ➤ Masat mbrojtëse; Kërcënimi ose incidenti kibernetikë, nënkuptohen veprimet e nevojshme me qëllim mbrojtjen e sistemeve të informacionit apo rrjeteve të komunikimit elektronik, ose veprimet me qëllim zgjidhjen e një incidenti të konstatuar të sigurisë kibernetike.

STRATEGJITË E MBROJTJES SË TË DHËNAVE NË INSTITUCIONET FINANCIARE

Ditët e sotme kriminaliteti është kthyer në një problem tejet shqetësues për shoqërinë, por me kalimin e kohës dhe periudhave të ndryshme, janë bërë përmirësime në trajtimin e tij. Kriminaliteti është një dukuri negative dhe e rrezikshme, ku për të cilin gjithnjë kemi në luftë për ta parandaluar.

Krim nuk kryejnë vetëm personat madhor, por edhe të miturit. Pamvarsisht nga shkalla e rrezikshmërisë së një veprë penale, gjithmonë të miturit janë dënuar në formë më të butë në krahasim me personat madhor. Një tjetër shqetësim është se numri i veprave penale të kryer nga të miturit është gjithnjë në rritje. Ndaj si institucionet ashtu dhe shoqëria, i ka kushtuar një kujdes dhe vëmendje të theksuar sjelljeve të të miturve.

Faktorët që ndikojnë që këta të mitur të kryejnë një veprë penale, janë të shumtë dhe të ndryshëm në natyrë, ndaj gjithnjë kriminologjia është marrë me studimin e këtyre faktorëve me qëllim që këta të mitur të mos ndikohen prej tyre. Ndersa sistemi i drejtësisë ka krijuar masa më të buta për vuajtjen e dënimit të këtyrë të miturve, duke krijuar ligje më të buta por edhe institucione enkas për ta, me qëllim që të rehabilitohen edhe të edukohen.

Përgjatë këtij studimi do të vihen re faktorët, analizën e tyre si dhe trajtimi juridiko-penal i të miturve në Republikën e Shqipërisë.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Për realizimin e këtij punimi janë përdorur dy metoda:

Metodë analizuuese e faktoreve ndikues. Perzgjedhja e literaturës që mund të ishte e vlefshme për këtë studim, ku duke marrë informacione nga botime të ndryshme, kam arritur të analizoj këto faktor si dhe të dal në një përfundim.

Metoda statistikore. Janë kërkuar informacione statistikore në 12 Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit, në lidhje me numrin e të miturve që kanë kryer vepra penale gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Me pas këto statistika janë analizuar dhe krahasuar mes viteve por edhe mes qarqeve.

1. KUPTIMI I NOCIONIT DELIKUENCA E TË MITURVE

Nocionin “i mitur” e kemi hasur shpeshë here, si në literature të ndryshme, dokumentar, në përditshmëri etj, Me fjalën “i mitur” ne kuptojmë një person i cili nuk ka arritur akoma moshën e pjekurisë, pra një fëmijë. Këtë nocion do ta ezaurojmë në konceptin kriminologjik, ku i mitur konsiderohet cdo person që nuk ka mbushur moshën 18 vjec.

Ndërsa me nocionin “delikuencë” kuptojmë përgjithësisht shprehjet, sjelljet dhe veprimet e përsëritura të të miturve që bien ndesh me moralin, zakonet dhe ligjet e mjedisit ku jetojnë. Nga ana historike, delikuenca e të miturve është e vjetër sa edhe vetë njeriu dhe shoqëria. Delikuent quhet ai që ka sjellje të përsëritura devijuese, që kryen vepra penale, duke shkelur kështu normat ligjore në fuqi.¹

Pra konkretisht me Delikuenc të të miturve kuptojmë të gjitha sjelljet e të rinjve që nuk janë në pajtim me normat e shkruara dhe të pashkruara të sjelljeve shoqërore.² Këta të mitur që kanë kryer këto sjellje, janë persona të moshës 14 – 18 vjecë, por në fakt kjo sjellje nuk nis që në këtë mosh. Ka studime që tregojnë se të miturit e krijojnë sjelljen e tyre asocial që në moshën e pubertetit, pra 11 – 14 vjec. Kryesisht sjellja asocial që këta të mitur krijojnë, ka të bëjë me mosdurimin, sharje, ofendime, mosbindje etj.³ Këto sjellje mund të jenë zanafilla e një sjellje delikuede e cila mund të arrijë deri në kryerjen e një veprë penale të rëndë.

Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar. Delikuenca gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë. Me nocionin kryes i veprës penale nënkuptojmë kryerësit e mitur të veprave penale qofshin ata si kryerës, bashkë kryerës, nxitës apo ndihmës.⁴

¹[https://sq.wikipedia.org/wiki/Delikuenca#:~:text=Termi%20Delikuenc%C3%AB\(Devijim\)%20rrjedh%20nga,ligjet%20e%20mjedisit%20ku%20jetojn%C3%AB](https://sq.wikipedia.org/wiki/Delikuenca#:~:text=Termi%20Delikuenc%C3%AB(Devijim)%20rrjedh%20nga,ligjet%20e%20mjedisit%20ku%20jetojn%C3%AB).

² Prof. Dr. Vesel Latifi, Kriminialistika e delikuencaes se te miturve, Prishtine 1984

³ Shih po aty

⁴ Lindona Salihu, Sanksionet penale ndaj te miturve, Prishtine 2010

2. TRAJTIMI JURIDIKO-PENAL I TË MITURVE

Veprat penale nuk kryhen vetëm nga të rriturit, por edhe nga persona të mitur. Rëndësia dhe shkaqet e veprës, në të dyja rastet janë të njëjta, por ajo cka ndryshon është trajtimi penal i autorit. Të miturit kanë një kod penal të vecantë, i cili parasheh të gjitha sanksionet dhe dispozitat përkatëse. Në Republikën e Shqipërisë ai njihet si Ligji Nr. 37/2017 KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR dhe përmban 143 Nene.

Kodi Penal për të mitur thotë se i mitur është cdo person nën moshën 18 vjec, Por mosha minimale e përgjegjësisë penale është 14 vjec kur një i mitur kryen një krim dhe 16 vjec kur kryen një kundërvajtje penale.⁵ Pra në vendin tonë një i mitur nis të ketë përgjegjësi penale që në moshën 14 vjecë, por trajtohet me masa të ndryshme nga ato të personave madhor, kur në momentin që ka kryer veprën penale, nuk ka qenë më shumë se 18 vjec. Ndërsa personat që janë nën moshën 14 vjecë, konsiderohen fëmijë dhe janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale.

Së pari kategorizimi i të miturve mes moshës së tyre ndikon edhe të përcaktimi i dënimit. Pra nga 14 – 16 vjec zakonisht të miturit i shqiptohen vetëm masat, të cilat kanë një tjetër kategorizim. Ndërsa 16 – 18 vjec një të mituri i shqiptohet edhe dënimi më burgim i cili konsiderohet si masa më e rëndë e aplikuar të një i mitur.

Në Republikën e Shqipërisë, dënimi me burgim tek të miturit shqiptohet kur vepra penale e kryer nga i mituri, parashikon minimum 7 vite burgim. Pra në këtë rast i mituri mund të dënohet me burgim sa gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale, por jo më shumë se 12 vjetë.⁶ Pran je i mitur nuk mund të dënohet më shumë se 12 vjetë burg, në çfaredo lloj veprën penale që të ketë kryer.

Një i mitur mund të lirohet me kusht në rastet kur ai ka kryer jo më pak se 1/3 e dënimit me burgim në rast se është dënuar deri në 3 vjet. Në rastet kur ka kryer jo më pak se 1/2 e dënimit me burg në rast se është dënuar deri në 8 vjet dhe jo më pak se 2/3 e dënimit në rast se është dënuar me mbi 8 vite burgim.⁷

⁵ Ligji Nr. 37/2017 KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

⁶ Po aty

⁷ Po aty

3. KRIMET KUNDËR JETËS TË KRYERA NGA TË MITURIT

Në botën bashkëkohore vërehet një shtim i madh i të gjitha sjelljeve kriminale që manifestohen me aplikimin e agresivitetit dhe dhunës ndaj individit. Të dhënat tregojnë që kriminaliteti po shtohet dhe kjo gjë po shkakton brengosje te vendet ku po paraqitet. Krimet e kryera prej të miturve janë të njëjta me ato që kanë kryer dhe personat madhor. Janë krime të tipit: vrasje, plagosje, dhunë në familje, vjedhje, përdorim dhe shitje të lëndëve narkotike etj.

3.1 Vrasjet

Krimet e vrasjes në shkencën juridiko-penale dhe atë kriminologjike, cilësohen si një ndër format më të rënda të atakimit të vlerave dhe të mirave të njëriut, pra individit humbet jetën ndërsa autori lirin.⁸

Vrasja në Kodin Penal është e cilësuar si privimi i jetës nga një person tjetër, ai që e privon një individ, dënohet me burgim. Kjo gjë vlen dhe për të miturit ku shpeshherë në këtë lloj veprë penale, është shqiptuar dënimi me burgim. Vrasja është një veprë penale që kryhet rrallë prej të miturve, zakonisht kur ata janë përfshirë në një konflikt të momentit, çështje hakmarrje etj.

3.2 Plagosjet

Plagosjet përfshihen te grupi i veprave penale kundër jetës dhe trupit. Plagosjet mund të vijnë si pasojë e dhunës fizike apo seksuale, por ka dhe raste kur plagosjet janë kryer aksidentalisht. Shpeshherë tendeca që një i mitur gjatë një konflikti të plagosë dike është e lartë pasi mund të jetë i pajisur me armet ë ftohtë si të tipit doreza, thikë etj. Gjithashtu edhe plagosja në Kodin Penale dënohet me burgim në rastet kur është plagosje e rëndë apo plagosje me pasojë vdekjen.

Në rastet më të këqija, shkak i një plagosje mund të pasoj më vonë me një hakmarrje, ku mund të kemi serisht plagosje por edhe vrasje. Shkaqet që këta të mitur kryejnë vepra penale të rënda janë nga më të ndryshmet, por në rastin e plagosjes atom und të vijnë dhe si pasojë e konflikteve banale, pasionet seksuale etj.

⁸ Prof. Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtin 2000, faqe 164

3.3 Vjedhjet

Vjedhja është një nga veprat penale kryesore të drejtuara kundër pasurisë së personave dhe ka ekzistuar që kohë më parë dhe vazhdonë të jetë e përhapur kudo. Me vjedhje nënkuptojmë marrjen e një sendi të huaj me qëllim përvetësimin e tij.⁹ Vjedhja është një nga format e kriminalitetit më të përhapura tek të miturit. Për arsye nga më të ndryshmet ata ndërmarrin hapin për të kryer një vjedhje. Shpeshë herë ata vjedhin dyqane apo markete të vogla, për të marr para ose ushqime, pra një factor i vjedhjes është dhe gjëndja e vështirë ekonomike.

3.4 Dhuna në familje

Familja si institucion shoqërore me funksione të shumëfishta ka si për qëllim zhvillimin dhe formimin e të miturve, por ndonjëherë dhe dështon. Dhuna në familje sot për sot është kthyer në një fenomen tromaktik dhe po haset pothuajse cdo dite, mes bashkëshortëve apo dhe prindi ndaj fëmijës.

Në këtë rast do të përqëndrohemi tek një ndër rastet e vecanta dhe të rralla por aspak të këndshme, dhuna në familje e ushtruar nga të miturit. Kjo lloj e dhunës shpesh haset tek marrëdhëniet familjare vëlla-motër, pra një i mitur ushtron dhunë apo kanosje ndaj vëllait ose motrës së tij. Por një rast i vecantë që është bërë dhe public në mendja ku një i mitur godet babain e tij me mjet prerës. Kjo lloj forme e dhunës mund të ketë disa faktor që e nxisin një të mitur të ndërmarrë këtë akt. Për këto factor ndikues, do të flasim detajisht më poshtë.

3.5 Dhuna seksuale

Kur të miturit arrijnë të hyjnë në moshën e pubertetit, ata fillojnë të zhvillojnë imagjinatën seksuale, e cila mund të arrij deri në dhunë seksuale ose përdhunim. Dhuna seksuale ndikon rëndë tek viktima por edhe tek familja e viktimës pasi cënon lirin dhe dinjitetin e tyre. Dhuna seksuale e kryer nga një i mitur është e parapare dhe në të drejtën penale por jo vetëm, interes për të kanë dhe fushat e tjera si kriminologjia, mjeksia, psikologjia. Të gjitha këto fusha kanë arsyetime të ndryshme rreth këtij fenomeni, por konkluzionë është i njëjtë, që dhuna seksuale shkakton pasoja të mëdha.

⁹ Prof. Dr. Vesel Latifi, Kriminalistika, Prishtinë 2006, faqe 317

4. SHKAQET E DELIKUENCËS SË TË MITURVE

4.1 Shkaqet ekonomike-sociale

Kushtet ekonomike luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një të mituri, ndaj dhe është një ndër faktorët ndikues më të shpeshtë që të miturit gabojnë. Krizat ekonomike janë trajtuar shumë herë me kujdes nga institucionet si një factor që krijon sjellje kriminale, qoftë tek të miturit por edhe tek të rriturit.¹⁰

Varfëria

Në vendet e zhvilluara industrial kemi një rritje permanente të standardit dhe një kualitet të lartë jetese, ndërsa në vendet e varfëra është e kundërta, kemi skamje, varfëri, kriminalitet. Nevoja për të patur një standard jetese minimal, krijon mendimin dhe ëndërrën me bazë kriminale, ku si pasoj individ i do të kryej vepër penale për ta realizuar.

Pra , njerzit në pamundësi të sigurimit të ekzistencë së tyre dhe familjes, janë dedikuar të veprojnë shpeshë në veprime që janë në kundërshtim me ligjin¹¹. Si rezultat i varfërisë është krijuar shtresa e ulët, por a janë vetëm të varfërit që kryejnë krime?

Pasuria

Më sipër folëm për të varfërit që kryejnë vepra penale dhe në fund shtruum pyetjen a janë vetëm të varfërit që kryejnë vepra penale, dhe në fakt Jo. Nuk janë vetëm të varfërit që kryejnë vepra penale por varfëria është vetëm një factor ndikues njëjt si dhe pasuria. Por si ndikon pasuria tek sjelljet delikuate të të miturve, Shpeshë herë kemi vën re që të miturit konsumojnë lëndë narkotike, frekuentojnë klubet e natës dhe konsumojnë alcohol, apo shëtisin me makina luksoze pa patur leje drejtimi. Prat ë gjitha këto janë në kundërshtim me rregullat por edhe me ligjin. Këto kundërvajtje penale vijnë si pasojë e të qenit i pasur, pasi mund ti konsiderojmë si “kundërvajtje të kushtueshmë”. Pasuria e familjes ka ndikuar në një formë të gabuar në zhvillimin e një të mituri.

¹⁰ Prof. Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtin 2005, faqe 248

¹¹ Lindona Salihu, Sanksionet penale për të mitur, Prishtin 2021

Papunësia

Papunësia mund të lidhet me varfërinë si factor, pasi dukë mos patur një punë, një familje arrin në varfëri. Shpeshë herë papunësia si factor ka ndikuar tek të miturit, të cilët me ndjenjën e heroizmit kanë këmbngulur me cdo kusht të sigurojnë të ardhura për të mbajtur familjen. Të ardhura këto që i nxjerrin në rrugë të gabuar, si psh duke shpërndarë lëndë narkotike, apo edhe duke vjedhur. Kemi raste kur prindërit kanë nxjerrë fëmijët për të lypur, në këtë rast në kundërshtim me ligjin janë prindërit, por pasojat negative bien mbi të miturin, pasi duke ushtruar atë punë ai nuk do mund të civilizohet apo edukohet dhe do të vazhdojë gjithnjë të lyp.

Migrimi / Emigrimi

Në bazë të kushteve të këqija ekonomike , familjet ndërmarrin hapin e vështir duke migruar brenda vendit në fshat - qytet apo edhe duke emigruar, për një jetë më të mirë. Në fakt kjo gjë ndikon negativisht tek një i mitur.

Migrimi i shpejtuar nga një zonë rurale në atë urbane i popullsisë, dhe papunësia në kohë reale për shkak të tejngopjes me fuqi puntore, sjell probleme të shumta sociale, kulturore dhe educative.¹²

Lëvizja e kësaj popullsie në vendet industrializura për një jetes më të mirë krijon probleme tek një i mitur, pasi nuk do mund të përshatet mënyrës së jetesës në atë zone. Shumë prej të miturve e përjetojnë rëndë këtë gjë, pasi për ta ka ndryshuar cdo gje, shoqëria, ambjenti, menyra e jetesës etj. Ka raste kur të miturit janë përballur edhe me bullizime kur kanë shkuar në një klasë të rë. Duke u nisur nga këto rrethana ata fillojnë të braktisin shkollën. Duke braktisur shkollën shancet që të kryejnë sjellje delikuede janë të larta, pasi shkolla shërben si një institucion zhvillimi edukativ.

4.2 Mjetet e komunikimit masiv

Mjetet e komunikimit masiv janë konsideruar si lehtësim i jetesës dhe si një evolucion teknologjik. Përvec të mirave që kanë këto mjete komunikimi, kanë edhe disa disavantazhe , që në këtë rast ndikojnë negativisht tek të miturit.

¹² Prof. Dr. Vesel Latifi, Kriminalistika e delikuencës së të miturve, Prishtinë 1982, faqe

Literatua

Kemi thënë që literature ka një ndikim pozitiv tek të miturit, sa më shumë të lexojnë aq më tepër zhvillohen mendërisht. Në fakt ka një përjashtim të kësaj ideje pasi ka libra me përmbajtje jo ideale, sit ë tipit romane erotic, romane me luftëra dhe vrasje, të cilat nxisin zhvillimin e imagjinatës kriminogjene tek një i mitur. Psiko-Kriminologjia ka treguar që një individ nuk lind kriminel, por bëhet gjatë jetës së tij. Ndaj janë këto “grimca ngacmuese” që zgjojnë frymën kriminale tek një individ.

Televizioni

Televizioni ditët e sotme ka ndikuar pozitivisht për shkak se infromon publikun e gjerë për cdo dukuri të ndodhur por në fakt ka ndikim negative tek të miturit. Zakonisht televizionet transmetojnë filma vizatimor, programe humori, lajme etj, por cdo ditë numri i stacioneve televiziv është duke u shtuar dhe selektimi i tyre për ti përshatur për një të mitur është pothuajse jo i mundur. Disa televizione transmetojnë skena të nxehta erotike por dhe dokumentare se si menaxhohen veprat kriminale. Të mitur mund të ndikohen nga këto, pa e ditur që është dicka e gabuar, dhe do duan ta provojnë.

Interneti

Ditët e sotme internet përvec të mirave të shumta që ka, është kthyer në një problematic kryesore, qoft për të miturit ashtu dhe për të rriturit. Në internet ka materiale të pafundme që një tek një i mitur do të ndikonin negativisht. Koheve të fundit është hapur dhe platëforma Tik-Tok, ku me anë të realizimit të videove dhe publikimit të tyre, qëllimi është arritja e një shikueshmërie të lartë. Duke publikuar çfarëdolloj video për qëllime financiare apo të tjera, përdoruesit nuk i elektojnë këto video të cilat mund të përmbajnë imazhe të ndaluara. Psh publikimi i një videojë ku shfaqet një person duke konsumuar lëndë narkotike, shfaq kuriozitet për ta provuar tek një i mitur, gjë e cila do të sillte efekt negative tek ai .

4.3 Rrethi Familjar dhe Kriminaliteti

Familja është mjedisi I parë ku një fëmijë mëson sjelljet e para në jetë, se si të flasësh apo si të sillet me veten e me të tjerët. Puna e familjes për ti dhënë një edukat fëmijës është shumë e madhe dhe e vështirë pasi duhet ti mësojë se çfarë është e duhur dhe çfarë është e gabuar, me qëllim që fëmija të mos gabojë. Nëse një familje nuk ia del mban me këtë detyr dhe rezulton e pasuksesshme, atëherë

fëmija në të ardhme mund të bëj gabime të cilat do të jenë në kundërshtim me ligjin.¹³

Familjet problematike

Sic folëm e më sipër, familja ka rëndësi të vecantë në formimin dhe edukimin e personalitetit të një të mituri. Në shumë raste rrethi familjar jep shumë ndikime negative, kjo gjë nuk është vetëm tek familjet e ndara dhe shkatërruara por dhe tek familjet e plotë, të cilat mund të kenë marrëdhënië jo të shëndosha.¹⁴

Problemet familjare mes bashkëshortëve apo dhe anëtarëve të tjerë, ndikojnë negativisht në një të mitur. Një i mitur ka tendencën që të mësojë prej atyre që e rrethojnë, pra ai mund të mësohet me atë sjellje agresive dhe do ta pasqyrojë tek të tjerët në të ardhmen por jo vetëm.

Familje ku konsumohet lëndë narkotike

Në familjet ku konsumohen drogëra të ndryshme, nuk ekzistojnë normat morale dhe ato shoqërore. Anëtarët e kësaj familje janë p[ërdorues të drograve, konsumojnë alcohol apo luajnë bixhoz, dhe nuk u intereson aspak edukimi I fëmijës. Sic kemi thënë fëmija mëson nga më i madhi, nga babai, nëna, vëllai etj. Duke parë se si këta veprojnë, në të njëjtën mënyrë do të veproi dhe ai. Do të jetë kureshtarë të provoi alkolin dhe më pas lëndët narkotike, deri në momentin që këto sjellje do ti kthehen në vese.

Pra mendimi im në këtë temë është se në një familje ku konsumohen këto lëndë të ndaluara, probabiliteti që një i mitur të veprojë njësojë sit ë rriturit, është shumë i lartë,

Gjithëashtu ekzistojnë dhe shumë faktorë të tjerë ndikues, si ato socio-patologjik ku perfshihet narkomania, alkoolizimi, ikja nga shtëpia, prostitucioni etj.

5. PARANDALIMI I DELIKUNCËS SË TË MITURVE

Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur ka paraparë disa masa të cilat janë parandaluese që një i mitur të përsëris veprën penale. Përvec denimit me privim nga liria apo dënimeve të tjera të rënda, janë vendosur disa masa më të lehta.

¹³ Lindona Salihu, Sanksionet penale për të mitur, Prishtin 2021

¹⁴ Dr. Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve në RMV, Tetovë 2010, faqe 93

Te tilla janë Masat alternative për shmangien nga ndjekja penale e një të miturit të cilat përfshijne:

Programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit.

Organi procedues vendos për zbatimin e kësaj mase në përputhje me legjislacionin për ndërmjetësim, me qëllimin që i mituri të ketë mundësi në të korigjojë pasojat e veprës penale që ka kryer. Normalisht ky program nis të zbatohet me pëlqimin e të miturit. Në këtë program përfshihet që i mituri ti kërkojë falje viktimës, të kompësojë dëmin e shkaktuar, të pranoi dhe kuptoi përgjegjësin për veprën penale dhe të pasojës ndaj viktimës.¹⁵ Duke ndërmarrë këto hapa , i mituri mund të arrij shmangien nga ndjekja penale.

Këshillimi për të miturin dhe familjen.

Ky lloj program konsiston në informimin e të miturit dhe familjes së tij në lidhje me veprën penale që ka kryer, rrezikshmërit dhe pasojat e shkaktuara prej saj. Kjo masë këshillimi jepet kur organi kompetent e konsideron të mjaftueshme dhe ne interes të të miturit, pra që do të ndikoi pozitivisht dhe nuk do ta përsërisë.

¹⁶

Paralajmërimi me gojë

Paralajmërimi me gojë përfshinë të gjitha shpjegimet që i jepen të miturit mbi dëmin e shkaktuar prej veprimit të tij dhe pasojat nëse do të përsërisë këto veprime. Ky shpjegim bëhet nga organet kompetente.

Paralajmërimi me shkrim

Paralajmërimi me shkrim përfshinë në një procesverbal të gjitha shpjegimet në lidhje me veprën penale të kryer, sipas nenit 65 të Kodit Penal për të Mitur, të Republikës së Shqipërisë. Si paralajmërimi me gojë ashtu dhe ai me shkrim, të dy përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë¹⁷

Masat detyruese

Ndaj një të mituri mund të shqiptohen këto masa detyruese, që ai të ndalohet:

¹⁵ Ligji Nr. 37/2017 KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

¹⁶ Po aty

¹⁷ Po aty

Të takojë një person të caktuar

Të vizitojë një vend të caktuar

Të largohet nga shtëpia gjatë periudhës së caktuar apo si dhe

Të kryej veprime që pengojnë rehabilitimin e tij

Masa të tjera detyruese janë që ai :

Të vazhdoi të ndjek procesin mësimor në institucionet arsimore

Të fillojë punë, sipas ligjeve të Kodit të Punës

Të përmbush detyrime të tjera që do të ndikojnë në risocializimin e tij. ¹⁸

Të gjitha këto masa shqipëtohen nga gjykata ose prokurori, duke u bazuar tek vepra penale që i mituri ka kryer. Nëse vepra penale që ai ka kryer nuk ka rrezikshmëri të lartë në shoqëri atëherë do ti shqiptohen këto masa. Me shqiptimin e masave, i mitur është i detyruar ti zbatoi ato, më qëllim verifikim e procesit të zbatimitit të tyre, ngarkohet me këtë detyr Shërbimi i Provës. i cili raporton me shkrim Prokurorin nëse i mituri e ka zbatuar asën e dhënë apo jo.

6. LLOJET E DËNIMIT PËR TË MITUR

Sipas Kodit Penal për të Mitur dënimet për të miturit ndahen në dënimet jo me burgim dhe dënimi me burgim. Në dënimet jo me burgim përfshihen:

- kufizimi i lirisë; Kufizimi i lirisë është vendosja e të miturit në një institucion/qendër të caktuar nën mbikëqyrje pa u izoluar nga shoqëria dhe komuniteti, me qëllim edukimin dhe rehabilitimin përmes programeve të posaçme. Në këto mjedise niveli i masave të sigurisë është i ulët dhe numri i të miturve të vendosur në to është sa më i vogël, me qëllim që të mundësohet trajtimi individual i tyre;

- qëndrimi në shtëpi; Qëndrimi në shtëpi parashikon detyrimin e të miturit të mos largohet, për një periudhë të caktuar nga shtëpia . Qëndrimi në shtëpi mund

¹⁸ Ligji Nr. 37/2017 KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

të jepet për një periudh nga 6 muaj deri në 1 vit dhe zbatohet në rastin e veprave penale që dënohen jo më shumë se me 5 vjet burgim¹⁹

- gjoba; Masa e gjobës mund të zbatohet për një të mitur nëse ka të ardhura monetare nga një burim I ligjshëm. Në rastet kur gjoba i vendoset një të mituri, masa e saj është sa gjysma e gjobës që do t'i jepej një të rrituri në të njëjtat kushte, sipas parashikimeve të Kodit Penal.

- kryerja e një pune me interes publik; Sipas Kodit Penal për të Mitur, kryerja e një pune me interes publik për të miturit mund të jetë nga 40 deri në 300 orë. Kohëzgjatja ditore e punës me interes publik nuk mund të jetë më shumë se 4 orë në ditë.

- ndalimi për kryerjen e një veprimtarie; . I mituri mund të ndalohej të kryejë një veprimtari të caktuar për një periudhë kohore nga një deri në tre vjet, nëse kjo çmohet si e papërshtatshme nga gjykata për rehabilitimin e të miturit dhe parandalimin e kryerjes prej tij të veprave penale të tjera. I mituri mund të ndalohej të kryejë një veprimtari të caktuar, deri në moshën 18 vjec.²⁰

Dënimet ndaj të miturit klasifikohen në dënime kryesore dhe plotësuese.

2. Janë dënime kryesore:

- burgimi;
- kufizimi i lirisë;
- gjoba.

3. Dënime plotësuese

- ndalimi për kryerjen e një veprimtarie;
- kryerja e një pune me interes publik;
- përmbushja e detyrimeve të caktuara;
- qëndrimi në shtëpi

- Burgimi. Ndaj një të mituri mund të zbatohet burgimi në rast se ai ka kryer një veprë penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë. Dënimi me burgim nuk mund

¹⁹ Po aty

²⁰ Ligji Nr. 37/2017 KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet.²¹

6. INSTITUTI I TË MITURVE KAVAJË

Instituti i të miturve u hap në tetor të vitit 2009 dhe aktualisht është institut i vetëm për të mitur në Republikën e Shqipërisë. Ky institut shërben si një qendër rehabilitimi, këshillimi dhe shkolle për të miturit.

Në këtë institut, trajtohen minorenë të cilët kanë kryer vepra të ndryshme penale. Mosha e të miturve që do të vuajnë dënimin aty do të jetë nga 14-18 vjeç.

Klasifikimi i të dënuarve nëpër dhoma, u krye në bazë të mbledhjes së informacioneve parësore nga edukatorët. Psh. nëse kanë konflikte me të dënuarit e tjerë ose raste hasmërie, gjendja psiko-sociale, etj. Më pas në bazë të veprës penale që kanë kryer dhe moshës. Kapacitetet akomoduese të institucionit janë për 40 persona.

Është për t'u theksuar se rreth 80% e stafit është civil dhe pjesa tjetër policor. Ambientet janë përshtatur në atë mënyrë që të ndjehet sa më pak mbyllja apo "izolimi" i tyre në një vend, ku pjesën më të madhe të kohës e zënë programet e ndryshme mësimore, sociale e psikologjike për t'i ardhur në ndihmë minorenëve dhe veçanërisht të mos përsërisin ato vepra penale për të cilat duhet të vuajnë një dënim qoftë edhe në këtë qendër të specializuar dhe me standarde të larta bashkëkohore, e cila plotëson kushtet optimale për trajtimin e minorenëve.²²

Më poshtë kemi disa të dhëna aktuale në lidhje me të miturit në këtë institucion.²³

Tabela nr.1 Të dhënat e moshës dhe numrit total të të miturve në Instituti i Të Miturve Kavajë

| KAVAJ | 14 - 16 | 16 - 18 | 18 - 21 | TOTAL |
|---------------|---------|---------|---------|-------|
| Të dënuar | 0 | 2 | 2 | 4 |
| Në paraburgim | 5 | 15 | 6 | 26 |

²¹ Po aty

²² <https://dpbsh.gov.al/ievp/kavaja/>

²³ Informacion Statistikor i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bazë të kërkesës për informacion

Tabela nr.2 Periudha e dënimit të të miturve

| Të Dënuar | Më pak se 1 vit | 1 – 3 vite | 5 – 10 vite | Vrasje | Vjedhje |
|-----------|-----------------|------------|-------------|--------|---------|
| | 1 | 1 | 2 | 2 | 2 |

Tabela nr.3 Veprat Penal që akuzohen të miturit në paraburgim

| Në Paraburgim AKUZAT | Vjedhje | Vrasje | Plagosje | Drogë | V.P të tjera |
|----------------------|---------|--------|----------|-------|--------------|
| | 6 | 5 | 3 | 5 | 7 |

Aktualisht në këtë institucion ndodhen 30 të mitur prej nga mosha 14 deri në 21 vjec, të cilët janë të akuzuar për vepra penale të ndryshme. Por vetëm këta 30 të mitur kanë shkelur ligjin? Në fakt jo, ekzistojnë informacione të tjera statistikore që përfshijnë të gjithë të miturit që janë shoqëruar në komisariat për shkak se kanë shkelur ligjin. Këto të dhëna i gjeni më poshtë në faqet në vazhdim.

Puna e sektorit të edukimit shtrihet në këto drejtime:

Asistencë psikologjike e cila konsiston në këshillim individual dhe në grup çdo ditë të javës;

Për minorenët e ardhur rishtas në institucion të jepet informacioni fillestar për rregullat e institutit, të drejtat dhe detyrimet si dhe i nënshtrohen një pyetësori më qëllim njohjen e gjendjes së tij psikologjike;

Kontakti i vazhdueshëm dhe i rregullt me familjarët e minorenëve për t'i informuar mbi gjendjen e tyre në institucion;

Për sa i përket fushës së edukimit dhe arsimit frekuentimi i bibliotekës çdo ditë të javës sipas kërkesave të minorenëve.

Aktivitetet sportive që përfshijnë lojëra si: futboll, basketboll, bejzboll si dhe lojëra tavoline;

Kurs kompjuteri dhe i gjuhës së huaj si dhe kurs kundër analfabetizmit.²⁴

²⁴ <https://dpbsh.gov.al/ievp/kavaja/>

7. INFORMACIONE STATISTIKORE MBI NOMRIN TOTAL TË TË MITURVE QË KANË KRYER VEPRA PENALE PËR PERIUdhËN 2014 – 2023

Informacioni statistikor, se sa të mitur janë shoqëruar në komisariat për vitet e fundit ka një rëndësi të vecanti pasi mund të kuptojmë nëse ka përmirësim, është njësoj apo është përkeqësuar situatë e delikuencës së të miturve. Ndaj u dërguan 12 kërkesa 12 Drejtorive Vendore të Policisë për të marrë këtë informacion.

Kukes

Në qarkun e Kukësit në total nga viti 2016 – 2023 kemi 177 të mitur të cilët janë shoqëruar në komisariat pasi kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin.²⁵

Tabela nr. 4 Të dhëna statistikore për qarkun e Elbasanit

| Viti | Autor gjithsej | Klasifikim sipas moshes | | Klasifikim sipas gjinise | |
|-------|----------------|-------------------------|---------|--------------------------|-------|
| | | Deri 14 vjec | 14 - 18 | Meshkuj | Femra |
| 2014 | 86 | 38 | 48 | 69 | 17 |
| 2015 | 126 | 58 | 68 | 72 | 54 |
| 2016 | 147 | 61 | 86 | 94 | 53 |
| 2017 | 166 | 81 | 85 | 101 | 65 |
| 2018 | 126 | 67 | 59 | 92 | 34 |
| 2019 | 126 | 71 | 55 | 87 | 39 |
| 2020 | 113 | 52 | 61 | 74 | 39 |
| 2021 | 116 | 52 | 64 | 61 | 55 |
| 2022 | 120 | 62 | 58 | 82 | 38 |
| 2023 | 159 | 85 | 74 | 123 | 36 |
| Shuma | 1285 | 627 | 658 | 855 | 430 |

Në qarkun e Elbasanit kemi një numër të konsiderueshëm të miturish që kanë kryer vepra penale që arrijnë në 1285. Viti me numrin më të ulët është 2014 me 86 të mitur ndërsa viti me numrin më të lartë është 2017. Sipas statistikave gjëndja është e qëndrueshme me pak luhatje por jo me ndonjë ndryshim të

²⁵ Informacion i marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut Kukës

theksuar. Ajo cka vihet re është numri i autoreve të gjinisë femërore që është sa gjysma e numrit total të të miturve të gjinisë mashkullore²⁶

Tabela nr. 5 Të dhëna statistikore për qarkun e Gjirokastrës

| Viti | Autor gjithsej | Klasifikim sipas moshes | | Klasifikim sipas gjinise | |
|-------|----------------|-------------------------|---------|--------------------------|-------|
| | | Deri 14 vjec | 14 - 18 | Meshkuj | Femra |
| 2021 | 8 | 0 | 8 | 8 | 0 |
| 2022 | 41 | 4 | 37 | 41 | 0 |
| 2023 | 47 | 10 | 37 | 45 | 2 |
| Shuma | 96 | 14 | 82 | 94 | 2 |

Në Qarkun e Gjirokastrës nuk kemi informacion për të gjitha vitet por duke analizuar informacionin në dispozicion, numri i të miturve në total është 96 ku vetëm 2 prej tyre janë të gjinisë femërore.²⁷

Tabela nr. 6 Të dhëna statistikore për qarkun e Vlorës

| Vitet 2013 - 2023 | Autor gjithsej | Klasifikim sipas moshes | |
|-------------------|----------------|-------------------------|---------|
| | | Deri 14 vjec | 14 - 18 |
| SHUMA | 363 | 54 | 309 |

Në qarkun e Vlorës kemi shumën totale të të miturve që nga viti 2013 – 2023 janë 363 të mitur të akuzuar për kryerje të veprave penale. Të cilët ndahen në 54 të mitur të moshës nën 14 vjec dhe 309 të mitur të moshës 14 – 18 vjec.²⁸

Ndërkohë në qarkun e Korçës numri total i të miturve që kanë kryer vepra penale është 780, ku 105 prej tyre janë të moshës nën 14 vjec dhe 675 janë të moshës 14-18 vjec. Duke i kategorizuar në gjini, numri i të miturve të gjinisë mashkullore arrin në 765 ndërsa i atyre femërore në 15.²⁹

Tabela nr. 7 Të dhëna statistikore për qarkun e Korçës

²⁶ Informacion i marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut Elbasan

²⁷ Informacion i marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut Gjirokastrë

²⁸ Informacion i marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut Vlorë

²⁹ Informacion i marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut Korçë

| Viti | Autor gjithsej | Klasifikim sipas moshes | | Klasifikim sipas gjinise | |
|-------|----------------|-------------------------|---------|--------------------------|-------|
| | | Deri 14 vjec | 14 - 18 | Meshkuj | Femra |
| 2014 | 96 | 18 | 78 | 94 | 2 |
| 2015 | 79 | 6 | 73 | 76 | 3 |
| 2016 | 50 | 9 | 41 | 49 | 1 |
| 2017 | 68 | 7 | 61 | 67 | 1 |
| 2018 | 110 | 14 | 96 | 109 | 1 |
| 2019 | 84 | 13 | 71 | 84 | 0 |
| 2020 | 46 | 0 | 46 | 45 | 1 |
| 2021 | 77 | 9 | 68 | 76 | 1 |
| 2022 | 88 | 12 | 76 | 87 | 1 |
| 2023 | 82 | 17 | 65 | 78 | 4 |
| Shuma | 780 | 105 | 675 | 765 | 15 |

Tabela nr. 8 Të dhëna statistikore për qarkun Durrës

| Vitet 2013 - 2023 | Autor gjithsej | Klasifikim sipas moshes | |
|-------------------|----------------|-------------------------|---------|
| | | Deri 14 vjec | 14 - 18 |
| SHUMA | 2003 | 400 | 1603 |

Në Qarkun e Durrësit kemi numri total të të miturve për periudhën 2013 – 2023, ku numri total i të miturve është 2003, ku 400 prej tyre i përkasin moshës nën 14 dhe 1603 i përkasin grupmoshës 14-18 vjec.³⁰

Ndërsa në Qarkun e Dibrës për periudhën 2014 – 2023 numri total I të miturve arrin në 460, ku 58 prej tyre janë të mitur që i përkasin moshës nën 14 vjec dhe 402 janë në moshën 14 – 18 vjec. Në këtë qark, viti që ka numrin më të lartë të të miturve është viti 2018 me 65 të mitur, ndërsa viti 2017 është viti më numrin më të ulët, 19 të mitur.³¹

Tabela nr. 9 Të dhëna statistikore për qarkun Dibër

³⁰ Informacion i marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut Durrës

³¹ Informacion i marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut Dibër

| Viti | Autor gjithsej | Klasifikim sipas moshes | |
|-------|----------------|-------------------------|---------|
| | | Deri 14 vjec | 14 - 18 |
| 2014 | 42 | 4 | 38 |
| 2015 | 40 | 5 | 35 |
| 2016 | 43 | 6 | 37 |
| 2017 | 19 | 1 | 18 |
| 2018 | 65 | 10 | 55 |
| 2019 | 64 | 9 | 55 |
| 2020 | 42 | 4 | 38 |
| 2021 | 46 | 2 | 44 |
| 2022 | 48 | 7 | 41 |
| 2023 | 51 | 10 | 41 |
| Shuma | 460 | 58 | 402 |

Tabela nr. 10 Të dhëna statistikore për qarkun Berat (Numri i Autorëve)

| Viti | Autor gjithsej | Klasifikim sipas moshes | | Klasifikim sipas gjinise | |
|-------|----------------|-------------------------|---------|--------------------------|-------|
| | | Deri 14 vjec | 14 - 18 | Meshkuj | Femra |
| 2019 | 18 | 1 | 17 | 18 | 0 |
| 2020 | 14 | 4 | 10 | 14 | 0 |
| 2021 | 30 | 1 | 29 | 30 | 0 |
| 2022 | 28 | 4 | 24 | 28 | 0 |
| 2023 | 44 | 10 | 34 | 43 | 1 |
| Shuma | 134 | 20 | 114 | 133 | 1 |

Tabela nr. 11 Të dhëna statistikore për qarkun Berat (Numri i Viktimave/ Dëmtuarve)

| Viti | Viktima/Dëmtuar gjithsej | Klasifikim sipas moshes | | Klasifikim sipas gjinise | |
|------|--------------------------|-------------------------|---------|--------------------------|-------|
| | | Deri 14 vjec | 14 - 18 | Meshkuj | Femra |
| 2019 | 4 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| 2020 | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 |
| 2021 | 27 | 7 | 20 | 19 | 8 |
| 2022 | 19 | 19 | 0 | 12 | 7 |
| 2023 | 21 | 10 | 11 | 12 | 9 |

| | | | | | |
|-------|----|----|----|----|----|
| Shuma | 72 | 38 | 34 | 46 | 26 |
|-------|----|----|----|----|----|

Ndryshe nga të dhënat statistikore të Qarqeve të tjera, në Qarkun e Beratit përvec numrit total të të miturve që kanë kryer vepra penale, kemi dhe numrin total të të miturve të klasifikuar si viktima ose të dëmtuar.

Informacionë i përkasin peridhës 2019-2023, ku numri i autorëve të mitur është 134, ku 20 prej tyre janë të moshës nën 20 vjec dhe 114 janë të grupmoshës 14 – 18 vjec. Klasifikimi në gjini , 133 meshkuj dhe vetëm 1 femër.

Ndërsa tek të miturit viktima ose të dëmtuar numri total arrin në 72 ku 38 prej tyre i përkasin moshës nën 14 vjec dhe 34 prej tyre i përkasin grupmoshës 14 – 18 vjec. Meshkuj janë 46 te mitur ndërsa femra 26 të mitura.³²

Gjithashtu në një pyetësor ku disa të mitur të moshës 14 – 18 u pyeten se nëse Një prej prindërve do të vritej, cfare do të bënin?, Do ta linin çështjen në duart e drejtësisë apo do të hakmerreshin.

Nga 112 të mitur të pyetur ballë për ballë, 98 prej tyre u përgjigjën se do ta linin çështjen në duart e drejtësisë ndërsa 14 pohuan se do të hakmerreshin. Pra 12% e të miturve janë të gatshëm të kryejnë një vepër penale, duke u nxitur nga faktori hakmarrjes.

Konkluzion

Në Republikën e Shqipërise, Kodi Penal për të Mitur ka paraparë cdo dispozitë për të trajtuar të miturit që janë në konflikt me ligjin. Një vemëndje e vecantë i kushtohet sanksioneve për të miturit, ku mes tyre shumica janë masa edukuese, me qëllim që një i mitur mos të privohet nga liria.

Shkaqet që të miturit kryejnë vepra penale nuk janë vetëm ato të cilat listuam në këtë studim, por janë disa herë më të shumta në numër, madje disa nuk mund të jenë zbuluar akoma, pasi psikologjia e një të mituri ka një pikënisje pa mbarim, ku për cdo veprim të gabuar mund të ketë një shkak të ndryshëm.

Duke iu referuar të dhënave statistikore, në bazë të popullsisë të cdo qarku, numri i të miturve që kanë kryer vepra penale është i lartë, dhe për këtë institucionet duhet të marrin masa, që në vitet e ardhshme ky numër të bjerë

³² Informacion i marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut Berat

dukshëm. Edukimi duhet të nisë që nga familja e më pas në institucionet arsimore, ku për të realizuar një punë frytdhënëse, prindër dhe institucione duhet të bëhen bashkë, për të arritur një qëllim.

Referenca

1. Informacion Statistikor i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bazë të kërkëses për informacion
2. Informacion i marrë nga Drejtorit Vendore të Policisë të Qarqeve Kukës, Elbasan, Gjirokastrë, Vlorë, Korçë, Durrës, Dibër, Berat
3. Prof. Dr. Vesel Latifi, Kriminalistika e delikuences se te miturve, Prishtine 1984
4. Prof. Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2005
5. Dr. Ismet Salihu, E Drejta Pena për të Mitur, Prishtinë 2005
6. Dr. Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë, Tetovë 2010
7. Lindona Salihu, Sanksionet penale ndaj te miturve, Prishtine 2010
8. Ligji Nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur i Republikës së Shqipërisë
9. [https://sq.wikipedia.org/wiki/Delikuenca#:~:text=Termi%20Delikuenc%C3%AB\(Devijim\)%20rrjedh%20nga,ligjet%20e%20mjedisit%20ku%20jetojn%C3%AB](https://sq.wikipedia.org/wiki/Delikuenca#:~:text=Termi%20Delikuenc%C3%AB(Devijim)%20rrjedh%20nga,ligjet%20e%20mjedisit%20ku%20jetojn%C3%AB).
10. <https://dpbsh.gov.al/ievp/kavaja/>

VËSHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE ATIJ KOSOVAR NË FUSHËN E EKZEKUTIMIT TË DETYRUESHËM TË VENDIMEVE GJYQËSORE.

Esmeralda Rama (Dregjoni)

Avokate, anëtare e Dhomës së Avokatisë Durrës. Asistente lektore pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” edregjoni@yahoo.com

Hygerta Istrefi

Juriste, Diplomuar pranë Fakultetit të Drejtësisë Universiteti i Tiranës, Master Shkencor në “E drejtë Civile” hygerta.istrefi@gmail.com

ABSTRAKT

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një komponent të qenësishëm dhe esencial në finalizimin efektiv të qëllimeve të shtetit të së drejtës. Faza e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve gjyqësore mbart një rëndësi të veçantë në përlllogaritjen e afatit të arsyeshëm, duke u cilësuar edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vendimmarrjen e saj që ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga çdo gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë integrale e “proçesit gjyqësor” sipas qëllimeve të Nenit 6 të Konventës. Marrëdhënia juridike procedurale civile që merr jetë gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve gjyqësore, në bërthamën e saj ka elemente, veçori specifike, që do sillen në trajtën krahasimore. E drejta përmbartimore përkufizohet si tërësia e normave juridike procedurale me të cilat rregullohen marrëdhëniet procedurale që krijohen gjatë proçedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutive. E drejta përmbartimore materializohet në Kodin e Procedurës Civile, më saktësisht në pjesën e katërt të tij dhe në ligjin nr. 29/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” i ndryshuar, në ligjin nr.8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbartimit gjyqësor”, në ligjin nr.04/L-139 “Për proçedurën përmbartimore” i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.05/L-118 “Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-139 “Për proçedurën përmbartimore dhe me ndryshimet e fundit të pasqyruara në Gazetën Zyrtare të Republikës së

Kosovës, me ligjin Nr. 08/L-102 “Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-139 “Për procedurën përbarimore” , ku reflektohen elementët më të qenësishëm të procedurës përbarimore si dhe mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të titujve ekzekutivë.”

Fjalë kyçe: *titull ekzekutiv, ekzekutim i detyrueshëm, përbarim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

Hyrje

“Gjykatë”- organi i vetëm që ushtron pushtetin gjyqësor, i ngarkuar me ligj për dhënien e drejtësisë. Dy kriteret që duhet të përmbushë organi për t’u quajtur “gjykatë” në kuptim të KEDNJ-së janë pavarësia (*sidomos nga ekzekutivi*) dhe paanshmëria.

“Titull ekzekutiv”- akti i lëshuar nga gjykatat ose organet kompetente shtetërore, që vërteton qënien e së drejtës subjektive të kreditorit dhe përcakton detyrimin e debitorit dhe që vihet në ekzekutim të detyrueshëm nga shërbimi përbarimor gjyqësor (shtetëror ose privat), pas lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit.

“Urdhër ekzekutimi”- nënkupton vendimin e gjykatës me anën e të cilit konstatohet ekzistenca e një titulli ekzekutiv të aftë për t’u ekzekutuar dhe për pasojë urdhërohet organi i përbarimit që të ekzekutojë përmbajtjen e këtij titulli ekzekutiv.

“Procedurë përbarimore”- nënkupton çdo veprim të ndërmarrë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, në ligjin nr.26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, në ligjin nr.04/L-139 “Për procedurën përbarimore”, me qëllim ekzekutimin e titujve ekzekutive.

“Ekzekutimi vullnetar”- përfaqëson përmbushjen vullnetare të detyrimit nga ana e debitorit, që përmbahet në titullin ekzekutiv, brenda një afati të caktuar.

“Lajmërim për ekzekutim vullnetar”- lajmërimi i bërë nga përbaruesi gjyqësor, debitorit për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, brenda afatit të caktuar.

“Ekzekutim i detyrueshëm”- nënkupton procesin e ndërmarrë për vënien në ekzekutim të titujve ekzekutivë, kur ka kaluar afati për përmbushjen vullnetare të detyrimit nga ana e debitorit.

“Vënie në ekzekutim”- fillimi i procedurave të ekzekutimit të titullit ekzekutiv nga shërbimi përbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat në bazë të kërkesës së kreditorit.

“Kërkesë për vënie në ekzekutim”- kërkesa drejtuar përbaruesit gjyqësor nga kreditori, për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit.

“Përbarues gjyqësor”- është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, ligjin nr.26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, në ligjin nr.04/L-139 “Për procedurën përbarimore”.

“Kompetenca tokësore e përbaruesit”- çështja se cilit përbarues gjyqësor duhet t’i paraqitet kërkesa për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit.

Studimi i marrëdhënies juridiko-procedurale-ekzekutive

Gjeneza historike. Një prezantim i përgjithshëm.

Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore, më parë ka përfaqësuar një institut të panjohur, disi të largët në botëkuptimin ligjor. Që do të thotë, nuk mund të flitej për ekzistencën e një procedure ekzekutive në fazat e hershme të formimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar. Gjithashtu, dhe për shtetin kosovar ka rezultuar një rrugëtim me pengesa gati të pakapërcyeshme, për të mbyllur hendeqet e së kaluarës. Nëse i referohemi shtetit shqiptar para vitit 1912, ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore nuk kishte marrë drejtimin e duhur, për shkak të peshës së ligjeve otomane. Legjislacioni otoman zinte peshën më të madhe në këtë kohë. Pra, zbatohet e drejta dhe juridiksioni i gjykatave osmane. Ndërkohë në zonat malore ka vepruar e drejta zakonore shqiptare para shpalljes së pavarësisë. Përmendim, Kanunin e Lekë Dukagjinit, Labërisë, Skënderbeut që kishin të parashikuar organet e veta, me emërtime të ndryshme. Si psh: Këshilli i Pleqve, Gjyqi i Pleqve. Historiku i krijimit të shërbimit të përbarimit gjyqësor privat, si aktivitet funksional, daton që në vitin 1915, dy vite pas krijimit të shtetit shqiptar¹. Është interesant fakti i rëndësisë që merrte ky profesion në atë kohë, ku kërkesa ligjore për autoritetin që do lejohej të ishte

¹ Ina Barjamaj, “Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe prblematika e praktikës gjyqësore”, Tiranë, 2016, faqe, 19.

përmbarues përmbante shumë komponentë si: aftësitë morale, juridike, diplomë universiteti, ose vërtetim se kandidati ka vepruar së paku 10 vjet si avokat².

Përgjatë viteve, 1915, 1917, 1922, 1924, 1925, 1928, aktiviteti përmbarimor privat dokumentohet në shumë shkresa (të ruajtura deri sot nga arkiva e shtetit), si një veprimtari që zhvillohej nga një zyrë e posaçme, që i drejtohej Ministrisë së Drejtësisë së asaj kohe me terminologjinë “përmbarimi paguhet nga të interesuarit dhe jo nga arka e shtetit³. Miratimi i legjislacionit civil në 1929, nga qeveria e Zogut u shoqërua edhe me plotësimin e ligjit të përmbarimit. Gjatë komunizmit, ky shërbim u vendos në funksion shtetëror të kohës, në varësi direkte të gjykatave. Nga viti 1945 deri në vitin 1991, përmbarimi në baza private nuk lejohej. Si organe përmbarimore të viteve 1944-1951 konsideroheshin seksionet e drejtësisë. Ligje të viteve 1951 dhe 1968 rregulluan disi procedurat përmbarimore, por i vendosën ato totalisht nën varësinë e gjykatave popullore të rretheve, që kontrolloheshin plotësisht nga kryetari i gjykatës, duke zhdukur tërësisht autonominë procedurale të një përmbaruesi gjyqësor.⁴ Vetëm në vitin 2001 miratohet për herë të parë një ligj organik për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror, i cili trajtoi në mënyrë të veçantë këtë shërbim, që funksionon edhe sot si i tillë. U miratua ligji nr.10031 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat” në 2008, që më pas u shfuqizua në 2019 me ligjin nr.26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

Nga ana tjetër, ballafaqohemi me historikun e Kosovës që nuk ka qenë aspak i lehtë. Megjithatë, u arrit të vendoseshin një nga një tullat për ndërtimin e shtëpise ligjore kosovare dhe arritjes së qenurit një shtet i pavarur. Formimi i sistemit juridik të Kosovës, e cila sapo kishte dale nga lufta dhe jetonte me sfidat e shumta të menaxhimit të fazës së pasluftës, ishte mjaft i nderlikuar.⁵ Kemi tre faza kryesore:

1. Faza e parë e periudhës tranzitore: Administrimi i Kosovës nga UNMIK-u 1999-2001.

² <http://www.nchb.al-2/> , në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, aksesuar për herë të fundit më 03/03/2024

³ *Ibid.*

⁴ *Ibid.*

⁵ Arsim Bajrami, Enver Hasani, Hajredin Kuci, Iliriana Islami, Haxhi Gashi, Iset Morina, Avni Puka, Azem Hajdari, Mirlinda Batalli, Remzije Istrefi, “Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë”, Prishtinë, faqja 19

2. Faza e dytë e periudhës tranzitore: Krijimi i institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, 2001-2005.
3. Faza e tretë: Përgatitja për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, 2005-2008, njihet ndryshe si faza e negociatave për statusin final të Kosovës.

Faza e fundit karakterizohet kryesisht me proceset politike, që lidheshin me negociatat për statusin përfundimtar të Kosovës, respektivisht shpalljen e pavarësisë së saj. Tri momente që konsiderohen si vendimtare karshi procesit të përcaktimit të statusit janë:

- Standartet për Kosovën ose të ashtuquajturit standarte për statusin;
- Raporti i z. Kai Aide;
- Bisedimet e Vjenës;⁶

Nga rezultatet e këtyre tri momenteve më pas rrodhi *Pakoja e Ahtistaarit* mbi bazën e së cilës edhe u përcaktua statusi përfundimtar i Kosovës. Pas dështimit të OKB-së për të pranuar rekomandimin për pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës, institucionet e Kosovës të posadala nga zgjedhjet e nacionale të muajit nëntor 2007, filluan përgatitjet për shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Element kyç i përgatitjes së aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës ishte përgatitja e Deklaratës së Pavarësisë. Përfundimisht, më 17 shkurt 2008 Kuvendi i Kosovës miratoi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.⁷ E drejta e Kosovës është nën ndikimin e një procesi të pandalshëm zhvillimi dhe përmirësimi, pasi shteti kosovar ka një moshë relativisht të re. Pak nga pak nisën të plotësoheshin vakumet dhe të ngrihej monumenti i vet ligjor, pa asnjë lloj grimce negative, të diktuar nga faktorë të jashtëm. Kjo qasje e re preku dhe procedurën përmbartimore. Në vitin 2008 u miratua *ligji nr.03/L-008 "Për procedurën përmbartimore."* Ky ligj në përmbajtjen e tij përcakton se është gjykata organi kryesor, që do të realizojë ekzekutimin e detyrueshëm, në fillim kryesisht Gjykata Komunale dhe më vonë Gjykata Themelore. Ligji shpreh që procedura e përmbartimit e nisur deri në ditën e fillimit të aplikimit të këtij ligji, do përfundojë sipas dispozitave të ligjit "Për procedurën e përmbartimit" (Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr.20/1978). Ligji i 2008 u shfuqizua më pas me ligjin nr.04/L-139 "Për

⁶ Arsim Bajrami (Departamenti Kushtetues dhe Administrativ), "*Tranzicioni i rendit juridik në Kosovë*", Prishtinë, fq 25

⁷ *Ibid.* 29.

procedurën përbarimore.” Ligji nr.05/L-118 ndryshon dhe plotëson ligjin nr.04/L-139.

Kuptimi i marrëdhënies juridiko-procedurale-ekzekutive. Karakteristikat e saj.

E drejta përbarimore është tërësia e normave juridike procedurale me të cilat rregullohen marrëdhëniet procedurale që krijohen gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutive.⁸ E drejta përbarimore materializohet në KPrC, më saktësisht në pjesën e katërt të tij dhe në ligjin nr. 26/2019, “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, në ligjin nr.8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përbarimit gjyqësor”, në ligjin nr.04/L-139 “Për procedurën përbarimore” i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.05/L-118 “Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-139 “Për procedurën përbarimore” dhe së fundmi me ligjin Nr. 08/L-102 “Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-139”. Marrëdhënia juridiko-procedurale-ekzekutive ka subjektet e saj që janë:

- Palët (kreditori dhe debitori);
- Përbaruesi gjyqësor, qoftë privat apo shtetëror;
- Gjykata;

Kreditori është subjekti në favor të cilit është dhënë titulli ekzekutiv e që po në favor të të cilit do të realizohet ekzekutimi i detyrueshëm, debitori është personi ndaj të cilit do të kryhen të gjitha veprimet gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Përbaruesi gjyqësor shtetëror dhe privat, si subjekt shumë i rëndësishëm, që ligji i ka veshur përgjegjësinë e ekzekutimit të titullit ekzekutiv dhe gjykata në momentin kur kemi të bëjmë me mosmarrëveshje që lidhen me ekzekutimin e detyrueshëm. Në kuptim më të gjerë të mundshëm me ekzekutim në fushën e së drejtës do kuptojmë realizimin praktik të një parashikimi ligjor të caktuar. Qëllimi i ekzekutimit të detyrueshëm lidhet me ekzekutimin kundrejt debitorit, të detyrimit që përmbahet në titullin ekzekutiv, pavarësisht nga vullneti i këtij të fundit.⁹

Objekti i marrëdhënies juridiko-procedurale-ekzekutive përfaqëson detyrimin që permban titulli ekzekutiv. Mund të jetë objekt i kësaj marrëdhënieje:

⁸ Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi, “*Procedurë Civile*”, shtëpia botuese Albas, 2018

⁹ Po aty, faqe 345

*detyrimi për të kryer një veprim të caktuar, detyrimi për të liruar dhe dorëzuar sendin, detyrimi për të paguar pensionin ushqimor.*¹⁰

Përmbajtja e marrëdhënies juridike procedurale civile të krijuar gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, konsiston në të drejtat e detyrimit që kanë subjektet në këtë proces. Ato janë parshikuar qartësisht në Kodin e Procedurës Civile dhe në ligjin nr.04/L-139 “Për procedurën përmbartimore.” Si p.sh, debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas, (neni 609 i Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar)

Një e drejtë tjetër që palët kanë është dhe kundërshtimi (ankimi) ndaj veprimeve të përmbartuesit gjyqësor. Neni 615, gërma (b) i njeh mundësinë kreditorit, që të kërkojë pezullimin e përkohshëm të ekzekutimit të detyrueshëm, kjo gjithmonë në përputhje me nevojat e tij. Ndërkohë edhe në ligjin nr.04/L-139 “Për procedurën përmbartimore” është parashikuar e drejta e kreditorit dhe debitorit që në rrethanat e caktuara në ligj, të kërkojnë shtyrjen e përmbartimit, përkatësisht në nenet 60 dhe 61 të tij. Në nenin 52 të LPP-së është përcaktuar që nëse gjatë kryerjes së veprimeve përmbartimore janë bërë parregullsi, palët ose pjesëmarrësi tjetër i procedurës mund të kërkojë nga Gjykata me anë të parashtresës që t’i eliminojë këto parregullsi. Me pjesëmarrës tjetër në kuptim të këtij ligji do të jetë personi i cili në procedurën e përmbartimit realizon ndonjë të drejtë apo interes juridik, e që nuk është palë në procedurën përmbartimore. Pra, nuk është kreditor apo debitor. Këtë përkufizim e gjejmë në nenin 2 të LPP-së. Normalisht, të drejtat e palëve pjesëmarrëse në këtë proces nuk mbyllet në një rreth të tillë. Është më i gjerë se kaq. Përpos të drejtave, kanë dhe detyrime që rëndojnë mbi ta e që normohen nga ligjet përkatëse.

“Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson të domosdoshme të theksojë që krijimi i marrëdhënies juridike-procedurale të ekzekutimit të detyrueshëm, kërkon të ekzistojnë njëherazi disa elementë faktikë dhe juridikë në mënyrë që të kënaqen pritshmëritë dhe kërkesat e ligjit. Ky kolegji vlerëson se, përveç gjykimit deklarativ ose të njohjes së një të drejte, kemi edhe gjykimin ekzekutiv të rivendosjes në vend të së drejtës së shkelur. Në këtë lloj gjykimi e drejta duhet të jetë e sigurtë dhe e saktë, gjykim nga i cili kërkohet të realizohet materialisht dhe forcërisht e drejta. Kjo fazë e ekzekutimit të detyrueshëm zhvillohet gjithmonë mbi bazën e një titulli

¹⁰ Ina Barjamaj, “Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe problematika e praktikës gjyqësore”, Tiranë 2016

ekzekutiv, që janë parashikuar shprehimisht në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile, ku ndër të tjera parashikohet se: “Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv”¹¹.

Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kuptohet mbrojtja që të dyja Kushtetutat bëjnë në lidhje me procesin e rregullt ligjor, kjo në përputhje me misionin e shtetit të së drejtës.

Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, Thomas Hammarberg ka shprehur se: “Përmbarimi i mangët i vendimeve përfundimtare gjyqësore duhet të shihet si refuzim për të pranuar sundimin e ligjit dhe është një problem serioz për të drejtat e njeriut.¹² Zbatimi me të meta i vendimeve gjyqësore zbeh besimin në drejtësinë e shtetit. “Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës dhe të nocionit gjykim i drejtë. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin që çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë dhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ajo që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurtë, por kërkohet që ajo të vihet në jetë. Në këtë kuptim, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, pra vetëm me dhënien e vendimit gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë.”¹³

Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të së drejtës së fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të

¹¹ Vendim i Kolegjit Civil të GJL-së, nr.00-2016-1859 (174)

¹² http://www.coe.int/t/commissioner/Viewpoints/090831_en.asp, aksesuar për herë të fundit më 07.05.2024

¹³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr.28, datë 19.05.2016

drejtën e tij të fituar.¹⁴ Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës.¹⁵ Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.¹⁶

Autoritetet kompetente kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për ekzekutimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, si dhe që të sigurojë zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme. Ekzekutimi i një aktgjykimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si një pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 të Konventës.¹⁷ Shteti i së drejtës, njëri prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike është pjesë përbërëse e tërësisë së neneve të Konventës dhe kupton detyrën e çdo shteti/autoriteti publik që të bindet ndaj një vendimi gjyqësor që i drejtohet atyre.

Titujt ekzekutivë, sipas legjislacionit shqiptar dhe atij kosovar.

Titulli ekzekutiv është akti përfundimtar që përmban njohjen e detyrimit të plotë, të saktë, të përcaktuar të një personi apo subjekti kundrejt një tjetri sipas parashikimeve të ligjit.¹⁸ Titulli ekzekutiv përmban në thelb marrëdhënien juridike të dokumentuar në formën e caktuar nga ligji, të cilës ky i fundit i ka njohur aftësinë për t'u ekzekutuar forcërisht sipas kërkesës së kreditorit për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, pa pasur nevojë kreditori të bëjë një gjyq themeli me palë kundërshtare, në lidhje me saktësimin e kësaj marrëdhënieje dhe urdhërimit të debitorit të përmbushë detyrimin që përmban titulli ekzekutiv.¹⁹ Sipas neni 510 të Kodit të Procedurës Civile janë tituj ekzekutivë:

- a) Vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;
- b) Vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;

¹⁴ Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr.21, datë 07.04.2014

¹⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 30.03.2015

¹⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.12, datë 16.04.2013

¹⁷ Aktgjykim në rastin nr.KI 08/09 (Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, Aktvendimi C.nr.340/2001, i datës 11 janar 2002

¹⁸ Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.169, datë 05.03.2013

¹⁹ Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi, "Procedurë Civile", shtëpia botuese Albas, 2018, faqe 347

- c) Vendimet e gjykatave të arbitrazhit të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi;
- d) Vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;
- e) Aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare;
- f) Kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato;
- g) Aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tyre;

Ne ligjin nr.04/L-139 “Për procedurën përmbartimore”, neni 22 parashikon si tituj ekzekutivë (dokumente përmbartues):

- a) Vendimi përmbartues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbartuese;
- b) Vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (ujdia);
- c) Dokumenti noterial i përmbartueshëm në pajtim me ligjin për noterinë;
- d) Marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës;
- e) Aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujditë gjyqësore të gjykatave të huaja si dhe vendimet e gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujditë e arritura para gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, që janë pranuar për përmbartim brenda territorit të Republikës së Kosovës;
- f) Vendimet dhe marrëveshjet përmbartuese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata;
- g) Kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit;
- h) Vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbartues evropian;
- i) Dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbartues;

Këto ishin parashikimet ligjore si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri përsa i përket titujve ekzekutivë. Tani do ndalemi në trajtimin e secilit prej tyre, ngjashmëritë dhe dallime që konsistojnë. Terminologjia e përdorur në secilin legjislacion është e ndryshme, por në raste të caktuara thelbi është i njëjtë. Në ligjin nr.04/L-139 “Për procedurën përmbartimore”, një karakteristikë tipike është fakti që parashikon si tituj ekzekutivë dhe dokumentet e besueshëm. Sipas nenit 29 të LPP tek dokumentet e besueshme përfshihen:

- a) Kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyese, po qe se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës;
- b) Ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave;
- c) Faturat;
- d) Dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;

Përmbarrimit nuk i nënshtrohen të gjitha vendimet gjyqësore apo ato të dhëna në procedurë administrative, por vetëm ato të parashikuara shprehimisht në LPP dhe në ligje tjera të veçanta. Në dispozitat e LPP-së identifikojmë kushtet që duhet të plotësojë një “dokument” që të jetë i ekzekutueshëm:

- Forma e prerë e vendimit (neni 24 i LPP-së)
- Specifikimi në vendim i kreditorit dhe debitorit (neni 27 i LPP-së)
- Ka përfunduar afati për përmbushje vullnetare (neni 24 i LPP-së)

Në ligjin tonë procedural, ashtu sikurse LPP-ja jemi në të njëjtën situatë, gjë që evidentohet në përmbajtjen e nenit 510 të KPrC-së. Gjithashtu, përmbaruesi gjyqësor, kur fillon ekzekutimi i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin. Ekzekutimi i detyrueshëm fillon vetëm pas mbarimit të afatit për ekzekutimin vullnetar. Afati është 5 ditë kur, objekti është pagë ose detyrim për ushqim dhe 10 ditë në të gjitha rastet e tjera. Në KPrC nuk janë parashikuar shprehimisht si tituj ekzekutivë faturat, si në nenin 29 të LPP. Shikojmë që ligjvënësi kosovar kur ka përfshirë si tituj ekzekutivë faturat, i ka përgjithësuar, duke na lënë të nënkuptojmë që mund të jenë p.sh fatura e konsumit të ujit të pijshëm, faturë e konsumit të energjisë elektrike apo faturë tjetër e rregulluar me ligj të veçantë që përcaktohet si titull ekzekutiv. Neni 510 i KPrC, pika e fundit, ka një parashikim të përgjithshëm dhe më konkretisht, janë tituj ekzekutivë aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbarrimit për ekzekutimin e tyre. Duke e lidhur dhe me nenin 29 të LPP pika c, si titull ekzekutiv në ligjet e veçanta shqiptare jane edhe faturat. Bëhet fjalë për ligjin nr.8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike” (i ndryshuar) i cili në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Fatura tatimore e konsumit, të shitjes, të blerjes dhe faturat e shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit 36 të ligjit Nr. 7928, datë*

27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” është titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat e përmbarimit me ekzekutimin e tyre. Përmendim këtu edhe ligjin Nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv, i ndryshuar me ligjin Nr.9286, datë 30.09.2004, ku në nenin 1 të këtij ligji është parashikuar se: “Fatura tatimore e konsumit të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të përdorura, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Financave, në bazë të nenit 36 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tij”. Kushtetushmëria e kësaj norme është konfirmuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Dokumenti i besueshëm si titull ekzekutiv

Procedura e përmbarimit mund të kryhet vetëm në bazë të një titulli përmbarimor (ekzekutiv), i cili mund të fitohet si në procedurën kontestimore, edhe në atë jokontestimore.²⁰ Nocioni procedura jokontestimore është nocion i pranuar dhe tradicional, por juridikisht i gabuar²¹. Ligji “Për procedurën përmbarimore nuk është konsekuent në terminologjinë juridike, lidhur me dokumentin e besueshëm²². Si nocion i përgjithshëm mund të përdorej “titull përmbarimor”, si për dokumentin përmbarimor, ashtu edhe për dokumentin e besueshëm. Procedura përmbarimore mund të fillojë edhe në bazë të një dokumenti të besueshëm, por padyshim si titull kryesor përmbarimor është aktgjykimi (nenet 21 dhe 22 të LPP-së).

Po çfarë do të kuptojmë me aktgjykim?

Duke u mbështetur në fjalorin juridik: *Aktgjykimi* është lloj i vendimit, që merret nga gjykata. Në procedurën civile gjykata vendos përfundimisht lidhur me çështjen kryesore me aktgjykim. Në aspektin formal, secili aktgjykim duhet të ketë tri pjesë kryesore të domosdoshme, pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e ankimit. Dispozitivi i aktgjykimit është pjesa kryesore dhe më e rëndësishme e aktgjykimit²³. Dispozitivi përmban vendimin lidhur me çështjen kryesore (kërkesëpadinë), çështjet aksesore (shpenzimet procedurale) dhe përmbarueshmërinë e vendimit.

²⁰ Iset Morina, “Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë” (E drejta procedurale civile), Prishtinë, 2019, faqe, 263.

²¹ Morina, op.cit. faqe, 266.

²² Morina, op.cit. faqe, 263.

²³ Iset Morina, Ardit Gashi, “Fjalor juridik” (E drejta private), Prishtinë, 2019, faqe, 15.

Meqë organi përmbarues mbështetet në dispozitivin për të zhvilluar procedurën e përmbarimit, atëherë është e domosdoshme, që dispozitivi të jetë i qartë²⁴.

Përfundimisht me aktgjykim në kuptim të procedurës përmbarimore do të kuptojmë secilin aktgjykim apo aktvendim përfundimtar të nxjerrë në procedurën kontestimore para gjykatës shtetërore apo arbitrazhit dhe atë në procedurën jokontestimore²⁵. Dokumenti i besueshëm luan një rol të madh në praktikë dhe rrjedhimisht edhe në doktrinë, në praktikën gjyqësore. Një dokument i besueshëm është një dokument publik, një dokument privat i vërtetuar, një kambial, një çek, si dhe regjistrat afarist të vërtetuar. Dokumente të besueshme në kuptim të ligjit “Për procedurën përmbarimore”, janë edhe të ashtuquajturat ekstraktet e regjistrave afarist për pagimin e shpenzimeve komunale lidhur me furnizimin me ujë, energji elektrike, dhe transportin e mbeturinave. Për shkak të pasojave të ndryshme procedurale dhe sidomos për shkak të procedurës sipas mjeteve të goditjes së vendimit është i nevojshëm një diferencim në faktin nëse procedura përmbarimore ka filluar në bazë të një dokumenti përmbarues apo një dokumenti të besueshëm²⁶.

Përsa i përket vendimit të gjykatës për sigurimin e padisë, ai në vetvete përbën një titull ekektiv dhe që për të nuk lëshohet një urdhër ekzekutimi, sipas nenit 511 të KPrC-së kurse në nenet 22 dhe 29 të LPP-së nuk ka një parashikim të tillë. Në fakt është ligji “Për Procedurën Kontestimore” që shprehet në lidhje me këtë. Neni 307 i LPK-së, pika 1 dhe 3 shprehet që: *“Në aktvendimin mbi caktimin e masës së sigurimit gjykata e përcakton llojin e masës, mjetet me të cilat ajo do të realizohet dhunshëm dhe objektin e masës së sigurimit, duke i aplikuar përkatësisht rregullat e procedurës gjyqësore përmbaruese. Gjykata sipas detyrës zyrtare ia dërgon aktvendimin mbi caktimin e masës së sigurimit gjykatës përmbaruese kompetente me qëllim të ekzekutimit të tij të përdhunshëm dhe regjistrin publik me qëllim të regjistrimit të tij.”* Pika 3 vijon si më poshtë: *“Aktvendimi me të cilin është caktuar masa e sigurimit ka efekt të aktvendimit mbi ekzekutimin nga ligji “Për procedurën përmbarimore”.*

Në ligjin e vjetër të LPK-së, nuk ka qenë e rregulluar procedura për sigurimin e padisë, ligji i ri i LPK-së e rregullon institutin e sigurimit padisë përkatësisht në nenet 296-318 të tij. KPrC e rregullon sigurimin e padisë në nenet 202-211. LPK në krahasim me Kodin e Procedurës Civile, përdor termat

²⁴ *Ibid.* 16.

²⁵ I. Morina, “Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë”, Prishtinë, 2019, faqe, 263.

²⁶ *Ibid.*

propozues i sigurimit dhe kundërshtar i propozimit, që në fakt janë ekuivalente me termat paditës dhe i paditur në KPrC. Në nenin 202 të KPrC dhe në nenin 297 të LPK-së, janë parashikuar kushtet për sigurimin e padisë. Në nenin 297, pika 1 ligjvënësi kosovar ka përcaktuar se masa e sigurimit mund të caktohet, kur propozuesi i sigurimit (paditësi) e bën të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive, duke e lënë çështje të hapur sesi mund ta provojë apo të plotësojë këtë kusht ligjor propozuesi i sigurimit. Në lidhje me këtë kusht, mendohet që propozuesi i sigurimit, duhet ta dëshmojë atë përmes ndonjë vendimi më të hershëm të gjykatës apo të një organi administrativ, testament, kontratë, ndonjë dokumenti përbarimor, respektivisht ndonjë titulli juridik²⁷.

Ndërkohë, neni 202 i KPrC-së parashikon që sigurimi i padisë do të lejohet kur padia mbështetet në prova me shkresë. Ekzistenca e provave shkresore presupozon se qartëson nevojën për vendosjen e masave për sigurimin e padisë, pa paragjykuar faktin se çfarë vlere provuese do të kenë këto prova për themelin e çështjes²⁸. Nga krahasimi midis këtyre dy dispozitave, kuptojmë që në rastin e LPK-së kushtet për sigurimin e padisë janë kumulative, ligjvënësi përdor lidhëzën “dhe” për ta bërë më të qartë këtë fakt. Ndërsa në KPrC nuk është përdorur, pra, nëse paditësi nuk disponon prova me shkresë dhe plotëson kushtet në paragrafin e parë të nenit 202, gjykata duhet t’i kërkojë paditësit që të japë garanci. Kjo garanci mund të jetë: një shumë parash, lënia peng e një sendi të luajtshëm etj. Vihet re që, do të jetë gjykata ajo që do të përcaktojë llojin dhe masën e garancisë që duhet të vendosë paditësi. Dhënia e garancisë, bëhet për të garantuar të paditurin për dëmin që mund t’i vijë nga vendosja e masës së sigurimit të padisë.

Sipas nenit 297, pika 2 e LPK-së parashikohet që gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm nëse propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar, jep garanci në llojin dhe masën e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t’i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në ligj. Nëse propozuesi i sigurimit nuk jep garanci brenda afatit të caktuar nga gjykata, atëherë gjykata refuzon propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Po kështu, në pikën 4 të këtij neni, parashikohet që bashkësitë e pushtetit lokal janë të përjashtuara nga detyrimi i dhënies së garancisë. Edhe ligji “Per procedurën përbarimore” përmban një parashikim të

²⁷ A. Zogaj, Z. Leku, V. Tutaj, B. HasanPapaj, M. A. Cunniff, “Manual për zbatim të procedurës kontestimore”, Prishtinë, 2019, faqe, 199.

²⁸ Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi, “Procedurë Civile”, shtëpia botuese Albas, 2018, faqe, 302.

tillë, konkretisht në nenin 14, pika 2. Sipas kësaj dispozite, institucionet e Kosovës dhe organet ose shërbimet e tyre nuk janë të detyruara të deponojnë garancinë kur në procedurën përmbartimore dalin palë. Këtë parashikim nuk e hasim në Kodin e Procedurës Civile, në nenet që rregullojnë institutin e sigurimit të padisë.

Në të dyja rastet si në LPK dhe në KPrC, gjykata do të vendosë për sigurimin e padisë vetëm nëse ka një kërkesë/propozim të tillë nga paditësi/propozuesi i sigurimit. Nga termi i përdorur në Kodin e Procedurës Civile “kërkesë për sigurimin e padisë”, kuptohet që nuk kemi të bëjmë me një kërkesëpadi, pra që nuk synohet zgjidhja në themel e çështjes. Në LPK, është përdorur termi “propozim për sigurimin e padisë”. Edhe këtu, nga leximi tërësor i dispozitave që rregullojnë sigurimin e padisë, kuptohet që nuk synohet zgjidhja në themel e mosmarrëveshjes. Në fakt, në LPK, neni 304, përcakton sesi duhet të bëhet propozimi për sigurimin e padisë, pra në çfarë forme duhet paraqitur ai para gjykatës. Veçantia qëndron se propozimi mund të bëhet edhe gojarisht, nëse propozimi është i lidhur me procesin gjyqësor që është në zhvillim e sipër.

Në KPrC nuk gjejmë një parashikim të ngjashëm ligjor, përse i përket formës së kërkesës për sigurimin e padisë. Duke u referuar gjithashtu, në nenin 202, nenin 153 të Kodit të Procedurës Civile, themi që kërkesa për sigurimin e padisë bëhet në formë shkresore. Por nga ana tjetër, neni 115 i KPrC-së, parashikon që aktet procedurale, për të cilat ligji nuk kërkon një formë të caktuar, mund të kryhen në formën më të dobishme për arritjen e qëllimit të tyre. Duke qenë se, nuk përcaktohet shprehimisht në Kod një formë e caktuar për kërkesën për sigurimin e padisë, ajo mund të bëhet edhe në një formë tjetër, për sa kohë arrin qëllimin e saj. Llojet e masave për sigurimin e padisë janë të përcaktuara në nenin 206 të KPrC dhe në nenet 299, 300 dhe 301 të LPK-së.

Sipas LPK-së mund të bëhet sigurimi i:

- 1) Kërkesës në të holla²⁹.
- 2) Sigurimi i kërkesës i drejtuar ndaj sendit apo një pjese të caktuar të tij³⁰.
- 3) Sigurimi i të drejtave të tjera apo për ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave³¹.

²⁹ Neni 299 i ligjit “Për procedurën kontestimore”.

³⁰ Neni 300 i LPK-së.

³¹ Neni 301 i LPK-së.

Për sigurimin e kërkesës në të holla dhe sigurimin e kërkesës drejtuar ndaj sendit apo një pjese të caktuar të tij, janë caktuar në mënyrë taksative llojet e masave të sigurimit në LPK. Për sigurimin e të drejtave të tjera apo për ruajtjen e gjendjes ekzistuese të rrethanave, lista nuk është e mbyllur. Gjykata ka një hapësirë që të caktojë edhe masa të tjera, nëse e sheh të nevojshme dhe të domosdoshme për sigurimin e kërkesëpadsisë së propozuesit të masës përkatëse të sigurimit³².

Neni 206 i KPrC-së ka parashikuar se sigurimi i padsisë bëhet me anë të sequestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit. Vlen të theksohet që bëhet fjalë për sequestrimin konservativ. Pika b e nenit 206 e Kodit të Procedurës Civile, përdor termin “masa të tjera të përshtatshme”, duke i lënë gjyqtarit që sipas rrethanave të çështjes, të para sipërfaqësisht, të vendosë marrjen e masave të tjera që duhet të vlerësohen si të përshtatshme³³.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin njehsues nr. 10/2004, kanë përcaktuar që, masat e sigurimit nuk mund të merren për të rivendosur gjendjen e mëparshme të marrëdhënies kontraktore midis palëve, ashtu siç ka ekzistuar para lindjes së mosmarrëveshjes. *“Në asnjë rast nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkohshme të sigurimit të padsisë urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padsisë dhe që prapësohet nga i padituri.”* Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara theksojnë edhe raste përjashtimore, kur një gjë e tillë është e justifikueshme nga ana ligjore ose rezulton e nevojshme nga natyra e marrëdhënies juridike. Më tej, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shprehen që:

“Një masë e tillë e vendosur nga gjykata, që konsiston në rivendosjen e një lidhjeje të ndërprerë në mënyrë të njëanshme apo arbitrare, do të konsiderohej e ligjshme e do të përfshihej në masat e tjera të përshtatshme të sigurimit të padsisë, nëse do të parashikohej në mënyrë taksative në ligj dhe/ose do të rezultonte nga vetë natyra e marrëdhënies juridike (e kontratës së lidhur midis palëve)”

Të tilla janë p.sh disa kontrata furnizimi me lëndë të parë apo energji, të ndërvarura nga njëra-tjetra, që sigurojnë funksionimin e vazhdueshëm e të pandërprerë të një veprimtarie industriale, të një procesi teknologjik të caktuar, të

³² A. Zogaj, Z. Leku, V. Totaj, B. HasanPapaj, M. A. Cunniff, “Manual për zbatim të procedurës kontestimore”, Prishtinë, 2019, faqe, 202.

³³ Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi, “Procedurë Civile”, shtëpia botuese Albas, 2018, faqe, 309.

një veprimtarie të vendosur për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve etj., ndërprerja e të cilave do të shkaktonte dëme të pallogaritshme e të pariparueshme, shkatërrime të mëdha apo katastrofa. *Përsa u përket masave të tjera të përshtatshme që merren për sigurimin e padisë, në kuptim të nenit 206 pika “b” të Kodit të Procedurës Civile, duhet të kemi parasysh gjithashtu se edhe ato duhet të kushtëzohen kurdoherë nga një objekt material i përcaktuar, apo i përcaktueshem, i padisë. Është kjo aryeja që gjykata mund të lejojë sigurimin e padisë me disa nga llojet e ndryshme të masave të sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se ajo e padisë³⁴.*

Ankimi ndaj vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit.

Vendimet e ndërmjetme janë vendime që nuk synojnë të japin zgjidhje përfundimtare lidhur me themelin e padisë. Të tilla janë edhe vendimet e gjykatës për sigurimin e padisë. Në nenin 310 të LPK-së parashikohet mundësia që kundër vendimit të gjykatës mbi caktimin e masës së sigurimit, të paraqitet ankimi brenda një afati prej shtatë ditësh nga dita e dorëzimit të tij. Në Kodin e Procedurës Civile, nëse i referohemi nenit 470, vendimet e ndërmjetme (në këtë rast vendimi i gjykatës mbi sigurimin e padisë), mund të goditen në ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Por, për rastet e parashikuara shprehimisht në Kodin e Procedurës Civile, kundër vendimeve të ndërmjetme mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit ose rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë, brenda 5 ditëve nga njoftimi i tyre.

Neni 310, pika 3 e LPK-së përcakton: “Mbi ankesën vendos gjykata e shkallës së dytë (Apelit) brenda afatit 15 ditë nga dita në të cilën i arrin përgjigja në ankesë (nga ana e kundërshtarit të sigurimit) apo përfundimit për paraqitjen e saj”. Nga interpretimi i nenit 310, nuk janë përcaktuar shprehimisht se cilat do të jenë ato vendime që mund të ankimohen në gjykatën e shkallës së dytë (Apelit). Ndërsa në nenin 209 të KPrC-së janë parashikuar shprehimisht se cilat do të jenë ato vendime që do të ankimohen në gjykatën e apelit. Ato janë:

- 1) Vendimi i pranimit të kërkesës për sigurimin e padisë;
- 2) Vendimi i ndryshimit të masës së sigurimit të dhënë;
- 3) Vendimi i revokimit ose heqjes së masës së sigurimit;

³⁴Përmbledhje e vendimeve unifikuese të GJL 2000-2006, botim i QPZ-së, korrik, 2006, faqe, 291.

Megjithatë, ajo që konstatohet është se në nenin 209 të KPrC-së nuk ka një përcaktim të shprehur për ankimin kundër vendimit që rrëzon kërkesën për sigurimin e padisë. Edhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë, përbën një vendim të ndërmjetëm në kuptim të nenit 125 të KPrC-së³⁵. Kështu që, vendimi i gjykatës për rrëzimin e masës së sigurimit, mund të ankimohet së bashku me ankimin kundër vendimit përfundimtar që i jep fund shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Përpara ndryshimeve të vitit 1995, në Kodin e Procedures Civile italian, nuk ishte i parashikuar ankimi kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë. Në vitin 1995, dispozita e nenit 669 i KPrC italian u ndryshua duke lejuar ankimin edhe ndaj vendimeve për rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë, njësoj sikurse lejohej për vendimin e pranimit, ndryshimit, revokimit³⁶. Ky ndryshim u bë për shkak se Gjykata Kushtetuese Italiane e konsideroi antikushtetues nenin 669-terdecies për pjesën që nuk lejonte ankimin ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurim padie³⁷. Në arsyetimin e saj ka shprehur që mungesa e një parashikimi të tillë përbën një shkelje të së drejtës për t'u mbrojtur, duke pasur parasysh parimet që domosdoshmërisht duhet të karakterizojnë procesin civil, atë të barazisë së plotë të palëve para gjykatës dhe barazisë së armëve mes palëve.

Akti noterial si titull ekzekutiv.

Në nenin 22 të LPP-së është parashikuar si dokument përmbarues (*titulus executionis*) edhe akti noterial (në ligj dokumenti noterial i përmbarueshëm). Duhet theksuar që kjo është një risi e ligjit të ri nr. 04/L-139 “Per proceduren permbarimore”. Ligji i vjetër nr. 03/L-008 “Per procedurën përmbarimore” nuk e parashikonte si titull ekzekutiv aktin noterial. Për herë të parë në LPP parashikohet si titull përmbarimor edhe kontrata e hipotekës. Në nenin 199 të ligjit “Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore” parashikohet që: “Në rast të vonesës ose të një shkelje tjetër të kontratës nga debitori, kreditori hipotekues mund të fitojë përmes padisë gjyqësore që paluajtshmërinë e ngarkuar ta shesë dhe kërkesën e siguruar ta përmbushë në radhë të parë nga shuma rezultuese (e fituar nga shitja). Nga vetë titulli i nenit “Përmbushja e kërkesës së kreditorit

³⁵ Neni 125 i KPrC-së: Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi.

³⁶ Silvana Çinari, “Masat e sigurimit të padisë ne proceset gjyqësore dhe të arbitrazhit”, Tiranë, 2015, faqe, 61.

³⁷ *Ibid.* 62.

hipotekues përmes përbarimit të detyrueshëm”, kuptohet që kushtet dhe procedura që do të ndiqet do të mbështeten në dispozitat e përbarimit të detyrueshëm, pra në LPP. Ndërsa në KPrC, akti noterial ka qenë i parashikuar si titull ekzekutiv dhe vazhdon akoma të jetë i tillë, titull ekzekutiv. Neni 510 i KPrC-së, pika d: Janë tituj ekzekutivë aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare. Ky formulim që është aktualisht në fuqi, është ndryshuar disa herë, respektivisht me ligjet:

- a) ligji nr.8812, datë 17.5.2001
- b) ligji nr.9953, datë 14.7.2008

Kështu aktet noteriale si tituj ekzekutivë më parë formuloheshin si: akte noteriale që përmbajnë detyrime për pagime në para³⁸. Në shumë raste gjykata të shkallëve të ndryshme kanë quajtur tituj ekzekutivë kontratat e huasë të lidhura në formë noteriale³⁹. Madje është avancuar edhe më tej, duke quajtur si titull ekzekutiv edhe një kontratë shitjeje të letrave me vlerë, të lidhur në formë noteriale (me akt të përgatitur e të vërtetuar nga noteri). Një formulim tjetër ka qenë : Janë tituj ekzekutivë aktet noteriale me të cilat autorizohet shlyerja e një detyrimi kontraktual, ose e çdo detyrimi tjetër të mëparshëm, drejtëpërdrejt nga depozitat bankare ose nga paga e autorizuesit dhe në kreditë e tij tek të tretët⁴⁰. Me ligjin nr.9953, datë 14.7.2008, ndryshon formulimi i pikës d të nenit 510. Në ligjin “Per procedurën përbarimore”, neni 22, pika 3 nuk ka një formulim të aktit noterial si titull ekzekutiv, ashtu sikurse e gjejmë KPrC. Që të përbëjë titull ekzekutiv, sipas LPP mjafton vetëm që të jetë në pajtim me ligjin për noterinë, duke mos specifikuar se çfarë duhet të përmbajë ky dokument noterial, për të qenë titull përbarimor sipas ligjit. Tituj ekzekutiv janë kryesisht vendimet gjyqësore, por parashikimi i akteve noteriale si titulus executionis në LPP dhe KPrC, tregon që për nga fuqia e tyre ekzekutive barazohen për të gjitha efektet me vendimet gjyqësore të formës së prerë.

³⁸ Përmbledhje e vendimeve unifikuese të GJL 2000-2006, botim i QPZ-së, korrik, 2006, faqe 70.

³⁹ *Ibid.*

⁴⁰ *Ibid.* 72.

Parimet bazë në procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë.

Faza e ekzekutimit të detyrueshëm është pjesë e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së, e drejta për proces të rregullt ligjor do të ishte iluzionare, nëse një sistem i brendshëm i një shteti anëtar, do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej i paekzekutuar në dëm të palës, që ka fituar gjyqin⁴¹. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një element i rëndësishëm i së drejtës për një proces të rregullt, sepse një e drejtë e fituar mbetet pa vlerë nëse nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit⁴². Ekzekutimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e zbatimit të së drejtës të fituar juridiksht.

Lidhur me parimet, do t'i referohemi sidomos ligjit "Për procedurën përmbartimore". Kështu, krahas parimeve të përgjithshme, që mund të vlejné në procedurën e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, ekzistojné disa rregulla të veçanta, që vlejné kryesisht dhe veçanërisht vetëm në procedurën përmbartimore. Këto parime janë:

- a) parimi i legalitetit rigoroz formal;
- b) parimi i mbrojtjes së debitorit;
- c) parimi i prioritetit;
- d) parimi i efikasitetit;

Duke u bazuar në parimin e legalitetit rigoroz formal, organi përmbartues nuk mund të merret me faktin nëse titulli ekzekutiv është apo jo i drejtë dhe efektiv⁴³. Kjo është e kuptueshme meqë vendimi i formës së prerë është një çështje e gjykuar dhe si i tillë nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në një proces gjyqësor apo jashtëgjyqësor⁴⁴. Në procedurën e përmbartimit vlen edhe parimi i mbrojtjes së debitorit. Më konkretisht, detyrë parësore e procedurës së përmbartimit është realizimi faktik i kërkesave të kreditorit. Kështu lind nevoja që të mbrohet edhe interesi i kreditorit, por edhe interesi i debitorit për ruajtjen e

⁴¹ Ina Barjamaj, "Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe problematika e praktikës gjyqësore", Tiranë, 2016, faqe, 136.

⁴² *Ibid.*

⁴³ Iset Morina, "Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë" (*E drejta procedurale civile*), Prishtinë, 2019, faqe, 262.

⁴⁴ *Ibid.*

dinjitetit të tij⁴⁵. Mbrojtja e dinjitetit të debitorit në procedurën përbarimore është parashikuar shprehimisht në nenet 9, 342, 85 të LPP-së, me synimin kryesor në mbrojtjen e personalitetit të debitorit. Në KPrC nuk kemi një dispozitë që të parashikojë shprehimisht mbrojtjen e dinjitetit të debitorit sikurse në nenin 9 të LPP-së. Nisur nga neni 529 i Kodit të Procedurës Civile, qëllimi është mosvarfërimi i debitorit, sigurimi i minimumit ekzistencial për debitorin dhe anëtarët e tij të familjes dhe tërthorazi kuptojmë që kemi të bëjmë me një mbrojtje të pozitës së debitorit në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë. Sipas nenit 9 të LPP-së, organi përbarues ka për detyrë që të veprojë duke respektuar jo vetëm personalitetin e debitorit, por edhe të familjarëve të tij.

Interesant është parashikimi në pikën tre të nenit 9 të LPP-së. Në kuptim të kësaj dispozite, rregulli i përgjithshëm është që procedura e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë nuk mund të bëhet gjatë ditëve të pushimit ose gjatë orëve të natës. Por, nëse ekziston një arsye legjitime dhe nëse organi përbarues ka një miratim, organi përbarues mund të realizojë procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë gjatë ditëve të pushimit ose gjatë orëve të natës. Sërish mbetet e paqartë se cili do të jetë organi, që do t'i japë miratimin organit përbarues për të vepruar në një situatë të tillë. Neni 9 nuk shprehet në lidhje me këtë fakt. Pavarësisht se, ne nuk kemi një dispozitë në KPrC, si neni 9 i ligjit “Për procedurën përbarimore”, dalim në konkluzionin që përbaruesi gjyqësor, qoftë shtetëror apo privat, gjatë realizimit të detyrës së tij, duhet të ketë parasysh respektimin e dinjitetit të debitorit dhe anëtarëve të familjes së tij.

Ligji 26/2019 “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, në nenet 21 dhe 37 të tij ka parashikuar se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e përbaruesit gjyqësor privat. Neni 37, pika g, parashikon shprehimisht që përbaruesi gjyqësor privat ka detyrimin të marrë masat dhe veprimet e nevojshme për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, në respekt të dinjitetit njerëzor duke vënë në balancë nevojat e debitorëve dhe të kreditorëve. Mbrojtja e dinjitetit të debitorit parashikohet në një ligj të veçantë, sikurse u përmend ligji “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”.

Gjithashtu neni 21, pika 2 e ligjit “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, thekson që përbaruesi gjyqësor bën betimin para ministrit ose një përfaqësuesi të autorizuar prej tij, sipas deklaratës solemne: **“Betohe se detyrat**

⁴⁵ *Ibid.* 263.

e përmbaaruesit gjyqësor privat do t'i kryej në përputhje me ligjin, duke i qëndruar besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, do të ruaj sekretin profesional dhe gjatë veprimtarisë sime do të udhëhiqem nga parimet e profesionalizmit, paanësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut". Që nga këtu kuptojmë se një nga detyrat primare të përmbaaruesit gjyqësor privat gjatë ushtrimit të funksionit të tij, është respektimi i të drejtave të njeriut. Për më tepër, neni 38 i ligjit "Për shërbimin përmbaarimor gjyqësor privat", ndalon përmbaaruesin gjyqësor privat të kryejë veprime që çenojnë apo abuzojnë me subjektet që u nënshtrohen procedurave të ekzekutimit, duke listuar kategorinë e veprimeve që nuk duhet kryhen gjatë fazës së ekzekutimit të titujve ekzekutivë.

Parimi i efikasitetit dhe urgjencës (nenet 3 dhe 6 të LPP-së), nënkupton që procedura e përmbaarimit duhet të realizohet shpejt, brenda një afati të arsyeshëm. Praktika ka treguar që kemi pasur stërzgjatje të procedurës së ekzekutimit të titujve ekzekutivë, kjo për një sërë shkaqesh. Në të njëjtin përfundim, arrijmë edhe nga interpretimi literal i nenit 37 të ligjit "Për shërbimin përmbaarimor gjyqësor privat". Në vija të përgjithshme u prezantuan parimet që qëndrojnë në themel të procedurës së ekzekutimit, përpos parimeve të përgjithshme që janë paraqitur që në fillim të punimit.

Sendet mbi të cilat nuk mund të vendoset sekuestroja.

Sendet mbi të cilat nuk mund të vendoset sekuestroja, janë përcaktuar në nenin 529 të KPrC-së dhe në nenet 8 e 85 të LPP-së. Neni 8 i LPP-së parashikon që nuk mund të jenë objekt i ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë, sendet që janë jashtë qarkullimit civil, pasuritë nëntokësore dhe pasuritë e tjera natyrore, pajisjet e forcave të armatosura dhe të policisë, mjetet financiare të përdorura për këtë qëllim, në dallim nga KPrC-ja, që nuk e bën këtë parashikim. Rrethi i sendeve që përjashtohen nga vendosja e sekuestros, sipas nenit 529 të KPrC-së janë:

- 1) sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiljet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;
- 2) ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;
- 3) dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;

- 4) librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;
- 5) deri në 3 dynymë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për tre muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;
- 6) ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa studimi, përveç kur detyrimi është për ushqim.
- 7) Frutat natyrore një muaj para se ato të piqen;
- 8) Sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës.

Sipas nenit 85 të LPP-së, do të përjashtohen nga përbarimi:

- 1) Veshjet, këpucët, ndërresat dhe gjësendet tjera personale, çarçafët, veglat e kuzhinës, orenditë, stufa, frigoriferi dhe objekte tjera me vlerë të zakonshme që shërbejnë për përmbushjen e nevojave themelore të familjes, nëse janë të nevojshme nga debitori dhe familjarët e tij;
- 2) Furnizimi me ushqim për 3 muaj dhe materialet për nxehje që shfrytëzohen nga debitori dhe familjarët e tij;
- 3) Kafshët e punës dhe mbarështimit, pajisjet bujqësore dhe mjetet tjera, farërat, ushqimi për kafshë, mjetet, makinat dhe objektet tjera që i duhen debitorit, bujkut apo zanatliut për vazhdimin e punës në bujqësi;
- 4) Të hollat e gatshme të debitorit që ka të hyra të mujore të përhershme deri në shumën mujore që sipas ligjit përjashtohet nga përbarimi e proporcionalisht me afatin kohor deri në pagesën e ardhshme;
- 5) Librat dhe objektet tjera që janë të nevojshme për debitorin që në mënyrë të pavarur dhe me punë personale të kryejë një aktivitet shkencor, artistik apo aktivitet tjetër profesional;
- 6) Dekorimet, medaljet, certifikatat ushtarake të nderit apo dekoratat tjera të debitorit për vlerësimin e nderit, unazën e martesës, letrat personale, manuskriptet apo dokumentet tjera personale që i përkasin debitorit, si dhe fotografitë e familjes.
- 7) Mjetet mjekësore që u jepen personave me aftësi të kufizuara apo personave të tjerë me paaftësi fizike, në pajtim me rregulloret, apo që ai ka përvetësuar personalisht dhe që janë të domosdoshme për kryerjen e funksioneve jetësore.

Me ligjin Nr. 08/L-102 “Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-139 Për procedurën përbarimore i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 05/L-11

janë përjashtuar nga objekti i përmbarrimit të hyrat nga pakot emergjente apo masat specifike të miratuara nga Qeveria për rrethana të jashtëzakonshme apo emergjente, siç janë pandemitë apo fatkeqësitë natyrore. Nga leximi i dy dispozitave, nenit 85 të LPP-së dhe 529 të KPrC-së, nxjerrim në pah që në disa pika, kanë ngjashmëri midis tyre dhe në disa të tjera ndryshojnë nga njëra-tjetra. Pika 2 e të dy neneve është indetike. Domethënë, do të përjashtohen nga sekuestroja ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për 3 muaj. Në pikën 5 të nenit 529 të KPrC-së, është përcaktuar numri i kafshëve që do të përjashtohen nga sekuestroja, ndërsa në nenin 85, pika 3 e LPP-së nuk është përcaktuar. E veçanta për LPP qëndron se ajo ka parashikuar se, do të përjashtohen nga përmbarrimi mjetet mjekësore që u jepen personave me aftësi të kufizuara kurse KPrC-ja nuk e përmban një parashikim të tillë. KPrC-ja nga ana tjetër përjashton nga sekuestroja pensionet e pleqërisë, invaliditetit, familjarë, ndihma që u jepet nënave, bursat e studimit, ndërsa LPP-ja nuk e bën. Në pikat 1, 5 të nenit 85 janë parashikuar më shumë raste të përjashtimit se në pikën 1 dhe 3 të KPrC-së. Paragrafi 2 i nenit 85 të LPP-së parashikon që pakot postare apo transferimet monetare përmes postës që i janë adresuar debitorit nuk mund të jenë objekt i përmbarrimit para se t'i dërgohen debitorit.

Po cilat janë disa nga problemet e hasura gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë?

Panoramë e përgjithshme

Siç e kemi nënvizuar në këtë punim, një nga të drejtat themelore dhe të qenësishme të njeriut është e drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore si pjesë e elementëve të procesit të rregullt gjyqësor, vendos detyrime pozitive mbi shtetet, në mënyrë që ata të organizojnë instrumenta efikasë për ekzekutimin dhe krijimin e strukturave të specializuara në këtë fushë⁴⁶. Megjithëse Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut siguron gëzimin e së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, kjo e drejtë çënohet vazhdimisht nga organet e Administratës Publike⁴⁷. Në jurisprudencën e saj Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konstatuar pikërisht shkelje të parimit të procesit të rregullt gjyqësor nga ndërhyrjet apo nga mosrespektimi i

⁴⁶ Ina Barjamaj, "Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe problematika e praktikës gjyqësore", Tiranë 2016, faqe 155.

⁴⁷ Avokati i Popullit (Shqipëri), Raport i vecantë (II) "Administrata publike dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës", viti 2014, faqe 26.

dispozitive dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në fakt, një interpretim i tillë është bërë në çështjen Burdov kundër Rosisë⁴⁸. Në këtë rast, ku shteti paraqitej në rolin e debitorit, GJEDNJ arriti në konkluzionin që mungesa e fondeve nuk është një arsye për mosrespektimin e borxhit. Një vonesë në ekzekutimin e vendimit mund të arsyetohet, por kjo në disa raste të caktuara dhe specifike. Vonesa në ekzekutimin e vendimit nuk duhet të jetë e madhe sa të dëmtojë plotësisht thelbin e së drejtës nga dispozita e nenit 6/1 e Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁴⁹. Në çështjen në fjalë, parashtruesi i kërkesës nuk duhej të pengohej për të përfituar nga kompensimi i dëmit të shkaktuar ndaj shëndetit, duke u justifikuar me vështirësitë e supozuara financiare që po kalonte shteti⁵⁰.

Në analizimin e rolit të përmbaruesit gjyqësor privat kuptojmë që ata janë një hallkë e rëndësishme në efektivitetin e zbatimit të vendimeve gjyqësore. Kjo është vënë në dukje edhe nga GJEDNJ, duke përforcuar kështu detyrimet pozitive të shteteve. Në çështjen Pini, Bertani, Manera dhe Atripaldi kundër Rumanisë, më 22 qershor 2004, GJEDNJ ka evidentuar që përmbaruesit gjyqësorë veprojnë në interesin e një administrimi të mirë të drejtësisë, gjë që bën që ata të jenë një element thelbësor i shtetit të së drejtës⁵¹. Më tej, Gjykata vijon argumentimin e saj duke theksuar që autoritetet rumune mund të konsideroheshin përgjegjëse për veprimet e një institucioni privat që i kishte bërë pa vlerë dispozitat e nenit 6/1 të Konventës dhe duke sjellë nga ana tjetër dështimin për më tepër se tre vjet në marrjen e masave efektive për të respektuar vendimet gjyqësore të formës së prerë. Konflikti lindi pikërisht nga koha e tejzgjatur e moszbatimit të një vendimi gjyqësor të marrë në interes të fëmijëve.

Ky vendim (Pini, Bertani, Manera dhe Atripaldi kundër Rumanisë) dha një kontribut në një çështje tjetër të rëndësishme-gjykatat që merren me të drejtën familjare janë të detyruara që në marrjen e vendimeve të tyre të mbajnë parasysh në radhë të parë interesat e fëmijëve⁵². Ndaj një shtet duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme që përmbaruesit gjyqësorë të realizojnë dhe të përmbushin siç duhet detyrën e tyre. Kuptojmë që, çështja e respektimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt gjyqësor në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë prej autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e tyre, si rrjedhojë e

⁴⁸ Burdov kundër Rosisë, vendim i GJEDNJ-së i 7 majit 2002.

⁴⁹ Ina Barjamaj, "Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe problematika e praktikës gjyqësore", Tiranë 2016, faqe 155.

⁵⁰ *Ibid.*

⁵¹ *Ibid.* 156.

⁵² Ledi Bianku, Odeta Kumbaro, "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut", botimi i katërt, Tiranë, 2017, faqe 635.

mosekzekutimit të titujve ekzekutivë në një afat të arsyeshëm, ka qenë dhe mbetet një temë me rëndësi thelbësore, sepse lidhet me krijimin, forcimin dhe zhvillimin e një sistemi gjyqësor të respektueshëm për të gjithë⁵³.

Shtetet mbajnë përgjegjësi për vonesat që u atribuohen autoriteteve administrative dhe gjyqësore-një detyrë që kryhet pavarësisht kostove apo burimeve⁵⁴. Shtetet duhet të ofrojnë shërbime gjyqësore efikase për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë⁵⁵. Në rastin Muti kundër Italisë⁵⁶, GJEDNJ deklaroi se shtetet kanë detyrë t'i organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që t'u lejojnë gjykatave të respektojnë kushtet e nenit 6 paragrafi 1 i KEDNJ, përfshi edhe të drejtën për gjykimin brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Problemi i mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore ka qenë shqetësues si në Republikën e Shqipërisë ashtu edhe në Republikën e Kosovës dhe kjo lidhet me një sërë shkaqesh. Që në vitin 2004, sipas analizës që iu bë sistemit ligjor në Shqipëri nga OSBE, u nxor në dukje se besimi i publikut në sistemin e drejtësisë ishte shumë i ulët. Më tej, vijohet që shtetasit shqiptarë hasnin vështirësi të konsiderueshme në zbatimin e vendimeve gjyqësore⁵⁷. Shpeshherë, përmbaruesit thjesht nuk kishin burimet e nevojshme, ndonjëherë kuadri ligjor është i mangët. Megjithatë më shqetësuese ka qenë fakti se shtetasit shqiptarë që kanë fituar gjykimet për detyrim në të holla ndaj shtetit shqiptar, e kanë pasur të vështirë t'i ekzekutojnë titujt e tyre⁵⁸.

Kjo dukuri vazhdon, dhe në Proges Raportin 2014 për Shqipërinë, nga Komisioni European është evidentuar që ekzekutimi i vendimeve të gjykatave kombëtare, sidomos ato ku palë janë institucionet shtetërore, është i ngadaltë dhe vazhdon të dëmtojë sigurinë juridike. Kjo shkel parimin se shteti dhe ata që ushtrojnë pushtet në emër të shtetit, duhet t'u binden rregullave ashtu siç do shtetas. Pavarësisht përmirësimeve të dukshme që solli Shërbimi Përmbarimor Privat, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, për reduktimin e kohës për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, ende ka problematika të theksuara në këtë fazë.

⁵³ Avokati i Popullit (Shqipëri), “Raporti Vjetor 2018” (Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative), faqe 36.

⁵⁴ OSCE, “Drejt Drejtësisë”, viti 2013, faqe, 23.

⁵⁵ *Ibid.*

⁵⁶ Muti kundër Italisë, GJEDNJ, 23 mars i vitit 1994.

⁵⁷ OSBE, Prezenca në Shqipëri, “Analizë e sistemit ligjor në Shqipëri”, 2004.

⁵⁸ *Ibid.*

Sipas vlerësimit të institucionit të Avokatit të Popullit të R. Shqipërisë, në raportin e vitit 2018, cënimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të titujve ekzekutivë në një afat të arsyeshëm, ka ardhur si rezultat i këtyre faktorëve:

- 1) Mungesa e cilësisë profesionale e përmbartuesve gjyqësorë, që shfaqet në veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë fazës së ekzekutimit të titujve ekzekutivë;
- 2) Mosnjohja e legjislacionit civil dhe atij procedural nga ana e përmbartuesve gjyqësorë;
- 3) Kryerja e veprimeve përmbartimore jashtë objektit të ekzekutimit, si dhe keqinterpretimin e dispozitivit të vendimit gjyqësor;
- 4) Mungesa e vullnetit apo frika e përmbartuesve gjyqësorë, për vendosjen e sanksioneve ndaj personit të detyruar, sipas vendimit gjyqësor, apo ndaj personave të tjerë në procesin e ekzekutimit, që refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet, ose kryejnë të kundërtën e asaj që është vendosur në vendimin e formës së prerë të gjykatës;
- 5) Moskryerja në mënyrë korrekte e veprimeve përmbartimore si dhe mospërpilimin e akteve në përputhje me kompetencat e dhëna në legjislacionin në fuqi;
- 6) Moskryerja e veprimeve prej autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, të cilat mundësojnë përmbushjen e detyrimit në të holla, që institucioni shtetëror të paguajë sipas vendimit të formës së prerë të gjykatës; Po të njëjtat shkaqe janë listuar edhe në raportin vjetor “Për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit, 2019” (Shqipëri), me ndryshimin e vetëm që është shtuar dhe një shkak tjetër që ka ndikuar në mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Mosnxjerrja e akteve nënligjore prej Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat dhe atij për rendin dhe sigurinë publike, sikurse parashikuar në nenin 24, pika 3; nenin 36, pika 2; neni 39; neni 54, pika 4; neni 55, pika 3 dhe neni 56, pika 2, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 89 të ligjit “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” përbën faktorin ndryshe.

Ajo që bën përshtypje është sesi në raportet vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri, apo edhe në analizën që i është bërë sistemit të drejtësisë në vitin 2015, si ngërçe të rëndësishme në ekzekutimin e titujve ekzekutivë janë pikasur: mangësia profesionale tek një pjesë e stafit përmbartimor,

zvarritjet e pajustificuara gjatë procesi të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë, si dhe mungesa e transparencës dhe përkushtimit gjatë detyrës. Praktika ka treguar raste kur subjektet përbarimore kanë shkelur të drejtat e palëve, duke tejkalluar parashikimin që përmbajnë termat juridikë: kreditorë, debitorë. Pothuajse në çdo rast shkelje të tilla kanë ardhur si pasojë e ambiguitetit dhe paaftësisë së përbaruesit për të bërë një interpretim të drejtë të dispozitave ligjore dhe nënligjore⁵⁹. Shikojmë që performanca e përbaruesve gjyqësorë në realizimin efektiv të detyrave të tyre nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar. Kapacitetet profesionale e krijimi i mundësive për zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme/kualifikimi në përputhje me standartet dhe praktikat më të mira janë të ulëta.

3.2 Pikat kyçe të Raportit Vjetor 2019 të Avokatit të Popullit në

Republikën e Shqipërisë.

Procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë, ka mbartur të njëjtat vështirësi ndër vite sikurse është pasqyruar në raportet e kaluara të institucionit të Avokatit të Popullit. Një problematikë e trashëguar e që evidentohet dukshëm gjatë veprimtarisë së përbaruesvë gjyqësorë privatë, është sidomos procesi i ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë mbi të ardhurat mujore (pagën) të debitorit. Në fakt qoftë shërbimi gjyqësor përbarimor privat apo edhe ai shtetëror, kanë kryer dhe kryejnë sekuestrimin e të ardhurave mujore të debitorit, duke krijuar kështu situata në cënim të interesave jetikë të tij për shkak të mosrespektimit të parashikimeve të nenit 533 të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 123 të Kodit të Punës⁶⁰.

Neni 123 i Kodit të Punës parashikon shprehimisht që paga konsiderohet e paprekshme në masën që është e nevojshme për të siguruar jetesën e punëmarrësit dhe të familjes së tij. Paga e paprekshme ka për qëllim që të lejojë punëmarrësin për përballimin e të gjitha shpenzimeve apo kostove të domosdoshme jetësore personale⁶¹. Sipas përfundimeve që ka arritur Komiteti i Ekspertëve të së Drejtës Sociale të Këshillit të Evropës, të vitit 2010 për nenin 4/5 të Kartës Sociale

⁵⁹Komisioni i Posacëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, “*Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*”, qershor, 2015, faqe, 252.

⁶⁰ Avokati i Popullit, “*Raport Vjetor 2019*”, faqe, 59.

⁶¹ Albana Shtylla, “*Komentari i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë*”, Tiranë, 2017, faqe, 221.

Evropiane të Rishikuar, Shqipëria “*nuk ka vendosur që zbritjet nga paga nuk do të privojnë punëmarrësit dhe familjarët në varësi të tyre, nga mjetet e tyre të nevojshme të mbështetjes*” Paga e paprekshme nuk është e njëjtë me pagën minimale në shkallë vendi, pasi shpenzimet e secilit punëmarrës janë të ndryshme dhe mund të qëndrojnë mbi vlerën e pagës minimale. Po kështu, është gjykata ajo që cakton pagën e paprekshme duke u bazuar në provat që paraqet punëmarrësi për kostot e domosdoshme të jetës së tij dhe/ose familjes së tij. Këtu përfshijmë: shpenzimet për ushqim, veshje, ***kredi*** etj.

Nga ana tjetër, neni 533 i Kodit të Procedurës Civile parashikon që përmbaruesi gjyqësor nuk duhet të cënojë ***minimumin jetik***, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, kur sekuestrohet paga e debitorit. Pavarësisht këtij parashikimi, deri më sot minimumi jetik nuk është përcaktuar, duke bërë që neni 533 i KPrC-së të jetë i pazbatueshëm nga shërbimi përmbarimor shtetëror apo privat. **Kjo situatë meriton vëmendjen maksimale për trajtimin e saj në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në respektim të të drejtave të njeriut**⁶². Një çështje tjetër që është konsideruar e rëndësishme nga institucioni i Avokatit të Popullit është problematika që ky institucion ka pasur me përmbarues priavatë dhe Ministrinë e Drejtësisë. Në mënyrë të gabuar, kuptohet, se veprimtaria e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat është jashtë sferës së kompetencës dhe juridiksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit⁶³. Nga përmbarues gjyqësorë të veçantë është shfaqur një qëndrim refuzues për dhënie informacioni dhe shpjegime në lidhje me procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë.


Analiza statistikore e përmbarimit në vitet 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019 për Shqipërinë.

Gjatë vitit 2019: **47, 612** – çështje që janë regjistruar për ekzekutim. **10, 598** – çështje që u është dhënë zgjidhje ligjore ose e shprehur në përqindje, 22% të çështjeve që u është dhënë zgjidhje ligjor.

⁶² Avokati i Popullit, “Raport Vjetor 2019”, faqe, 59.

⁶³ *Ibid.* 60.

| Periudha | Total i çështjeve | Numri i ÇZL | % e ÇZL |
|------------------|-------------------|-------------|---------|
| Viti 2015 | 42 417 | 12 148 | 29% |
| Viti 2016 | 44 437 | 13 487 | 30% |
| Viti 2017 | 46 394 | 12 411 | 27% |
| Viti 2018 | 44 055 | 15 056 | 34% |
| Viti 2019 | 47 612 | 10 598 | 22% |



1. Gjatë vitit 2015 nga 42, 417 çështje gjithësej rreth 12,148 iu është një zgjidhje ligjore.
2. Në vitin 2016 nga 44, 437 çështje gjithësej, 13,487 iu është dhënë zgjidhje ligjore.
3. Në vitin 2017 nga 46,394 çështje, 12,411 prej tyre iu është dhënë zgjidhje ligjore
4. Në vitin 2018 nga 44,055 çështje gjithësej, 15,056 iu është dhënë një zgjidhje ligjore.
5. Në vitin 2019 nga 47,612 çështje, 10,598 iu është dhënë zgjidhje ligjore

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E VITIT 2019 PËR SHQIPËRINË

| Gjykata e Rrethit Gjyqësor | Çështje totale | Me afat të plotësuar | | | Brenda afatit | | | Refuzuar | Pezulluar me vendim gjykatë | Të transferuara | Pushuar | GjobC përmb. | Kallëzim penal |
|-------------------------------|----------------|----------------------|------------|---------|---------------|------------|---------|----------|-----------------------------|-----------------|---------|--------------|----------------|
| | | Në ekzekutim | Ekzekutuar | Pushuar | Në ekzekutim | Ekzekutuar | Pushuar | | | | | | |
| Berat | 1,441 | 0 | 0 | 0 | 1,168 | 261 | 0 | 0 | 0 | 12 | 0 | 0 | 0 |
| Dibër | 1,120 | 0 | 0 | 0 | 579 | 270 | 171 | 6 | 0 | 94 | 0 | 0 | 0 |
| Durrës | 7,528 | 0 | 0 | 0 | 6,601 | 797 | 11 | 0 | 28 | 88 | 3 | 0 | 0 |
| Elbasan | 5,348 | 0 | 0 | 0 | 4,125 | 815 | 237 | 81 | 2 | 82 | 6 | 0 | 0 |
| Fier | 1,441 | 0 | 0 | 0 | 624 | 448 | 198 | 1 | 0 | 165 | 5 | 3 | 0 |
| Gjirokastrë | 1,129 | 0 | 0 | 0 | 914 | 121 | 3 | 0 | 0 | 15 | 76 | 0 | 0 |
| Kavaje | 1,139 | 783 | 325 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 14 | 17 | 0 | 0 | 0 |
| Korçë | 2,998 | 25 | 1 | 0 | 1,694 | 617 | 8 | 10 | 6 | 634 | 3 | 0 | 0 |
| Krujë | 435 | 0 | 0 | 0 | 209 | 162 | 1 | 0 | 54 | 9 | 0 | 0 | 0 |
| Kukës | 1,071 | 22 | 39 | 560 | 328 | 111 | 0 | 1 | 0 | 6 | 4 | 0 | 0 |
| Kurbin | 740 | 0 | 0 | 0 | 349 | 215 | 4 | 0 | 133 | 39 | 0 | 0 | 0 |
| Lezhë | 1,173 | 0 | 0 | 0 | 475 | 412 | 5 | 7 | 208 | 61 | 5 | 0 | 0 |
| Lushnjë | 1,316 | 0 | 0 | 0 | 501 | 339 | 86 | 1 | 347 | 42 | 0 | 0 | 0 |
| Mat | 554 | 0 | 0 | 0 | 359 | 86 | 0 | 0 | 96 | 13 | 0 | 0 | 3 |
| Përmet | 120 | 3 | 5 | 20 | 52 | 34 | 0 | 0 | 0 | 6 | 0 | 11 | 0 |
| Pogradec | 698 | 115 | 10 | 0 | 388 | 88 | 74 | 0 | 0 | 23 | 0 | 0 | 0 |
| Pukë | 271 | 0 | 0 | 0 | 125 | 70 | 0 | 7 | 4 | 18 | 47 | 0 | 0 |
| Sarandë | 1,948 | 0 | 0 | 0 | 660 | 261 | 0 | 0 | 0 | 1,027 | 0 | 0 | 0 |
| Shkodër | 1,736 | 0 | 0 | 0 | 992 | 469 | 11 | 6 | 243 | 15 | 0 | 0 | 0 |
| Tiranë | 13,141 | 0 | 0 | 0 | 11,370 | 1,072 | 74 | 8 | 22 | 235 | 0 | 0 | 0 |
| Tropojë | 243 | 0 | 0 | 0 | 81 | 143 | 2 | 1 | 1 | 15 | 0 | 0 | 0 |
| Vlorë | 2,022 | 0 | 0 | 0 | 1,204 | 546 | 258 | 0 | 0 | 14 | 0 | 1 | 0 |
| Totali | 47,612 | 948 | 380 | 580 | 33,158 | 7,337 | 1,143 | 129 | 1,158 | 2630 | 149 | 15 | 3 |

*Të dhënat e mësipërme janë marrë nga Kreu XV i Vjetarit Statistikor të Ministrisë së Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, për vitin 2019. Më saktësisht janë të dhëna statistikore të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit Gjyqësor. Këtu na paraqitet sesi ka ecur procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë në Republikën e Shqipërisë gjatë vitit 2019.

Edhe sipas raportit të vitit 2016 nga institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë vihet re se ka pasur një numër të konsiderueshëm të ankesave⁶⁴ lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Sipas raportit të 6 mujorit të parë për vitin 2016 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në lidhje me çështjet civile, rezultojnë se gjykatat kanë pasur në shqyrtim 3179 çështje, prej të cilave 880 janë ekzekutuar dhe 2299 kanë mbetur pa u ekzekutuar. Kjo tregon se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në Kosovë mbetet i ulët. Ka shumë vendime gjyqësore që kanë mbetur të paekzekutuara në Kosovë dhe që disa prej tyre janë shqyrtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, ku janë konstatuar edhe shkelje të nenit 31 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës e që është kërkuar ekzekutimi i këtyre vendimeve⁶⁵. Vërehet se përmbaruesit privat e kanë përmirësuar nivelin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe qytetarëve u është ofruar mundësi më efikase dhe efektive në realizimin e të drejtave të tyre⁶⁶. Kjo pjesë e raportit të institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë gjatë vitit 2016, është kontradiktore me atë që paraqitëm më sipër. Në këtë raport (raporti i Avokatit të Popullit në Kosovë, 2016) u theksua fakti që kemi të bëjmë me një numër të lartë vendimesh gjyqësore të paekzekutuara dhe nga ana tjetër po në këtë raport thuhet që është përmirësuar niveli i ekzekutimit nga përmbaruesit gjyqësorë private.

Kur përmbaruesit privatë e kanë rritur performancën e tyre, atëherë pse në raportin e 6-mujorit të parë 2016 të KGJK-së rezultojnë 2299 vendime të paekzekutuara nga 3179 vendime gjithësej? Kjo tregon se përmbaruesit gjyqësorë privatë diku janë penguar ose kanë treguar neglizhencë gjatë kryerjes së detyrës së tyre. Është parë si pengesë kryesore në disa situata të caktuara, gjendja ekonomike e debitorit. Nga 104777 raste përmbarimore civile të pazgjydhura në sistem nga fundi i vitit 2010, numri më i madh 47509 ose 45% i rasteve të përgjithshme kanë qenë në Prishtinë, Peja me numrin e dytë më të madh prej 30155 ose 29% të numrit të përgjithshëm dhe vendin e tretë e zinte Prizreni me 16381 vendime të paekzekutuara ose 16% të rasteve përgjithshme⁶⁷. Vendi i katërt dhe i pestë mbahej respektivisht nga Gjilani me 8448 raste ose 8% të numrit të përgjithshëm dhe Mitrovica me 2284 ose 2% të numrit të përgjithshëm të rasteve përmbarimore civile të pazgjydhura në Kosovë. Në një analizë të kornizës aktuale ligjore në

⁶⁴ Ankesat, A.928/2016, kundër Gjykatës Themelore Prishtinë, A.842/2016, kundër Gjykatës Themelore Prishtinë, A.778/2016, kundër Gjykatës Themelore Prishtinë-Dega Gillogoc, A.303/2015 kundër Gjykatës Themelore Prizren.

⁶⁵ Avokati i Popullit (Kosovë), “Raport vjetor 2016”, Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore, faqe, 24.

⁶⁶ *Ibid.* 25.

⁶⁷ OSCE, Misioni në Kosovë, “Ekzekutimi i aktgjykimeve”, janar, 2012, faqe, 12.

Kosovë që rregullon procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, ku si ligj më të rëndësishëm përmendim ligjin “Për procedurën përmbartimore”, themi që sërish përmbartuesit privatë në Kosovë, po kështu dhe Oda e Përmbartuesve Privatë të Kosovës përballen me sfida të shumta. Ekzistenca e problemeve, vështirësive ka ndikuar negativisht në përmbartimin e titujve ekzekutivë, veçanërisht ndikojnë në zvogëlimin e performancës dhe dëmtimin e imazhit të përmbartuesve privatë në Kosovë. Gjatë vitit 2019 në Odë janë pranuar edhe ankesa ndaj përmbartuesve. Ka pasur rreth 71 ankesa ndaj përmbartuesve privatë, në dallim nga viti 2018 ku janë pranuar rreth 58 ankesa.

Shumica e këtyre ankesave kanë pasur në thelb punën e përmbartuesve privatë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre⁶⁸. Ankesat në përgjithësi janë shqyrtuar brenda afateve të arsyeshme dhe para se Oda të përgjigjej, secila nga ankesat iu është dërguar përmbartuesit ndaj të cilit është bërë ankesa⁶⁹. Oda e Përmbartuesve Privatë në Kosovë, ka dhënë mendimin e saj profesional në lidhje me ankesat. Mendimi profesional që jep Oda nuk konsiderohet që është një derivat i një procedure administrative, dhe nuk paragjykon ose parandalon asnjë procedure tjetër, cfarëdo natyre të ketë. Ka pasur raste (ndonëse të pakta në numër) që përmbartuesit nuk i kanë dërguar përgjigje Odës, prova të bashkëngjitura përgjigjes lidhur me ankesat e parashtruara ndaj tyre. Ndodhur në këto rrethana, Oda është shprehur që nuk mund të japë një mendim profesional bazuar vetëm në deklaratimet e njërës palë⁷⁰. Vetë neni 372 i ligjit “Për procedurën përmbartimore” përcakton që Komisioni Disiplinor menjëherë vë në dijeni përmbartuesin privat se ndaj tij ka nisur procedimi disiplinor dhe përmbartuesi ka të drejtën që në një afat prej 15 ditësh të paraqesë mbrojtjen me shkrim.

Gjatë vitit 2019 në mbi 80% e ankesave të shqyrtuara nga Komisioni disiplinor përmbartuesit privatë janë shpallur jopërgjegjës. Kjo rritje e jashtëzakonshme e ankesave ndaj përmbartuesve privatë është si rezultat i dispozitavë ligjore të LPP-së, të cilat nuk kanë vendosur një filtër për shqyrtim paraprak të ankesave. Në cdo procedure (administrative ose gjyqësore) ekziston ajo që quhet **shqyrtim paraprak** i ankesave ose kërkesave të palëve, ndërsa në LPP nuk ka një parashikim të tillë lidhur me proceduren dhe punën e Komisionit Disiplinor⁷¹. Përkatësisht në nenin 366 të LPP-së vihet re ky vakum ligjor. Çdo

⁶⁸ Oda e Përmbartuesve Privatë, “Raport i Punës së Odës së Përmbartuesve Privatë për vitin 2019”, mars, 2020, faqe, 38.

⁶⁹ *Ibid.*

⁷⁰ *Ibid.*

⁷¹ *Ibid.* 37.

ankesë ose kërkesë e kujtdo qoftë (madje edhe në rastet kur ankuesi nuk është fare palë në procedurë) ka shkaktuar pasoja shumë negative për tërë sistemin e përbarimit, si psh rritja e madhe e nr. të ankesave, shpenzime të mëdha të buxhtetit të Odës, imazhi publik i përbaruesit (meqë perceptohet si shkelës por që në fakt në fund shpallet jopërgjegjës), performanca negative e Komisionit Disiplinor (pasi pjesa më e madhe e ankesave kanë qenë të pabaza).

Siç e përmendëm pak më sipër, përbaruesit privatë, Oda, vihen përballë shumë sfidave. Listojmë këtu:

- 1) Korniza ligjore është e paqartë ose e dykuptimtë, e mangët dhe në disa çështje e rregulluar në mënyrë joprofesionale;
- 2) Çështjet disiplinore (përfshirë kompetencat e Komisionit Disiplinor) ndaj përbaruesve privatë nuk janë rregulluara siç duhet;
- 3) Financimi i Komisionit Disiplinor nga Oda është tërësisht mënyrë e gabuar, joprofesionale dhe e dëmshme për pjesën financiare të Odës;
- 4) Mungesa e bashkëpunimit me disa institucione (psh Agjencia Kadastrale e Kosovës); etj.

Ligji “Për procedurën përbarimore” është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2017 dhe së fundmi në vitin 2023.. Është parë që në praktikë këto ndryshime dhe plotësime që ka pësuar LPP kanë shkaktuar paqartësi dhe vështirësi të shumta në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë. Sipas raportit të vitit 2019 i Odës së Përbaruesve Privatë, Kosovë janë indetifikuar dispozita të ligjit “Për procedurën përbarimore” që kanë shkaktuar impakte negative. Një ndër to është veçuar neni 247 i LPP-së. Ky nen është konsideruar si i “dëmshëm” për debitorin, por edhe në kundërshtim me të gjitha parimet e drejtësisë dhe standartet ndërkombëtare të përbarimit (neni 13 i LPP-së). Nuk është vetëm ky problemi i vetëm, ka dhe çështje që nuk janë rregulluar fare në ligj, pra vihemi përballë një zbrazëtire juridike sidomos në rastin e dorëheqjes së përbaruesit privat, sesi do vazhdohet me titujt ekzekutivë që ky përbarues ka nën ngarkim. Krahas kësaj, shqetësues paraqitet fakti se nuk kemi një përcaktim të qartë në LPP të kompetencës (territoriale por edhe lëndore) të përbaruesit privat. Disa gjykata konsiderojnë që përbaruesi privat është kompetent për të gjitha çështjet monetare, ndërsa disa të tjera shprehen që përbaruesi privat nuk është kompetent për të gjitha çështjet monetare⁷².


⁷² Oda e Përbaruesve Privatë, “Raport i Punës së Odës së Përbaruesve Privatë për vitin 2019”, mars, 2020, faqe 39.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm që ka efekt si për palët në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë është fakti që kreditori (përfshirë këtu edhe institucionet publike) ka të drejtë të zgjedhë përmbaruesin. Një mundësi dhe një e drejtë e tillë sidomos në rastin kur kreditor është një institucion/organ publik ka shkaktuar shumë pakënaqësi, problem dhe mund të shkaktojë korrupsion pasi institucioni publik do të duhej të ofrojë shërbime të barabarta për të gjithë qytetarët⁷³. Nga ana tjetër është vërejtur si problematikë pjesëmarrja e ulët e përmbaruesve privatë në trajnime, por edhe në aktivitete të Odës. Ka cështje që janë parashikuar në LPP sikurse aktivitetet plotësuese të përmbaruesit privat, por që nuk kanë dalë aktet nënligjore përkatëse, të nevojshme për të shmangur paqartësitë në të ardhmen.


Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë më rastin e mbylljes së vitit kalendarik 2019 organizoi konferencën e prezantimit të rezultateve të punës të këtij institucioni. Në këtë konferencë Avokati i Popullit z. Hilmi Jashari theksoi që Kosova si një nga problemet më serioze ka legjislacionin e saj. Domethënë, një pjesë e madhe e ligjeve që nxirren ende nuk janë të harmonizuara dhe së dyti ende vazhdon të mos ketë një kodifikim të së drejtës, gjë që prek gjithë sistemin e drejtësisë duke pamundësuar në njëfarë mënyre zbatimin adekuat të ligjeve. Në vijim të kësaj konferencë u përmend fakti që sistemi gjyqësor në vitin 2019 ka pasur zvarritje të shqyrtimit të cështjeve, dukë cuar kështu në shkelje të të drejtave të njeriut duke kaluar kufijtë e afatit të arsyeshëm, për më tepër se 5 vjet. Nëse i referohemi të dy raporteve të institucionit të Avokatit të Popullit, përkatësisht atij të vitit 2019 dhe 2020, numri më i madh i rasteve të hetuara nga IAP gjatë periudhës raportuese lidhen kryesisht me të drejtën për një gjykim të paanshëm dhe të drejtë.

⁷³ *Ibid.* 40.

Analizë Statistike Për Republikën e Kosovës.




Siç e shikojmë nga grafiku i vitit 2015, numri i çështjeve të pazgjidhura (ku me çështje të zgjidhura do të kuptojmë titujt që janë ekzekutuar nga përmbaruesit privatë në Kosovë) është me e madhe se ajo e çështjeve të zgjidhura. Numri total i çështjeve është rreth 19,704, i çështjeve të zgjidhura 4,485 dhe ai i çështjeve të pazgjidhura 14,820⁷⁴.



⁷⁴ Ismajl Shabani, "Përmbarimi Privat në Republikën e Kosovës", Prishtinë, 2019, faqe, 32.

Sërish, duke studiuar grafikun për vitin 2016, kuptojmë që ka një numër të lartë të çështjeve të pazgjidhura. Numri i përgjithshëm i çështjeve për vitin 2016 ka qenë 28,415 në total, ku 5732 i takon numrit të çështjeve të zgjidhura dhe 21,873 ai i çështjeve të pazgjidhura⁷⁵.



Sipas grafikut numër 4 për vitin 2017, edhe këtu vërehet problematika e hasur në vitet 2015, 2016 në lidhje me mosekzekutimin e titujve ekzekutivë. Bëhet fjalë për 46,596 çështje në total, ku 7798 është numri i çështjeve të zgjidhura dhe 36,978 ai i çështjeve të pazgjidhura⁷⁶.

Për shkak të vështirësive gjatë procesit të konsolidimit të shtetit kosovar, mungesës së personelit dhe resurseve, tranzicionit të vazhdueshëm, janë grumbulluar shumë çështje të vjetra e të pazgjidhura⁷⁷. Kjo ka shkaktuar që qytetarët kosovarë të kenë një mungesë besimi në sistemin e drejtësisë, dukuri që e hasëm edhe në sistemin shqiptar të drejtësisë. Kur në vitin 2015 KGJK-ja filloi me përpilimin e statistikave të integruara 430,923 çështje prisnin të zgjidheshin në shkallë të ndryshme të gjyqësorit, deri në fund të vitit ky numër arriti në 440,923⁷⁸. Ligji “Për procedurën përmbartimore” solli një ndihmesë në këtë

⁷⁵ Ismajl Shabani, “Përmbartimi Privat në Republikën e Kosovës”, Prishtinë, 2019, faqe 33.

⁷⁶ *Ibid.* 34.

⁷⁷ Balkans Policy Research Group, “Gjyqësori i keq-administruar i Kosovës”, shtator, 2019, faqe, 21.

⁷⁸ *Ibid.*

drejtim, por sërish marrja e aktgjykimit për ekzekutim mbetet një çështje e paorganizuar që kërkon kohë dhe vëmendje. Institucioni i Avokatit të Popullit, është shprehur që ka një hendikap në sistemin gjyqësor, pasi numri i vendimeve gjyqësore të paekzekutuara arrin në 100,000.

Sipas tij (Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë), autoritetet përgjegjëse duhet të bejnë diçka, sepse ky është një problem që prek jo vetëm sistemin e drejtësisë, por që tregon dhe dobësinë e shtyllave të tjera të pushtetit dhe zbeh besimin e qytetarëve. Duke qenë se procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë është shoqëruar gjithmonë me problematika janë ndërmarrë iniciativa të ndryshme për të minimizuar të tilla probleme. Në fillim të vitit 2019 numri i lëndëve (çështjeve të vjetra) ishte zvogëluar në 245,515 që është rreth 44% më pak krahasuar me tre vite më parë⁷⁹. Gjatë vitit 2017 gjykatat vendore kishin në dispozicion rreth 415 ditë për zgjidhjen e një çështjeje. Kjo është më shumë se dyfishi, krahasuar me mesataren evropiane e cila sipas Komisionit Evropian për Efikasitet të Drejtësisë (KEED) të Këshillit të Evropës është, 235 ditë për një çështje civile, 315 ditë për një çështje administrative dhe 138 ditë për çështjet penale⁸⁰. Ajo që evidentojmë nga tërësia e raporteve, studimeve, që i janë bërë sistemit të drejtësisë në Kosovë, veçanërisht fazës së përbarimit të titujve ekzekutivë, është se nuk janë specifikuar qartë dhe shprehimisht se cilët janë ato faktorë kyç që shkaktojnë këtë problematikë në procesin e ekzekutimit. Në disa prej tyre janë listuar por nuk janë shtjelluar dhe analizuar, të paktën ato që janë prezantuar dhe paraqitur në këtë punim. Informacionet/të dhënat në lidhje me vështirësitë në pjesën më të madhe të rasteve nxirren indirekt ose janë të shpërndara në hapësira të veçanta të këtyre raporteve.

Për shembull, në këto studime nuk është përmendur apo përcaktuar shprehimisht si shkak mangësia e cilësisë profesionale apo qasja jo e duhur e përbaruesve gjyqësorë privatë. Ndërkohë sipas mendimit tim, është një shkak për t'u vlerësuar si burim vështirësie. Këtë e nxjerr indirekt nga Raporti i Punës së Odës së Përbaruesve Privatë për vitin 2019, ku është vërejtur pjesëmarrja e ulët e përbaruesve privatë në trajnime dhe aktivitete të tjera të Odës. Trajnimet i shërbejnë veprimtarisë së përbaruesve privatë dhe janë në të mirë të përsosjes së performancës së tyre. Kjo jo domosdoshmërisht do të thotë që këta përbarues që nuk marrin pjesë në trajnime janë të paaftë në realizimin e detyrave të tyre, por

⁷⁹ Balkans Policy Research Group, "Gjyqësori i keq-administruar i Kosovës", shtator, 2019, faqe, 22.

⁸⁰ *Ibid.*

nuk mund të mos themi që do të ketë një lloj mangësie në formimin e mëtejshëm të tyre. Përpos këtyre, është theksuar shpeshherë paqartësia dhe dykuptimtësia e disa dispozitave të ligjit “Për procedurën përmbartimore”. Atëherë si mund të premtojnë për një proces ekzekutimi të suksesshëm, përmbartues që refuzojnë ose neglizhojnë pjesëmarrjen e vazhdueshme në aktivitete të Odës apo në trajnime? Si do munden ata të zbatojnë këto dispozita të paqarta apo dhe të tjera të LPP-së? Në këndvështrimin tim, duke qenë se përmbartuesi gjyqësor privat është një aktor i rëndësishëm në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë është e pamundur që të mos analizohet sjellja e tij në këtë fazë. Shtoj këtu, që edhe numri i vendimeve gjyqësore të paekzekutuara ka qenë i lartë në Kosovë ndër vite dhe përmbartuesi gjyqësor privat nuk mund të mos cilësohet si faktor esencial që ka ndikuar në këtë aspekt.

Në analizën e procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës, nxjerrim në dukje problematikat e vazhdueshme, që kanë cënuar konceptin e “procesit të rregullt ligjor” dhe “afatin e arsyeshëm”. Duhet theksuar që, në të dy shtetet janë ndërmarrë hapa dhe masa për të bërë progres në këtë fazë të rëndësishme, atë të ekzekutimit të titujve ekzekutivë, por që përmirësimi ka qenë shumë i ngadalhtë. Në atë që është parashtruar më sipër, ndër vite numri i vendimeve gjyqësore të paekzekutuara ka qenë i lartë. Ndonëse sipas studimit të gjyqësorit në Kosovë, i realizuar nga Balkans Policy Research Group, në vitin 2019 është shënuar një zvogëlim i çështjeve të vjetra, të mëparshme, pra rreth 44% më pak se në vitet 2018, 2017 dhe 2016, në Shqipëri përgjatë këtij viti 37,014 çështje kanë mbetur pa zgjidhje ligjore nga 47,612 çështje në total. Bëhet fjalë vetëm për 10,598 çështje që kanë përfunduar me sukses. Ky është një numër i ulët në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve, përkthyer në përqindje, i takon rreth 22%.

Një e përbashkët e konstatuar midis krahasimit të problematikave të të dy sistemeve është ai i mungesës së bashkëpunimit me institucionet e përfshira në procesin e ekzekutimit⁸¹. Kjo është evidentuar edhe në raportin e punës së Odës së Përmbartuesve Privatë për vitin 2019 në Kosovë. Përmendim që si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, gjatë ekzekutimit të vendimeve të gjykatave ku palë kanë qenë institucionet shtetërore, ka pasur një ‘ngadalësi’ në këtë proces dhe disa vështirësi. Gjithashtu, problem ka qenë dhe mosrespektimi i dispozitave ligjore të LPP-së dhe Kodit të Procedurës Civile lidhur me procesin e ekzekutimit të titujve

⁸¹ Komisioni i Posaçëm Parlamentar Për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, “Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri”, qershor, 2015, faqe, 251.

ekzekutivë mbi të ardhurat mujore të debitorit dhe moskryerja në mënyrë korrekte e veprimeve përbarimore. Në Kosovë në raportin e vitit 2016 të Institucionit të Avokatit të Popullit është evidentuar fakti që në disa raste përbaruesit privatë kanë tejkaluar normat ligjore lidhur me ekzekutimin e titujve ekzekutivë, duke “bllokuar” ndihmat sociale, pensionet e pleqërisë.

Sistemi elektronik ALBIS në Shqipëri, që do të përqëndronte dhe standartizonte procesimin e mijëra çështjeve të përbarimit gjyqësor, në njëfarë mënyrë dështoi. Rezultoi që ALBIS nuk ishte plotësisht në funksion, për arsye të nevojës për një mbështetje të vazhdueshme teknike dhe kërkesës për një shtytje të mëtejshme drejt implementimit të tij, duke sjellë problem në regjistrimin e çështjeve përbarimore⁸². Për një kohë relativisht të gjatë procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë është parë si i shkëputur nga tabloja e procesit të rregullt ligjor. Një qasje e cila është shoqëruar me një zinxhir pasojash negative, siç e pamë më lart. Vendimet e GJEDNJ-së janë përkthyer në shembuj të denjë për t’i dhënë rëndësinë e duhur fazës së ekzekutimit. Sigurisht që, ka akoma për të bërë, pasi këto probleme janë shqetësuese dhe nëse nuk trajtohen shpejt e me efikasitet, drejtësia rrezikon të humbasë qëllimin e saj dhe besimi në drejtësi mund të shuhet.

Rast nga praktika në Kosovë në lidhje me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Në janar të vitit 2009, një nxënëseje 15 vjeçare, në shkollën e mesme i ishte tërhequr vëmendja nga autoritetet e shkollës që ajo duhet të zgjidhte midis mbajtjes së shamisë dhe të largohej nga shkolla apo të hiqte shamine dhe të vazhdonte normalisht me studimet. Në rast se ajo do të zgjidhte të mbante shaminë ajo do të përjashtohej nga shkolla. Në prill të vitit 2009, ajo inicioi një procedurë administrative në përpjekje që ta shtynte Departamentin për Arsim në komunën ku ajo banonte, që t’i lejonte kthimin në shkollë. Kjo procedurë rezultoi e pasuksesshme dhe në shtator të vitit 2009, ajo vuri në lëvizje Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme u shpreh që nuk kishte juridiksion për këtë çështje dhe e dërgoi në Gjykatën e Qarkut. Më 17 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut vendosi në favor të paditëses dhe e gjeti në shkelje Departamentin për Arsim, duke theksuar që Departamenti për Arsim nuk ka pasur baza ligjore për ta kërcënuar paditësen me përjashtim nga shkolla dhe që duhet ta kthejë në shkollë për të vijuar me mësimet.

⁸² *Ibid.* 252.

Departamenti për Arsim nuk e ankimoi këtë vendim të Gjykatës së Qarkut dhe ka refuzuar ta zbatojë vendimin.

Në një intervistë me monitoruesin e OSBE-së, zyrtarët komunalë kishin thënë që nuk u interesonte se çfarë kishte vendosur gjykata dhe ishin të vendosur se nuk kishin ndërmend të rikthenin nxënësen në shkollë pasi ajo mban shaminë në kokë⁸³. Kjo dëshmon një mospërfillje totale ndaj vendimit të gjykatës. Vonesa e vazhdueshme në zbatimin e vendimit shkel të drejtën e paditëses për një gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm, por çenohet në këtë rast edhe e drejta për t'u arsimuar. Këto fakte pasqyrojnë natyrën urgjente të zbatimit të vendimit gjyqësor dhe përbën një nga ato çështje që sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së institucionet kanë detyrimin ta trajtojnë me përgjegjësi dhe brenda një kohe të arsyeshme⁸⁴.

Komisioni Evropian, në Raportin e vet të Progresit në Kosovë për vitin 2010, nënvizon që disa komuna vazhdimisht kanë refuzuar t'i zbatojnë vendimet gjyqësore⁸⁵. Ka dhe raste të tjera nga praktika që tregojnë se, kur organi publik është në cilësinë e debitorit janë sfida të posaçme për përmbarimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare. Duhet bërë një dallim thelbësor midis ekzekutimit të detyrueshëm kundrejt subjekteve private dhe atyre shtetërore. Nëse shteti paraqitet në cilësinë e debitorit kundrejt një personi tjetër dhe kjo cilësi është vërtetuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose vendim të ndërmjetëm me fuqi ekzekutive të menjëhershme, atëherë shteti duhet të veprojë kryesisht për të përmbushur detyrimin që rrjedh nga vendimi i gjykatës, pa pasur nevojë kreditori të iniciojë procedurat përmbarimore⁸⁶. Madje në çështjen Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë është ritheksuar nga GJEDNJ që ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga gjykata, përfshirë edhe vendimet për sigurimin e padisë duhen kosideruar si pjesë integrale e procesit gjyqësor.

⁸³ OSCE (Misioni në Kosovë) “*Ekzekutimi i Aktgjykimeve*”, janar, 2012, faqe, 14.

⁸⁴ *Ibid.* 15.

⁸⁵ *Ibid.* 13.

⁸⁶ Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi, “*Procedurë Civile*”, pjesa II, shtëpia botuese Albas, 2018, faqe, 346.

Rastet e Shqipërisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e

Njeriut.

Për herë të parë problematika e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri është trajtuar në vendimin Qufaj Co sh.p.k kundër Shqipërisë⁸⁷. Me anë të këtij vendimi u nxor në pah rëndësia e fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, si pjesë përbërëse e një procesi të rregullt gjyqësor. Në këtë rast, Bashkia e Tiranës i kishte dhënë Qufaj Co sh.p.k **lejen e planifikimit** për të ndërtuar 500 apartamente në një hapësirë prej 15,788 metra katrorë, që Bashkia ja kishte shitur shoqërisë, mirëpo nga ana tjetër kishte refuzuar të jepte **lejen e ndërtimit** Qufaj Co sh.p.k. Për shkak të mosdhënies së lejes së ndërtimit nga Bashkia, për një kohë të gjatë u penguan kështu punimet e ndërtimit të 500 apartamenteve. Ankuesi (Qufaj Co sh.p.k) kërkoi kompensim për humbjen e shkaktuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo kërkesë u hodh poshtë nga Gjykata me vendimin nr.4064 të datës 23 qershor 1995.

Në fazën e apelit, Gjykata e Apelit Tiranë prishi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke urdhëruar Bashkinë që t'i paguante shoqërisë shumën prej 60.000.000 lekësh. Vendimi i Gjykatës së Apelit mori formë të prerë dhe u bë i ekzekuteshëm. Edhe pse zyra e Përmbarimit e kishte njoftuar Bashkinë që ajo duhej të ekzekutonte vendimin e nr.1197, datë 23 shkurt 1996 të Gjykatës së Apelit, Bashkia vazhdimisht refuzonte zbatimin me argumentimin se nuk kishte një buxhet të mjaftueshëm. Meqë vendimi i Gjykatës së Apelit nuk u ekzekutua Qufaj Co sh.p.k paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, por GJK e hodhi poshtë kërkesën me arsyetimin se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është jashtë juridiksionit të saj. GjEDNJ-ja edha vendimin e saj në 18 nëntor 2004, duke deklaruar që kishte gjetur shkelje të mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga Bashkia. Komiteti i Ministrave mbi bazën e procedurave të zgjeruara të mbikëqyrjes e cilësoi rastin si një çështje “orientuese” për rastet e tjera të ngjashme⁸⁸. Në përfundim pra, u nënvizua dhe qartësua se ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga cdo gjykatë duhet të konsiderohet pjesë integrale e “procesit gjyqësor” sipas qëllimeve të nenit 6 të Konventës.

“Nuk i lejohet një autoriteti shtetëror që të përmendë mungesën e fondeve si një shfajësim për mospërbushjen e një vendimi gjyqësor që i ngarkon një

⁸⁷ “Qufaj Co sh.p.k kundër Shqipërisë”, 18 nëntor 2004, kërkesa nr. 54268/00.

⁸⁸ “Mjetet efektive për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore”, Tiranë, 2017, faqe, 9.

detyrim. Pa dyshim një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të vecanta. Por vonesa nuk duhet të jetë e tillë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës së mbrojtur nga neni 6 (1)⁸⁹. E drejta për proces të rregullt ligjor mbetet iluzive dhe e humbet qëllimin e saj nëse sistemi i brendshëm ligjor i lejon autoritetet vendase që të refuzojnë, të neglizhojnë ose të vonojnë ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë në dëm të një pale tjetër. Edhe në çështjen “Vukelić kundër Malit të Zi” GJEDNJ ka përmendur që ekzekutimi i një vendimi gjyqësor nuk mund të pengohet, shfuqizohet, shtyhet padrejtësisht. Shteti ka detyrimin që të organizojë një sistem efektiv për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare, si nga pikëpamja ligjore, ashtu edhe ajo në praktikë.

Qëndrimi i GJEDNJ-së në çështjen “Vukelić kundër Malit të Zi” u pasqyrua edhe në çështjen Bushati kundër Shqipërisë⁹⁰. Pra, shteti duhet të sigurojë zbatimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare pa asnjë vonesë të papërshtatshme. Në rastet kur autoritetet janë të detyruara të ndërmarrin veprime të caktuara për ekzekutimin e një vendimi, por nuk arrijnë dot, paaftësia e tij për ndërmarrjen e veprimeve të duhura mund të lindë përgjegjësi për shtetin, bazuar në nenin 6(1) të Konventës.

Çështja Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë⁹¹ ka të bëjë me një problem strukturor përse i përket mosekzekutimit të vendimeve përfundimtare të gjykatave të brendshme si dhe vendimet administrative lidhur me të drejtën e ankuesve për për kthim ose kompensim prone (qoftë pasuror ose në natyrë) për pronat e shtetëzuara gjatë regjimit komunist (shkelje të nenit 6/1 dhe nenit 1 të Protokollit nr.1). GJEDNJ vëren se nuk vihet në diskutim detyrimi i lënë pezull i shtetit për të zbatuar vendimin e datës 6 mars të vitit 2003. Gjykata rikujton se forma më e përshtatshme e kompensimit, lidhur me një shkelje të nenit 6, është që ankuesit t’i sigurohet, për aq sa është e mundur, kthimi në pozitën e mëparshme nëse nuk do të ishin anashkaluar dispozitat e nenit 6 të KEDNJ-së. **GJEDNJ është e mendimit në këtë rast që qeveria duhet të sigurojë, përmes mjeteve të përshtatshme dhe me shpejtësi, zbatimin e vendimit përfundimtar të gjykatave të brendshme⁹².**

⁸⁹ Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi, “*Procedurë Civile*”, pjesa II, 2018, faqe, 346.

⁹⁰ Kërkesa nr. 6397/04, vendim i datës 14 shkurt 2012.

⁹¹ Kërkesa nr. 10508/02, datë 23 tetor 2007.

⁹² “*Mjetet efektive për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore*”, Tiranë, 2017, faqe, 18.

Çështja Driza kundër Shqipërisë⁹³ lidhet me dështimin e autoriteteve të brendshme për të zbatuar një vendim të brendshëm të formës së prerë, i cili i njohu ankuesit të drejtën për kompensim në natyrë. Edhe në këtë vendim e gjejmë shtetin shqiptar në shkelje të nenit 6/1 të KEDNJ-së dhe të nenit 1 të Protokollit nr.1, ashtu dhe në shkelje të nenit 13 të Konventës në lidhje me nenin 6/1 të saj. “Gjykata urdhëroi në bazë të nenit 41 të Konventës se ankuesi Çaus Driza vazhdon të gëzojë të drejtën e kompensimit në natyrë, në përputhje me vendimin e Gjykatës së Apelit, në favor të tij dhe autoritetet janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar zbatimin e këtij vendimi”.

Në çështjen Marini kundër Shqipërisë⁹⁴ ankuesi z.Vlash Marini u ankua për shkelje të nenit 6/1 të KEDNJ-së për mosekzekutim të vendimeve të formës së prerë të dhëna në favor të tij, tejzgjatje në kohë të proceseve, mungesë arsytimi të vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe kufizim të së drejtës së tij për t’u dëgjuar nga gjykata, për dy shkaqe: 1. Refuzimi i kërkësës së tij drejtuar GJK për shkak se çështja nuk u votua nga shumica e kërkuar dhe 2. nxjerrja e urdhrit për likuidimin e shoqërisë, që e kishin penguar atë të vinte në lëvizje gjykatën në mbrojtje të interesave të tij. GJEDNJ gjykoi se ka pasur shkelje të nenit 6/1 përse i përket mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë të datës 7 korrik të 1993 dhe zgjatje të tepruar në kohë të procesit të parë dhe të dytë gjyqësor.

PËRFUNDIME

Pas analizës së bërë në këtë punim, arrijmë në disa përfundime:

1. Faza e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë (vendimeve gjyqësore), është pjesë përbërëse e procesit të rregullt gjyqësor. Vlen të përmendet vendimi i parë i GJEDNJ-së, ai “*Qufaj Co. sh.p.k kundër Shqipërisë*”, 18 nëntor 2004, që nxjerr në dukje natyrën e vërtetë të kësaj faze, duke e cilësuar si pjesë integrale të procesit gjyqësor, kjo sipas qëllimeve të nenit 6 të KEDNJ.
2. GJEDNJ ka evidentuar në shumë vendime të saj, probleme të ekzekutueshmërisë së vendimeve gjyqësore, pavarësisht faktit që ato kanë marrë formë të prerë. Në këto vendime është theksuar fakti që, nëse një

⁹³ Kërkesa nr. 3371/02, datë 13 nëntor 2007.

⁹⁴ Vendim i GJEDNJ-së datë 18.12.2007, ankimi nr.3738/02.

vendim gjyqësor i formës së prerë ose një vendim i ndërmjetëm i dhënë përkohësisht deri në zgjidhjen e çështjes në themel, mbetet i pazbatueshëm, e drejta e palës për të vendosur në vend të drejtën e cënuar do mbetet iluzive. Po kështu autoritetet përgjegjëse nuk mund të justifikohen me mungesën e fondeve, si një lloj shfajësimi për mos përmbushjen e një vendimi gjyqësor që i ngarkon një detyrim.

3. Sikurse në Shqipëri edhe në Kosovë po bëhen përpjekje të vazhdueshme nga ana e mekanizmave përgjegjës, për t'i dhënë rëndësinë e duhur ekzekutimit të detyrueshëm (si pjesë e procesit gjyqësor). Kjo vihet re me ndryshimet që ka pësuar Kodi i Procedurës Civile, me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” (në Shqipëri) dhe të ligjit nr.04/L-139 “Për procedurën përmbartimore” (në Kosovë). Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve sërish janë hasur vështirësi në praktikë, por edhe në kuptimin/interpretimin e dispozitave të caktuara të ligjeve të përmendura më sipër.
4. Në ligjin “Për procedurën përmbartimore”, titujt ekzekutive janë ndarë në dy kategori kryesore, në dokumente të përmbartueshëm dhe në dokumente të besueshëm. Nuk është i qartë ky kategorizim, pasi mund të përdorej vetëm një nocion i përgjithshëm për të dyja rastet, ai i titullit ekzekutiv/titull përmbartimor. E veçanta në këtë ligj është se në ndryshim nga Kodi i Procedurës Civile, janë parashikuar shprehimisht si tituj ekzekutivë faturat.
5. Në LPK e vjetër nuk kanë qenë e rregulluar procedura për sigurimin e padisë, por tanimë ligji i ri “Për procedurën kontestimore” rregullon sigurimin e padisë. Në LPK, në nenin 304 të tij, është përcaktuar forma sesi duhet të paraqitet në gjykatë propozimi për sigurimin e padisë, ndërsa në Kodin tonë të Procedurës Civile nuk është përcaktuar forma e kërkesës për sigurimin e padisë.
6. Ligji “Për procedurën përmbartimore” sjell një nga risitë më revolucionare, që është padyshim reformimi i organit përmbartimor. Në ligjin nr.03/L-008 “Për procedurën përmbartimore” që është shfuqizuar, organ i vetëm kryesor në procedurën e përmbartimit ishte gjykata, ndërsa me ligjin e ri nr.04/L-139 “Për procedurën përmbartimore”, organ përmbartimor nuk është vetëm gjykata, por edhe përmbartuesi gjyqësor privat. Për të mos

thënë që përmbaruesi gjyqësor privat është shndërruar në organin kryesor në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë.

7. Problemi i moszekutimit të vendimeve gjyqësore ka qenë i dukshëm si në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë. Kjo lidhet me një sërë faktorësh, ku ndër më të rëndësishmit janë: mungesa e cilësisë profesionale e përmbaruesve gjyqësorë, moskryerja në mënyrë të duhur e veprimeve përmbarimore, mosnjohja në shkallën e duhur të legjislacionit civil dhe atij procedural nga ana e përmbaruesve gjyqësorë privatë.
8. Në Raportet e Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe në Kosovë janë të pasqyruara problemet, vështirësitë, shqetësimet, që e kanë shoqëruar fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë dhe duhet nënvizuar që ndër vite është mëse evident numri i lartë i vendimeve gjyqësore të paekzekutuara. Në Kosovë ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të ankesave ndaj punës së përmbaruesve gjyqësorë privatë, por në pjesën më të madhe të rasteve përmbaruesit janë shpallur jo përgjegjës. Ligji “Për procedurën përmbarimore” është kritikuar për pasjen e dispozitave të paqarta, të dykuptimta. Një ndër to është edhe neni 247 i LPP-së.

Duke u mbështetur në analizën që i është bërë legjislacionit shqiptar dhe atij kosovar në fushën e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë, kuptohet që gjithmonë do të ketë vend për rekomandime. Këtu mund të përmendim:

1. Neni 79 i ligjit “Për procedurën përmbarimore” paraqitet problematik në aspektin që nuk është e përcaktuar qartë se cilës gjykatë do t’i drejtohen palët për të paraqitur ankesën ndaj parregullsisë të kryera nga përmbaruesi. Po kështu problematike është pjesa që ankesa duhet të bëhet brenda një afati 7 ditësh nga dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar. Sugjerojmë që ky nen të ndryshohet, që në të ardhmen të mos kemi cënime të vazhdueshme të të drejtave të palëve. Një mënyrë sesi mund të riformulohet kjo dispozitë është: “Kjo kërkesë i bëhet Gjykatës (të përcaktohet cilës gjykatë) me një parashtesë me shkrim në afat prej 7 ditësh nga **kryerja e parregullsisë, kur palët ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë, kanë qenë të pranishme në krverjen e parregullsisë** dhe në raste të tjera, **nga dita që kanë marrë dijeni për parregullsinë e kryer**”. Ky ndryshim nuk ka ndodhur pavarësisht se ndryshimet e fundit në ligjin “Për procedurën përmbarimore” kanë ndodhur në 2023. Ndërkohë që nga

trajtimi i bërë nga ana jonë në punim, ku kemi cekur që neni 247 i LPP-së paraqitet mjaft problematik dhe me ndryshimet e fundit është bërë shfuqizimi i paragrafit të dytë të këtij neni që parashikon se: *“Prokurori publik nuk mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të kapërcimit të kërkesëpadisë dhe as për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike”*.

2. Një tjetër çështje që është e paqartë në LPP (neni 79) është fakti që nuk është saktësuar se ku konsiston parregullsia e kryer nga përmbaruesi. Mendojmë që, ligjvënësi duhet të ndërmarrë hapa në drejtim të specifikimit të natyrës së parregullsisë. Përndryshe, palët ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë do të parashitrojnë para gjykatës çdo veprim ose mosveprim që do ta konsiderojnë si parregullsi duke shkaktuar kështu një “lloj vonese” në përmbushjen e qëllimit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë. Mund të parashikohen një listë me shkaqe, sikurse në nenin 71 të LPP-së.
3. Në Kodin e Procedurës Civile, përkatësisht në nenin 209 të tij është parashikuar vetëm ankimi kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë. Ndërkohë që nuk është parashikuar mundësia e ankimit ndaj vendimit të gjykatës, që ka refuzuar kërkesën për sigurimin e padisë. Do ishte mirë, nëse kjo dispozitë ndryshohet dhe përfshihet në të dhe mundësia e ankimit ndaj vendimit të gjykatës që refuzon kërkesën për sigurimin e padisë. Kjo për t’i vendosur në të njëjtin plan si vendimin që pranohet/ndryshohet/hiqet sigurimi i padisë, ashtu dhe vendimin që refuzohet kjo kërkesë.
4. Duke qenë se shkak i rëndësishëm për shfaqjen e vështirësive në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë mbetet mangësia e cilësive profesionale nga ana e përmbaruesve, duhet kushtuar një rëndësi e veçantë formimit të mëtejshëm të tyre. Pra, nuk është e mjaftueshme vetëm pasja e disa dispozitave që parashikojnë pjesën e trajnimeve, por edhe ngritja e mekanizmave, strukturave, që do të ndihmojnë në fuqizimin e aftësive të përmbaruesve dhe njohjes së plotë ndaj rregullave të etikës, standarteve profesionale dhe ligjeve respektive.
5. Sugjerojmë nga ana tjetër të përforcohet bashkëpunimi midis Shërbimit Përmbarimor Shtetëror dhe Shërbimit Përmbarimor Privat, po kështu edhe

midis shërbimit përbarimor shtetëror/privat dhe institucioneve shtetërore apo subjekteve private. Duhet të krijohen mekanizmat e duhur që të jenë të aplikueshëm për të arritur një qëllim të tillë. Duke patur një bashkëpunim efikas, frytdhënës sheshohen problematikat që ne sollëm në fokus dhe përmirësohet aspektet e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë.

BIBLIOGRAFI

1. A. Zogaj, Z. Leku, V. Totaj, B. HasanPapaj, M. A. Cunnif, *Manual për zbatim të procedurës kontestimore*, Prishtinë, 2019.
2. Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi, *Procedurë Civile*, pjesa I, botimi II, Tiranë, 2018.
3. Flutura Kola Tafaj, Asim Vokshi *Procedurë Civile*, pjesa II, botimi II, Tiranë, 2018.
4. A. Bajrami, E. Hasani, H. Kuçi, I. Islami, H. Gashi, I. Morina, A. Puka, A. Hajdari, M. Batalli, R. Istrefi, *Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë*, Prishtinë, 2019.
5. Ardit Gashi, Avni Puka, Iset Morina, Nebojša Boričić, Visar Morina, *Fjalor juridik*, Prishtinë, 2019.
6. Ina Barjamaj, *Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe problematika e praktikës gjyqësore*, Tiranë, 2016.
7. Ismajl Shabani, *Përmbartimi Privat në Republikën e Kosovës*, Prishtinë, 2019.
8. Albana Shtylla, *Komentari i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2017.
9. Ledi Bianku, Odeta Kumbaro, *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*, botim i katërt, Tiranë, 2017.
10. Silvana Çinari, *Masat e sigurimit të padisë në proceset gjyqësore dhe të arbitrazhit*, Tiranë, 2015.
11. Përmbledhje e vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë 2000-2006, botim i QPZ-së, korrik, 2006.
12. Avokati i Popullit (Shqipëri), Raport i veçantë (II), *Administrata publike dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës*, 2014.
13. Avokati i Popullit (Shqipëri), *Raporti Vjetor 2018*, (Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe administrative).
14. Avokati i Popullit, *Raport Vjetor 2019*.

15. Avokati i Popullit (Kosovë), *Raport Vjetor 2016*, (Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore).
16. OSCE, Misioni në Kosovë, *Ekzekutimi i aktgjykimeve*, janar, 2012.
17. OSCE, *Drejt Drejtësisë*, 2013.
18. OSBE, Prezenca në Shqipëri, *Analizë e sistemit ligjor në Shqipëri, 2004*.
19. Oda e Përmbauesve Privatë, *Raport i Punës së Odës së Përmbauesve Privatë për vitin 2019*, mars, 2020.
20. Balkans Policy Research Group, *Gjyqësori i keq-administruar i Kosovës*, shtator, 2019.
21. Komisioni i Posaçëm Parlamentar Për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, *Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*, qershor, 2015.
22. *Mjetet efektive për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore*, Tiranë, 2017.
23. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10. 1998.
24. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
25. Ligj nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar).
26. Ligj nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
27. Ligj nr.26/2019 “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”
28. Ligji 04/L-139 “Për procedurën përmbauesorë”
29. Ligji “Për procedurën kontestimore”
30. Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr.28, datë 19.05.2016
31. Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr.14, datë 30.03.2015
32. Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr.30, datë 25.05.2015
33. Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr.21, datë 07.04.2014
34. Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr.12, datë 16.04.2013
35. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.00-2016-1859 (174)
36. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.180, datë 2.04.2015
37. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.00-2014-4333 (658)
38. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.658, datë 10.12.2014
39. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.169, datë 5.03.2013
40. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr. 00-2013-1424 (348), datë, 4.06.2013
41. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.580, datë 22.10.2013
42. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.6, datë 10.01.2012

43. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.272, datë 10.06.2010
44. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.366, datë 30.09.2010
45. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.36, datë 19.02.2009
46. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr.9, datë 09.03.2006
47. Vendim i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, nr.00-2015-2266, datë 21.05.2015
48. Çështja *Muti kundër Italisë*, GJEDNJ, 23 mars 1994.
49. Vendimi *Burdov kundër Ruisë*, GJEDNJ, 7 maj 2002.
50. Çështja *Pini, Bertani, Manera dhe Atripaldi kundër Rumanisë*, GJEDNJ, 22 qershor 2004.
51. Çështja *Vukelić kundër Malit të Zi*, GJEDNJ, 4 korrik 2013.
52. Vendimi *Bushati kundër Shqipërisë*, GJEDNJ, 14 shkurt 2012, kërkesa nr.6397/04.
53. Vendimi *Qufaj Co sh.p.k kundër Shqipërisë*, GJEDNJ, 18 nëntor 2004.
54. Vendimi *Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, GJEDNJ, 23 tetor 2007.
55. Vendimi *Marini kundër Shqipërisë*, GJEDNJ, 18 dhjetor 2007.
56. Vendimi *Driza kundër Shqipërisë*, GJEDNJ, 13 nëntor 2007.
57. <http://www.nchb.al-2/>, në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.
58. http://www.coe.int/t/commissioner/Viewpoints/090831_en.asp

IMPLEMENTIMI I NJË CHATBOT-I PËR VETË-DIAGNOSTIKIM TË SËMUNDJEVE DUKE PËRDORUR AI DHE NLP

Dr. Fatmira PRODANI

miraprovani@gmail.com Universiteti Aleksandër Moisiu

PhD. Candidate Lirinda VAKO ABEDINI

l.vako@eust.edu.mk International University of Struga

Abstrakt

Ky punim trajton analizën dhe dizajnin e një Chatbot mjekësor për vetë-diagnostikim, i cili shfrytëzon fuqinë e algoritmeve të inteligjencës artificiale (AI) për të ndihmuar përdoruesit në vlerësimin e simptomave të tyre dhe dhënien e sugjerimeve fillestare për diagnoza të mundshme. Chatbot-i është projektuar për të siguruar një qasje më të shpejtë, të personalizuar dhe të saktë në shërbimet shëndetësore, duke përmirësuar aksesin e përdoruesve në informacionin mjekësor bazë pa nevojën e konsultimeve të menjëhershme me mjekë.

Punimi përqendrohet në dy aspekte kryesore: analiza e algoritmeve të AI të përdorura në përpunimin e gjuhës natyrore (NLP) dhe të dhënat mjekësore për njohjen e simptomave, si dhe dizajni i ndërfaqes së përdoruesit për të siguruar një përvojë interaktive dhe intuitive. Rezultatet paraprake tregojnë një potencial të lartë për përmirësimin e parashikimeve mjekësore dhe zvogëlimin e mbingarkesës në sistemet shëndetësore. Ky punim kontribuon në fushën e inteligjencës artificiale në mjekësi, duke propozuar një qasje efikase dhe të përballueshme për vetë-diagnostikimin e sëmundjeve, dhe ofron rekomandime për përmirësime të mëtejshme në performancën dhe sigurinë e chatbot-ëve mjekësorë.

Keywords: *AI, NLP, machine learning, parashikimi i sëmundjeve*

Hyrje

Një chatbot mjekësor është një program softuerik që përdor inteligjencën artificiale dhe teknologjitë e përpunimit të gjuhës natyrore për të ofruar ndihmë dhe këshilla mjekësore për përdoruesit. Chatbotët mjekësorë mund t'i ndihmojnë përdoruesit të identifikojnë simptoma dhe të ofrojnë informacion mbi trajtimet dhe modifikimet, si dhe të japin këshilla të përgjithshme për shëndetin dhe mirëqenien. Ata gjithashtu mund t'i ndihmojnë përdoruesit të gjejnë ofrues të kujdesit shëndetësor në afërsi ose të caktojnë takime me mjekët.

Këta chatbotë janë të aksesueshëm në platforma të ndryshme, si aplikacionet e mesazheve, mediat sociale dhe faqet e internetit. Ata janë dizajnuar që të jenë të lehtë për përdorim dhe interaktivë, duke ofruar një ndërfaqe bisedore që imiton ndërveprimin njerëzor. Tendencat kryesore të chatbot-ëve mjekësorë përfshijnë përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe përmirësimin e përvojës së pacientëve. Chatbotët ekzistues ofrojnë shërbime si caktimi i takimeve, gjetja e objekteve mjekësore dhe inkurajimi për pjesëmarrje në provat klinike (Luba, 2020). Ata ndërveprojnë me pacientët, bëjnë pyetje në lidhje me simptomat e tyre, ofrojnë udhëzime fillestare për diagnozën dhe i drejtojnë pacientët të bëjnë një takim me një profesionist shëndetësor. Për shembull, chatbot-i "About Ada: Personal Health Companion", 2023, udhëzon përdoruesit për një diagnozë bazuar në simptomat dhe ofron udhëzime për hapat e ardhshëm.

Chatbotët mjekësorë mësojnë nga të dhënat e përdoruesve përmes algoritmeve të të mësuarit makinerik, duke rregulluar përgjigjet sipas preferencave individuale. Me përdorimin e IA dhe teknologjive të përpunimit të gjuhës natyrore (NLP), chatbotët përmirësojnë aftësinë e tyre për të kuptuar dhe gjeneruar gjuhë njerëzore, duke i bërë më efektivë në përgjigjet ndaj pyetjeve të përdoruesve. Fazat kryesore të NLP-së në implementimin e chatbot-ëve janë përshkruar në figurën e mëposhtme.




Figura 1: Diagrami i rrjedhës për përpunimin e hyrjeve në aplikimin tipik NLP

Në hapin e parë, tokenizimi, rrjedha e karaktereve shndërrohet në një koleksion tokensh që përfshijnë fjalë, numra ose simbole speciale. Pastaj, fjalët kthehen në shkronja të vogla dhe zbatohet stemimi, i cili shkurton fjalët në rrënjë më të thjeshta duke hequr parashtesat dhe prapashtesat. Në fund, renditja kategorizon dhe grupon elementët duke i vendosur në një rend të caktuar.

Ne synojmë të përdorim një chatbot bisedor mjekësor për të mbledhur simptomat e raportuara nga përdoruesit, për të klasifikuar sëmundjen dhe për të ofruar informacion përkatës mbi të. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se chatbotët mjekësorë nuk janë zëvendësim për këshillën profesionale mjekësore. Ata janë të dizajnuar për të ofruar udhëzime të përgjithshme dhe nuk duhet të zëvendësojnë konsultimin me një profesionist mjekësor për diagnozën ose trajtimin. Konsultimi me një specialist të kujdesit shëndetësor është thelbësor për vlerësimin, diagnozën dhe trajtimin e sëmundjeve.

Rishikimi i literaturës

2.1. Chatbotët mjekësorë

Në të kaluarën janë kryer disa studime mbi grupe të dhënash që lidhen me sëmundje dhe simptoma shumëklasore, me qëllim parashikimin e sëmundjeve të përdoruesve në bazë të simptomave të tyre. Një nga algoritmet më të përdorur në këto studime është Random Forest, i cili kombinon disa pemë vendimmarrëse për të arritur një rezultat. Për shembull, një studim i realizuar nga (A.N.V.K Swarupa; V.Hema Sree; S. Nookambika; Y. Kiran Sai Kishore; U. Ravi Teja, 2021) zbuloi se një sistem diagnostikimi i bazuar në Random Forest arrin një saktësi prej 95%, duke përzgjedhur 95 nga 132 veçori.

Një studim tjetër nga (Gupta, 2022) krijoi një sistem parashikimi të sëmundjeve që përfshin Pemat Vendimmarrëse, Random Forest, K-nearest neighbors dhe Naïve Bayes. Saktësia e këtij sistemi varionte nga 93% deri në 95%, ku K-nearest neighbors arriti rezultatin më të lartë. Për këtë sistem, u përdor një GUI Tkinter që lejonte përdoruesit të zgjidhnin simptomat nga një listë rënëse dhe të merrnin informacion mbi sëmundjet e parashikuara.

(J. Nirmal Jothi, 2022) krijuan një chatbot inteligjence artificiale për të adresuar pyetje mjekësore të zakonshme, veçanërisht për sëmundjet e zemrës. Një grup të dhënash u krijua me modele pyetjesh dhe përgjigjesh në një skedar JSON.

Me ndihmën e metodave NLP, chatbot-i arriti një saktësi prej 99% pas trajnimit mbi të dhënat e përpunuara për 1000 epoka.

(Prakhar Srivastava, Nishant Singh, 2020) zhvilluan një chatbot diagnostikimi që angazhon pacientët në biseda mjekësore dhe ofron diagnoza të personalizuar. Ky chatbot identifikoi simptomat nga të dhënat e përdoruesve me një saktësi standarde prej 65%. Një tjetër punim nga (Rohit Binu Mathew; Sandra Varghese; Sera Elsa Joy; Swanthana Susan Alex, 2019) prezantoi një sistem chatbot-i që përdorte Natural Language Toolkit (NLTK) për të përpunuar tekstin e simptomave dhe për të ofruar parashikime sëmundjesh.

Po ashtu, (Philip Indra Prayitno, Reinhart Perbowo Pujo Leksono, Fernando Chai, , 2021) krijuan një chatbot shëndetësor që përdor ngjashmërinë e kosinusit për të krahasuar simptomat e përdoruesit me ato të një baze të dhënash. Ky sistem arriti një saktësi prej 87.5% dhe ka plane për përmirësime të ardhshme, duke përfshirë mundësinë e blerjes së barnave përmes chatbot-it.

2.2. Parashikimi i sëmundjeve

Parashikimi i sëmundjeve duke përdorur algoritmet e të mësuarit makinerik është studiuar gjerësisht me shumë grupe të dhënash dhe teknika. Disa nga grupet më të njohura për këtë qëllim përfshijnë grupin e të dhënave për kancerin e gjirit Wisconsin, grupin e të dhënave për diabetin e indianëve Pima, grupin e të dhënave për sëmundjet e zemrës UCI, dhe grupin e të dhënave për sëmundjet e tiroides UCI. Në këtë seksion, do të kategorizojmë teknikat e klasifikimit të përdorura për secilin grup të dhënash.

Teknika Random Forest është ndër metodat më të njohura të të mësuarit makinerik dhe përdoret për të zbuluar sëmundje të ndryshme. Në një studim nga (Mridha, 2021), ajo u aplikua për parashikimin e hershëm të kancerit të gjirit, duke arritur një saktësi prej 98.83%. Një tjetër studim nga (Zahrul Jannat, Md. Shymon Islam, Mst. Kamrun Naher Chumki, 2022) zbuloi se modeli Random Forest arriti një saktësi prej 99.58% për sëmundjet e tiroides UCI.

Support Vector Machines (SVM) është një metodë tjetër e njohur që përdoret gjithashtu për parashikimin e sëmundjeve. Në një studim nga (Ankita Tyagi, Ritika Mehra, 2019), modeli SVM arriti një saktësi prej 99.63% me grupin e të dhënave për sëmundjet e tiroides UCI.

Aplikacioni i propozuar HealthBot

Shtjella e chatbot-it tonë, të quajtur HealthBot, është e përcaktuar si më poshtë:

HealthBot duhet të jetë në gjendje të kuptojë nëse përdoruesi dëshiron të di për sëmundjen e parashikuar në bazë të simptomave të tij.

HealthBot duhet të jetë në gjendje të kuptojë nëse përdoruesi po jep simptomat e tij dhe të përgjigjet me pyetje ndihmëse për të kontrolluar nëse përdoruesi ka ndonjë simptomë tjetër.

HealthBot duhet të jetë në gjendje të parashikojë sëmundjen në bazë të simptomave të përdoruesit dhe të përgjigjet me një sëmundje të parashikuar.

HealthBot duhet të jetë në gjendje të kuptojë nëse përdoruesi dëshiron të dijë më shumë informacione rreth një sëmundjeje.




Figura 2: Diagrami i rrjedhës për funksionin bazë të HealthBot

3.1. Ndërtimi i HealthBot

Në projektin tonë, ne përdorim Rasa NLU dhe Rasa Core për të ndihmuar në ndërtimin dhe trajnim e një aplikacioni chatbot mjekësor të quajtur HealthBot. Rasa është një bibliotekë e hapur për NLP që përdoret zakonisht për klasifikimin e qëllimeve dhe nxjerrjen e entiteteve në chatbot. Rasa NLU përdoret për të kuptuar qëllimin e përdoruesit dhe për të nxjerrë çdo entitet nga teksti i tij.

Për të kryer klasifikimin e qëllimeve dhe nxjerrjen e entiteteve, Rasa NLU përdor metoda NLP, si metodat e paraqitura në figurën 1, për të trajnuar një model të caktuar të të mësuarit makinerik. Pasi të identifikohen qëllimi dhe entitetet e përdoruesit, Rasa Core merr informacionin dhe përpiqet të ndërtojë një model probabiliteti që do të vendosë cilat veprime do të kryejë chatbot-i.

HealthBot ka dy funksione kryesore siç tregohet në Figurën 2: parashikimi i sëmundjes në bazë të simptomave të përdoruesit dhe kërkimi për informacione rreth një sëmundjeje. Ne krijojmë veprime të personalizuar në skedarin tonë `actions.py` për të kryer çdo veprim kur është e nevojshme.

Për të parashikuar një sëmundje në bazë të simptomave të përdoruesit, HealthBot do të ngarkojë një model të mësuar makinerik për parashikimin e sëmundjeve të trajnuar më parë në skedarin tonë `actions.py` dhe do të kalojë simptomat e përdoruesit si një vektor numerik në model. Më pas, HealthBot kthen klasën e parashikuar të sëmundjes për përdoruesin.

Për të kthyer informacion mbi një sëmundje për përdoruesin, ne përdorim grupin e të dhënave `Description.csv` për simptomat, siç tregohet në Tabelën 1, dhe grupin e të dhënave `precaution.csv`, siç tregohet në Tabelën 2. Çdo grup të dhënash përmban informacion mbi sëmundjet nga grupi i të dhënave Sëmundje-Simptomë.

| Sëmundja | Masa Paraprake 1 | Masa Paraprake 2 | Masa Paraprake 3 | Masa Paraprake 4 |
|----------------|--|--|--------------------------------------|---|
| Diabeti | Përdorni një dietë të ekuilibruar, të pasur me fruta dhe | Kontrolloni rregullisht nivelin e sheqerit në gjak | Bëni aktivitete fizike të rregullta. | Mbani peshën trupore në nivel të shëndetshëm. |

| | | | | |
|--------------|--|---|--|---|
| | perime. | | | |
| Gripi | Mbroni gojën dhe hundën kur teshtini ose kollitni. | Merrni vaksinat e rekomanduara çdo vit. | Evitoni kontaktin e ngushtë me individë që janë të sëmurë. | Konsumoni lëngje të shumta për të qëndruar të hidratuar |

Tabela 1: Nje pjese e grupit të të dhënave për përshkrimin e simptomave

| Sëmundja | Përshkrimi |
|----------------|---|
| Diabeti | Një sëmundje kronike që ndodh kur trupi nuk prodhon mjaftueshëm insulinë ose nuk e përdor atë siç duhet, duke çuar në nivele të larta të sheqerit në gjak. Simptomat përfshijnë etje të madhe, urinim të shpeshtë, lodhje dhe humbje peshe. |
| Gripi | Një infeksion viral që prek rrugët e frymëmarrjes. Simptomat përfshijnë ethe, dhimbje koke, lodhje, kollë, dhe dhimbje të muskujve. Gripi shpesh shfaqet sezonalisht dhe mund të shkaktojë komplikime serioze, sidomos tek individët e rrezikuar. |

Tabela 2: Pershkrimi i simptomave

Krijimi i Modelit për Parashikimin e Sëmundjeve

Hapat e propozuar në Figurën 3 lejojnë chatbot-in tonë mjekësor të parashikojë sëmundjet në bazë të simptomave të përdoruesit. Ne do të përdorim grupin e të dhënave Sëmundje-Simptomë nga Kaggle, i cili ka rreth 132 lloje simptomash (kolona) dhe rreth 42 lloje sëmundjesh, duke ofruar më shumë fleksibilitet në gjetjen e një saktësie më të lartë për një model të mësuar makinerik. Metoda e propozuar është e ndarë në dy hapa të përgjithshëm: përpunimi i grupit të të dhënave dhe aplikimi i algoritmeve të mësuarit makinerik. Modeli që performon më mirë nga tre do të përdoret në HealthBot.




Figura 3 Flow Diagrami për Modelin e Parashikimit të Sëmundjeve që përdoret nga HealthBot

Hapat e përpunimit:

Hapi i përpunimit ndahet në dy pjesë, Inxhinieria e veçorive dhe Përzgjedhja e veçorive.

Inxhinieria e Veçorive: Ne rrisim cilësinë e të dhënave duke hequr vlerat null, duke hequr kolonat (atributet) pa të dhëna, dhe duke konvertuar të dhënat kategorike në të dhëna numerike duke përdorur metodën e kodimit me etiketë.

Përzgjedhja e Veçorive: Ne përpiqemi të identifikojmë korrelacionin midis veçorive dhe variablit të synuar dhe të zgjedhim vetëm veçoritë e rëndësishme që përshtaten në një model në mënyrë që të mund të trajnohet mirë dhe të japë saktësi të mirë. Me më pak veçori për të përpunuar, modelet tona të mësuarit makinerik do të funksionojnë më efikasht duke reduktuar kohët e llogaritjes. Ne do të përdorim Eliminimin e Veçorive të Përsëritura (RFE), i cili është një

algoritëm përzgjedhjeje veçorish që mund të përdoret për problemet e klasifikimit dhe regresionit. RFE heq veçoritë nga një grup të dhënash deri sa të arrihet numri i dëshiruar i veçorive. Numri i dëshiruar i veçorive zgjidhet "duke përshtatur algoritmin e mësuar makinerik të dhënë që përdoret në thelbin e modelit, duke renditur veçoritë sipas rëndësisë, duke hequr veçoritë më pak të rëndësishme dhe duke përshtatur sërish modelin." Random Forests mund të përdoren për të vlerësuar rëndësinë e veçorive dhe për të kthyer rezultatet e tyre. Prandaj, Random Forests do të përdoret si estimatori kryesor për algoritmin tonë të Eliminimit të Veçorive të Përsëritura.

Aplikimi i Algoritmeve të Mësuarit Makinerik

Në metodën tonë, algoritmet e mësuarit makinerik aplikohen për të trajtuar problemet e klasifikimit multi-klasë, si Pemët Vendimmarrëse, Naïve Bayes, Gradient Boosting dhe Support Vector Machines.

Pemët Vendimmarrëse: Bëjnë parashikime duke ndarë të dhënat në bazë të një veçorie të zgjedhur. Ato janë të lehta për t'u interpretuar dhe mund të trajtojnë marrëdhënie komplekse midis variablave.

Gradient Boosting: Modelet e dobëta të mësuarit makinerik bashkohen në një ensemble për të krijuar një model përfundimtar që mund të ketë një fuqi parashikuese më të lartë. Ensembled zakonisht ndërtohen me pemë vendimmarrëse. Megjithatë, "numri i pemëve në pemët vendimmarrëse të gradientit është shumë kritik në lidhje me mbivendosjen. Shtimi i shumë pemëve do të shkaktojë mbivendosje, prandaj është e rëndësishme të ndalet shtimi i pemëve në një moment të caktuar." (Yildirim, 2020).

Support Vector Machine (SVM): Është një algoritëm që mund të përdoret me grupe të dhënash të vogla dhe komplekse. Funkcionon për të gjetur hiperplanet që ndajnë më së miri të dhënat në klasa të ndryshme. SVM është gjithashtu efektiv në hapësira me dimensione të larta ku ka shumë veçori, siç janë 132 veçoritë në grupin tonë të të dhënave Sëmundje-Simptomë.

Implementimi I HealthBot

Përdoruesi mund të kryejë dy veprime kryesore në HealthBot:

Të marrë një diagnozë të parashikuar bazuar në simptomat e tij.

Të marrë informacion mbi një sëmundje.

HealthBot përdor dy veprime të personalizuar, *ZgjidhSëmundjet* dhe *ParashikoSëmundjen*, për të përgjigjur kërkesave të përdoruesve. Nëse qëllimi i përdoruesit është të marrë një sëmundje të parashikuar bazuar në simptomat e tij duke përdorur *KontrolluesiSimptomave*, aktivizohet një Rasa Form për të pyetur përdoruesit një seri pyetjesh që mbledhin informacion rreth simptomave të përjetuara. Rasa Forms përdoren për të definuar fushat e formës për të mbushur vende, për të verifikuar inputet e përdoruesit dhe për të trajtuar përgjigjen e përdoruesit në një mënyrë konverzionale.




Figura 4: Nderveprimi I përdoruesit me HealthBot

Pas inserimit të simptomave nga përdoruesi, HealthBot i ruan ato në një slot simptomash për t'u përdorur në veprimin e personalizuar *ParashikoSëmundjen*.

Veprimi i personalizuar Rasa, *Parashiko Sëmundjen*, merr simptomat e përdoruesit dhe kthen një parashikim të sëmundjes së tij. Kjo realizohet duke marrë simptomat që janë ruajtur dhe duke kontrolluar numrin e hyrjeve për të parë

nëse përdoruesi ka futur një numër të mjaftueshëm simptomash për të bërë një parashikim.

Nëse përdoruesi ka futur numrin e nevojshëm të simptomave, thirrret modeli i mësuar me *Support Vector Machine* për të parashikuar sëmundjen e përdoruesit. Rezultati i parashikuar i sëmundjes i jepet përdoruesit dhe informacioni mbi sëmundjen merret duke kaluar nëpër skedarët *symptoms Description.csv* dhe *symptoms precautions.csv*, të cilat përmbajnë përshkrime të sëmundjes dhe masa paraprake që ndoshta duhet të shqyrtojë personi i prekur, siç tregohet në Figurën 4. Veprimi përfundon me përdoruesin që ka mundësinë të fusë një grup të ri simptomash, të mësojë për një sëmundje tjetër ose të dërgojë një mesazh të personalizuar.

Nëse qëllimi i përdoruesit është të mësojë më shumë rreth një sëmundjeje, HealthBot kthen një listë kategorish sëmundjesh që përdoruesi mund të zgjedhë, siç janë sëmundjet infektive, sëmundjet kardiovaskulare dhe të tjera. Veprimi i personalizuar Rasa, *ZgjidhSëmundjet*, aktivizohet kur përdoruesi zgjedh të përzgjedhë një sëmundje nga një kategori. Veprimi i personalizuar *ZgjidhSëmundjet* do të kthejë informacion mbi sëmundjen e zgjedhur nga skedarët *symptom Description.csv* dhe *symptom precaution.csv*, siç tregohet në Figurën 4. Përdoruesi më pas pyetet nëse dëshiron të provojë *symptom checker*, të kërkojë një sëmundje, ose të krijojë një mesazh të personalizuar.

Modelet e Parashikimit të Sëmundjeve

HealthBot mund të parashikojë sëmundjen e përdoruesit bazuar në simptomat e tij duke përdorur modelin e parashikimit të sëmundjeve. Ky model grumbullon grupin e të dhënave të simptomave të sëmundjeve dhe kryen disa hapa të mësimin makinerik për të trajnuar katër modele: **Pemë Vendimmarrëse, Gradient Boosting, Support Vector Machines**, dhe **Naïve Bayes**.

Paraqitja e të Dhënave

Paraqitja e të dhënave është një hap thelbësor në mësimin makinerik dhe përfshin pastrimin dhe transformimin e të dhënave të papërpunuara në një format të përshtatshëm për modelin.

Në hapin e parë të paraqitjes së të dhënave, ne pastruam të dhënat tona, e cila përfshin eliminimin e informacionit të panevojshëm ose të tepërt, rregullimin e gabimeve ose inkonsistencave, dhe zgjidhjen e vlerave të mungesës ose null. Pasi të eliminohet informacioni i panevojshëm, trajtohen vlerat null. Vlerat null

mund të trajtohen duke i mbushur ato me një vlerë specifike, si mesatarja ose median e kolonës. Më pas, të dhënat kategorike konvertohen në të dhëna numerike, pasi disa modele të mësimit makinerik nuk mund të trajtojnë të dhëna kategorike. Kjo bëhet duke përdorur teknikën e kodifikimit me etiketë.

Vlerat ekstreme, të njohura si **outliers**, mund të ndikojnë në saktësinë e një modeli. Ato mund të zbulohen dhe të trajtohen duke i eliminuar nga grupi i të dhënave, duke i transformuar ato, ose duke i zëvendësuar me një vlerë më përfaqësuese, siç është median.

Trajnimi dhe Testimi

Pasi të kemi pastruar të dhënat, grupi i të dhënave të simptomave të sëmundjeve ndahet në mënyrë 50-50, që do të thotë se 50% e të dhënave përdoren për grupin e të dhënave të trajnimit, dhe 50% për të testuar performancën e çdo modeli. Grupi i të dhënave të testimit përdoret për të vlerësuar modelet e trajnuara në të dhëna që nuk janë parë gjatë trajnimit.

Grupi i të dhënave të trajnimit ndahet më tej në 70-30, që do të thotë se 70% e të dhënave të trajnimit përdoren për të trajnuar çdo model, dhe 30% për të shërbyer si grup validimi. Grupi i të dhënave të validimit përdoret për të konfigurimin e hiperparametrave për çdo model dhe për të krahasuar modelet gjatë trajnimit. Përdorimi i një grupi validimi e lejon grupin e të dhënave të testimit të mbetet i paqartë për modelet tona gjatë trajnimit.

Eliminimi i Veçorive të Panevojshme

Siç është përmendur më parë, **Eliminimi i Veçorive të Përsëritura (RFE)** është një metodë e përzgjedhjes së veçorive në Python që ndihmon në përzgjedhjen e veçorive më të mira nga një grup të dhënash të dhënë. Duke eliminuar përherë veçoritë më pak të rëndësishme, RFE ndihmon në përmirësimin e performancës së modelit duke reduktuar mbipërputhjen dhe duke rritur përgjithësimin.

Në zbatimin tonë, konfigurëm një model RFE me një klasifikues **Random Forest** si estimues për shkak të aftësisë së tij për të zgjedhur veçoritë më të rëndësishme. Nga 132 veçori, ne zgjedhim 95 veçoritë më të rëndësishme bazuar në rëndësinë e tyre në modelin Random Forest.

Pasi trajnuam modelin tonë RFE duke përdorur grupin tonë të të dhënave të trajnimit, grupet e të dhënave të trajnimit, validimit, dhe testimit u transformuan

për të treguar vetëm kolonat e veçorive të zgjedhura. Grupi i të dhënave të transformuar të trajnimit përdoret më pas për të trajnuar modelet **Pemë Vendimmarrëse, Gradient Boosting, Support Vector Machine**, dhe **Naïve Bayes**. Në fund, modelet tona të trajnuara vlerësohen në grupin e të dhënave të transformuar të validimit për të kontrolluar konfigurimet e mundshme të hiperparametrave që shmangin mbipërputhjen dhe ndërhyrjen e zhurmave.

Rezultate

Pasi u mblodhën të dhënat e trajnimit, u zhvillua një chatbot bazuar në Rasa. Pasi përfundoi procesi i zhvillimit të aplikacionit të chatbot-it, u kryen teste të ndryshme duke përdorur një gamë të gjerë të inputeve të përdoruesve. Rezultatet e eksperimenteve janë shfaqur në Tabelën 3 dhe Tabelën 4.

Tabela 3 tregon rezultatin e saktësisë së modeleve tona të trajnuara në të dhëna të testimit të papara më parë. Të gjitha modelet e mësimit makinerik treguan rezultate të larta të saktësisë kur u përdor algoritmi i Eliminimit të Karakteristikave Recursiv. Nga katër modelet që kemi zgjedhur, modeli i Makinës së Vektorëve Mbështetës tregoi rezultatin më të lartë të saktësisë me 100%. Ndërsa modeli i Pemës Vendimmarrëse dha rezultatin më të ulët të saktësisë me 97.93%.

| Algoritmi | Saktesia % |
|-------------------------------|------------|
| Decision Tree | 97.93% |
| Gradient Boosting | 99.63% |
| Naïve Bayes | 99.84% |
| Support vectir machine | 100% |

Tabela 3: Rezultatet e saktësisë së modeleve të trajnuara duke përdorur të dhënat e testimit

| Algoritmi | Parashikimi | Semundja |
|-------------------------------|---------------------------------|---------------------|
| Decision Tree | Ethe Dengue | Infeksion kerpudhor |
| Gradient Boosting | Infeksion bacterial Impetigo | Infeksion kerpudhor |
| Naïve Bayes | Infeksion kerpudhor | Infeksion kerpudhor |
| Support vectir machine | Infeksion kerpudhor | Infeksion kerpudhor |

Tabela 4: Parashikimet e modeleve të trajnuara për një mostër të panjohur të infeksionit kërpudhor

Ne vlerësuam modelet tona të trajnuara në një mostër të panjohur më parë që përmbante një grup më të larmishëm të karakteristikave për klasën e infeksionit kërpudhor, konkretisht arna diskromike, shpërthime të lëkurës nodale, kruarje dhe skuqje të lëkurës. Mostra e re për klasën e infeksionit kërpudhor përmban karakteristikat e mëposhtme: kruarje, skuqje të lëkurës, njolla të kuqe në trup, histori familjare dhe plagë të kuqe rreth hundës.

Siç tregohet në Tabelën 4, modelet Pema Vendimmarrëse dhe Gradient Boosting nuk arritën të parashikonin me sukses mostrën e re si një infeksion kërpudhor, pavarësisht performancës së tyre të lartë në të dhënat e testimit. Kjo sugjeron mundësinë e mbingarkimit të të dhënave të trajnimit, edhe pse u zbatua selektimi i karakteristikave me RFE. Në të kundërt, modelet e Makinës së Vektorëve Mbështetës dhe Naïve Bayes parashikuan me sukses mostrën e re si një infeksion kërpudhor. Performanca e këtyre modeleve në të dhëna të papara më parë tregon se të dyja modelet janë të afta të identifikojnë modelet e nënkuptuara në grupin tonë të të dhënave.

Referenca

1. A.N.V.K Swarupa; V.Hema Sree; S. Nookambika; Y. Kiran Sai Kishore; U. Ravi Teja. (2021). Disease Prediction: Smart Disease Prediction System using Random Forest Algorithm. 2021 IEEE International Conference on Intelligent Systems, Smart and Green Technologies (ICISSGT). Visakhapatnam, India: IEEE.
2. Ankita Tyagi, Ritika Mehra. (2019). Interactive Thyroid Disease Prediction System Using Machine Learning Technique. 2018 Fifth International Conference on Parallel, Distributed and Grid Computing (PDGC).
3. Gupta, A. (2022). Prediction of Diseases Using Different Machine Learning Approaches. 3rd International Conference on Intelligent Engineering and Management (ICIEM).
4. J. Nirmal Jothi, S. V. (2022). AI Based Humanoid Chatbot for Medical Application. 3rd International Conference on Smart Electronics and Communication (ICOSEC).
6. Luba, P. (2020, May 14). Healthcare Chatbots Can Help With the Pandemic. Retrieved from Towards Data Science: <https://towardsdatascience.com/healthcare-chatbots-can-help-with-the-pandemic-bcc07fc606c9>
7. Mridha, K. (2021). Early Prediction of Breast Cancer by using Artificial Neural Network and Machine Learning Techniques. 10th IEEE

- International Conference on Communication Systems and Network Technologies (CSNT). IEEE.
8. Philip Indra Prayitno, Reinhart Perbowo Pujo Leksono, Fernando Chai, . (2021). Health Chatbot Using Natural Language Processing for Disease Prediction and Treatment. 1st International Conference on Computer Science and Artificial Intelligence (ICCSAI).
 9. Prakhar Srivastava, Nishant Singh. (2020). Automatized Medical Chatbot (Medibot). International Conference on Power Electronics & IoT Applications in Renewable Energy and its Control (PARC).
 10. Rohit Binu Mathew; Sandra Varghese; Sera Elsa Joy; Swanthana Susan Alex. (2019). Chatbot for Disease Prediction and Treatment Recommendation using Machine Learning. 3rd International Conference on Trends in Electronics and Informatics (ICOEI).
 11. Yildirim, S. (2020). Gradient Boosted Decision Trees-Explained. Towards Data Science.
 12. Zahrul Jannat, Md. Shymo
 13. n Islam, Mst. Kamrun Naher Chumki. (2022). Thyroid Disease Prediction based on Feature Selection and Machine Learning. 25th International Conference on Computer and Information Technology (ICCIT).

NDIKIMI I KURSIT TË KËMBIMIT VALUTOR NË EKONOMINË SHQIPTARE NË VITIN 2023 DHE 2024

Doc.Dr.Gazmend Beshi,

Doktor i Shkencave Ekonomike: g.beshi@eust.edu.mk

Abstract

Ky studim synon të analizojë ndikimin e kursit të këmbimit valutor në ekonominë shqiptare gjatë viteve 2008-2024, veçanërisht për vitet 2023-2024. Meqenëse kursi i këmbimit është një faktor kyç në tregtinë ndërkombëtare dhe stabilitetin ekonomik, ky kërkim përqendrohet në vlerësimin e efekteve të ndryshimeve të tij mbi disa aspekte kryesore të ekonomisë shqiptare, përfshirë inflacionin, eksportet, importet, dhe investimet e huaja.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka përjetuar luhatje të konsiderueshme të kursit të këmbimit, kryesisht si rezultat i faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm, përfshirë krizën globale ekonomike dhe politike. Kjo ka ndikuar direkt në kostot e importit dhe eksporteve, si dhe në nivelin e inflacionit në vend. Përmes analizës së të dhënave makroekonomike dhe statistikore, ky studim eksploron sesi këto ndryshime kanë ndikuar sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe çfarë politikash mund të adoptohen për të minimizuar efektet negative.

Studimi përdor metodologji të përziera, duke kombinuar analiza kuantitative dhe kualitative. Të dhënat kryesore janë mbledhur nga institucionet financiare vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë Bankën e Shqipërisë, INSTAT dhe organizatat ndërkombëtare si FMN dhe Banka Botërore. Gjithashtu, janë kryer intervista me ekspertë të fushës për të ofruar një perspektivë më të gjerë mbi ndikimet e ndryshme të kursit të këmbimit.

Rezultatet paraprake tregojnë se një rritje e vlerës së monedhës vendase (LEK) ka tendencë të ulë konkurrueshmërinë e eksporteve shqiptare, ndërsa një zhvlerësim i saj rrit kostot e importeve dhe inflacionin. Në të njëjtën kohë, ndryshimet në kursin e këmbimit kanë një ndikim të ndjeshëm në investimet e huaja direkte (IHD), ku një monedhë më e qëndrueshme dhe e parashikueshme priret të tërheqë më shumë investitorë.

Në përfundim, studimi sugjeron që politika të mirëmenaxhuara të kursit të këmbimit janë thelbësore për stabilitetin ekonomik të Shqipërisë. Rekomandimet përfshijnë forcimin e politikave monetare dhe fiskale, rritjen e diversifikimit të ekonomisë dhe përmirësimin e infrastrukturës financiare për të mbështetur tregtinë dhe investimet.

Ky hulumtim kontribuon në literaturën ekzistuese duke ofruar një analizë të thelluar të sfidave dhe mundësive që ndodhen përpara ekonomisë shqiptare në kontekstin e ndryshimeve të kursit të këmbimit në vitet 2023 dhe 2024.

PREZANTIMI.

Luhatjet e kursit të këmbimit janë një fenomen i zakonshëm në ekonominë e hapura, ku tregjet ndërkombëtare dhe faktorët e brendshëm ekonomikë luajnë një rol kyç. Për Shqipërinë, si një vend me ekonomi në zhvillim dhe lidhje të forta tregtare me Bashkimin Evropian dhe rajonin, këto luhatje mund të kenë pasoja të ndjeshme. Studimi shqyrton faktorët që ndikojnë në kursin e këmbimit të lekut shqiptar (ALL) kundrejt euros (EUR) dhe dollarit amerikan (USD), si dhe efektet e këtyre luhatjeve në sektorët kryesorë të ekonomisë.

Metodologjia

Operatorët Ekonomike që përdorin në Aktivitetin e tyre në përditshmëri aspektin e veprimtarisë që lidhet me Këmbimin Valutor, do duhet të përdorin një qasje të kombinuar kuantitative dhe cilësore, konkretisht:

- Analizën nga të dhënat historike: Përfshin të dhëna mbi kursin e këmbimit, inflacionin, normat e interesit, dhe tregtinë ndërkombëtare për periudhën 2018-2024.

- Modelet ekonometrike: Përdoren për të parashikuar ndikimin e ndryshimeve në kursin e këmbimit mbi variabla të ndryshëm ekonomikë.

- Intervista me ekspertë: Konsultime me ekonomistë dhe profesionistë të sektorit bankar dhe tregtar për të kuptuar më mirë ndikimet praktike dhe për të verifikuar gjetjet e modeleve.

Në dekadën e fundit, ekonomia shqiptare ka qenë e ndikuar nga një seri luhatjesh të kursit të këmbimit të shkaktuara nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë presionet globale inflacioniste, politikat monetare të bankave qendrore të vendeve të tjera dhe zhvillimet politike rajonale. Ky studim përqendrohet në analizimin e ndikimit të këtyre luhatjeve të kursit të këmbimit të lekut (ALL) ndaj valutave kryesore si euro (EUR) dhe dollari amerikan (USD).

Metodologjia e përdorur përfshin analizën e të dhënave historike të kursit të këmbimit, intervistat me ekspertë të ekonomisë dhe financave, si dhe një shqyrtim të gjerë të literaturës ekzistuese mbi këtë temë. Modelet ekonometrike janë përdorur për të parashikuar trendet e ardhshme të kursit të këmbimit dhe për të vlerësuar ndikimet potenciale në sektorë kryesorë të ekonomisë shqiptare, si eksportet, importet, investimet e huaja dhe stabiliteti makroekonomik.


Rezultatet e këtij studimi tregojnë se luhatjet e mëdha dhe të papritura të kursit të këmbimit mund të kenë efekte negative në ekonominë shqiptare, duke rritur pasigurinë ekonomike, duke ndikuar në koston e prodhimit dhe konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare. Kursi i qëndrueshëm i këmbimit shihet si një faktor kritik për ruajtjen e një ambienti ekonomik të qëndrueshëm dhe për të nxitur rritjen ekonomike të qëndrueshme.

Sipas të dhënave zyrtare të konsultuara dhe të siguruara nga Banka e Shqipërisë, efekti i kursit të këmbimit valuator tregon se për të garantuar një qasje profesionale ndaj këtij fenomeni do duhet të koordinohet politika monetare dhe fiskale për të menaxhuar efektet e luhatjeve të kursit të këmbimit. Gjithashtu, nëpërmjet studimit sugjerohen masa për të rritur rezistencën e ekonomisë shqiptare ndaj tronditjeve të jashtme financiare, duke përfshirë diversifikimin e burimeve të të ardhurave dhe përmirësimin e mjedisit të investimeve.

Konkretisht, në studim janë analizuar të dhënat e luhatshmërisë së Kursit të këmbimit Valutor prej Vitit 2008 dhe deri 2023, studimi ka qasje dhe përcakton Metodologji, jep Rezultate dhe Diskuton për efektet e shumfishta që Kursi i këmbimit Valutor afekton Ekonominë shqiptare.

Monedha jonë kombëtare, Leku, ka shfaqur një rritje të konsiderueshme të vlerës së saj kundrejt euros dhe monedhave të tjera. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në vitin 2023 ishte në nivelin 108.7 lek/euro, nga mesatarisht 119.0 lek/euro gjatë vitit 2022. Kjo ecuri nënkupton një forcim vjetor të lekut prej 8.7%.

Grafiku 1. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut ndaj euros, në nivel (majtas) dhe si ndryshim vjetor (në %, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Arsyet dhe pasojat e këtij fenomeni janë diskutuar gjerësisht midis analistëve të ekonomisë dhe grupeve të interesit. Në tërësi, diskutimi profesional përqendrohet në dy tema kryesore.

Së pari, nëse forcimi i kursit të këmbimit bazohet në përmirësime reale dhe strukturore të ekonomisë sonë, apo shpjegohet me arsye të tjera, ku si hipotezë primare sugjerohet prania e flukseve të larta hyrëse të euros informale.

Së dyti, nëse ky zhvillim duhet pranuar si lëvizje drejt një ekuilibri të ri dhe më të përshtatshëm në aspektin makroekonomik, apo nëse ai është një zhvillim i dëmshëm për ekonominë dhe tregjet financiare shqiptare.


Nga të dhënat e paraqitura në Grafikon si më sipër cituar jap në këtë studim konceptet që lidhen me:

Arsyet e forcimit të kursit të këmbimit të lekut.

Në një regjim të lirë të kursit të këmbimit, sikundër aplikohet në Shqipëri, dinamika e kursit është funksion i raportit të kërkesës dhe ofertës për valutë. Në mungesë të ndërhyrjeve të autoriteteve publike, ky raport diktohet nga forcat e tregut dhe i përgjigjet trendeve ekonomike e financiare të vendit. I parë në këtë kontekst, forcimi i kursit të këmbimit të lekut gjatë vitit 2023 sugjeron praninë e një teprice oferte valute në tregun e brendshëm valutator. Analiza e informacionit të disponuar tregon se kjo tepricë është diktuar nga përmirësimi i fortë dhe i vazhdueshëm i bilancit të shkëmbimeve tregtare e financiare me jashtë gjatë dy viteve të fundit.

Në një këndvështrim të përgjithshëm, teprica e ofertës valutore në tregun e brendshëm (Grafikët 2 dhe 3) diktohet nga rënia e shpejtë e deficitit tregtar dhe atij të llogarisë korrente gjatë viteve të fundit (Grafiku 2) dhe përmirësimi i raportit të financimit të tij me investime të huaja direkte (Grafiku 3). Në 9-mujorin e parë të vitit 2023, llogaria korrente ka rezultuar për herë të parë në histori në suficit (Grafiku 2, paneli majtas). Në raport ndaj PBB-së, suficiti korrent vlerësohet në 0.2%, ndërkohë që për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, deficitin korrent ishte në masën 4.7% ndaj PBB-së. Ky zhvillim përfaqëson një përmirësim të shpejtë e të paprecedentë të bilancit të jashtëm të ekonomisë shqiptare, të nxitur nga përmirësimi strukturor i bilancit të shkëmbimeve tregtare në mallra dhe shërbime (Grafiku 2, paneli djathtas).

Grafiku 2. Ecuria vjetore e bilancit të llogarisë korrente dhe e bilancit tregtar (në % të PBB-së)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Paralelisht me përmirësimin e bilancit tregtar dhe atë të llogarisë korrente, investimet e huaja direkte kanë pasur një trend të qartë rritës gjatë viteve të fundit. Për pasojë, raporti i tyre ndaj deficitit të llogarisë korrente ka pasur trend të vazhdueshëm rritës (Grafiku 3, paneli majtas). Vlera pozitive e këtij raporti tregon se flukset valutore të gjeneruara nga investimet e huaja direkte (hyrje valute) janë më të larta se deficitin e llogarisë korrente (dalje valute). Kjo dinamikë rezulton në një tepriçë oferte në tregun vendas dhe një mbiçmim të kursit të këmbimit. Gjithashtu, ky grafik sugjeron dhe dy konkluzione paraprake:

1. Shqipëria ka pasur historikisht një tepriçë hyrjesh valutore në vend, çka dikton dhe një trend gradual forcimi të kursit të këmbimit.

2. Momentet e rritjes së shpejtë të këtij raporti (periudha 2017 – 2018 dhe 2022 – 2023) përkojnë dhe me periudhat e forcimit të shpejtë të kursit të këmbimit të lekut ndaj euros.

Grafiku 3. Deficiti i llogarisë korrente dhe IHD neto (majtas, në mln Euro) dhe raporti i tyre (djathtas, në %)




Shënim: Për çdo tregues, të dhënat janë ndërtuar në formën e mesatares rrëshqitëse të katër tremujorëve të fundit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në një këndvështrim më të detajuar, trendi i dukshëm i përmirësimit të deficitit të llogarisë korrente gjatë viteve të fundit shënon një përmirësim të rëndësishëm strukturor të ekonomisë shqiptare. Ky deficit ka zbritur nga një nivel mesatar prej 10% të PBB-së në gjysmën e parë të dekadës së shkuar, rreth një niveli mesatar prej 3.5% në vitet e fundit (Grafiku 4, paneli majtas). Për më tepër, ky përmirësim strukturor ka pasqyruar reduktimin e deficitit të eksporteve neto, rrugëtim i cili e ka zbritur këtë deficit nga një mesatare prej rreth 20% të PBB-së në gjysmën e parë të dekadës së kaluar, në një nivel prej më pak se 4.5% të PBB-së në nëntëmujorin e parë të vitit 2023.

Reduktimi i deficitit të eksporteve neto gjatë kësaj periudhe është diktuar nga rritja e eksporteve të mallrave e shërbimeve (Grafiku 4, paneli djathtas). Eksportet shqiptare janë rritur nga një nivel mesatar prej rreth 28% të PBB-së në gjysmën e parë të dekadës së kaluar, në 39% të PBB-së në dy vitet e fundit.


Grafiku 4. Faktorët përcaktues të deficitit të llogarisë korrente (djathtas, në % të PBB-së) dhe të deficitit tregtar (majtas, në % të PBB-së)



Shënim: Për çdo tregues, të dhënat janë ndërtuar në formën e mesatares rrëshqitëse të katër tremujorëve të fundit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në analizë të fundit, reduktimi i deficitit tregtar dhe i deficitit të llogarisë, rritja e tepricës së valutës në treg dhe forcimi i kursit të këmbimit, janë diktuar nga trendi rritës i eksporteve shqiptare dhe dinamika në kohë e tyre. Ky trend filloi të bëhet i dukshëm gjatë periudhës 2016 – 2018, u ndërpre nga goditjet e tërmetit dhe të pandemisë dhe u rishfaq më i fortë gjatë dy viteve të fundit. Kjo dinamikë ilustron edhe në Grafikon 5; paneli i majtë i tij pasqyron ecurinë e eksporteve ndaj PBB-së dhe paneli djathtas ndryshimet vjetore të tyre. Të dy këta tregues sugjerojnë një rritje të shpejtë të eksporteve totale të mallrave e shërbimeve gjatë dy viteve të fundit. Po ashtu, ky grafik sugjeron se rritja e eksporteve është diktuar, në masën më të madhe, nga rritja e eksportit të shërbimeve, ku turizmi zë vendin parësor, dhe më pak nga rritja e eksportit të mallrave.

Grafiku 5. Ecuria e eksporteve, si raport ndaj PBB-së (majtas, në %) dhe si ndryshim vjetor (djathtas, në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke u fokusuar në vitin 2023, arsyet e forcimit të shpejtë të kursit të këmbimit mbështeten tek përmirësimi i shpejtë dhe më i fortë se pritjet, i bilancit të shkëmbimeve tregtare e financiare të Shqipërisë me jashtë. Në këtë drejtim, vërejmë sa më poshtë:

Llogaria korrente shënoi suficit, për herë të parë në historinë ekonomike post-tranzicion. Ky suficit, i vlerësuar në nivelin 0.2% të PBB-së për 9-mujorin e parë të vitit 2023, tregon një përmirësim të dukshëm kundrejt deficitit prej 5.9% të PBB-së të regjistruar në vitin 2022. Arsyeja kryesore e përmirësimit të deficitit lidhet me rritjen e lartë të flukseve hyrëse të turizmit në vend. Për 9-mujorin e parë të vitit, të ardhurat nga turizmi i sollën ekonomisë shqiptare një fluks valutor prej 3.2 miliardë eurosh, me rritje vjetore 46.6%. Ndikime të mëtejshme pozitive kanë ardhur nga rritja e remitancave, të cilat ishin rreth 676 milionë euro në 9-mujorin e parë, me rritje vjetore 14.2%.

Investimet e huaja direkte qëndruan në nivele të larta, të vlerësuara në rreth 1.08 miliard euro në 9-mujorin e parë, duke shënuar një rritje vjetore prej 10.6%.

Kjo analizë mbështet pikëpamjen e shprehur nga Banka e Shqipërisë se forcimi i kursit të këmbimit buron nga përmirësimi i bilancit të shkëmbimeve tregtare e financiare me jashtë, çka ka rezultuar në rritje të ofertës së valutës në tregun e brendshëm valutor.

Megjithatë, kjo pikëpamje mbështetet edhe nga dy konsiderata të tjera.

Së pari, analizat tona ekonometrike, të bazuara në modelin e paritetit të pambuluar të normave të interesit (PPNI), si pjesë integrale e modelit tonë të analizës dhe parashikimit, sugjerojnë se forcimi i kursit të këmbimit të lekut ndaj euros është diktuar në masën më të madhe nga forcimi i kursit real të këmbimit, sikundër ilustrohet në Grafikon 5. Trendi forcues i kursit real të këmbimit është një dukuri e njohur për vendet në zhvillim, si Shqipëria, në një fazë konvergjence me partnerë të mëdhenj e më të zhvilluar tregtarë, si Bashkimi Evropian. Në një këndvështrim teorik, forcimi i kursit real të këmbimit sugjeron një tendencë konvergjence të pagave e të çmimeve midis ekonomisë shqiptare dhe asaj të Eurozonës. Ky është një zhvillim i mirëpritur, për sa kohë ai mbështetet në rritje të produktivitetit në ekonomi dhe nuk sinjalizon një rënie të përgjithshme të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare. Në këtë kontekst, vlen të theksohet se trendi rritës i eksporteve, i mbështetur nga rritja e turizmit si pasojë e kërkesës më të lartë në këtë sektor, përfaqëson dhe një trend rritës të produktivitetit të ekonomisë, për sa kohë sektori i turizmit ofron vlerë të shtuar dhe paga më të larta se mesatarja e ekonomisë shqiptare.

Grafiku 6. Ndikimi i faktorëve realë e financiarë në ecurinë e kursit të këmbimit lek/euro




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në të njëjtin kah me kursin real të këmbimit ka vepruar edhe rritja e besimit në monedhën tonë kombëtare, e kapur në grafik nga reduktimi i primeve të rrezikut, të cilët operatorët ekonomikë kërkojnë për të ruajtur kursimet e tyre në monedhën tonë kombëtare. Nga ana tjetër, diferenca e normave të interesit midis lekut dhe euros, e cila pasqyron dhe politikat monetare respektive të Bankës së Shqipërisë dhe të Bankës Qendrore Evropiane, ka një efekt të papërfillshëm, madje të kahut të kundërt në forcimin e lekut.

Së dyti, analiza e të dhënave të aktivitetit të tregut valutor gjatë vitit 2023 nuk ofron asnjë indikator të shmangies së funksionimit të këtij tregu nga normaliteti. Në tërësinë e tyre, vëllimet e transaksioneve në tregun e brendshëm valutor janë në linjë me vëllimin e tregtisë së jashtme në mallra e shërbime. Sikundër ilustrohet në Grafikon 6, ky konkluzion është i vërtetë si për kahun e lëvizjes së këtyre dy treguesve, ashtu edhe për faktin se vëllimi i këmbimeve në tregun valutor ka qenë e mbetet poshtë vëllimit të raportuar të tregtisë së jashtme në mallra e shërbime. Në këtë kontekst, analizat tona nuk evidentojnë burime të tjera të cilat kanë ndikuar në mënyrë materiale ecurinë e tregut të brendshëm valutor, përpos atyre të tregtisë së jashtme.

Grafiku 7. Vëllimi i shkëmbimeve në tregun e brendshëm valutor (vëllimi i transaksioneve midis bankave dhe zyrave të këmbimit me klientët e tyre, në mln euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Së treti, forcimi i kursit të këmbimit nuk është diktuar nga shkalla e lartë e euroizimit të ekonomisë. Nga njëra anë, është me vend të theksohet se, përballë një oferte të rritur valute në ekonominë shqiptare, një politikë më agresive drejt dekurajimit të përdorimit të monedhës euro në favor të asaj kombëtare do të rezultonte në një forcim më të shpejtë të kursit të këmbimit, dhe jo e kundërta.

Rreferuar sa më sipër nga të dhënat statistikore të siguruar nga Burime Zyrtare”Banka e Shqipërisë”

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për të pasur një efekt pozitiv në Ekonomi dhe që lidhet me luhatshmërinë e Kursit të këmbimit Valutor, Vendimarrësit në Sektorin Financiar, do të duhet të fokusohen në:

1. Forcimi i Politikës dhe Rezervës Monetare.

2. Forcimi i Politikës Fiskale

3. Diversifikimi i Ekonomisë.

4. Përmirësimi i Infrastrukturës Financiare si Instrument mbështetës për Tregëtinë dhe Investimet.

5. Në Analiza të detajuara dhe të dhëna historike.

6. Të përdorin me analizë profesionale Modelin Ekonometrik, e cila është në gjendje për të parashikuar trendet e ardhshme të kursit të këmbimit dhe për të vlerësuar ndikimet potenciale në sektorë kryesorë të ekonomisë shqiptare, si eksportet, importet, investimet e huaja dhe stabiliteti makroekonomik.

7. Të mbështeten fort në këshilla dhe sugjerime të ofruar në mënyrë periodike nga Ekspertët e fushës në kombinim të plotë me të dhënat që përfitojnë në Tregun Valutor në përditshmëri.

8. Në masa konkrete për të rritur rezistencën e ekonomisë shqiptare ndaj tronditjeve të jashtme financiare, duke përfshirë diversifikimin e burimeve të të ardhurave dhe përmirësimin e mjedisit të investimeve.

9. Në një politikë më agresive drejt dekurajimit të përdorimit të monedhës euro në favor të asaj kombëtare do të rezultonte në një forcim më të shpejtë të kursit të këmbimit, dhe jo e kundërta.

REFERENCAT

1. Banka Qëndrore e Shqipërisë, Shkurt.2024: https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/
2. Instat <http://www.instat.gov.al>

CREATING PERSONALIZED LEARNER PROFILES IN E-LEARNING ENVIRONMENT USING AI TECHNIQUEA: A COMPARATIVE ANALYSIS

Dr. Frida Gjermeni

Faculty of Information Technology, “Aleksander Moisiu” University of Durres

MSc. Uendi Cerma

Faculty of Information Technology, “Aleksander Moisiu” University of Durres

Abstract

The advent of artificial intelligence (AI) has revolutionized various industries, and education is no exception. One of the most promising applications of AI in education is the creation of personalized learning environments. This paper explores how AI can be leveraged to develop comprehensive learner profiles that cater to individual needs, preferences, and learning styles, thereby enhancing the overall e-learning experience. We discuss the key components of a learner profile, in an interactive e-learning environment; the AI techniques employed for profile creation. A comparative analysis on strengths and weaknesses of AI techniques is demonstrated and the potential benefits and challenges associated with this approach.

Introduction

Personalized learning, which tailors educational content and experiences to individual learners, has long been recognized as a powerful strategy for improving learning outcomes. (6)However, traditional personalized learning approaches often rely on manual methods that are time-consuming and may not capture the full complexity of learner profiles. AI offers a more efficient and effective solution by automating the process of learner profile creation and enabling real-time adaptation of learning materials.(4) In the next sections we discuss about the interaction that the learner characteristics in an interactive e-learning environment, different AI techniques that can be used, a comparative analysis of strengths and weaknesses, conclusions and future work.(11)

Understanding Learner-Environment Interaction

